



JUSTICIA

**Revistë shkencore juridike e
prokurorëve të sapo
emëruar të Programit të
Trajnimit Fillestar
2016/2018 në Akademinë e
Drejtësisë**

JUSTICIA

Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar

Viti VI, Nr 6/2016-2018

Prishtinë, 2018

Botues

Akademia e Drejtësisë

ANËTARËT E REDAKSISË

Dr. Fejzullah Hasani, Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës
Nebojsa Boriçiç, Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës
Mr. Sc. Muhamet Rexha, Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës
Laura Pula, Prokurore në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit
Dr. Osman Ismaili, Profesor në Fakultetin Juridik/Universiteti i Prishtinës
“Hasan Prishtina”
Dr. Haxhi Gashi, Dekan në Fakultetin Juridik/Universiteti i Prishtinës
“Hasan Prishtina”
Idanin Ismajli, Prokuror në Prokurorinë e Apelit
Mr. Sc. Afrim Shala, Gjyqtar i Gjykatës Themelore Gjilan
Valon Kurtaj, Drejtor Ekzekutiv në Akademinë e Drejtësisë

Redaktor teknik
Luljetë Hetemi, juriste e diplomuar

Dizajni dhe radhitja kompjuterike:

Akademia e Drejtësisë

Publikuar nga Akademia e Drejtësisë

© Akademia e Drejtësisë 2018, Të gjitha të drejtat e rezervuara

Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë

Pikëpamjet e autorëve nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Akademisë së Drejtësisë.

Tabela e përmbajtjes

Fjala hyrëse..... 5

Arian Xhema

BASHKPUNIMI I PROKURORIT TE SHTETIT ME POLICINË 6

Armend Zenelaj

PARABURGIMI DHE APLIKIMI I TIJ NË PRAKTIKË 25

Besart Mustafa

AKTAKUZA-FAZA E NGRITJES SË AKTAKUZËS DHE DEKLARIMIT. 47

Dren Paca

AKTGJYKIMI..... 65

Edina Jupolli

**MARRËVESHJA MBI PRANIMIN E FAJËSISË SIPAS LEGJISLACIONIT
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS 83**

Enis Gashi

NOCIONI DHE RËNDEsia E FAJIT NË TË DREJTËN PENALE 97

Ilir Morina

**DISA ASPEKTE PRAKTIKE TË TRAJTIMIT TË VEPRËS PENALE:
RREZIKIMI I TRAFIKUT PUBLIK NGA PROKURORI I SHTETIT 120**

Iliriana Çollaku-Tafa

VEPRA PENALE NXITJA E URREJTJES, PËRÇARJES OSE MOS DURIMIT KOMBËTAR, RACOR, FETAR APO ETNIK	135
--	------------

Jehona Grantolli

ASPEKTI JURIDIKO-PSIKOLOGJIK I KRIMIT DHE DËNIMIT NË KOSOVË	156
--	------------

Mimoza Syla

BASHKËKYERJA SI FORMË E BASHKËPUNIMIT NË KRYERJEN E VEPRËS PENALE.....	170
---	------------

Milot Krasniqi

NDËRMJETËSIMI NË PROCEDURË PENALE PËR TË MITUR	196
---	------------

Shpend Binaj

MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT NË PROCEDURË PENALE ME THEKS TË VEÇANTË-DORËZANIA	214
---	------------

Fjala hyrëse

Të nderuar lexues!

Ndjehem i privilegjuar të paraqesë para jush numrin e gjashtë të revistës juridike shkencore “Justicia” e cila publikohet nga Akademia e Drejtësisë. Kjo revistë ka për synim të pasuroj literaturën juridike dhe të nxisë mendimin kritik ligjor në funksion të mbështetjes së bartësve të funksionit gjyqësor dhe prokurorial.

Revista Justicia është revistë ekskluzive e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapo emëruar, të cilët ndjekin Programin e Trajnimit Fillestar në Akademinë e Drejtësisë. Publikimi i kësaj reviste tashmë është bërë traditë e çdo gjenerate në këtë program, duke zënë vend të çmueshëm në botimet e Akademisë.

Autorët e punimeve në këtë revistë janë prokurorët e shtetit të sapoemëruar, të cilët kanë vijuar Programin e Trajnimit Fillestar për dymbëdhjetë muaj me radhë, duke ndjekur trajnimin teorik në Akademinë e Drejtësisë, si dhe njëkohësisht edhe programin praktik në Prokuroritë Themelore përkatëse ku ata janë emëruar.

Revista përmban punime të cilat prekin aspektin material dhe procedural të fushës penale, duke vënë në pah praktikën gjyqësore të mbështetur nga hulumtimi dhe argumentimi shkencor, me ç ‘rast japin kontributin e tyre duke sjellë perspektiva të reja për çështje konkrete ligjore.

Kontribut të rëndësishëm në cilësinë e kësaj reviste ka pasur edhe Këshilli i Redaksisë së revistave të Akademisë, i cili ka aplikuar kritere dhe standarde të larta për hartimin e punimeve e deri në publikimin e tyre në këtë revistë.

Shpresojmë që ky numër i revistës “Justicia” të ofrojë informacione të duhura për çështje konkrete dhe të jetë lehtësuese në punën e përditshme të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor.

Me respekt,

Valon Kurtaj

Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë

*Arijan Xhema**

BASHKËPUNIMI I PROKURORIT TË SHTETIT ME POLICINË

Abstrakt

Qëllimi i punimit të kësaj teme është që të sqarohet roli dhe bashkëpunimi i prokurorit të shtetit me policinë sipas Kodit të Procedurës Penale¹ dhe ligjeve tjera. Përmes këtij punimi do të sqarohet se cilat janë raportet e prokurorit të shtetit me policinë prej momentit të paraqitjes së ndonjë vepre penale, duke vazhduar me raportet rreth vendit të ngjarjes, mënyrave të hetimit dhe zbulimit, kontrollimit të personave dhe ndërtesave, fushat e intervistimit me fokus në fazën që prokurori i beson policisë intervistimin, arrestimi dhe ndalimin policor, koordinimi i punës të cilën e kryen policia bashkë me udhëzimet përkatëse gjatë veprimeve procedurale, si dhe mbikëqyrja e punës së policisë në grumbullimin dhe ruajtjen e provave.

Prokurori i shtetit koordinon punën të cilën e kryen policia si dhe jep udhëzime përkatëse gjatë veprimeve procedurale, mbikëqyrë punën e policisë në fazën parapenale, bën kërkesë për grumbullimin e informatave të nevojshme për kompletimin e rastit dhe ruajtjen e provave.

Për përgatitjen e këtij artikulli kemi përdorur metodën juridike-normative dhe atë të analizës. Si përfundim kryesor nga ky artikull del se bashkëpunimi ndërmjet policisë dhe prokurorisë së shtetit në procedurë penale është jetik dhe garanton se çështja penale do të zgjidhet në mënyrë të plotë dhe të drejtë.

Fjalët kyçe: policia, prokurori i shtetit, bashkëpunimi, procedura penale.

* Arjan Xhema, Prokuror i sapoemëruar në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

¹ Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13 dhjetor 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

Hyrje

Bashkëpunimi i prokurorit të shtetit dhe policisë është lidhur ngushtë në lidhje me parandalimin, hetimin dhe zbulimin e veprave penale të formave të ndryshme të kriminalitetit, si terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit me njerëz, narkotikeve, etj. Ky bashkëpunim realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi edhe përmes hartimit dhe implementimit të strategjive të përbashkëta.

Ligji i Policisë dhe KPP janë ligjet bazike dhe kryesore të cilat e përcaktojnë qartë bashkëpunimin në mes prokurorit të shtetit dhe policisë. Policia zbaton urdhrat dhe udhëzimet e lëshuara në mënyrë të ligjshme nga prokurori ose gjyqtari kompetent.²

Parandalimi, hetimi dhe zbulimi i një veprave penale nuk është punë e lehtë, e cila nuk mund të arrihet pa një bashkëpunim të ndërsjellë nga të gjithë faktorëve të përfshirë në proces, e posaçërisht veprimet dhe bashkëpunimi i prokurorit të shtetit me policinë, të cilëve nuk mjafton vetëm baza ligjore, e cila pa veprime konkrete është e pamjaftueshme në këtë drejtim.

Sikurse edhe në çdo sferë të jetës, edhe ndërveprimi në mes prokurorit të shtetit dhe policisë në luftimin e kriminalitetit është një hallkë e ndjeshme e cila duhet të funksionojë mirë në mënyrë që të arrihen caqet e dëshiruara.

Komunikimi dhe bashkëpunimi cilësor në mes të policisë dhe prokurorëve janë elemente të domosdoshme për të arritur një luftim efektiv dhe efikas të krimit. Në funksion të zbatimit të ligjit, prokurori duhet të ketë kontakte të pandërprera me policinë, qoftë duke përdorë masa preventive, duke bërë parandalimin e kryerjes së veprës penale, dhe nga momenti kur policia e njofton për kryerjen e një veprave penale dhe të kërkojë nga policia materiale dhe provat e nevojshme për të përmbush detyrimet ligjore.

1. Bashkëpunimi i policisë me prokurorin e shtetit

Siç është cekur më parë, KPP dhe Ligji për policinë janë ligjet kryesore që parashikojnë bashkëpunimin në mes policisë dhe prokurorit të shtetit në Kosovë. Policia bashkëpunon dhe i raporton Zyrës së Prokurorit kompetent

² Neni 6 i Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, i datës 2 mars 2012.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

për informatat lidhur me akuzat për aktivitete të dyshimta kriminale, për të cilat policia është njoftuar në pajtim me ligjin e aplikueshëm.³

Policia, duke vepruar në parandalimin dhe zbulimin e krimit i ofron prokurorit të shtetit dhe gjykatës material të nevojshëm për fillimin e procedurës penale; gjatë zhvillimit të procedurës penale ofron ndihme kriminalistike; ofron ndihmë për ekzekutimin e vendimeve; jep të dhëna nga evidencat e caktuara; në kushte të caktuara ligjore dhe nën mbikëqyrjen e prokurorit të shtetit policia kryen edhe veprime hetimore.⁴

Hetimet policore mund të fillohen nga zyrtari i policisë në pajtim me nenet 69-83 të KPP-së. Policia heton veprat penale në pajtim me nenin 70 të këtij Kodi dhe ia raporton ato prokurorit të shtetit sa më shpejt që të jetë e mundur. Prokurori i shtetit dhe policia punojnë bashkërisht gjatë veprimeve fillestare nga neni 70 të këtij Kodi. Pas autorizimit për zbatimin e masës nga neni 84⁵ apo pas fillimit të procedurës penale nga neni 102 i këtij Kodi, prokurori i shtetit drejton dhe mbikëqyr punën e policisë apo organit tjetër që zbaton hetimin penal. Prokurori i shtetit ka qasje në të gjitha informatat përkatëse të hetimit që policia ka në posedim gjatë veprimeve fillestare.⁶

Ndryshimet që janë bërë në KPP kanë vënë në pah faktin se tani hetimet i zhvillon prokurori i shtetit, hetime këto të cilat paraprihen nga hetimet policore, të cilat i bënë policia gjithmonë e koordinuar me prokurorin e shtetit, i cili nga fillimi i drejton dhe e mbikëqyr punën e policisë. Së pari, roli i prokurorit dhe i policisë ka ndryshuar, ashtu që policisë i jepet më shumë autonomi gjatë fazës fillestare të zbulimit të krimit.

Policia ka një autonomi të caktuar për ndërmarrjen e disa hapave fillestarë në hetimin e veprave penale sipas neneve 69-83 të KPP. Sipas nenit 69 paragrafi 2 të KPP, prokurori i shtetit dhe policia punojnë së bashku gjatë këtyre hapave fillestarë për të përcaktuar nëse duhet të fillohet një procedurë penale.⁷ Disa aktivitete hetimore policia i ndërmerr me vetiniciativë duke u bazuar edhe në autorizimet që dalin nga ligji për policinë.

Neni 70 i KPP, rregullon veprimtarinë e policisë para fillimit të procedurës penale, qëllimi i së cilës, në rend të parë, është që në rast të dyshimit se është

³ Neni 6 i Ligji nr.04/L-076 për Policinë.

⁴ Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2016, faqe 153.

⁵ Neni 84 i KPP parashikon masat e ndërmarra para fillimit të procedurës penale.

⁶ Neni 69 paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 i KPP.

⁷ Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë, 2013, faqe 3.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

kryer vepër penale, e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, të konstatohet nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi konkret ka kryer vepër penale. Nga ana tjetër, nëse është e nevojshme, ndaj personit për të cilin ekziston dyshimi i arsyeshëm, të ndërmerren disa masa shtrëngimi, të cilat i kërkon interesi i procedurës penale të ardhshme. Policia ka për detyrë të angazhohet në zbulimin e të gjitha veprave penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare, përfshirë edhe ato që ndiqen sipas propozimit (nëse propozimin e ka paraqitur personi i autorizuar).⁸

Prandaj, për sa i përket detyrës dhe aktivitetit të policisë rreth zbulimit të veprave penale dhe të kryerësve të tyre, KPP është mjaft përcaktues dhe konkret. Dispozita e paragrafi 1 të nenit 70 të KPP, përcakton qartë se kur duhet të aktivizohet policia lidhur me veprën e kryer penale. Autorizimet e policisë, sipas paragrafit 3 të këtij neni, kanë të bëjnë: a) me mbledhjen e informatave nga personat; me intervistimin e dëshmitarëve apo të të dyshuarit; b) me kryerjen e kontrolleve të ndryshme; për të zbuluar vendndodhjen e individit ose të sendit që kërkohet; të kontrollojë lokalet e organeve publike; c) të zbulojë, mbledhë dhe ruajë gjurmët dhe provat nga vendi i ngjarjes; d) të ndërmarrë hapat të nevojshëm për gjetjen e kryerësit të veprës penale dhe për të parandaluar fshehjen ose arratisjen e tij.

Sipas KPP, roli dhe rëndësia e provave tani është më e sofistikuar, posaçërisht gjatë fazave më të hershme që ndërlidhet me veprimet fillestare. Sa për ilustrim, sipas nenit 70 të KPP, policia mund të sigurojë prova gjatë hapave fillestarë pa mbikëqyrjen e prokurorit, por personi i cili mbledh provat nga ana e policisë duhet të jetë mirë i trajnuar dhe duhet të jetë i aftë dhe në gjendje për t'i shpjeguar veprimet e ndërmarra prokurorit, e më vonë edhe gjykatësit dhe kjo mënyrë lehtë i bën provat e transportueshme (të pranueshme), sipas nenit 150 paragrafi 7 dhe 8 të KPP, që janë marrë pa urdhër hetimi nga prokurori apo gjyqtari.⁹

Deri në përfundimin e hetimeve shfrytëzohen të gjitha materialet nga veprimtaria operative kriminalistike, ndonëse ato në këtë fazë nuk ekzistojnë si provë në të cilin mund të mbështetet vendimi gjyqësor (shih: nenin 8,

⁸ Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep; Elshani, Xhevdet: Komentar, Kodi i Procedurës Penale, Prishtinë, 2014 faqe 240.

⁹ Hulaj, Murat; Beqiri, Sebahate : Pozita juridike e gjyqtarit të procedurës paraprake në relacion me subjektet tjera gjatë hetimeve paraprake, Revista "Justicia", faqe 9.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

paragrafi 2 i KPP),¹⁰ po si burim të dhënash për fakte të caktuara. Në fazën e akuzimit mund të shfrytëzohen si provë shkresat për sendet e gjetura dhe të sekuestruara, gjurmët e veprës penale, skicat, fotografitë, folia me shenjat e vijave papilare, raportet e organeve të përpiluara në bazë të evidencave që mbajnë organet e tilla, si dhe regjistrimet e bëra në bazë të urdhrimit për zbatim të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit. Andaj, shkresat në të cilat janë regjistruar të dhënat e tilla, duhet të përpilohen në formë të procesverbalit. Është me rëndësi të theksohet fakti se, pavarësisht nëse është fjala për mbledhje të informacionit sipas nenit 70 të KPP, që policia mund ta bëjë me vetiniciativë, apo për marrjen në pyetje të të pandehurit nga ana e policisë, që bëhet në bazë të delegimit të këtij autorizimi nga prokurori i shtetit, sipas nenit 152 të KPP, që, kur i pandehuri merret në pyetje për herë të parë, policia duhet t'i vërë në funksion garancitë procedurale të parapara me nenet 10, 257, 152 të KPP-së. Fakti se policia, që nga marrja në pyetje për herë të parë, duhet ta informojë të pandehurin për garancitë procedurale, ngrit vlerën provuese të deklaramit të tij. Në nenin 156 të KPP, është parashikuar efekti provues i deklaramit të të pandehurit dhënë policisë.

Rezultatet e arritura nëpërmjet mbledhjes së informacioneve ose nëpërmjet marrjes në pyetje, fiksohen në procesverbal, kurse, marrja në pyetje mund të fiksohet edhe nëpërmjet regjistrimit teknik.

Dispozita e nenit 70 paragrafit 4 të KPP, detyron policinë që posa të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, është e detyruar që brenda 24 orësh t'i dërgojë raport prokurorit kompetent të shtetit, i cili pastaj, vendos nëse duhet filluar procedura penale. Personi kundër të cilit policia ka ndërmarrë ndonjë masë ka të drejtë të paraqes ankesë te prokurori kompetent në afat prej tri ditësh. Në rast të tillë prokurori pa vonesë e verifikon bazueshmërinë e ankimit, dhe nëse vërteton se veprimet ose masat e zbatuara e shkelin ligjin vepron në pajtim me ligjin dhe e njofton personin që e ka paraqitur ankimin.¹¹

¹⁰ Neni 8 i KPP parasheh që “Gjykata merr vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim gjyqësor”.

¹¹ Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep: vepra e cituar, faqe 307.

2. Raporti i Prokurorit të shtetit me policinë lidhur me paraqitjen e kallëzimit penal të policisë

Duke u bazuar në të dhënat dhe provat e mbledhura, policia përpilon kallëzim penal të policisë në të cilin paraqiten provat e zbuluara në procesin e mbledhjes së të dhënave.

Kallëzimi penal i policisë përpilohet me shkrim dhe në të paraqitet njoftimi për provat e zbuluara gjatë mbledhjes së të dhënave. Andaj, kallëzimi penal i policisë ka të bëjë me një raport, i cili përmban rezultatet e veprimtarisë operative të policisë, me njoftimet e tjera dhe provat e mbledhura për veprën e kryer penale. Si i tillë, kallëzimi paraqet informacion që i ofron prokurorit njohuritë e para për veprën penale dhe për kryerësin e saj. Veprimtaria e policisë rreth zbulimit të një çështje penale, zakonisht, kurorëzohet me kallëzim penal, të cilin ky organ e përpilon edhe ia dërgon prokurorit të shtetit. Së bashku me kallëzim penal dërgohen edhe sendet, skicat, fotografitë, raportet e mbledhura, shkresat mbi masat dhe veprimet e ndërmarra, shënimet zyrtare, deklaratat dhe materialet tjera, që mund të jenë të dobishme për zhvillimin me sukses të procedurës.

KPP ka shpjeguar rregullat që duhet të respektohen nga të gjitha organet e zbatimit të hetimeve, me qëllim të mos dënimit të ndonjë të pafajshmi për vepër penale të cilën nuk e ka kryer, ndërsa, kryerësi i veprës dënohet në bazë të ligjit penal dhe të kushteve të parapara në procedurën penale. Për të arritur këtë qëllim, procedurat penale përshkruajnë bashkëpunimin e ndërsjellë të organeve në procedurë në mes të prokurorisë dhe policisë. Kallëzimi penal është dokument thelbësor komunikues në mes të policisë dhe prokurorit, si dhe asnjë hetim penal nuk mund të bëhet nëse nuk dërgohet kallëzimi penal, për të njëjtën gjë, ku në këtë drejtim çdo oficer policor duhet të jetë në gjendje të shkruaj një kallëzim të plotë dhe korrekt penal. Para se gjithash, kallëzimi penal është informacion për prokurorin se është kryer vepra penale, për të cilën ligji parasheh ndjekje të menjëhershme ose sipas propozimit.

Qëllimi i kësaj është të lejojë prokurorin përkatës të shikoj se cilët hapa hetimor duhet të ndërmerren. Sipas nenit 81 paragrafi 2 të KPP, kallëzimi penal i policisë i dorëzohet prokurorit të shtetit së bashku me sendet, skicat, fotografitë, raportet e marra, procesverbalet e masave dhe veprimeve të kryera,

shënimet zyrtare, deklaratimet e marra dhe materialet e tjera të cilat mund të kontribuojnë në zbatimin efektiv të procedurës.

Nëse pas dorëzimit të kallëzimit penal të policisë, policia mëson fakte të reja ose nxjerr prova apo gjurmë të veprës penale, ajo detyrohet që vazhdimisht të mbledhë informata të nevojshme dhe për këtë menjëherë duhet t'ia dorëzojë prokurorit të shtetit raportin plotësues të kallëzimit penal të policisë.

Nëse masat dhe veprimet e kryera nga policia, provat dhe të dhënat e mbledhura nuk sigurojnë bazë për kallëzim penal të policisë, dhe nëse kjo nuk justifikon ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm se është kryer veprë penale, policia megjithatë i dërgon për këtë raport të veçantë prokurorit të shtetit.

3. Veprimet e prokurorit të shtetit lidhur me kallëzimin penal të policisë

Prokurori i shtetit, pasi të pranojë kallëzimin penal, çmon bazueshmërinë e tij dhe varësisht nga elementet që i përmban ai kallëzim penal, i njëjti mund të:

- a) hedhë kallëzimin penal,
- b) kërkojë informata plotësuese,
- c) fillojë zbatimin e hetimit dhe të ngrejë aktakuzën.

Nëse kallëzimi penal, ofron prova dhe informacione të mjaftueshme për dyshimin e arsyeshëm për veprën penale dhe për kryesin e saj, prokurori mund të fillojë hetimin duke nxjerr aktvendim mbi fillimin e hetimeve në përputhje me nenin 102 të KPP. Mundësia tjetër e prokurorit është që ta hedh kallëzimin penal nëse janë plotësuar kushtet ligjore, në përputhje me nenin 82 të KPP. Prokurori ka mundësinë që të ngrit aktakuzë të drejtpërdrejtë, nëse ka prova të mjaftueshme për veprën penale dhe kryesin e saj të cilat vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë dhe vepra penale është e dënueshme deri ne tri vjet¹². Dhe në fund, prokurori nga policia mund të kërkojë të dhëna plotësuese, në ato raste kur provat dhe informacionet e siguruar nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për të vendosur se a do të fillojë hetimi apo të hedhet kallëzimi penal.

¹² Neni 101 paragrafi 2 i KPP.

4. Masat e marra para fillimit të procedurës penale, raporti polici - prokurori te masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit

Për të pasur sukses në një procedurë penale, ndonjëherë nuk janë të mjaftueshme vetëm veprimet e rëndomta në procedurë, por nevojitet që për raste të caktuara pa shkaktuar vështërsi të paarsyeshme ose rrezik për njerëz dhe pronë, duhet që të nderrmerren edhe disa masa tjera, të cilat do të ndihmonin zbulimin e veprave penale dhe kryesve të tyre.

Të gjitha këto metoda mund të urdhërohen nga gjyqtari i procedurës paraprake ose në disa rrethana prokurori i shtetit. Sidoqoftë, KPP përcakton se këto teknika do të zhvillohen nga policia, duke punuar nën mbikqyrje të prokurorit të shtetit. Ky zhvillim i rëndësishëm do të lejojë policinë që të marrë një rol më proaktiv (reagues) në mbledhjen e dëshmimeve, veçanërisht në lidhje me veprat e rënda dhe krimin e organizuar. Është e qartë që teknikat kaq të avancuara do të përfshijnë edhe sigurimin e pajisjeve të specializuara dhe trajnim intenziv për zyrtarët e policisë. Zbatimi i masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit bëhet në pajtim me nenet 86-100 të KPP.

Policia i bën kërkesë për masa të fshehta prokurorit të shtetit e ai paraqet një kërkesë në formë të shkruar për urdhër nga gjyqtari.

Urdhëri i lëshuar nga gjyqtari do të specifikojë detajet e lëndës së urdhërit, llojin e masës, bazën e urdhërit, kohëzgjatjen e urdhërit dhe policinë përgjegjëse për mbikëqyrjen e implementimit të këtillë. Policia duhet që të sigurojë raportin e implementimit për gjyqtarin në periudhë kohë (interval) prej 15 ditë.

Sipas nenit 91 të KPP, në rastet e urgjente, kur pritja e urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake do të rrezikonte sigurinë e hetimeve ose jetën dhe sigurinë e të dëmtuarit, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre, prokurori i shtetit mund të jep urdhër të përkohshëm për njërën nga masat e parapara në 91 paragrafi 2 të KPP.

Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit mund të autorizohen: a) para fillimit të procedurës penale formale (gjatë hetimit paraprak të policisë), në pajtim me nenin 84 të KPP, apo b) në të njëjtën kohë kur merret aktvendimi i prokurorit të shtetit për të filluar hetimet, ose c) pas fillimit të procedurës penale (gjatë zbatimit të saj). Në rastet nën b) dhe c) prokurori i shtetit mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të autorizojë masat e fshehta

dhe teknike të hetimit, në pajtim me nenet 86-100 të KPP. Zyrtari i autorizuar i policisë fillon zbatimin e urdhrin për zbatimin e ndonjë mase nga ky Kapitull jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë nga dita e lëshimit. Zyrtari i autorizuar i policisë¹³ shënon kohën dhe datën e fillimit dhe të përfundimit të secilit veprim të ndërmarrë për zbatimin e urdhrin. Në procesverbal shënohen emrat e zyrtarëve të autorizuar të policisë të cilët kanë ndërmarrë cilindo veprim dhe funksion. Procesverbalit të tillë i bashkëngjiten raportet që i dorëzohen prokurorit të shtetit apo gjyqtarit kompetent sipas nenit 92, paragrafi 2 i KPP. Pasi të përfundojë zbatimi i masës sipas këtij kapitulli, zyrtari i autorizuar i policisë duhet t'ia dërgojë prokurorit të shtetit të gjitha materialet e mbledhura, ku bëjnë pjesë të gjitha shkresat, shiritat dhe sendet tjera lidhur me urdhrin dhe zbatimin e tij.

5. Bashkëpunimi i prokurorit me policin me policinë pas aktvendimit për fillimin e fazës së hetimit

Rezultatet e veprimeve fillestare të policisë dhe mbledhjes së provave janë pjesë e lëndës hetimore. Pas nxjerrjes së aktvendimit për fillimin e hetimit, hetimi zbatohet dhe mbikëqyret nga prokurori i shtetit. Mirëpo, prokurori i shtetit mund të autorizojë policinë që të ndërmarrë veprime hetimore në të mirë të hetimeve të zbatuara nga ana e vetë prokurorit, i cili në çdo rast konkret pas ngritjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve është “dominis litis” i çështjes përkatëse. Rezultatet e veprimeve hetimore qofshin ato veprime policore apo të ndërmarra nga ana e prokurorit të shtetit lidhur me mbledhjen e provave si dhe rezultatet e veprimeve fillestare nga këto dy institucione, janë pjesë e lëndës hetimore. Prokurori i shtetit mund të ndërmerr veprime hetimore ose të autorizojë policinë që të ndërmerr veprime hetimore lidhur me mbledhjen e provave.

¹³ Sipas nenit 19 të KPP, “Zyrtari i autorizuar i policisë” është zyrtari i policisë apo cilido pjestar i Policisë së Kosovës apo pjestari i ndonjë shërbimi tjetër të autorizuar për të zhvilluar hetime penale ose për të ekzekutuar vendimin e prokurorit të shtetit apo të gjykatës.

6. Bashkëpunimi i prokurorit me policinë në rastet e kontrollit dhe sekuestrimit

Kontrollimi i një personi apo pronës së tij/saj është një hap serioz, ku krijohet mundësia faktike që kur kryhet në mënyrë të kundërligjshme shkelë të drejtën themelore të jetës private dhe dinjitetit personal. Konventa Evropiane për Drejtat e Njeriut e parasheh këtë të drejtë dhe aty thuhet se “Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij”.¹⁴ Për këtë arsye, KPP kufizon dhe ndalon autoritetin për këto lloje të kontrollimeve, por gjithashtu edhe përcakton mënyrën në të cilën ato zhvillohen. Kontrollimi dhe sekuestrimi i sendeve është shumë i rëndësishëm të cilat mund të shërbejnë si dëshmi gjatë gjykimit që personi i caktuar ka kryer ose nuk ka kryer veprën e caktuar penale.

Policia është në shërbim të prokurorit të shtetit në rastet e hetimit të ndonjë veprë penale dhe puna e tyre varet nga kualiteti i dëshmive se a do të dënohet kryesi i veprës penale. Kështu, policia duhet të jenë të njoftuar me të gjitha veprimet procedurale në mënyrë që t’i shmangen gabimeve dhe gjithnjë duhet të koordinohet dhe të marr udhëzime nga prokurori i shtetit. Edhe gabimi më i vogël gjatë kryerjes së kontrollimit ose sekuestrimit të përkohshëm të sendeve mund të jetë një dëshmi e mirë për mospranim në gjykatë nga ana e kryesit të veprës.

Urdhër kontrolli lëshohet me shkrim në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit, ndërsa, në raste të ngutshme lëshohet në bazë të kërkesës me shkrim të zyrtarit të autorizuar të policisë. Urdhërkontrollin e ekzekutojnë zyrtarët e autorizuar të policisë me ndihmën e nevojshme të zyrtarëve të tjerë të policisë brenda dyzet e tetë (48) orëve nga lëshimi i urdhrit.¹⁵ Sipas kësaj dispozite ligjore, është në kompetencën e prokurorit të shtetit të bëjë kërkesën kur është në pyetje kontrolli i një ndërtese apo personi, por në rastet e ngutshme këtë mund të bëjë edhe policia dhe kërkesa duhet të jetë me shkrim, ndërsa, ekzekutimin e urdhërkontrollit e bën policia.

¹⁴ Neni 8 i Konventës.

¹⁵ Neni 105 i KPP.

7. Raportimi nga policia në rastet e kontrollit pa urdhër gjyqësor

Kur është e domosdoshme dhe në masë të nevojshme, zyrtarët policor mund të hyjnë në shtëpinë dhe lokalet tjera të personit dhe të zbatojnë kontrollin pa urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake nëse:

- personi përkatës me dije dhe me vullnet jep pëlqimin për kontroll;
- personi thërret për ndihmë;
- kryerësi i kapur në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale duhet arrestuar pas ndjekjes;
- arsyet për mbrojtjen e njerëzve dhe pasurisë e kërkojnë një veprim të tillë për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejt dhe serioz për njerëzit dhe pronën;
- personi kundër të cilit është lëshuar urdhërarrest nga gjykata gjendet në shtëpi apo në lokale të tjera.

Kur bëhet kontrollimi pa urdhër gjyqësor është e nevojshme që brenda afatit prej dymbëdhjetë orësh të njoftohet prokurori i shtetit dhe gjyqtari kompetent, nëse për këtë çështje është caktuar ndonjë gjyqtar në mënyrë që të merret aprovimi retroaktiv gjyqësor i kontrollit në pajtim me Kushtetutën.¹⁶

Në rrethana të ngutshme, kur urdhri me shkrim për kontroll nuk mund të merret me kohë dhe nëse ekziston rreziku real për vonesë, që mund të rezultojë me humbjen e provave ose me rrezik ndaj jetës ose shëndetit të njerëzve, zyrtari i autorizuar i policisë mund të fillojë kontrollin në bazë të lejes gojore nga gjyqtari i procedurës paraprakë. Por edhe në këtë rast, bashkpunimi prokurori-polici është i pashmangshëm, sepse në praktikë pavarësisht nga iniciativa e policisë është prokurori i shtetit ai i cili kërkon leje gojore nga gjyqtari i procedurës paraprake dhe më pas këtë leje ia konfirmon policisë.¹⁷

Që provat e mbledhura gjatë kontrollimit në bazë të lejes gojore/pa urdhër të shkruar të gjyqtarit të procedurës paraprake të jenë të pranueshme, nevojitet aprovim retroaktiv gjyqësor i lejes gojore për kontrollim. Ky aprovim bëhet pas kontrollit, ashtu që policia i dërgon raport lidhur më këtë prokurorit të shtetit dhe gjyqtarit kompetent.

Sendet dhe pasuria e sekuestruar përkohësisht janë nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e prokurorit të shtetit. Prokurori i shtetit mund t'ia delegojë

¹⁶ Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep: vepra e cituar, faqe 209.

¹⁷ Neni 110, paragrafi 5 i KPP.

mbikëqyrjen dhe kontrollin zyrtarit të autorizuar të policisë për sendet dhe pasurinë e sekuestruar përkohësisht.

8. Identifikimi i personave apo sendeve

Kur është e nevojshme të vendoset se një dëshmitar a e njeh personin ose sendin, nga dëshmitari i tillë së pari kërkohet të përshkruajë dhe tregojë tiparet dalluese të personit ose të sendit të tillë.¹⁸

Njohja e personit ose e sendit është veprim hetimor dhe veprim kriminalistik ku dëshmitarit i prezantohet ndonjë send apo person në mes të sendeve tjera apo personave tjerë me qëllim të identifikimit dhe kjo me qëllim që të zbulohet kryesi i veprës penale apo sendi i cili është produkt i veprës penale apo send të cilin kryesi e ka përdorë për të kryer veprën penale.

Procesi i identifikimit të personit apo sendit nëpërmjet njohjes, mund të mbikëqyret nga policia apo nga prokurori i shtetit ku në një rend vendoset personi i dyshuar me personat të cilët nuk janë kryes të veprës penale dhe dëshmitari e identifikon personin dhe ky proces mund të përsëritet disa herë me qëllim të eliminimit të dilemave, i njëjti proces i identifikimit mund të bëhet edhe ndaj sendeve.

Njohja shërben për vërtetim të njëjtësisë së personave dhe të sendeve me personin ose sendin që është parë më parë, në mënyrë që të verifikohet deklarimi.¹⁹

Konform me dispozitat e nenit 120 të KPP, njohja mund të bëhet edhe në mënyrë të *tërthortë* nëpërmjet fotografisë. Me rastin e zbatimit të procesit të njohjes së personit apo sendit, dëshmitari duhet, sa është e mundshme më në detaje, të përshkruajë personin ose sendin. Është me rëndësi të veçantë të përshkruhet, kur dihet, ndonjë karakteristikë specifike e personit apo e sendit. Pastaj, dëshmitarit i tregohet personi me persona të tjerë të panjohur për dëshmitarin ose fotografitë e tyre apo sendi me sende të tjera të llojit të njëjtë ose fotografitë e tyre.

¹⁸ Neni 120 i KPP.

¹⁹ Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep; Elshani, Xhevdet: vepra e cituar, faqe 333.

9. Raporti i Prokurorit të shtetit në rastet e këqyrjes dhe rikonstruksioni të vendit të ngjarjes

Në kuptimin kriminalistik, këqyrja është një tërësi veprimesh e ndërlikuar dhe një sistem i aplikimit të metodave dhe mjeteve të posaçme teknike me të cilat nëpërmjet vëzhgimit zbulohen, sigurohen, përshkruhen dhe regjistrohen sendet, gjurmët dhe rrethanat tjera të rëndësishme për procedurë penale.²⁰

Këqyrja si burim i provës ndërmerret kur për vërtetimin ose sqarimin e ndonjë fakti të rëndësishëm në procedure nevojitet vrojtimi i drejtpërdrejtë.²¹

Praktikisht ishte bërë rregull që këqyrja të bëhet para fillimit të procedurës penale, para marrjes së aktvendimit për zbatimin e hetimit. Një praktikë të tillë e kanë imponuar rrethanat objektive meqenëse rezultati i këqyrjes shpesh është bazë për paraqitje të kallëzimit penal dhe se provat materiale të gjetura në vendin e ngjarjes rrallë dhe vështirë mund të rrëzohen.

Këqyrjen ose rikonstruksionin e vendit të ngjarjes e kryen prokurori i shtetit ose policia. Një numër policësh janë trajnuar mirë dhe kanë përvojë për këqyrjen apo rikonstruksionin e vendit të ngjarjes. Pas zbulimit të veprës penale, ata mund t'i kenë ekzaminuar dhe mbledhur provat në vendin e ngjarjes. Nëse policia përpilon një raport i cili është në pajtim me nenin 138 të KPP²² raporti dhe provat e tilla mund të jenë të pranueshme si prova.

Prokurori i shtetit mund të urdhërojë këqyrjen ose rikonstruksionin e vendit të ngjarjes për të shqyrtuar provat e mbledhura ose për të qartësuar faktet e rëndësishme për procedurën penale.

Këqyrjen ose rikonstruksionin e tillë të vendit të ngjarjes e kryen prokurori i shtetit ose policia. Prokurori i shtetit dhe policia mund të kryejnë këqyrjen ose

²⁰ Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep; Elshani, Xhevdet: vepra e cituar, faqe 408.

²¹ Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep; vepra e cituar, faqe 289.

²² Sipas nenit 138 të KPP, raporti i ekspertit duhet të përmbajë: të dhënat mbi identitetin e ekspertit dhe të dhënat mbi hetimin; , pyetjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit apo shkallën e dëmit të shkaktuar me vepër penale; , përvoja dhe trajnimet e specializuara të ekspertit, arsyet pse këto janë relevante dhe sa është aktuale ajo përvojë apo ato trajnime; përshkrimi i provave që janë analizuar; përshkrimi i ekspertizës, përfshirë fotografitë relevante, vizatimet, tabelat përmbledhëse, radioskopinë, imazhet, rezultatet laboratorike ose të dhënat tjera shkencore apo teknike që janë të rëndësishme, shpjegimin se praktikatat analitike janë kryesisht të pranuar në fushën e ekspertit ose kanë bazë shkencore apo teknike; dhe përfundimin që paraqet mendimin e ekspertit lidhur me pyetjet në paragrafin 2. të këtij neni, ose që shpjegon përse nuk është arritur të jepen përgjigje në ato pyetje.

rikonstruksionin e tillë për t'u njoftuar personalisht me gjendjen, e cila do t'u ndihmonte në përcaktimin e besueshmërisë ose gjetjen e fakteve, por në rastin e tillë, rezultatet për gjykatën janë të papranueshme. Prokurori i shtetit mund ta përsërisë këqyrjen ose rikonstruksionin me ç'rast rezultatet e tilla janë të pranueshme.²³

Për tu konsideruar valid këqyrja ose rikonstruksioni i vendit të ngjarjes i kryer nga policia ose nga prokurori i shtetit, duhet që i dyshuari, i pandehuri, mbrojtësi i tij të njoftohen për ushtrimin e veprimit të tillë. Nëse këta të fundit janë të panjohur për prokurorin, gjyqtari i procedurës paraprake merr pjese në këqyrje ose rikonstruksion të vendit të ngjarjes.

Dallimi ndërmjet këqyrjes dhe rikonstruksionit qëndron në atë se këqyrja bëhet menjëherë pas ngjarjes me ç'rast gjendja e çështjes në vend të ngjarjes fiksohet, ashtu si kryesi i veprës penale e ka lënë pas kryerjes së veprës. Rikonstruksioni është përsëritje e mëvonshëm e gjendjes dhe kushteve çfarë kanë qenë në kohën e kryerjes së veprës penale dhe kjo mund të bëhet pas një kohe me kërkesë të prokurorit të shtetit apo gjykatës.

Rikonstruksioni ka të bëjë ose me përsëritjen e mënyrës së kryerjes së veprës penale ose të ndonjë faze ose me vendosjen e sendeve dhe të personave në pozitë të caktuar, në mënyrë që të verifikohen deklaratimet e dhëna. Nëse faktet ose situatat paraqiten ndryshe në dëshmitë e dëshmitarëve konkretë, në parim, rikonstruksioni i ngjarjes zbatohet veçmas me secilin dëshmitar. Çdo perceptim i mëvonshëm nuk është rikonstruksion, sepse edhe perceptimi i drejtpërdrejtë në interval kohor të mëvonshëm mund të jetë këqyrje. Në qoftë se në vend të ngjarjes (kohë të gjatë pas ngjarjes) verifikohet nëse dëshmitari, duke pasur parasysh konfiguracionin e terrenit, ka mundur të shohë atë që thotë, atëherë, kjo nuk është rikonstruksion, por është këqyrje.

10. Zbatimi i marrjes në pyetje të të pandehurit dhe dëshmitareve

E rëndësishme për suksesin e hetimit të një vepre penale janë informacionet që policia dhe prokurori i shtetit mbledhin nga burime të ndryshme. Këto informacione duhet të përshkruajnë se çfarë lloji i krimit është përgatitur, kur është paraqitur, si është kryer, dhe nga këto informacione nxjerren dëshmitë

²³ Neni 150 paragrafi 2 i KPP.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

dhe shpeshherë në hetime mungojnë ato. Nën rrethana të tilla intervistimi nga ana e prokurorit apo autorizimi i policisë për një gjë të tillë me viktimat e veprës penale, dëshmitarë dhe të dyshuar shpesh është edhe qelës i hetimit të këtyre veprave penale.

Për të përshkruar aktin kriminal, rrethanat apo pasojat e veprës dhe qëllimin e kryerësit, për hetimin e saj nevojitet përshkrim i besueshëm nga ana e viktimës, nëse është e mundur dëshmitarët okularë dhe nga i dyshuari për kryerje.

Sipas nenit 73 të KPP, policia ka të drejtë të marr në pyetje personat të cilët mund të jenë dëshmitarë ose të dyshuar të mundshëm për vepra penale, me kusht që marrja në pyetje duhet të regjistrohet dhe në pamundësi të regjistrimit duhet të bëhet një raport përmbledhës i cili duhet të përmbajë saktë pyetjet dhe përgjigjet gjatë marrjes në pyetje dhe arsyet pse bisedat nuk janë regjistruar. Kur interviston policia një person të dyshuar së pari duhet të njoftoj për veprën penale që dyshohet se e ka kryer dhe për të drejtat që i takojnë në bazë të nenit 125 paragrafi 3 i KPP. Si burim për ndriçimin e të dhënave të rëndësishme në procedurën penale, vend i rëndësishëm i takon edhe personit kundër të cilit zhvillohet procedura penale, respektivisht të pandehurit dhe deklaratës së tij.²⁴ Të pandehurin e merr në pyetje prokurori i shtetit. Prokurori i shtetit marrjen në pyetje mund t'ia besojë policisë.²⁵ Aktiviteti i policisë sipas nenit paragrafi 3, zhvillohet në dy drejtime: ajo së pari duhet të informojë të dyshuarin për veprat penale, për të cilat dyshohet se i ka kryer ai dhe për të drejtat e tij, në bazë të nenit 125 paragrafi 3 të KPP. Së dyti, policia duhet të hartojë një raport policor nga intervista. Raporti duhet të përmbledhë në mënyrë të saktë pyetjet dhe përgjigjet gjatë intervistës, duhet të japë identitetin e zyrtarit policor që interviston të dyshuarin, kohën, datën dhe vendin e mbajtjes së intervistimit.²⁶ Paragrafi 1 nisat nga koncepti se marrja në pyetje e të pandehurit paraqet një veprim hetimor të rëndësishëm, të cilin do duhej ta zbatojë vetë prokurori i shtetit ose për kryerjen e këtij veprimi ta autorizojë policinë. Prandaj, e konsiderojmë pa vend praktikën sipas së cilës, kur policia e ka marrë në pyetje të dyshuarin, prokurori pas fillimit të hetimit të konsiderojë se marrja e tillë në pyetje e konsumon marrjen në pyetje të të pandehurit sipas nenit 151 të KPP.

²⁴ Sahiti, Ejup; Murati, Rexhepi; vepra e cituar, faqe 142.

²⁵ Neni 151 i KPP.

²⁶ Sahiti, Ejup; Murati, Rexhepi; Elshani, Xhevdet; vepra e cituar, faqe 246.

Neni 151 paragrafi 1 i KPP, parasheh qartë se i pandehuri merret në pyetje në seancën e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake. Marrja në pyetje nga ana e policisë bëhet me kërkesën e prokurorit, e cila bëhet para se të filloj procedura penale. Ndërsa, nga momenti kur fillon procedura penale, prokurori i autorizon zyrtarët e policisë marrjen në pyetje të të dyshimit, si dhe vetë të marrë pjesë në marrjen në pyetje. Gjatë zbatimit të marrjes në pyetje duhet të mbahet procesverbal, ose incizohet audio ose video në pajtim me nenet 125, 152 dhe nenet 208 dhe 209 të KPP.

11. Raporti i prokurorit të shtetit dhe policisë në rastet e privimit nga liria për të pandehurin

Liria dhe siguria e çdo individit është e drejtë fundamentale dhe mbrojtja e kësaj të drejte duhet të jetë në rend të parë preokupim i çdo shteti për mbrojtjen e kësaj të drejte. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale.²⁷ Është shumë e rëndësishme që të kenë njohuri zyrtarët e policisë për shkaqet e arrestimit dhe procedurën të cilës duhet t'i përmbahen me rastin e arrestimit të personit të dyshimtë. Së këndejmi edhe çdo autoritet kur vendos për heqjen e lirisë së një personi duhet të bëjë atë vetëm në rastet kur është më se e domosdoshme dhe masat tjera janë të pamjaftueshme. E drejta për liri dhe siguri është një prej parimeve themelore të të drejtave të njeriut. Është me rëndësi të theksohet se autorizimi ligjor për të urdhëruar një arrestim i takon prokurorit të shtetit, ndërsa, autorizimi i policit për ta arrestuar të dyshimtin para gjykimit të tij është mjet i jashtëzakonshëm dhe nuk duhet të shikohet si rregull në ligj. Sidoqoftë, sistemi i drejtësisë penale nuk mund të funksionojë në mënyrë efektive pa këto autorizime për arrestim. Personat të cilët kryejnë vepra penale serioze natyrisht se do të kërkojnë t'i shmangen gjykimit dhe dënimit, derisa me forcë detyrohet që t'i dorëzohen prokurorit dhe policët duhet të ruajnë ekuilibrin në mes të të drejtave të qytetarëve dhe nevojave të sistemit të drejtësisë penale. Kjo do të thotë, aplikimi i ligjit me forcë minimale dhe zvoglimi i kontaktit negativ për ta qar çdo të dyshimtë para gjykatës. Hetimin si fazë të parë të procedurës penale e zbaton prokurori i shtetit. Prokurori i shtetit mund ta autorizojë policinë që të zbatojë hetimin të cilin ai

²⁷ Neni 5 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

e mbikëqyrë. Kur prokurori i shtetit autorizon hetimin, policia ka autorizime ta arrestojë dhe të ndalojë personin vetëm nëse:

- a. *ka dyshim të bazuar* se ai ka kryer vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe
- b. *ka baza të artikulueshme* për të besuar se ekzistojnë kushte për heqje të lirisë të parapara në nënparagrafin 1.2, kushte të cilat janë pothuaj të njëjta me kushtet për caktimin e paraburgimit sipas nenit 187, paragrafit 1 nënparagrafi 1.2 të KPP.

Arrestimi dhe ndalimi autorizohet nga prokurori i shtetit që ka filluar hetimin, ose kur për shkak të rrethanave të ngutshme autorizimi i tillë nuk mund të merret para arrestimit, nga policia e cila menjëherë pas arrestimit duhet të informojë prokurorin e shtetit. Është rregull se arrestimi dhe ndalimi autorizohet nga prokurori i shtetit i cili e ka autorizuar hetimin.

Mirëpo, kur për shkak të *rrethanave të ngutshme*, autorizimi i tillë nuk mund të merret para arrestimit, policia cakton masën me vetiniciativë dhe menjëherë pas arrestimit duhet të informojë prokurorin e shtetit. Ndonëse, KPP nuk përcakton më afër rrethanat e ngutshme, çmojmë se të tilla konsiderohen situatat kur prolongimi i zbatimit të arrestit dhe të ndalimit do të kishte efekt negativ për rrjedhën e procedurës penale.

Neni 64 i KPP parasheh se sa më shpejtë që është e mundur pas arrestimit dhe jo më vonë se gjashtë (6) orë nga koha e arrestimit, prokurori i shtetit i lëshon personit të arrestuar vendimin me shkrim mbi ndalimin, që përfshin emrin dhe mbiemrin e personit të arrestuar, vendin, ditën dhe kohën e saktë të arrestimit, veprën penale për të cilën dyshohet dhe bazën juridike për arrestim.²⁸ Prokurori i shtetit është i vetmi organ i cili mund të caktoj ndalimin policor për një person, i cili e ka kryer një vepër penale dhe për të cilin janë plotësuar kushtet ligjore për shqiptimin e një masë të tillë dhe për një vendim të tillë nuk mund ta autorizojë policinë.

²⁸ Neni 164 i KPP.

12. Përfundimi

- Pas trajtimit të temës *bashkëpunimi i prokurorit të shtetit dhe policisë* kemi ardhur në përfundim se ky raport i bashkëpunimit gjen mbështetje të plote në Kodin e Procedurës Penale dhe në Ligjin për Policinë.
- Shikuar në rrethanat aktuale ky bashkëpunim duhet të jetë më i afërtë në aspektin e shfrytëzimit të teknologjisë informative përkatësisht krijimin e një data baze prokurori – polici. Kjo data bazë do të rrisë efikasitetin dhe efektivitetin e bashkëpunimit, meqenëse të dhënat paraqiten në të njëjtën kohë në të dy institucionet.
- Rregullimin e komunikimit mes shkresave dhe raporteve në mënyre elektronike në mes policisë dhe prokurorisë është e domosdoshme edhe ndryshimet ligjore.
- Bashkëpunimi do të ishte me efikas, llogaridhënës dhe i pavarur nëse në zbatimin e veprimeve hetimore policia duhet t'i jepte llogari të drejtpërdrejtë prokurorit.
- Prokurori duhet të mbikëqyrë punën e policisë në vendin e ngjarjes me qellim që të mos dëmtohen dëshmitë me apo pa qëllim.
- Vazhdimi i mbajtjes dhe zhvillimit të sa më shumë trajnimeve të përbashkëta do të ngriste edhe më tutje nivelin e përgjegjësisë dhe profesionalizmit dhe
- Krijimi i strategjive të përbashkëta për luftimin e formave të reja të kriminalitetit qoftë krimin e organizuar, ekonomik, kibernetikë, terrorizmin dhe dukurive tjera kunderligjore.

Literatura dhe aktet juridike

- Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2016, faqe 153.
- Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep; Elshani, Xhevdet : Komentar, Kodi i Procedurës Penale, faqe 240, Prishtinë, Dhjetor 2014
- Hulaj, Murat; Beqiri, Sebahate: Pozita juridike e gjyqtarit të procedurës paraprake në relacion me subjektet tjera gjatë hetimeve paraprake, Revista “Justicia”, faqe 9.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

- Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë, 2013.
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës.
- Ligji për Policinë

Armend Zenelaj*

PARABURGIMI DHE APLIKIMI I TIJ NË PRAKTIKË

Abstrakt

Kjo analizë, fokus të veçantë do të ketë zbatimin e masës së paraburgimit, si njëri nga masat më të rënda për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë. E listuar si masa e fundit për sigurinë e prezencës së të pandehurit në procedurë, paraburgimi caktohet kur me masat tjera nuk mund të arrihet qëllimi.

Në këtë analizë, është përdorur metoda analizuuese dhe karahasimore, duke përafuar dhe lehtësuar njohuritë në zbatimin e kësaj mase për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale.

Sipas Kodi të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, prokurori i shtetit brenda njëzetekatër (24) orëve pas arrestimit të të dyshuarit, i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit. Nga këtu fillon numërimi në kohëzgjatje të kësaj mase e cila nuk lejohet të kalojë maksimumin e përgjithshëm prej 18 muajve para ngritjes së aktakuzës.

Analiza vë në pah se Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës nuk precizon kohën e saktë se sa një i akuzuar mund të qëndrojë në paraburgim pas ngritjes së aktakuzës. Kjo duket të jetë njëra nga mangësitë e këtij kodi, me çka lejon raste të stërzgjatjeve të paraburgimeve në praktikë duke rrezikuar shkeljen e të drejtave të njeriut të garantuara me Konventa ndërkombëtare. Duke i bërë një interpretim ekstenziv Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, përmes kësaj analize është arritur të nxirret analogji nga kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor, në kohëzgjatjen e paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës.

* Autori është Prokuror i shtetit në Departamentin e Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Gjakovë.

Në këtë analizë paraqiten arsyet e rasteve të ndërprerjes së paraburgimit dhe mbi të gjitha elaborohen rastet kur paraburgimi bëhet i detyrueshëm për gjykatën.

Në këtë analizë është munduar të hedhet dritë edhe në shqiptimin e masës së paraburgimit, në rastet kur kjo masë zbatohet ndaj personave të mitur.

Po ashtu, sqarohet trajtimi i rëndësisë së veçantë të masës së paraburgimit nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), me të vetmin qëllim që organet e drejtësisë t'i peshojnë si duhet dhe sa duhet arsyet në çdo rast kur mendojnë të caktojnë këtë masë, e cila jo rastësisht është renditur si masa e nëntë dhe e fundit në Kodin e Procedurës Penale për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë penale.

Fjalët kyçe: Paraburgimi, zbatimi, praktikë, procedurë penale, prokurori, gjyqtari i procedurës paraprake, i pandehuri, i mituri, personat me çrregullime mendore

Hyrje

Liria dhe siguria e çdo individi është fundamentale dhe mbrojtja e kësaj të drejte duhet të jetë në rendë të parë të luftës së çdo shteti për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Çdo autoritet ligjor kur vendos lidhur me heqjen e lirisë së një personi (paraburgimin) duhet të tregoj kujdes maksimal që atë ta bëjë vetëm kur ajo është e domosdoshme dhe masat tjera janë të pamjaftueshme.

Meqenëse liria personale është një e drejtë të cilën duhet ta gëzojë çdo njëri, privimi nga liria (paraburgimi) duhet të jetë e bazuar në ligj, e arsyetuar mirë dhe të zgjatë në afatin sa më të shkurtë

1. Paraburgimi - masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale

Me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, i cili ka në fuqi më 01 janar 2013, janë paraparë nëntë masa për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë penale. Një nga këto masa dhe më e rënda për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale është edhe masa e paraburgimit.¹

Personi i cili arrestohet dhe i nënshtrohet paraburgimit i gëzon një varg të drejtash;

- informohet në gjuhën që ai e kupton për arsyet e arrestimit;
- të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informatave për identitetin e tij;
- nëse nevojitet, t'i sigurohet përkthimi falas;
- të shfrytëzoi ndihmën e mbrojtësit dhe t'i caktohet mbrojtës nëse nuk ka mundësi të paguaj për ndihmë ligjore;
- për arrestimin e tij të lajmëroj ose të kërkoj nga policia ta lajmëroj anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij;
- të ketë kontroll dhe trajtim mjekësorë duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik dhe
- kur personi i arrestuar është shtetas i huaj, ai ka të drejtë ta njoftoj dhe komunikoj gojarisht ose me shkrim me zyrën e ndërlidhjes, me misionin diplomatik të shtetit të tij.

Masa e paraburgimit është e listuar si masa e fundit për sigurinë e prezencës së të pandehurit në procedurë, e njëjta urdhërohet kur me masat tjera nuk mund të arrihet qëllimi. Gjatë vendosjes për njërën nga këto masa, gjykatat në vendin tonë detyrohen t'i marrin parasysh kushtet e përcaktuara për masat konkrete dhe të sigurojnë që të mos zbatohet ndonjë masë më e rëndë kur mjafton aplikimi i ndonjë mase më të butë siç ka paraparë ligjvënësi në Kodin e Procedurës Penale.

Policia e Kosovës, sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, posa të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, është e detyruar që brenda njëzet e katër (24)

¹Shih neni 173 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

orëve t'i dorëzojë një raport policor prokurorit të shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendos nëse duhet filluar procedurën penale².

Sipas Kodi të Procedurës Penale të Kosovës, prokurori i shtetit brenda njëzetekatër (24) orëve pas arrestimit të të dyshuarit, i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesën për caktimin e paraburgimit.³

Me qëllim që prokurorët të hartojnë kërkesa për paraburgim të arsytuar mirë, ata brenda kësaj periudhe prej 24 orësh duhet të pranojnë sa më shpejtë kallëzimet penale të policisë, të cilat duhet të jenë të kompletuara, në mënyrë që kërkesat e prokurorit për caktimin e masës për prezencën e të dyshuarit në procedurë të jenë sa më të suksesshme. Policia duhet të kujdeset dhe të trajtojë me prioritet dorëzimin e kallëzimeve penale në prokurori në kohë sa më të shkurtër.

1.1 Kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit (neni 187)

Kur prokurori i shtetit paraqet kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit, varësisht prej gjendjes faktike të rastit dhe rrethanave të cilat paraqiten pas kryerjes së një veprë penale, kërkesën duhet ta paraqes bazuar në tri bazat kryesore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës⁴.

Kur: - ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer veprë penale dhe përmbushet njëri nga kushtet e mëposhtme:

- kur i dyshuari fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rreziku i ikjes së tij;
- kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit; ose
- kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër

² Shih nenin 70 paragraf 4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

³ Shih nenin 164 paragraf. 7 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës..

⁴ Shih nenin 187 paragraf 1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës..

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej.

Me rastin e kërkesës për caktimin e paraburgimit prokurorët duhet të bëjnë më shumë përpjekje për të arsyetuar kërkesat e tyre me arsye adekuate për rastet konkrete, vetëm atëherë kur kjo masë është e domosdoshme.

Kur i pandehuri mbahet në paraburgim, të gjitha organet që marrin pjesë në procedurën penale dhe organet që ofrojnë ndihmën juridike detyrohen të veprojnë me nguti të posaçme⁵.

Gjykatat në Kosovë duhet t'i përmbahen më me kujdes zbatimit të dipozitave ligjore të përcaktuara në kodin e procedurës penale të cilat rregullojnë kohëzgjatjen e paraburgimit dhe kohëzgjatjen e fillimit dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor. Gjykata sipas nenit 187, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, mund të caktoj paraburgimin ndaj një personi nëse;

- ekziston dyshimi i bazuar se personi i tillë ka kryer vepër penale;
- përmbushet njëri nga kushtet e mëposhtme:
 - (i) Kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana tjera që tregojnë se ekziston rreziku i ikjes së tij;
 - (ii) Kur ka arsye për të besuar se ai do t'i asgjësoj, fshehë, ndryshoj ose falsifikoj provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengoj rrjedhën e procedurës penale, duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuar, në bashkëpjesëmarrës, etj;
 - (iii) Kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund të përsëris veprën penale, mund ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryej veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej;
- Masat e parapara me nenin 173, paragrafi 1, të këtij kodi do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e personit të tillë, të parandaloj përsëritjen e veprës penale dhe të siguroj zbatimin e suksesshëm të procedurës penale

⁵Shih nenin 185 paragraf 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës..

1.2 Caktimi i paraburgimit

Sipas nenit 188 par. 1 të Kodit të Procedurës Penalë të Republikës së Kosovës, paraburgimin e cakton gjyqtari i procedurës paraprake i gjykatës kompetente, në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit pas seancës dëgjimore. Gjyqtari mund ta refuzojë kërkesën e prokurorit të shtetit për caktimin e masës së paraburgimit, dhe mund ta urdhëroj ndonjë masë tjetër.

Paraburgimi caktohet me aktvendim me shkrim i cili përfshinë; emrin dhe mbiemrin e personit të cilit i caktohet paraburgimi, si dhe të dhënat personale të tij, kohën e arrestimit, kohën e sjelljes para gjyqtarit të procedurës paraprake, kohën e marrjes në pyetje, veprën penale për të cilën akuzohet, bazën ligjore për paraburgim, njoftimin për të drejtën në ankesë, arsyetimin e të gjitha fakteve vendimtare që kanë shkaktuar paraburgimin, duke përfshirë edhe arsyet për dyshimin e bazuar se personi ka kryer veprën penale, si dhe faktet vendimtare nga neni 187 par 1, nënparagrafi 1.2 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Palët e pakënaqura me aktvendimin për caktimin e paraburgimit brenda njëzet e katër orëve (24) nga marrja e aktvendimit mund të paraqesin ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, për të cilën duhet të vendoset brenda dyzet e tetë orëve (48) nga paraqitja e saj, ankesa kundër aktvendimit nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

I paraburgosuri, mund të mbahet në paraburgim më së shumti një (1) muaj nga dita e arrestimit në bazë të urdhërit nga neni 188 i KPPRK-së. Pas kësaj kohe, ai mund të mbahet në paraburgim vetëm me aktvendim të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues me të cilin urdhërohet vazhdimi i paraburgimit.⁶

1.2.1 Shembull praktik: Aktvendimi Gjyqësor lidhur me paraburgimin

Ne vazhdim të kësaj analize ju paraqesim një shembull praktik të caktimit të paraburgimit:

⁶ Shih nenin 190 paragraf 1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Ppr nr. 52/17

Gjykata Themelore në P... – Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtarja e procedurës paraprake R.E, me bashkëpunëtorin profesional A.R, duke vendosur sipas kërkesës së Prokurorisë Themelore në P... – Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.55/2017 të datës 28.07.2017 mbi caktimin e paraburgimit kundër të pandehurit Y.R nga M, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP të Kosovës, të kanosjes nga neni 185 par.4 të KP të Kosovës, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KP të Kosovës, pas mbajtjes së seancës në praninë e prokurorit të shtetit R.R, të pandehurit dhe mbrojtëses së tij avokates B.B, me datën 29.07.2017 , muarr këtë

A K T V E N D I M

PËR CAKTIMIN E PARABURGIMIT

Kundër të pandehurit **Y.R**, nga i ati A dhe e ëma F– e lindura T, i lindur më 00.00.1961 në M. ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, me profesion bujk, i martuar – i ati katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në ndalim nga data 27.02.2017 nga ora 16:00 minuta, tek gjyqtarja e procedurës paraprake është sjell me datë 29.02.2017 nga ora 09:55 minuta.

CAKTOHET PARABURGIMI në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji i cili do të llogaritet prej kohës së arrestimit prej datës 27.02.2017 prej orës 16:00 dhe do të zgjasë gjerë më datën 26.03.2017 gjerë në ora 16:00, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP të Kosovës, të kanosjes nga neni 185 par.4 të KP të Kosovës, kuptim të nenit 187 par.1. nën par.1.1. dhe 1. 2.në lidhje me par.1nën par.1.2.1,1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP të Kosovës.

A r s y e t i m

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

PSH në P. me aktvendimin e saj PP.nr.55/2017 të datës 28.02.2017 ka filluar hetimet kundër të pandehurit Y.R nga M, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP të Kosovës, të kanosjes nga neni 185 par.4 të KP të Kosovës si dhe ka parashtruar kërkesën për caktimin e paraburgimit .

Gjyqtarja e procedurës paraprake duke vepruar sipas kërkesës për caktimin e paraburgimit ka caktuar seancën e ndëgjimit .

Prokurori i shtetit në P. R.R, në tërësi ka mbetur pranë kërkesës për caktimin e paraburgimit sepse ekziston dyshimi i arsyeshëm se i pandehuri ka kryer veprat penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP të Kosovës, të kanosjes nga neni 185 par.4 të KP të Kosovës, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KP të Kosovës, nga se janë plotësuar kushtet ligjore konformë nenit 165 par.2.nën par.2.4,. 2.5. 2.5.1 2.5.2 dhe 2.5.3. të KPP sepse ekziston rreziku i ikjes, ndikimit në dëmtuar dhe dëshmitarë si dhe duke pas parasysh peshën e veprave penale, mënyrën e kryerjes propozon caktimin e paraburgimit.

Mbrojtësja e të pandehurit avokatja B.B, në tërësi ka kundërshtuar propozimin për caktimin e paraburgimit, duke deklaruar se i pandehuri nuk e konteston se ka pasur mosmarrëveshje mes dëmtuarit dhe tij, i premtun se do ti përgjigjet ftesave të gjykatës dhe prokurorisë dhe i propozon që ndaj tij të caktojë një masë më të butë për sigurimin e prezencës së pandehurit. Me pohimet e mbrojtëses pajtohet edhe i pandehuri, duke shtuar se ka gjendjen e dobët shëndetësore, ka problem me lukth dhe kurrizin.

Gjyqtarja e procedurës penale pasi që ka vlerësuar thënjet e palëve, ka ardhur në përfundim se :

Kërkesa e prokurorit të shtetit në P. është e bazuar .

Nga ndëgjimi i palëve dhe argumentet e tyre të cekura lidhur me masën e caktimit të paraburgimit kundër të pandehurit Y.R, gjyqtarja e procedurës paraprake ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore të paraparë si në nenin 187 par.1. nën par.1.1. dhe 1. 2. në lidhje me par.1 nën par.1.2.1 të KPP-së. I pandehuri me qëndrimin në liri mund të fshihet apo të ipet në arrati,

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, e këtë lehtë mund ta bëjë në forma të ndryshme. Më tej, faktin se i njëjti nuk ka punë të rregullt, si dhe duke pas parasysh edhe peshën e veprave penale, mund të tentojë të ikë dhe me këtë rast të pamundësojë rrjedhën e procedurës penale, pika 1.2.2 të KPP-së, nga se i pandehuri mund të ndikojë në dëshmitar sepse në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se në ngjarjen e cila ka ndodhur ka pas edhe dëshmitarë tjerë, dhe me lënien e tij në liri, ai mund të ndikojë në dëshmitar, duke qenë se hetimet sapo kanë filluar, njëri prej të pandehurve gjendet në liri, po ashtu ende nuk janë marrë në pyetje të pandehurit, të dëmtuarit – dëshmitarët për mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale. Andaj, mendimi i gjykatës se nëse i pandehuri lihet në liri, i njëjti mund të tentojë të ndikojë tek i bashkëpandehuri, dëmtuari – dëshmitarët, po ashtu ekziston rreziku që deklaratimet e tyre të ndryshohen, të shmangen nga deklaratimet e mëhershme dhe në përgjithësi të eliminohen gjurmët e veprës penale si dhe pika 1.2.3 të KPP-së, duke pas parasysh peshën e veprave penale, mënyrën e kryerjes së veprave, i njëjti gjatë deklaratimit të tij në polici ka pranuar kryerjen e veprës penale si dhe në seancën e dëgjimit nuk e konteston mosmarrëveshjen me të dëmtuarin. Duke marr parasysh se këto vepra paraqesin rrezikshmëri të zmadhuar shoqërore, e në raste të posaqme edhe me pasoja të paparashikueshme sidomos në jetën e njerëzve, me përdorimin e tyre e duke marr parasysh edhe raportet e acaruar me të dëmtuarin që kjo rrethanë tregon mundësin e përsëritjes së kësaj vepre penale, e që mund të sjell pasoja më të rënda, andaj caktimi i paraburgimit në këtë fazë të procedurës është e domosdoshme dhe i arsyeshëm për zbatimin e rregullte të kësaj procedure penale.

Gjykata duke vendosur lidhur me kërkesën për caktimin e paraburgimit i morri parasysh edhe masat tjera alternative të parapara në nenin 173 të KPP të Kosovës si dhe masat e propozuar nga ana e mbrojtësit të pandehurit, por vlerësoi se të njëjtat nuk janë të mjaftueshme dhe të sigurt për sigurimin e prezencës së pandehurit në procedurë gjer në sqarimin e rrethanave për të cilën ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë e posaçërisht kur hetimet në këtë çështje penale janë në fazën fillestare, duke marr parasysh faktin se raportet mes të pandehurit dhe dëmtuarit janë të acaruar dhe me mbetjen e tij në liri mund të vijë deri tek pasoja edhe më të rënda që mund të shpien në pasoja fatale, andaj caktimi i

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

masës së paraburgimit tani për tani është pa dyshim të i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktvendimi konform nenit 187 par.1. nën par.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË P.

Ppr.nr. 52/2017, Më 29.02.2017

**B. Profesional,
procedurës paraprake**

A.R

Gjyqtarja e

R. E

KËSHILLA JURIDIKE. Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 24 orëve, **GJYKATËS SË APELIT.**

1.2.2 Zgjatja e Paraburgimit

Para ngritjes së aktakuzës paraburgimi nuk mund të zgjas më shumë se:

- Katër (4) muaj kur procedura zbatohet për vepra të dënueshme me më pak se pesë (5) vjet burg;
- Tetë (8) muaj kur procedura zbatohet për vepra penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burg;
- Në raste të jashtëzakonshme kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim, dhe kur rasti është i ndërlikuar siç përkufizohet në nenin 19 të KPPRK-së, e zvarritja nuk mund t'i atribuohet prokurorit të shtetit, përveç afateve të parapara me paragrafin 2 të nenit 190 të KPPRK-së, para ngritjes së aktakuzës, paraburgimi mund të vazhdojë më së shumti deri në katër (4) muaj për një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej dymbëdhjetë (12) muaj;
- Kur ka shkak të bazuar dhe bindës për të besuar se ekziston rreziku i përgjithshëm apo rreziku i dhunës nëse lirohet i

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

pandehuri në procedurë paraprake, vazhdimi i paraburgimit nga paragrafi 3 i nenit 190 të KPPRK-së, mund të vazhdohet edhe për gjashtë muaj tjerë për një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej tetëmbëdhjetë (18) muaj.

Pra, zgjatja e paraburgimit para ngritjes së aktakuzës mund të bëhet deri në një maksimum të përgjithshëm pre 18 muajve. Këtë zgjatje të paraburgimit para ngritjes së aktakuzës e bënë gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i trupit gjykues dhe çdo herë duhet të bëhet sipas propozimit të prokurorit të shtetit i cili do të vë në dukje arsyet e caktimit dhe vëzhgimit të paraburgimit dhe se sa janë ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyetueshme për të përjashtuar zbatimin e hetimit.⁷

Nëse aktakuza nuk ngritet brenda afatit të paraparë, i paraburgosuri lirohet. Ndaj çdo aktvendimi për vazhdimin e paraburgimit mund të ushtrohet ankesë brenda njëzet e katër (24) orëve.

2. Institucionet Korrektuese dhe zbatimi i paraburgimit

Paraburgimi mbahet në lokale të posaçme të paraburgimit ose në pjesë të ndarë të institucionit për vuajtjen e dënimeve me burgim..

Institucioni i paraburgimit detyrohet të mbajë evidencë për kohën e ardhjes së personit të paraburgosur në institucionin e paraburgimit, për kohën e skadimit të paraburgimit dhe të informojë të paraburgosurin dhe mbrojtësin e tij për datën e skadimit. Nëse institucioni i paraburgimit nuk e merr aktvendimin e gjykatës për vazhdimin e paraburgimit pasi të ketë skaduar afati nga aktvendimi, institucioni menjëherë duhet ta lirojë të paraburgosurin dhe për këtë të lajmërojë gjykatën kompetente. I paraburgosuri gjatë mbajtjes së paraburgimit, mund të mbajë dhe shfrytëzoj sende për përdorim personal, për mbajtje të higjienës, pajisje për dëgjimin e medieve publike, publikime, literaturë profesionale, para dhe sende tjera të cilat për nga masa dhe sasia

⁷ Shih nenin 191 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

mundësojnë jetë normale në hapsiarën e qëndrimit dhe nuk pengojnë të paraburgosurit tjerë.⁸

I paraburgosuri ka të drejtë në tetë orë pushim pa ndërprerë brenda 24 orëve dhe së paku 2 orë në ditë lëvizje në ambient të hapur.

I paraburgosuri mund të kryej punë të ndryshme. Për punën e kryer ka të drejtë pagese, është i obliguar të mbajë pastërtinë në lokalet e paraburgimit, ka të drejtë të merret me aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore, brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos dëmtojë rrjedhën e procedurës penale.

Personat e gjinive të ndryshme, ata që kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës së njëjtë penale, ata që vuajnë dënimin dhe personat që kanë përsëritur veprën penale, nuk mund të vendosen në të njëjtën dhomë.

Kryetari i gjykatës themelore kompetente ka përgjegjësinë përfundimtare për mbikëqyrjen e trajtimit të të paraburgosurve.

Kryetari i gjykatës themelore kompetente apo gjyqtari i cili ka urdhëruar paraburgimin, në çdo kohë mund të vizitojë të paraburgosurit, të bisedojë me ta dhe të pranojë ankesat e tyre.

Detyrimet që dalin nga neni 203 i KPPRK-së nuk ndikojnë në detyrimin e gjyqtarit kompetent nga neni 192 i KPPRK-së për të vlerësuar ankesat e të pandehurve të cilët paraqesin ankesa të vlefshme lidhur me kushtet e paraburgimit dhe t'i korrigjoj ato kushte të kundërligjshme.

3. Masa e paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, dispoziat e nenit 193 parag. 1 nuk precizojnë kohën e saktë se sa një i akuzuar mund të qëndrojë në paraburgim pas ngritjes së aktakuzës. Kjo duket të jetë njëra nga dilemat e këtij kodi.

Pas ngritjes së aktakuzës Kodi i Procedurës Penale nuk e kufizon paraburgimin me afate maksimale, por kohëzgjatja e tij lidhet me ekzistimin e

⁸ Shih nenin 198 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

mëtutjeshëm të kushteve për paraburgim dhe me zgjatjen e procedurës penale.⁹

Pas ngritjes së aktakuzës paraburgimi vazhdohet ose heqet ex-officio dhe pa propozimin e palëve (propozimi nuk përjashtohet), gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ka për detyrë që pasi të kalojnë dy muaj nga aktvendimi i fundit për paraburgim të shqyrtoj nëse ende ekzistojnë arsyet për paraburgim dhe sipas detyrës zyrtare ta vazhdojnë ose ta heqin paraburgimin.¹⁰

Përkundër këtyre dilemave në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës sa i përket kohëzgjatjes së paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës, megjithatë është përcaktuar saktë se sa duhet të jetë koha për përfundimin e një shqyrtimi gjyqësor.

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, nëse shqyrtimi gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda nëntëdhjetë (90) ditësh, ndërsa nëse shqyrtimi gjyqësor mbahet para trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda njëqindnjëzet (120) ditëve, me mundësi vazhdimi edhe për tridhjetë (30) ditë të tjera, në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme të numrit të madh të provave dhe dëshmitarëve.

Duke marrë një analogji me kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor, i bie që një i akuzuar i cili gjykohet para gjyqtarit individual, mund të qëndrojë në paraburgim pas ngritjes së aktakuzës edhe për katër muaj apo 120 ditë të tjera. Ndërsa, nëse gjykohet para trupit gjykues, pas ngritjes së aktakuzës mund të mbahet në paraburgim edhe pesë muaj të tjerë apo 150 ditë.

4. Ndërprerja e paraburgimit

Paraburgimi mund të ndërpritet në çdo kohë nga gjyqtari i procedurës paraprake, por kjo duhet të bëhet me pëlqimin e prokurorit të shtetit. Në raste

⁹ Shih nenin 193 paragraf 1 të Komentarit të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

¹⁰ Shih nenin 193 paragraf 2 të Komentarit të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

mospajtimi vendos Kolegji Penal brenda 48 orëve nga pranimi i kërkesës së Gjykatësit.

Me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe pikërisht nenit 192 paragrafi 2 deri 4, është paraparë një procedurë e re për heqjen e paraburgimit dhe atë vlerësimi i ligjshmërisë së caktimit dhe vazhdimit të paraburgimit. Sipas kërkesës së të paraburgosurit ose mbrojtësit të tij në çdo kohë mund t'i ankohen gjyqtarit të procedurës paraprake që të vendosë mbi ligjshmërinë e paraburgimit.

Arsyet për paraburgim nga neni 187 i këtij Kodi që nga vendimi gjyqësor për paraburgim kanë pushuar së ekzistuari, ndryshimit të rrethanave ose zbulimit të fakteve të reja ose ndalimi për ndonjë arsye tjetër është i paligjshëm.

Gjyqtari i procedurës paraprake në seancë dëgjimi urdhëron lirimin e menjëhershëm të të paraburgosurit kur konstaton se:

- Kanë pushuar së ekzistuari arsyet e paraburgimit nga neni 187 të këtij Kodi,
- Ka kaluar afati i paraburgut i urdhëruar nga gjykata (prokurori nuk ka ushtruar kërkesë për vazhdimin e paraburgimit);
- Afati i paraburgimit i caktuar nga gjykata kalon afatin e paraparë në nenin 190 (8,12 muaj);
- Ndalimi për ndonjë arsye tjetër është i paligjshëm

Masa e paraburgimit mund të hiqet në çdo fazë të procedurës penale, posa të pushojnë shkaqet për caktimin e tij. Për këtë arsye aktvendimi për caktimin dhe vazhdimin e paraburgimit, janë vendimet e vetme të gjykatës me të cilat procedura nuk përfundohet në formë të prerë.

5. Paraburgimi i detyrueshëm

Më lartë u prezantuan, rrethanat, bazat, kushtet dhe kohëzgjatja e paraburgimit. Mirëpo, jo çdo herë paraburgimi është i detyrueshëm, kjo i lihet në vlerësimin e prokurorit për kërkesën e caktimit të masës së paraburgimit nga njëra anë, dhe në vlerësimin e gjyqtarit për caktimin e apo jo të

paraburgimit, si një ndër masat më të rënda për sigurinë e prezencës së të pandehurit në procedurë.

Paraburgimi bëhet obligativ për gjykatën, kur të akuzuarin e ka deklaruar fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me 5 vjet e më tepër burg. Në këto raste gjykata të akuzuarit i cakton paraburgimin nëse ai nuk ndodhet në paraburgim ose i vazhdon paraburgimin pavarësisht kushteve të parapara në nenin 187 të Kodit të Procedurës Penale¹¹.

6. Paraburgimi ndaj të miturve

Paraburgimi ndaj të miturve mund të caktohet atëherë kur plotësohen kushtet e parapara për caktimin e paraburgimit në procedurën penale e cila zbatohet ndaj të rriturve, dhe nëse masat tjera për sigurimin e prezencës së të miturit në procedurë vlerësohen të pamjaftueshme për të siguruar prezencën e të miturit të tillë në gjykatore, për të parandaluar kryerjen e serishme të veprës penale dhe për të siguruar zbatimin e suksesshëm të procedurës.

Paraburgimin ndaj të miturve që kanë kryer vepër penale, me aktvendim e cakton gjyqtari për të mitur, në çdo rast aktvendimi mbi caktimin e paraburgimit duhet të përfshijë një shpjegim të arsyetuar për pamjaftueshmërinë e alternativave të tilla kundrejt paraburgimit.¹²

Në bazë të aktvendimit të gjyqtarit për të mitur, i mituri i pandehur mund të mbahet në paraburgim për një periudhë kohore maksimale prej 1 muaji, duke llogaritur nga dita kur ai është arrestuar. Pas këtij afati i mituri mund të mbahet në paraburgim në bazë të aktvendimit të kolegjit për të mitur mbi vazhdimin e paraburgimit. Ky vazhdim i paraburgimit mund të bëhet për një periudhë shtesë prej 2 muajsh, pas paraqitjes së propozimit për dënim të miturit mund t'i vazhdohet paraburgimi, në raste të tilla kërkohet që kolegji në prani të të miturit, mbrojtësit të tij dhe prokurorit ta rishikojë aktvendimin në fjalë brenda

¹¹ Shih nenin 367 par. 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

¹² Shih nenin 66 paragraf 1 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

1 muaji nga dita e marrjes së tij.¹³ Mirëpo përkundër këtyre mundësive të vazhdimit të paraburgimit ndaj të miturit, ai nuk mund të mbahet në paraburgim më tepër se 12 muaj nga dita e arrestit.¹⁴

6.1 Zbatimi i paraburgimit ndaj të miturit

Të miturit mbahen në paraburgim në qendrën e paraburgimit të ndarë nga të paraburgosurit madhorë. Megjithatë, në rastet kur konsiderohet të jetë në interes të të miturit ai mund të mbahet në paraburgim edhe në institucionin edukativo korrektues.¹⁵

Me lejen e gjyqtarit për të mitur, të miturin e paraburgosur mund ta vizitojnë të afërmit e tij e me kërkesën e mjekut edhe persona tjerë. Po ashtu, i mituri i paraburgosur mund të mbajë korrespondencë dhe kontakte tjera me personat jashtë institucionit të paraburgimit me lejen dhe nën mbikëqyrjen e gjyqtarit për të mitur. Nën kushte të caktuara ligjore, kur kjo konsiderohet e dëmshme për zhvillimin e procedurës, të miturit mund t'i ndalohej përkohësisht dorëzimi ose pranimi i dërgesave si dhe kontakti me personat tjerë, por kjo duhet të jetë përjashtim. Sidoqoftë, nuk mund të ndalohej dërgimi i kërkesave, ankesave dhe komunikimi i të miturit me mbrojtësin e tij.

Derisa mbahet në paraburgim, të miturit, sipas nevojës dhe në përputhje me moshën, gjininë dhe personalitetin e tij, i ofrohet ndihmë sociale, edukative, psikologjike, mjekësore dhe fizike.¹⁶

7. Paraburgimi për personat me çrregullime mendore

Përveç rasteve të parapara me nenin 187 të KPPRK-së ku mund të urdhërohet paraburgimi, Gjykata mund të urdhërojë paraburgim ndaj personit nëse:

- ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer vepër penale;

¹³ Shih nenin 66 paragraf 2 dhe 3 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur

¹⁴ Shih nenin 68 paragraf 2 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur

¹⁵ Shih nenin 67 paragraf 1 dhe 2 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur

¹⁶ Shih nenin 67 paragraf 3 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

- në bazë të ekzaminimit psikiatrik të urdhëruar sipas nenit 508 të këtij Kodi, personi ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale;
- personi aktualisht vuan nga çrregullimi mendor, dhe si rezultat i kësaj, ka arsye për të besuar se ai do të rrezikojë jetën apo shëndetin e ndonjë personi tjetër.

Paraburgimi mund të urdhërohet vetëm nëse prokurori i shtetit ka paraqitur propozimin. Paraburgimi i tillë mbahet në institucionin e kujdesit shëndetësor dhe mund të zgjasë për aq kohë sa i pandehuri është i rrezikshëm, por që nuk kalon afatet e parapara për paraburgim në nenin 190 të KPPRK-së.

Kur i pandehuri ndodhet në paraburgim dhe konstatohet se ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore në kohën e kryerjes së veprës penale, gjykata me aktvendim urdhëron që i pandehuri të mbajë paraburgimin në institucionin e kujdesit shëndetësor nëse ai aktualisht ndodhet në gjendje të çrregullimit mendor, ku një kopje e aktvendimit i dërgohet prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, institucionit mjekësor dhe qendrës së paraburgimit.¹⁷

8. Trajtimi i masës së paraburgimit sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e njeriut

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton qartë se heqja e lirisë duhet të trajtohet me shpejtësi, “Çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme”.¹⁸

Neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut parasheh se çdo person ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë. E gjithë barra për arsyeshmërinë e qëndrimit të një personi në paraburgim, bie mbi prokurorin, i cili duhet të argumentojë dyshimin e bazuar para gjykatës, të mbështetur në prova dhe fakte, që një

¹⁷ Shih nenin 509 paragraf 3 dhe 4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

¹⁸Shih nenin 5 paragraf 3 të KEDNj-së.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

person ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet dhe se i njëjti duhet të qëndrojë në paraburgim.

Sipas nenit 5 të KEDNj-së, askujt nuk mund ti hiqet liria me përjashtim të rasteve të cilat janë në përputhje me procedurat ligjore:

- a. kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;
 - b. kur arrestohet ose burgoset ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;
 - c. kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u dërguar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar që ai ka kryer një vepër penale, ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e domosdoshme që të pengohet të kryej një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;
 - d. kur është fjala për heqjen e lirisë së një të mituri ligjërisht, për të cilin është vendosur për edukim të mbikëqyrur, ose për heqjen e rregullt të lirisë së tij, me qëllim për ta dërguar përpara autoritetit gjyqësor kompetent;
 - e. kur është fjala për heqjen ligjërisht të lirisë së një personi për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve, të një të çmenduri, të një alkooliku, të një toksikomani ose të një vagabondi;
 - f. kur është fjala për arrestimin ose burgimin e ligjshëm të një personi me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e parregullt në atë vend, ose kundër të cilit është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi;
2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet, brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me akuzën që i bëhet.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

3. Çdo person i arrestuar dërgohet menjëherë përpara një gjykatësi ose magjistrati tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet gjatë procedurës. Lirimi mund të kushtëzohet me një garanci që siguron paraqitjen e personit të interesuar përpara gjykatës.
4. Çdo person të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të paraqes ankim përpara një gjykate me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe urdhëroi lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.
5. Çdo person, viktimë e një arrestimi ose një burgimi në kushte të kundërta me dispozitat e këtij neni ka të drejtë për dëmshpërblim.

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, në nenin 5 e ka të përcaktuar parimin për “Gjykim të drejtë, të paanshëm dhe në afat të arsyeshëm”. Edhe pse konventa nuk përcakton saktë kohën sa një i pandehur duhet të qëndrojë në paraburgim, afati kohor sa i përket qëndrimit në paraburgim para ngritjes së aktakuzës është specifikuar në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, sipas të cilës para ngritjes së aktakuzës, për vepra të rënda penale paraburgimi mund të zgjasë më së shumti deri në një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej tetëmbëdhjetë (18) muajsh.¹⁹

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) i ka kushtuar rëndësi të veçantë masës së paraburgimit, me të vetmin qëllim që organet e drejtësisë t’i peshojnë si duhet dhe sa duhet arsyet në çdo rast kur mendojnë të caktojnë paraburgimin. Sipas KEDNj-së: “Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht”.²⁰ Edhe ligjet e zbatueshme në Kosovë e përcaktojnë në mënyrë strikte “Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përpos rasteve dhe në pajtim me procedurën e përcaktuar me ligj”.²¹

¹⁹ Shih nenin 190 paragraf . 2 (1, 2) paragraf 3 dhe 4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

²⁰Shih nenin 6 par.2 të Konventes Evropiane për te Drejtat e Njeriut.

²¹Shih nenin 12 par. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Mungesën e përgjithshme të referimit të fakteve, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut kërkojnë nga gjykatat që ato të ofrojnë arsye të hollësishme dhe të mjaftueshme në vendimet e tyre.²² Një vendim i arsyetuar duhet ta zbatojë ligjin sipas fakteve specifike të lëndës dhe nuk duhet të jetë “i përgjithësuar apo abstrakt.” Arsyetimi adekuat i vendimit mbi caktimin e paraburgimit është i nevojshëm për të pandehurit për ta ushtruar të drejtën e tyre për ta kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit përmes ankesës ose një kërkesë ‘habeas corpus’.

Kodi i procedurës penale i Kosovës (KPPPK) kërkon nga gjykata që, kur të caktojë paraburgimin, të japë “arsyetimin e fakteve vendimtare që e kanë shkaktuar paraburgimin, duke përfshirë edhe arsyet për dyshim të bazuar se personi ka kryer veprë penale, dhe faktet vendimtare nga neni 281.”²³

Përfundime dhe Rekomandime

Pas punës në hulumtimin dhe studimin e masës së paraburgimit si masë për praninë e të pandehurit në procedurën penale, pengimin e ri kryerjes së veprës penale dhe zhvillimin me sukses të procedurës penale, mund të konstatohet:

1. Paraburgimi si masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit, e cila u trajtua në këtë punim, është njera ndër masat më të ashpra dhe njëhëkohsisht e fundit për sigurimin e rrjedhës së suksesshme të procedurës penale, pasi që me këtë masë kufizohen të drejtat e njeriut.

²² Shih, për shembull, lëndën Smirnova kundër Rusisë, GjEDNJ, Aktgjykimi i 24 tetorit 2003, paragrafët . Gjykata gjeti që paraburgimi i aplikuesve gjatë hetimeve kishte përbërë shkelje të nenit 5 të KEDNJ-së pasi që vendimet që i kishte nxjerrë gjykata ishin “tejet të shkurtra” dhe “nuk i përshkruanin hollësisht karakteristikat e situatës së aplikuesve”. (paragrafët 70-71)

²³ Shih nenin 283(1) të KPPPK-së. Për më tepër, sipas Qarkores së drejtësisë nr. 2000/27, të datës 19 dhjetor, të gjitha paraburgimet duhet të caktohen me vendim me shkrim të arsyetuar në mënyrë të plotë dhe ku janë përshkruar hollësisht bazat e paraburgimit dhe provat në përkrahje të këtyre bazave. Gjyqtarët e procedurës paraprake gjithashtu duhet t’i ofrojnë arsyet përse nuk janë të mjaftueshme masat alternative ndaj paraburgimit. (shih nenin 281(1)3 të KPPPK-së). KPPPK-ja u shpall me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/25 më 6 korrik 2003, dhe u ndryshua më vonë.

2. Kodi i Procedurës Penale përveç masës së paraburgimit ka paraparë edhe masa tjera për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale të cilat janë thirrja, urdhërarrestit, premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, dorëzania, ndalimi për t'i ofruar vendit ose personit të caktuar, paraqitja në stacionin policor, arresti shtëpiak, diversion.
3. Paraburgimit si masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale rëndësi të veçantë i ka kushtuar edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ku ka përcaktuar qartë se heqja e lirisë duhet të trajtohet me shpejtësi, “Çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme.
4. Nëse marrim parasysh aktet nderkombetare, siç është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është e preferueshme që paraburgimi të shqiptohet s’i masë e fundit në raport me masat tjera të parapara në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.
5. Në këtë analizë është munduar të hedhet dritë edhe në shqiptimin e masës së paraburgimit, në rastet kur kjo masë zbatohet ndaj personave të mitur dhe personave me çrregullime mendore.

Nga konkluzionet përfundimtare të këtij punimi mund të nxirren këto rekomandime kryesore.

- *Ç’do person ka të drejtë në liri dhe siguri;*
- *Askush nuk duhet të jetë subjekt i arrestimit dhe paraburgimit arbitrar;*
- *Askush nuk mundë të privohet nga liria përveç për arsye të caktuara dhe në pajtim me procedurën e caktuar që është vendosur me ligj.*

Bibliografia:

Kodi penal i Republikës së Kosovës

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Kodi i Drejtësisë për te Mitur

Konventa Evropianë për te Drejtat e Njeriut

Komentari i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Moduli i Kodit Penal të Republikës së Kosovës – Akademia e Drejtësisë, Prishtinë 2016

Besart Mustafa*

AKTAKUZA-FAZA E NGRITJES SË AKTAKUZËS DHE DEKLARIMIT

Abstrakt

Faza e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit është risi e përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale.¹

Bazuar në KPP, procedura penale ndahet në katër faza: *fazën e hetimit, fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit, fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe fazën e mjetit juridik*. Kështu që, faza e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit është një prej katër fazave të procedurës penale, por ndoshta më rëndësishmja, sepse pa këtë fazë nuk pasojnë dy fazat e radhës, faza e shqyrtimit gjyqësor, e cila është fazë shumë e rëndësishme sidomos sa i përket gjykatës dhe faza e mjetit juridik.

Faza e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit fillon kur prokurori i shtetit ngrit aktakuzë sipas nenit 241 të KPP pas përfundimit të hetimit ose drejtpërdrejt pa zhvilluar hetime për disa vepra penale, asnjëra nga të cilat nuk dënohet me më shumë se tre vjet burgim dhe prokurori i shtetit vlerëson se ekziston dyshim i bazuar mirë për të mbështetur aktakuzën.

Qëllimi i këtij punimi është trajtimi i kësaj teme, duke u mbështetur në aspektin teorik, ligjor dhe praktik, pasi që nuk është trajtuar shumë dhe si i tillë ky punim synon studimin e fazës së ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit. Metodat e përdorura në realizimin e këtij punimi janë: metoda juridike, metoda sociologjike, metoda e analizës dhe metoda statistikore.

Fjalët kyçe: aktakuza, faza e ngritjes së aktakuzës, faza e deklarimit, shqyrtimi fillestar, shqyrtimi i dytë.

* Autori mban titullin shkencor Ma.Sc. i Juridikut-Kushtetues Administrativ dhe pozitën Prokuror i Shtetit.

¹ Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13 dhjetor 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

Hyrje

Prokurori i shtetit është palë, që ka rol aktiv në katër fazat e procedurës penale: fazën e hetimit, fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit, fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe fazën e mjetit juridik. Në këtë aspekt shihet qartë roli dhe rëndësia e prokurorit në katër fazat e procedurës penale, por duhet thënë se në dy fazat e para, në fazën e hetimit dhe fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit, roli i prokurorit është rol kryesor, pasi që me KPP, prokurori i shtetit i zbaton hetimet dhe është prokurori, ai që ka të drejtën dhe detyrimin e ngritjes së aktakuzës. Pa ngritjen e aktakuzës nga prokurori i shtetit, procedura penale përfundon pa shqyrtim gjyqësor, gjegjësisht me aktvendim të prokurorit të shtetit për hudhjen e kallëzimit penal apo me aktvendim për pushimin e hetimeve siç përcaktohet me KPP.

Përveç me dispozitat e KPP, për shkak të rëndësisë që ka, faza e ngritjes së aktakuzës është tejet e madhe dhe si e tillë është e rregulluar edhe me dispozita të së drejtës ndërkombëtare, si dhe me dispozita kushtetuese. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, në nenin 6 - *E drejta për një proces të rregullt*, përmban dispozita për gjykimin e drejtë, po ashtu Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban parime, që garantojnë të drejtat e personit të akuzuar në këtë fazë të procedurës penale, përkatësisht në nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe në nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].

Këto dispozita parimore inkorporohen dhe sqarohen më hollësisht në KPP dhe kjo fazë sikurse edhe fazat e tjera është tejet formale, sepse rregullohet deri në detaje zbatimi i këtyre të drejtave në procedurën penale.

Në këtë punim trajtohet faza e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit, si dhe trajtohen aspekte përmbajtësore të aktakuzës, si një akt tejet formal i hartuar dhe i ngritur nga prokurori i shtetit. Faza e ngritjes së aktakuzës është kapitull i veçantë në kuadër të KPP, përkatësisht *Kapitulli XV-Faza e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit*, që përfshinë të gjitha nenet në kuadër të këtij kapitulli, nenet 240-256. Ndonëse faza e ngritjes së aktakuzës i referohet aktakuzës si akt akuzues, në procedurën penale akte akuzuese në kuptimin e gjerë janë edhe propozimi i prokurorit të shtetit për shqiptimin e masës edukative apo dënimit për të mitur dhe propozimi i prokurorit të shtetit për

shqiptimin e masës për trajtim të detyrueshëm psikiatrik. Në këtë punim do të trajtohet vetëm faza e ngritjes së aktakuzës dhe aktakuza në përgjithësi, pa u ndalur në trajtimin e posaçëm të këtyre akteve tjera akuzuese.

1. Nocioni i aktakuzës

KPP nuk përmban dispozita përkufizuese sa i përket nocionit të aktakuzës, ndonëse në nenin 19 të KPP jepen përkufizime të shprehjeve të përdorura në këtë kod.

Fjalori i gjuhës shqipe termin aktakuzë e përkufizon: dokument me të dhënat e akuzës së prokurorisë kundër një të pandehuri në gjyq.²

Përkufizimi i aktakuzës bëhet kryesisht në aspektin juridik nga doktrina juridike. Në teorinë e procedurës penale aktakuza përkufizohet kështu: “Aktakuza është akt formal të cilën në formë të shkruar, e paraqet në gjykatë prokurori i shtetit përmes së cilës kërkohet nga gjykata që të caktohet shqyrtimi gjyqësor, kundër personit të caktuar për veprën penale të caktuar”.³ Por edhe përkufizimet e tjera, kryesisht janë të ngjashme. Më poshtë po japim edhe një përkufizim tjetër. Aktakuza është akt formal me të cilin kërkohet nga gjykata që të caktohet shqyrtimi gjyqësor kundër personit të caktuar për veprën penale të caktuar.⁴ Pra, përkufizimet kryesisht janë të ngjashme, kështu që mund të themi se aktakuza është akt i përpiluar nga prokurori i shtetit kundër personit apo personave të akuzuar për veprën penale, e paraqitur në gjykatë dhe të cilën gjykata mund ta hudh, të refuzoj apo të akuzuarin ta shpall fajtor. Sa i përket aktakuzës mund të themi se është një nga aktet procedurale penale më të rëndësishme nga prokurori i shtetit, por edhe në procedurë penale dhe si e tillë faza e ngritjes së aktakuzës është fazë e veçantë në procedurën penale.

Faza e ngritjes së aktakuzës është faza e dytë, e cila fillon pas përfundimit të hetimit ose kur prokurori i shtetit konsideron se informacionet me të cilat ai

² Fjalori i shqipes së sotme, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, botimet “Toena”, Tiranë, 2002, faqe 33.

³ Instituti Gjyqësor i Kosovës, Kodi i Procedurës Penale, Material për prokurorët e sapoemëruar, Prishtinë, 2016, faqe 70.

⁴ Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013, fq. 334.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

disponon për veprën penale dhe kryesin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprë penale apo vepra penale. Rëndësia e kësaj faze është shumë e madhe, sepse është faza me të cilin prokurori i shtetit finalizon veprimin e tij kryesor procedurale ngritjen e aktakuzës, për arsye se procedura para gjykatës mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit.

Ngritja e aktakuzës është e kushtëzuar me përfundimin e hetimit dhe dyshimin e bazuar mirë, në të kundërtën prokurori i shtetit i përfundon hetimet me nxjerrjen e aktvendimit për pushimin e hetimit.

Mundësia e ngritjes së aktakuzës në mënyrë direkte, pa fillimin e hetimit është e rregulluar me dispozita ligjore dhe kushtëzohet me lartësi të dënimit. Kështu, në nenin 101 paragrafi 2 të KPP, është parashikuar se *“Kur policia apo ndonjë person tjetër bën kallëzim tek prokurori i shtetit për një dyshim të arsyeshëm për një veprë penale ose për disa vepra penale, asnjëra nga të cilat nuk dënohet me më shumë se tre vjet burgim dhe prokurori i shtetit vlerëson se ekziston dyshim i bazuar mirë për të mbështetur aktakuzën, prokurori i shtetit mund të ngrit aktakuzë sipas nenit 241 të këtij Kodi”*.

2. Përmbajtja e aktakuzës

Si akt tejet formal, përmbajtja e aktakuzës është e përcaktuar me dispozitat e KPP, në të cilat deri në detaje përcaktohet përmbajtja e aktakuzës.

Sipas nenit 241 paragrafi 1 të KPP, aktakuza përmban:

1.1. përcaktimin e gjykatës ku do të mbahet shqyrtimi gjyqësor;

1.2. emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhënat e tij personale;

1.3. të dhënat nëse është shqiptuar paraburgimi dhe sa kohë ka zgjatur ose masat e urdhëruara kundër të pandehurit për sigurimin e pranisë së tij, nëse ai ndodhet në liri dhe nëse ai është liruar para ngritjes së aktakuzës, sa është mbajtur në paraburgim.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

1.4. kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, objektin në të cilin është kryer dhe mjetin me të cilin është kryer vepra penale, si dhe rrethanat tjera të nevojshme për të përcaktuar me saktësi veprën penale;

1.5. emërtimin ligjor të veprës penale duke i'u referuar dispozitave të Kodit Penal;

1.6. Rekomandimin për provat që duhet prezentuar në shqyrtimin gjyqësor së bashku me emrat e dëshmitarëve dhe ekspertëve, shkresat që duhet lexuar dhe sendet që duhet marrë si provë.

1.7. Shpjegimin e arsyeve për ngritjen e aktakuzës bazuar në rezultatet e hetimit dhe provat që vërtetojnë faktet kryesore;

1.8. Nëse është zbatuar mundësia hetuese e veçantë, në aktakuzë duhet të ceken emrat e gjyqtarëve të kolegjit që ka drejtuar mundësinë hetuese të veçantë.

1.9. Aktakuza përcakton me saktësi çdo ndërtesë, pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme, fonde apo pasuri tjera që mund t'i nënshtrohen konfiskimit. Aktakuza po ashtu përshkruan provat e nevojshme që kërkohen për të arsyetuar konfiskimin nga Kapitulli XVIII i këtij Kodi.

Kjo përmbajtje nuk është në tërësi e domosdoshme në secilën aktakuzë, prandaj, ndahen elementet fakultative dhe elementet e detyrueshme.

Elementet e detyrueshme duhet t'i ketë çdo aktakuzë, ndërsa, elementet fakultative nuk janë të domosdoshme për çdo aktakuzë.

Elementet e *domosdoshme* të aktakuzës përcaktohen në paragrafin 1 të nenit 242 të KPP, ndërsa, elementet *fakultative* në paragrafin 2 dhe 3 të nenit 241 të KPP.⁵

Po ashtu në aktakuzë prokurori mund të propozojë që të jepet urdhri për paraburgim, ndërsa, kur i pandehuri gjendet në paraburgim mund të propozojë që ai të lirohet. Sipas nenit 241 paragrafi 3 të KPP, një aktakuzë mund të ngritet për disa vepra të ndryshme penale ose ndaj disa të pandehurve kur zbatohet procedura e përbashkët.

⁵ Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep; Elshani, Xhevdet: Komentar, Kodi i Procedurës Penale, Prishtinë, 2014 faqe 620.

3. Procedura për ngritjen e aktakuzës

Aktakuzën e ngrit prokurori i shtetit në përputhje me procedurën e përcaktuar me dispozitat ligjore procedurale të parapara në KPP.

*Aktakuza i paraqitet gjykatës kompetente në aq kopje sa ka të pandehur dhe mbrojtës të tyre dhe një kopje shtesë për gjykatën. Gjithashtu, gjykatës i dërgohet edhe lënda komplete e hetimit nga prokurori i shtetit.*⁶

Pas paraqitjes në gjykatë roli i prokurorit lidhur me ngritjen e aktakuzës përfundon dhe i mbetet gjykatës që të caktoj gjyqtarin ose trupin gjykues me kryetarin e tij nëpërmjet një procesi transparent për caktimin e çështjeve. Me paraqitjen e aktakuzës në këtë fazë të procedurës penale realizohet parimi akuzator “*nemo iudex sine actore*”.⁷

Nëse është zbatuar mundësia hetuese e veçantë, njëri nga gjyqtarët e kolegjit caktohet si gjyqtar i vetëm gjykues ose si kryetar i trupit gjykues ose si anëtar i trupit gjykues.

Pas pranimit të aktakuzës bazuar në dispozitat e nenit 242 të KPP, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton sipas detyrës zyrtare nëse ka kompetencë mbi çështjen që përmban aktakuzën, kështu që nëse kanë kompetencë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës, ndërsa nëse i pandehuri mbahet në paraburgim, shqyrtimi fillestar mbahet jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ngritjes së aktakuzës. Lidhur me kohën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, njoftohen prokurori i shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre.

Sa është numri i aktakuzave të ngritura në vitin e fundit, vitin 2016 në nivel të prokurorive në Republikën e Kosovës mund ta dimë nëse i referohemi Raportit të Punës së Prokurorit të Shtetit, 2016, pasi janë publikuar edhe këto të dhëna për Prokuroritë Themelore-Departamentet e Përgjithshme.

Nga numri i kallëzimeve penale në punë, në periudhën raportuese PTh-të kanë arritur që t'i procedojnë tek organet kompetente – gjykatat, 25,151 kallëzime penale ndaj 30,505 personave. Kallëzimet e zgjidhura penale të 30,505 personave kanë përfunduar si në vijim:

⁶ Neni 242 paragrafi 1 i KPP.

⁷ Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Prishtinë, 2015, faqe 274.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

- Me aktakuzë të drejtpërdrejt i kanë përfunduar 14,509 ose 47,56% të personave;
- Me aktakuzë me kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor kanë përfunduar 5347 ose 17,53 % të personave;
- Me hedhje të kallëzimit penal janë zgjidhur 5008 ose 16,42 % të personave;

prej hedhjeve të gjithmbarshme, rastet e 436 personave janë dërguar në procedurë kundërvajtjes;

- Me propozim për shqiptimin e masave për trajtim të detyrueshëm janë përfunduar rastet e 62 ose 0,2% të personave.⁸

Pra, nga statistikat e periudhës raportuese, vitit 2016, shihet se përqindja më e madhe e rasteve është përfunduar me ngritje të aktakuzës së drejtpërdrejt, si dhe me pastaj vijnë rastet me aktakuzë me urdhër ndëshkimor, gjë që kuptohet, pasi që janë shfrytëzuar mundësitë ligjore për ngritjen e aktakuzës së drejtpërdrejt dhe aktakuzës me urdhër ndëshkimor, përkatësisht lartësia maksimale e dënimit deri në 3 vjet. Një zgjidhje e tillë ligjore ndikon në efikasitetin dhe ekonomizimin e procedurës penale.

4. Shkresat që plotësojnë aktakuzën dhe materialet që i jepen të pandehurit me ngritjen e aktakuzës

4.1. Shkresat që plotësojnë aktakuzën

Shkresat, të cilat e plotësojnë aktakuzën, të cilat nuk janë të domosdoshme të dorëzohen çdo herë me aktakuzën apo më pas, paraqiten vetëm kur është e nevojshme.

Sipas nenit 243 paragrafi 1.1 të KPP, prokurori i shtetit kur është e nevojshme paraqet mbështetjen e pohimit nga neni 263 të këtij kodi së bashku me deklaratat e marra nga neni 132 të këtij kodi apo provat e siguruar nga neni 219, paragrafi 6 të këtij kodi, të cilat synon t'i paraqes si prova të drejtpërdrejta pa praninë e dëshmitarëve.

⁸ Raporti i Punës i Prokurorit të Shtetit, 2016.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Po ashtu, sipas neni 243, paragrafi 2 të KPP, prokurori i shtetit paraqet kërkesë për të vazhduar apo për të zbutur ndonjë nga masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit.

4.2 Materialet të cilat i jepen të pandehurit me ngritjen e aktakuzës

Nëse nuk i janë dhënë mbrojtësit gjatë hetimit, me ngritjen e aktakuzës prokurori i shtetit i siguron mbrojtësit apo mbrojtësit kryesor materialet ose kopjen e tyre, të cilat janë në posedim, në kontroll ose në mbrojtje të tij, si në vijim:

1.1. procesverbalet mbi deklaratimet ose pohimet, të nënshkruara apo të panënshkruara nga i pandehuri;

1.2. emrat e dëshmitarëve të cilët prokurori i shtetit ka ndërmend t'i thërret për dëshmim dhe çdo deklaratim të mëhershëm të dhënë nga dëshmitarët e tillë;

1.3. të dhënat mbi identifikimin e personave për të cilët prokurori i shtetit e di se posedojnë prova të pranueshme dhe shfajësuese ose informata lidhur me çështjen dhe çdo procesverbal të deklaratimeve, të nënshkruar apo të panënshkruar nga personat e tillë për këtë çështje;

1.4. rezultatet e ekzaminimit fizik dhe mendorë, testet shkencore ose eksperimentet e bëra lidhur me çështjen;

1.5. kallëzimet penale dhe raportet e policisë; dhe

1.6. përmbledhjet ose referencat për provat materiale të mbledhura gjatë hetimit.⁹

Vlen të potencohet se deklaratimet e dëshmitarëve i vihen në dispozicion të pandehurit në gjuhën, që ai e kupton dhe e flet, ndërsa pas ngritjes së aktakuzës prokurori i siguron mbrojtësit çfarëdo materiali të ri të cekur më lart brenda dhjetë ditëve pas pranimit.

Me sigurimin e materialeve të lartcekura të pandehurit nga prokurori i shtetit zbatohet me përpikëri parimi i barazisë së palëve në procedurën penale, kështu që i pandehuri dhe prokurori i shtetit kanë pozitë të barabartë.

Megjithatë, prokurori i shtetit, informacionet mbi provat mbështetëse përjashtimisht mund t'i paraqes edhe pas ngritjes së aktakuzës me kusht që ka mundur ta dijë bazën për paraqitjen e njoftimit apo kërkesës në kohën kur është ngritur aktakuza. Duke mos precizuar se deri në cilin moment procedural

⁹ Neni 244, nënparagrafët 1.1-1.6 të paragrafit 1 të KPP.

prokurori i shtetit mund të paraqes dokumentet nga nënparag. 1 parag. 1 të këtij neni, atij praktikisht i lihet hapësirë të gjerë të përdorimit të këtyre dokumenteve.¹⁰

5. Shqyrtimi fillestar

Pas ngritjes së aktakuzës, gjykata mban shqyrtimin fillestar, ku duhet të jenë të pranishëm prokurori i shtetit, i pandehuri apo të pandehurit dhe mbrojtësit. Shqyrtimi fillestar është shqyrtimi i parë i aktakuzës, para se i pandehuri të nxirret në shqyrtim gjyqësor, pasi që zhvillohen dy shqyrtime para shqyrtimit gjyqësor, shqyrtimi fillestar dhe shqyrtim i dytë.

Në seancën e shqyrtimit fillestar si rregull i bëhet një vlerësim paraprak ligjshmërisë së aktakuzës, por edhe i rrethanave tjera që i kanë paraprirë ngritjes së saj.¹¹ Shqyrtimi fillestar përbën fazën e parë të kontrollimit të aktakuzës. Kontrollimi i aktakuzës në shqyrtimin fillestar realizohet me pjesëmarrjen e subjekteve procedurale përkatëse.¹²

Obligimet e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues në shqyrtimin fillestar janë të përcaktuar në dispozitat e nenit 245 të KPP dhe atë:

- I jep kopjen e aktakuzës të pandehurit apo të pandehurve, nëse ata nuk i kanë pranuar këto kopje të aktakuzës më parë;
- Vendos për të gjitha propozimet për të vazhduar apo zbatuar masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit;
- Siguron që prokurori i shtetit të ketë përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 i KPP (materialet që i jepen të pandehurit me ngritjen e aktakuzës);
- Cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga

¹⁰ Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep; Elshani, Xhevdet: vepra e cituar, faqe 630.

¹¹ Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Prishtinë, 2015, faqe 276.

¹² Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep; Elshani, Xhevdet: vepra e cituar, faqe 635.

shqyrtimi fillestar. Me caktimin strikt të periudhës kohore brenda së cilës duhet të mbahet shqyrtimi i dytë, KPP synon arritjen e dy qëllimeve: a) mbrojtjen e të drejtave të pandehurit në procedurën penale dhe b) efikasitetin e procedurës penale.¹³

Po ashtu me dispozitat e nenit 245 të KPP, përcaktohet në mënyrë shprehimore që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues të njofton të pandehurin dhe mbrojtësin se para shqyrtimit të dytë, ata duhet:

- Të paraqesin kundërshtimet e tyre për provat e cekura në aktakuzë;
- Të paraqesin kërkesat për hudhjen e aktakuzës nëse është e ndalur ligjërisht; dhe
- Të paraqesin kërkesat për hudhjen e aktakuzës për shkak të mospërskkrimit të veprës penale sipas ligjit.

Shqyrtimi fillestar si fazë e kontrollimit të aktakuzës dhe deklaramit të pandehurit dallon nga shqyrtimi gjyqësor sepse asnjë dëshmitar apo ekspert nuk merret në pyetje dhe asnjë provë nuk paraqitet gjatë shqyrtimit fillestar, përveç, nëse dëshmitari është i nevojshëm për marrjen e vendimit mbi vazhdimin ose zbatimin e masave për të siguruar praninë e të pandehurit.

6. Pranimi i fajësisë dhe marrëveshja për pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar

6.1. Pranimi i fajësisë

Në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e udhëzon të pandehurin për të drejtën e tij:

1. për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë;
2. të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij;
3. të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

¹³ Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep; Elshani, Xhevdet: vepra e cituar, faqe 637.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Këto të drejta janë garanci procedurale që shqyrtimi fillestar të zhvillohet drejt dhe në përputhje me standardet më të avancuara të lirive dhe të drejtave të njeriut. Këto të drejta janë të përcaktuara në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.¹⁴

Roli i gjyqtari të vetëm gjykues ose kryetarit të trupi gjykues është roli kryesor, prandaj, çmon nëse e drejta e të pandehurit në mbrojtës është respektuar dhe nëse prokurori i shtetit ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 i KPP.

Veprim tjetër procedural që ndërmerret pastaj është leximi i aktakuzës nga prokurori i shtetit.

Leximi aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit është shprehje e parimit akuzator në procedurën penale. Leximi i aktakuzës, në shqyrtimin fillestar ka për qëllim që të pandehurit, të cilit i është dorëzuar aktakuza më parë, të njihet drejtpërsëdrejti nga prokurori i shtetit me aktakuzën a paraqitur.¹⁵

Sipas dispozitave procedurale pasi që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, të pandehurit i ofron mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm. Nëse i pandehuri nuk e ka kuptuar aktakuzën, dispozitat procedurale parashohin edhe një mundësi shtesë me qëllim që i pandehuri ta kuptojë aktakuzën, përmes kësaj mundësie kërkohet që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues të thërret prokurorin e shtetit që t'ia shpjegojë aktakuzën të pandehurit. Pasi të ketë kuptuar aktakuzën, i pandehuri deklarohet lidhur me fajësinë, përkatësisht ta pranojë fajësinë apo mos ta pranojë, por dispozitat e nenit 246, paragrafi 4 të KPP, parashohin edhe situatën kur i pandehuri nuk deklarohet dhe nëse i pandehuri nuk dëshiron të bëjë ndonjë deklaram lidhur me fajësinë e tij, konsiderohet se ai nuk e pranon fajësinë.

¹⁴ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, në nenin 6, paragrafi 3-c parasheh të drejtën që çdo njeri i akuzuar për një vepër penale të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës ligjore sipas zgjedhjes së tij ose, në qoftë se nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar, ndihma ligjore t'i jepet falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë. Ndërsa, Kushtetua e Republikës së Kosovës në nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] parasheh këtë të drejtë.

¹⁵ Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep; Elshani, Xhevdet: vepra e cituar, faqe 641.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Pasi që pranimi i fajësisë nga i pandehuri të bëhet për të gjitha pikat e aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kujdeset nëse:

1.1. i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;

1.2. pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, nëse i pandehuri ka mbrojtës;

1.3. pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i pandehuri; dhe

1.4. aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.¹⁶

Me rastin e pranimin të fajësisë nga i pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk ka obligim të kërkoj mendimin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit, por mund ta kërkoj, prandaj kjo mbetet në diskrecion të gjyqtarit që të marr një mendim dhe nuk mbetet i lidhur me këtë mendim.

Sipas dispozitave ligjore të KPP, kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk bindet se janë vërtetuar faktet lidhur me pranimin e fajësisë të cekura në mënyrë taksative në nenin 248, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1-1.4 të KPP, ai merr aktvendim me të cilin refuzon pranimin e fajësisë dhe procedon shqyrtimin fillestar sikur pranimi i fajësisë të mos ishte bërë. Ndërsa, kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues bindet se janë vërtetuar faktet e lartcekura, merr aktvendim me të cilin pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe vazhdon me shqiptimin e dënimit, caktimin e seancës për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me dënimin ose e pezullon dënimin deri në përfundimin e bashkëpunimit të të pandehurit me prokurorin e shtetit. Çështja e shqiptimit të dënimit nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues është paraparë me dispozita të KPP, por edhe forcohet me mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës nr.GJA .nr. 207/13.¹⁷

¹⁶ Neni 248, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1.-1.4 i KPP.

¹⁷ Mendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës GJA. nr.207/13 përcakton në mënyrë shprehimore: “Nëse i pandehuri ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar para gjyqtarit të vetëm apo kryetarit të trupit gjykues dhe gjyqtari i vetëm përkatësisht kryetari i trupit gjykues, vlerëson se pranimi është bërë në pajtim me ligjin, d.m.th janë përmbushur të gjitha parakushtet ligjore për pranimin e fajësisë që kërkohen me ligj, në një situatë të tillë, gjyqtari

Pranimi i fajësisë nga i pandehuri nuk është një e drejtë, që shfrytësohet vetëm në shqyrtimin fillestar, pasi që një gjë të tillë i pandehuri mund ta shfrytëzojë edhe më vonë.

Dispozitat e paragrafit 5 të nenit 248 të KPP i njohin të drejtën të pandehurit, i cili nuk pranon fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar se mund të ndryshojë deklaratën e tij dhe të pranojë fajësinë në çdo kohë dhe që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues zbaton përshtatshmërisht shqyrtimin e njëjtë. Kjo është një e drejtë që të pandehurit nuk i mohohet, përkundër që ka mundur të deklarojë njëherë se nuk e pranon fajësinë, kështu që vërehet se ligjdhënësi të pranojë fajësinë kurdo që ai bindet.

6.2 Marrëveshja për pranimin e fajësisë

Nëse së bashku me aktakuzën prokurori i shtetit paraqet marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, atëherë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues çmon marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe e pranon atë, e refuzon atë ose cakton shqyrtim të veçantë për pranimin e fajësisë siç parashihet në dispozitat e KPP, neni 248 - *Pranimi i fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar* dhe në përputhje me dispozitat e neni 233 - *Negocimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë*.

Me dispozitat për marrëveshjen e pranimit të fajësisë në shqyrtim fillestar është përcaktuar se i pandehuri mund ta ndryshojë deklaratën e tij dhe ta pranojë fajësinë dhe favoret ligjore lidhur me këtë ndryshim: *“Nëse i pandehuri deklarohej i pafajshëm, gjykata nuk mund ta dënojë të pandehurin, përveç nëse i pandehuri e ndryshon deklaratën e tij dhe pranon fajësinë, ose nëse gjykata e shpall fajtor të pandehurin pas shqyrtimit gjyqësor, pavarësisht nga marrëveshja mbi pranimin e fajësisë”*.¹⁸

Madje një mundësi favorizuese për të akuzuarin është paraparë, sepse gjykata mundet që marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ose pranimin e fajësisë ta shqyrtoj jo vetëm në shqyrtim fillestar, por në çdo kohë para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

i vetëm, përkatësisht kryetari i trupit gjykues mund të vazhdojë procesin me shqiptimin e dënimit, pa shkuar fare në shqyrtim si dhe pa plotësuar fare trupin gjykues edhe kur ligji për vepra të tilla parashikon që trupin gjykues ta përbëjnë tre (3) gjyqtarë profesionistë”.

¹⁸ Neni 247 i KPP.

7. Kundërshtimi i provave, kërkesa për hudhjen e aktakuzës dhe përgjigjet e prokurorit të shtetit

Gjatë kohës së kontrollit të aktakuzës, para shqyrtimit të dytë, i pandehuri mund të paraqesë kundërshtim ndaj provave të caktuara në aktakuzë, si dhe mund të paraqesë kërkesë për hudhjen e aktakuzës.

Kundërshtimin ndaj provave të caktuara i pandehuri mund ta paraqesë për këto arsye:

- 1. provat nuk janë marrë në mënyrë të ligjshme nga policia, prokurori i shtetit ose organi tjetër qeveritar;*
- 2. provat janë në kundërshtim me rregullat nga Kapitulli XVI i KPP ose*
- 3. ka bazë të artikuleshme që gjykata të çmojë provën si thelbësisht të pambështetshme.¹⁹*

Ndërsa, kërkesën për hudhjen e aktakuzës, i pandehuri mund ta paraqesë bazuar në dispozitat e nenit 250 të KPP, për arsye:

- 1. vepra për të cilën akuzohet nuk përbën veprë penale;*
- 2. ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;*
- 3. ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra penale është e përfshirë në falje ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; ose*
- 4. nuk ka prova të mjaftueshme, për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë, se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.²⁰*

Prokurorit të shtetit i është dhënë mundësia që të përgjigjet gojarisht ose me shkrim në afatin prej 1 jave gjatë shqyrtimit të dytë në kundërshtimin e paraqitur nga i pandehuri në bazë të nenit 249 të KPP dhe në kërkesën për hudhjen e aktakuzës të paraqitur nga i pandehuri në bazë të nenit 250 të KPP. Përveç përgjigjeve të cekura më lart, prokurorit të shtetit i është dhënë mundësia që ndaj kërkesës për hudhjen e aktakuzës të paraqes aktakuzë të ndryshuar.

Sipas dispozitës së nenit 252 paragrafi 3 e KPP, i pandehuri mund të paraqesë rapë kundërshtim të provave dhe kërkesë për hudhjen e aktakuzës, por vetëm për ato pjesë të aktakuzës së ndryshuar.

¹⁹ Neni 249, nënparagrafët 1.1-1.3 i KPP

²⁰ Neni 250, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1-1.4 i KPP.

Sa i përket ndryshimit të aktakuzës nga prokurori i shtetit një gjë e tillë është e rregulluar në mënyrë shprehimore. *Prokurori i shtetit mund të ndryshojë aktakuzën një herë, përveç në rastet kur siguron të dhëna të reja që bëjnë të nevojshme ndryshimin e aktakuzës.*²¹

Lidhur me kërkesën për hudhje të aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale siç e përcakton dispozita e nenit 253, paragrafi 1 të KPP, kur çmon se:

1. vepra me të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale;
2. ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;
3. ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra është përfshirë me amnesti apo falje, ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; ose
4. nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.

8. Shqyrtimi i dytë, shqyrtimet për vlefshmërinë e propozimeve dhe paraqitja e materialeve nga mbrojtja

8.1. Shqyrtimi i dytë

Para shqyrtimit gjyqësor aktakuza kontrollohet edhe në shqyrtimin e dytë, ku marrin pjesë prokurori i shtetit, i pandehuri ose të pandehurit dhe mbrojtësit, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues ka kërkuar vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e shqyrtimit të dytë, siç e përcakton edhe dispozita e nenit 254 të KPP.

Në shqyrtim të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sigurohet që mbrojtësi të ketë përmbushur të gjitha detyrimet lidhur me zbulimin e provave, përkatësisht paraqitjen e materialeve:

²¹ Neni 252, paragrafi 5 i KPP.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

1. njoftimin për qëllimin e prezentimit të alibit, duke precizuar vendin ose vendet ku i pandehuri pohon të ketë qenë në kohën e kryerjes së veprës penale si dhe emrat e dëshmitarëve dhe çdo provë tjetër që e mbështet alibinë;

2. njoftimin për qëllimin e prezentimit të arsyeve për përjashtim të përgjegjësisë penale, duke precizuar emrat e dëshmitarëve dhe çdo prove tjetër që e mbështet arsyen e tillë; dhe

3. njoftimin për emrat e dëshmitarëve të cilët mbrojtja synon t'i thërret për të dëshmuar.²²

Përgjegjësitë e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues gjatë shqyrtimit të dytë janë përcaktuar qartë dhe ato janë:

- Shqyrtimi i kundërshtimeve të provave dhe kërkesave për hudhjen e aktakuzës, të paraqitura nga i pandehuri;
- Caktimi i seancës dëgjimore nëse është e nevojshme për të vlerësuar kundërshtimet e provave dhe kërkesat për hudhjen e aktakuzës, të paraqitura nga i pandehuri;
- Caktimi i shqyrtimit gjyqësor, pas marrjes së aktvendimit lidhur me kundërshtimet dhe kërkesat për hudhjen e aktakuzës;
- Nëse gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues nuk ka vendosur për kundërshtimet kundër aktakuzës apo kërkesave për hudhjen e aktakuzës, pas shqyrtimit të dytë merr aktvendim me shkrim.

Edhe në shqyrtimin e dytë sikurse edhe në shqyrtimin fillestar nuk merret në pyetje asnjë dëshmitar apo ekspert dhe nuk paraqiten prova.

8.2. Shqyrtimet për përcaktimin e vlefshmërisë së provave

Lidhur me shqyrtimin e kundërshtimeve të provave të paraqitura nga i pandehurit apo kërkesave për hudhjen e aktakuzës, i është lënë në diskrecion gjyqtarit mbajtja e shqyrtimit, ku në mënyrë shprehimore me dispozitën e nenit 255, paragrafi 1 i KPP përcaktohet se nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues çmon se është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit, ai cakton dhe zbaton shqyrtimin e tillë sa më parë që të jetë e mundur dhe jo më vonë se tre (3) javë nga dita e shqyrtimit të dytë.

²² Neni 256, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1-1.3 i KPP.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Po ashtu, me dispozitat e nenit 255, paragrafi 2 i KPP është përcaktuar në mënyrë shprehimore forma e vendimmarrjes dhe afati lidhur me kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hudhjen e aktakuzës.

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nxjerr aktvendim me shkrim të arsyetuar sa më parë që të jetë e mundur pas shqyrtimit të mbajtur sipas këtij neni dhe jo më vonë se tre (3) javë nga dita e mbajtjes së shqyrtimit nga ky nen.²³

Pra, nga këto dispozita vërejmë se mbajtja e seancës mbetet në diskrecion të gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues, ndërsa sa i përket nxjerrjes me shkrim të aktvendimit përcaktohet se ai nxirret jo më vonë se tre javë, dhe kjo është një afat racional nga koha e mbajtjes së këtij shqyrtimi.

Përfundimi

- Pas trajtimit të temës “Aktakuza-faza e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit” mund të përfundojmë se kjo fazë është tejet e rëndësishme dhe se janë inkorporuar parimet e së drejtës ndërkombëtare të parapara me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe parimet kushtetuese të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Zgjidhjet ligjore që janë paraparë për këtë fazë, që nga ngritja e aktakuzës, pastaj deklarimi i të pandehurit dhe kontrolli i aktakuzës, që realizohet përmes shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë janë garanci se do të mbahet shqyrtim vetëm kur aktakuza të jetë kontrolluar dhe të jetë e bazuar mirë në provat mbi të cilat mbështetet.
- Bazuar në KPP, me të cilin përcaktohen rregullat e procedurës penale, të cilat janë të detyrueshme për punën e gjykatave, prokurorisë si dhe pjesëmarrësve tjerë, përmbajtja e aktakuzës është tejet formale, si dhe faza e ngritjes së aktakuzës është tejet formale dhe e rregulluar deri në detaje, kështu që nuk ka vend për arbitraritet.
- Prandaj, mund të përfundojmë se edhe në këtë fazë zbatohen parimet e parapara me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës

²³ Neni 255, paragrafi 2 i KPP.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

siç janë: parimi i pafajësisë së të pandehurit, in dubio “pro reo”, “Ne bis in Idem”, barazia e palëve, gjuhët dhe shkrimi dhe të gjitha parimet e tjera procedurale.

Literatura

- Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep : E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013.
- Sahiti, Ejup; Murati, Rexhep; Elshani, Xhevdet: Komentar, Kodi i Procedurës Penale, Prishtinë, 2014.
- Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Prishtinë, 2015.
- Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, 2013.
- Raporti i Punës së Prokurorit të Shtetit, 2016, Prishtinë, mars, 2017.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Fjalor i shqipes së sotme, botimet Toena, Tiranë, 2002.

Akte juridike

- Kushtetua e Republikës së Kosovës, ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, miratuar në Romë, më 4 nëntor 1950;
- Kodi nr .04/L-123 i Procedurës Penale, KPP, ka hyrë në fuqi me 1 janar 2013;
- Mendimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, GJA. nr. 207/13, i datës 19 mars 2013.

Burime nga faqe interneti

- <http://www.psh-ks.net/>
- <http://www.kpk-rks.org/>
- <http://www.gjyqesori-rks.org/>
- <https://gzk.rks-gov.net/>

*LL.M. Dren Paca**

AKTGJYKIMI

Abstrakt

Në këtë punim jam munduar të trajtoj dhe shtjelloj Aktgjykimin në procedurën penale, mënyrën se si meret dhe shpallet Aktgjykimi, rastet kur shqyrtimi gjyqësor përjashtimisht përfundon me Aktvendim, rëndësinë e identitetit subjektiv dhe objektiv të Aktgjykimit me Aktakuzë, bazën e Aktgjykimit, format dhe llojet e Aktgjykimit që mund të marrë gjykata, me theks të veçantë Aktgjykimin lirues, refuzues dhe fajësues.

Pastaj mënyrën dhe kohën e shpalljes së Aktgjykimit qoftë kur publiku është prezent ose është përjashtuar nga salla, udhëzimet dhe paralajmërimet për palët në procedurë që shoqërojnë Aktgjykimin, mënyrën si vendos gjykata përkitazi me caktimin e paraburgimit pas shpalljes së Aktgjykimit kur i akuzuari dënohet me burgim, kush e nënshkruan Aktgjykimin dhe kohën brenda së cilës gjykata duhet përpiluar dhe dorëzuar palëve në procedurë Aktgjykimin. Në veçanti vëmendje i është kushtuar përmbajtjes dhe formës që duhet të ketë Aktgjykimi (Hyrja, Dispozitivi dhe Arsyetimi) mënyrën e përmisimit të gabimeve të imëta, në emra dhe numra, gabimet tjera në llogaritje dhe mos përputhjet tjera në Aktgjykimin origjinal me kopjet, që mund të lëshohen nga gjykata me rrastin e përpilimit Aktgjykimit.

Fjalët kyqe: Aktgjykim, gjykata, i akuzuar, marrja, shpallja, refuzes, lirues, fajësues, hyrja, dispozitivi, arsyetimi.

* Dren Paca, Prokuror i sapo emëruar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë

Hyrje

Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat, të cilat gjykojnë në bazë të Kushtetutës së Kosovës dhe ligjit, pushteti gjyqësor në Kosovë është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata për të gjithë qytetarët e saj.¹

Aktgjykimi është vendimi kryesor i trupit gjyqësor apo i gjykatësit të vetëm me të cilin zgjidhet çështja penale konkrete. Ai mbështetet mbi bazën e shkresave të lëndës dhe provave të administruara në gjykatë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Aktgjykimi shpreh bindjen e gjyqtarëve për ekzistimin ose jo të çështjes penale, për fajësinë e të pandehurit dhe shkallën e rrezikshmërisë së tij shoqërore.²

Dhënia e Aktgjykimit është e drejtë ekskluzive e Gjykatës, ndërsa objekt i aktgjykimit është vepra penale e përfshirë në aktakuzën e paraqitur nga Prokurori i Shtetit. Nëpërmjet Aktgjykimit zbatohen masat e shtrëngimit shtetëror kundër atyre që është vërtetuar se kanë kryer ndonjë vepër penale. Aktgjykimi i formës së preprë ka fuqinë e ligjit për çështjen penale konkrete që është zgjidhur me të dhe si i tillë është i detyrueshëm për të gjitha palët të përfshira në kontest.³

1. Nxjerrja dhe shpallja e aktgjykimit

Aktgjykimi nxirret dhe shpallet në emër të popullit, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor dhe pasi që të jetë tërhequr trupi gjykues në seancën për këshillim dhe votim. Seanca për këshillim dhe votim zhvillohet nën drejtimin e kryetarit të trupit gjykues. Në të trajtohen të gjitha çështjet paraprake (procedurale dhe juridike), të cilat janë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës së procedurës si dhe çështja kryesore. Kështu, po qe se trupi gjykues

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 102, pika 2,3.

² Hajdari, Dr. Azem, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2010, fq. 285 dhe Doracaku për Pregatitjen e Provimit të Jurisprudencës, Prishtinë 2015, fq 299.

³ Sahiti, Dr. Ejup dhe Murati, Dr. Rexhep, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2013, fq. 370 dhe, Doracaku i Institutit Gjyqësor të Kosovës “Kodi i Procedurës Penale” Prishtinë 2016, fq 533.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

konsideron se ka kompetencë lëndore dhe se çështja është zbardhur aq sa nuk paraqitet nevoja për hapjen e sërishme të shqyrtimit gjyqësor për plotësimin e procedurës provuese, duhet të nxjerr aktgjykim. Pastaj trupi gjykues shikon se a ekziston vepra penale, a është i akuzuari kryrës i veprës penale, a është përgjegjës dhe se a mund t'i shqiptohet sanksioni penal, të ngarkohet me shpenzime të procedurës, me kërkesën pasurore juridike etj.

Për të gjitha çështjet që i parashtron kryetari i trupit gjykues anëtarët e tjerë të trupit duhet të deklarohen me votim, përveq gjyqtarit i cili ka votuar për lirimin e të akuzuarit dhe ka mbetur pakicë. Ai nuk është i obliguar të votojë për dënim. Përndryshe, vendimi merret me shumicë votash. Po që se me rastin e votimit nuk arihet shumica, çështjet ndahen dhe votimi përsëritet derisa të arrihet shumica e votave.⁴

Në mes të aktakuzës dhe aktgjykimit duhet të ekzistoj identiteti subjektiv dhe objektiv, dhe të realizohet për faktin se aktgjykimi mund t'i referohet vetëm personit apo personave të cilët janë akuzuar me aktakuzë dhe vetëm veprës e cila është objekt i akuzës të përmbajtur në aktakuzën e parashtruar, apo të ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin gjyqësor. Përndryshe, gjykata nuk është e lidhur me propozimet e prokurorit të shtetit në pikëpampje të cilësimit juridik të veprës.⁵

Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor. Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlersoj çdo provë një nga një dhe lidhjen e tyre me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është i provuar (neni 361 pika 1, 2 e K.P.P.) andaj, aktgjykimin duhet të pasqyrojë të vërtetën, zbulimi i së cilës mund të bëhet në qoftë se njoftimet për faktet dhe rrethanat në të cilat mbështetet gjykata janë të vërteta. Faktet rënduese në të cilat gjykata e bazon aktgjykimin duhet të provohen plotësisht. Po që se për saktësinë e tyre mbetet edhe një fije dyshimi gjykata, në bazë të parimit *in dubio pro reo*, do të veprojë sikurse ai fakt të mos ekzistonte.⁶

⁴ Sahiti, Dr. Ejup, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2005, fq 214 dhe 215.

⁵ Doracaku për Pregatitjen e Provimit të Jurispudencës, Prishtinë 2008, fq 121 dhe Doracaku i Institutit Gjyqësor të Kosovës “Kodi i Procedurës Penale” Prishtinë 2016, fq 533.

⁶ Hajdari, Dr. Azem, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2010, fq 286.

Vetëm në disa raste aktgjykimi nxjerret jashtë shqyrtimit gjyqësor, siç është aktgjykimi për urdhër ndëshkimesor të cilin e nxjerr gjyqtari i vetëm gjykues (neni 493 paragrafi 1, neni 495 paragrafi 1). Po ashtu, aktgjykimi i kolegjit prej tre gjyqtarësh për revokimin e dënimit me kusht (519 paragrafi 4); aktgjykimi i kolegjit të Gjykatës së Apelit me rastin e shqyrtimit të ankesës (neni 308); aktgjykimi i kolegjit me rastin e rishikimit jo të drejtë të procedurës penale (neni 420 paragrafi 5); aktgjykimi i kolegjit prej tre anëtarësh për njohje dhe ekzekutim të sanksionit të shqiptuar me vendim të gjykatës së huaj.

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, vetëm në raste të pakta shqyrtimi gjyqësor i filluar apo çështja e shtruar në të zgjidhet me aktvendim, si bie fjala kur hedhet akuza sipas nenit 358 të KPP, - *1.Trupi gjykues me aktvendim e hudh aktakuzën kur; 1.1. procedura është zbatuar pa kërkesën e prokurorit të shtetit; 1.2. ka munguar propozimi i kërkuar i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent, apo nëse organi publik kompetent e ka tërhequr lejen; ose 1.3. ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen.* Si dhe kur shqiptohet masa edukuese ndaj të miturit sipas nenit 73 par.3 të KDM, - *Trupi gjykues për të mitur me aktvendim shqipton masën edukative për të miturin. Në dispozitiv të aktvendimit ceket vetëm urdhëri për masën edukative dhe ç'fardo mase tjetër ose dënimi në kreun VIII, të këtij Kodi, por i mituri nuk shpallet fajtor për veprën penale të përshkruar në propozimin e prokurorit. Arsyetimi i aktvendimit përmban përshkrimin e veprës penale dhe rrethanat të cilat e arsyetojnë shqiptimin e masës edukative.*⁷

2. Llojet e aktgjykimeve

Në seancën për këshillim dhe votim, varësisht nga situata konkrete, gjykata mund të shqiptojë aktgjykim meritore dhe jo meritore. Aktgjykimi meritor është ai aktgjykim me të cilin çështja kryesore zgjidhet tërësisht, si aktgjykim meritor konsiderohet aktgjykimi lirues dhe aktgjykimi dënues. Aktgjykimi jo

⁷Sahiti, Dr. Ejup dhe Murati, Dr.Rexhep: E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2013, fq 370, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës - Nr. 04/ L-123, neni 358 par.1 dhe Kodi i Drejtësisë për të Mitur- Nr. 03/L-193, neni 73 par.3.

meritor është aktgjykim me të cilin refuzohet akuza, kur gjykata nxjerr këtë lloj të aktgjykimit fare nuk lëshohet në zgjidhjen dhe vendosjen e çështjes kryesore për të cilën është filluar procedura.⁸

Vlen të theksohet fakti se, një aktgjykim njëkohësisht nuk mund të jetë aktgjykim meritor edhe aktgjykim jo meritor, sikurse nuk mund që gjykata njëkohësisht për të njëjtën vepër ndaj të njëjtit kryes të shqiptojë, aktgjykim lirues edhe aktgjykim dënues. Mirëpo, po qe se kemi të bëjmë me koneksitetin e veprave penale me ç'rast akuza përfshinë shumë vepra penale, ekziston mundësia që për një vepër penale me aktgjykim të refuzohet akuza e për tjetrën të lirohet apo të shpallet fajtor. Në fakt, gjykata në seancën për këshillim dhe votim mund të nxjerr këto lloje të aktgjykimeve: aktgjykim refuzues; aktgjykim lirues dhe aktgjykim fajësues.⁹

2.1 Aktgjykimi refuzues

Aktgjykimi refuzues është aktgjykimi me të cilin çështja kyesore mbetet e pazgjidhur. Gjkata nxjerr aktgjykim refuzues atëherë kur në rrugë për zgjidhjen e çështjes kryesore paraqitet ndonjë pengesë procedurale¹⁰. Sipas nenit 363 par.1 të KPP, gjykata nxjerr aktgjykim me të cilin refuzohet aktakuza kur:

- 1. Prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza nga hapja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor;*
- 2. I akuzuari për të njëjtën vepër është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë ose procedura kundër tij është pushuar me aktvendim të formës së prerë;*

⁸ Sahiti, Dr. Ejup dhe Murati, Dr.Rexhep, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2013, fq 372.

⁹ Hajdari, Dr. Azem, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2010, fq 286; dhe Doracaku për Pregatitjen e Provimit të Jurisprudencës, Prishtinë 2015, fq 300.

¹⁰ Hajdari, Dr. Azem, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2010, neni 363, par .1.1, 1.2, 1.3.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

3. *Ka kaluar afati i parashkrimit dhe vepra përfshihet në amnisti ose falje, ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që përjashtojnë ndjekjen penale.*¹¹

1.1. Edhe pse sipas parimit të legalitetit, prokurori ka për detyrë të fillojë ndjekjen penale kur ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, prokurori i shtetit disponon me aktakuzë dhe ai në çdo kohë mund të tërhiqet nga ndjekja. Prokurori i shtetit poashtu tërhiqet nga ndjekja për veprat që ndiqen sipas propozimit për ndjekje të të dëmtuarit kurdo që i dëmtuari tërhiqet nga propozimi.¹²

2.2. Këtu kemi të bëjmë me *res judicata* – çështje të gjykuar. Nëse gjykata ka nxjerrë vendim meritore të formës së prerë, prokurori i shtetit më nuk mund të paraqes rishtas aktakuzë për të njëjtën veprë penale kundër të njëjtit person, përveq rasteve kur plotësohen kushtet për rishikim të procedurës. Në rastet kur aktakuza paraqitet, gjykata duhet ta refuzojë aktakuzën sepse askush nuk mund të gjykohet për të njëjtën veprë dy herë – *ne bis in idem*, neni 4 KPP.¹³

3.3. Përveq parashkrimit, amnestisë dhe faljes, si rrethana tjera që përjashtojnë ndjekjen penale kishin me qenë: vdekja e personit të akuzuar, kur personi i akuzuar nuk ka mbushur moshën e duhur për përgjegjësi penale etj.¹⁴

Për të gjitha shkaqet nga të cilat refuzohet aktakuza, gjykata duhet të mbajë llogari. Përndryshe, kur gjykata nxjerr aktgjykim refuzues, në dispozitiv duhet të përfshihet përshkrimi i veprës për të cilën është akuzuar i pandehuri, vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe vendimi mbi kërkesën pasurore juridike t'ia drejtoi gjykatës për çështje civile, nëse ajo ka qenë e paraqitur. Në fund, gjykata me aktgjykim refuzues duhet të urdhërojë lirimimin e menjëhershëm të akuzuarit të paraburgosur dhe të deklarojë heqjen e masave tjera të sigurisë të cilat mund të jenë shqiptuar ndaj tij.¹⁵

¹¹ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës - Nr. 04/ L-123, neni 363.

¹² Doracaku për Pregatitjen e Provimit të Jurispudencës, Prishtinë 2008, fq 121 dhe Sahiti, Dr. Ejup dhe Murati, Dr. Rexhep, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2013, fq 372.

¹³ Sahiti, Dr. Ejup, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2005, fq 214 dhe 215.

¹⁴ Hajdari, Dr. Azem: E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2010, fq 287.

¹⁵ Po aty.

2.2 Aktgjykimi lirues

Aktgjykimi lirues është aktgjykim meritore me të cilin gjykata e zgjidh tërësisht çështjen penale. Në këtë rast, zgjidhja e çështjes penale bëhet përmes lirimit të personit të akuzuar nga akuzat me të cilat ka qenë i ngarkuar¹⁶.

Gjykata nxjerr aktgjykim me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza nëse:

- 1. Vepra me të cilën i akuzuari akuzohet nuk përbën vepër penale;*
- 2. Ka rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale;*
- 3. Nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.*¹⁷

1.1. Në praktikë mund të ndodhë që vepra e akuzuar për të cilën i akuzuari ngarkohet të mos i ketë tiparet e veprës penale, por të ndonjë kundërvajtje, apo delikti disiplinor. Gjithashtu, mund të ndodhë që një person të akuzohet për vepër për të cilën ekzistojnë tiparet e veprës penale, mirëpo, sipas ndonjë baze të veçantë të përjashtohet kundërligjshmëria, si bie fjala, veprimi në mbrojtje të nevojshme, në mbrojtje ekstreme etj., në këto raste gjykata nxjerrë aktgjykim lirues.¹⁸

2.2. Si rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale konsiderohen: kryerja e veprës penale në gjendje të paaftësisë mendore neni 18 i (KPRK), ose në lajthim faktik (neni 25 (KPRK)).¹⁹

3.3. Në këto raste vepra penale ekziston (dhe ekzistenca e saj) duke u vërtetuar në mënyrë të padyshimtë – të saktë, por, nuk ka prova që vëretojnë në mënyrë të padyshimtë se atë e ka kryer i akuzuari, kështu që edhe në këto raste nxirret aktgjykim lirues. Aktgjykimimi lirues duhet dalluar nga lirimi dhe dënimi sipas nenit 77 dhe 78 të KPRK, sepse, me rastin e zbatimit të institutit të lirimit nga

¹⁶ Hajdari, Dr. Azem: E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2010, fq 287.

¹⁷ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës - Nr. 04/ L-123, neni 364

¹⁸ Sahiti, Dr. Ejup: dhe Murati, Dr. Rexhep, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2013, fq 373.

¹⁹ Po aty

dënimi, i akuzuari shpallet fajtor me aktgjykim dënues, por, lirohet nga dënimi.²⁰

Po qe se i akuzuari akuzohet për shumë vepra penale dhe disa nga ato vërtetohen e disa jo, gjykata në aktgjykim duhet të shënoj saktësisht për cilat vepra të akuzuarin e shpallë fajtor e për cilat e liron. Nëse i akuzuari lirohet nga akuza për shkak të ekzistimit të rrethanave që e përjashtojnë përgjegjësinë penale, ekziston mundësia e shqiptimit të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik apo masës së trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim të personave të varur nga droga ose alkooli. Masat shqiptohen në procedurë të posaqme me aktvendim të posaqëm.

Kur gjykata nxjerr aktgjykim lirues, aktgjykimi duhet të përfshijë përshkrimin e veprës me të cilën akuzohet i akuzuari, vendimin për shpenzimet e procedurës dhe vendimin për kërkesën pasurore juridike nëse ka qenë e paraqitur.²¹

2.3 Aktgjykimi fajësues

Gjykata nxjerrë aktgjykim fajësues (dënues) kur nuk ekzistojnë shkaqet të cilat sjellin deri te aktgjykimi refuzues apo lirues.²²

Sipas nenit 365 par. 1 të KPP, gjykata me aktgjykim me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon:

1.Veprën penale për të cilën shpallet fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal.

2.Emërtimin ligjor të veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit.

3.Dënimin e shqiptuar të akuzuarit, duke përfshirë edhe dënimin alternativ nga Kodi Penal ose lirimin nga dënimi.

²⁰ Hajdari, Dr. Azem, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2010, fq 288 dhe Sahiti, Dr. Ejup dhe Murati, Dr. Rexhep: E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2013, fq 373.

²¹ Sahiti, Dr. Ejup: E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2005, fq 217.

²² Sahiti, Dr. Ejup dhe Murati, Dr. Rexhep: E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2013, fq 374

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

4.Urdhrin për shqiptimin e masës për trajtim të detyrueshëm rehabilitues të kryerësve të varur nga droga dhe alkooli, ose për konfiskimin e dobisë pasurore që i nënshtrohet konfiskimit.

5.Vendimin për llogaritjen e paraburgimit ose dënimit të mëparshëm në lartësinë e dënimit.

6.Vendimin për shpenzimet e procedurës penale, për kërkesën pasurore juridike, si dhe përcaktimin se a duhet shpallur aktgjykimin e formës së prerë në shtyp, në radio apo në television.²³

1.1.Këtu është fjala për përshkrimin faktik të veprës së paraqitur në aktakuzë (identiteti objektiv).

2.2.Këtu kemi të bëjmë me kualifikimin ligjor të veprës, i cili bëhet duke e përcaktuar dispozitën ose dispozitat përkatëse të Kodit penal.²⁴

3.3.Gjykata në aktgjykim fajshues duhet të precizoj, në mënyrë të qartë, llojin e dënimit të cilin ia shqipton të akuzuarit dhe kohëzgjatjen e tij.

4.4.Këtu është fjala për definimin e qartë të llojit të masës së shqiptuar.

5.5.Sipas KPP-së, koha e kaluar në paraburgim, në institucionin e kujdesit shëndetësor si dhe çdo privim lirie lidhur me veprën penale llogaritet në dënimin e shqiptuar, qoftë ai dënim me burgim apo me gjobë.

6.6. Këtu është fjala për caktimin e lartësisë të shpenzimeve gjyqësore me të cilat ngarkohet i akuzuari që t'ia paguajë shtetit në llogari të buxhetit të shtetit caktimin e lartësisë e cila do duhej paguar në emër të realizimit të kërkesës pasurore juridike të personit të dëmtuar me vepër penale, si dhe definimin e qartë të ekzistimit apo jo të mundësisë të shpalljes së aktgjykimit të shqiptuar në shtyp, radio ose television sipas nenit 70 të KPRK.²⁵

3 Shpallja e aktgjykimit

Pasi gjykata të nxjerrë aktgjykimin, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, si rregull e shpallë atë menjëherë. Kur gjykata nuk ka mundësi që në të njëjtën ditë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të nxjerrë

²³ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës - Nr. 04/ L-123, neni 365.

²⁴ Sahiti, Dr. Ejup dhe Murati, Dr. Rexhep: E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2013, fq 374

²⁵ Hajdari, Dr. Azem: E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2010, fq 289 dhe 300.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

aktgjykimin, shpalljen e aktgjykimit e shtyn jo më shumë se 3 ditë, duke caktuar kohën dhe vendin e shpalljes së aktgjykimit, (paragrafi 1 i) neni 366, paragrafi 1. i KPP).²⁶

Tejkalimi i afatit treditör nuk ka pasoja procedurale përveç që palët mund ta theksojnë në ankesë si shkelje relative të procedurës penale (neni 384 paragrafi 2). Me atë rast Gjykata e Apelit çmon nëse ky lëshim ka ndikuar ose ka mund të ndikojë në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.²⁷

Shpallja e aktgjykimit siç është theksuar më lart, bëhet në emër të popullit dhe në seancë të hapur. Shpalljen e bën gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në prani të palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor, të përfaqësuesve të autorizuar dhe të mbrojtësve, me ç'rast lexon dispozitivin dhe prezanton në pika të shkurtra arsyet e aktgjykimit, kuptohet, përveç rasteve kur ka arsye të jashtëzakonshme për të shtyrë leximin e dispozitivit deri në nxjerrjen e aktgjykimit me shkrim.²⁸

Shpallja e aktgjykimit bëhet edhe kur pala, përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi i autorizuar ose mbrojtësi nuk janë të pranishëm. Në këtë rrjedhë, kur i akuzuari nuk është i pranishëm, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ia komunikon atij aktgjykimin gojarisht ose kopja e aktgjykimit i dërgohet me shkrim. Shpallja e aktgjykimit, përkatësisht leximi i dispozitivit të aktgjykimit bëhet gjithmonë publikisht, pavarësisht prej asaj se shqyrtimi gjyqësor mund të jetë zhvilluar pa të ashtuquajturin publicitet të përgjithshëm.

Ndërsa, sa i përket leximit të arsyetimit çështja është rregulluar paksa më ndryshe. Në fakt, trupi gjykues është autoriteti që vendosë se a do ta përjashtojë publikun me rastin e prezantimit të arsyeve të aktgjykimit dhe në ç'masë do ta përjashtojë atë. Është e rëndësishme të theksohet se me rastin e leximit të dispozitivit të pranishmit e dëgjojnë atë duke qëndruar në këmbë, (neni 366 pika 5 e KPP). Shpallja e aktgjykimit publikisht shërben për njohjen e palëve dhe publikut solemnisht me përmbajtjen e aktgjykimit ashtu që në

²⁶ Doracaku për Pregatitjen e Provimit të Jurisprudencës, Prishtinë 2015, fq 303 - 305.

²⁷ Komentari i Kodit të Procedurës Penale, Prishtinë 2014, fq 854.

²⁸ Hajdari, Dr.Azem: E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2010, fq 290.

masën aq sa është e mundur, shprehë transparencën e punës së gjykatës karshi qytetarëve²⁹

Pas shpalljes së aktgjykimit gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i udhëzon palët për të drejtën në ankesë. Në qoftë se, me aktgjykim është shqiptuar ndonjë dënim alternativ, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues paralajmëron të akuzuarin për rëndësinë e dënimit dhe kushtet të cilat duhet respektuar, udhëzimi shënohet në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor, poashtu gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i njofton palët për detyrimin që, deri në përfundim të procedurës duhet ta njoftojnë gjykatën për çdo ndryshim të adresës.³⁰

4 Paraburgimi pas shpalljes së aktgjykimit

Çështje me rëndësi që shtohet me rastin e shpalljes së aktgjykimit është çështja e paraburgimit. Në të vërtetë, me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit me të cilin i akuzuari dënohet me burgim, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues cakton paraburgimin kur ekzistojnë kushtet për caktimin e tij, ose e heq paraburgimin nëse i akuzuari ndodhet në paraburgim në rastet kur pushojnë së ekzistuari shkaqet për të cilat është paraburgosur, kjo rregull zbatohet deri sa aktgjykimi të marrë formën e prerë.³¹

Me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit me të cilin i akuzuari dënohet me burgim, konform paragrafit 1 të nenit 367 të Kodit të Procedurës Penale, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues:

- 1) Cakton, përkatësisht ia vazhdon paraburgimin kur ekzistojnë kushtet për caktimin apo vazhdimin e tij;
- 2) Ndërprenë paraburgimin nëse i akuzuari ndodhet në paraburgim kur pushojnë së ekzistuari shkaqet për të cilat është paraburgosur.

²⁹ Doracaku për Pregatitjen e Provimit të Jurisprudencës, Prishtinë 2015, fq 303 - 304.

³⁰ Sahiti, Dr. Ejup dhe Murati, Dr. Rexhep: E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2013, fq 376.

³¹ Hajdari, Dr. Azem: E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2010, fq 291

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues ka shpallë aktgjykim me të cilin shqipton dënim prej 5 apo më shumë vjet burgim, ai, ia cakton ose ia vazhdon paraburgimin të akuzuarit neni 367 paragrafi 2 i KPP).

Nëse, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues ka shpallë aktgjykim me të cilin shqipton dënim me burgim që është më pak se 5 vjet, ai urdhëron caktimin ose zgjatjen e paraburgimit vetëm nëse konsideron se janë plotësuar kushtet e përcaktuara ligjore për caktimin e paraburgimit, nenit 367 paragrafi 3 i KPP.

Së këndejmi, trupi gjykues gjithmonë ndërpre në paraburgimin dhe urdhëron lirim të akuzuarit nëse:

- 1) Është liruar nga akuza;
- 2) Është deklaruar fajtor, por, është liruar nga dënimi;
- 3) Është dënuar vetëm më gjohë ose i është shqiptuar vërejtja gjyqësore;
- 4) Është shqiptuar një nga dënimet alternative, përveç dënimit me gjysmëliri;
- 5) Për shkak të llogaritjes së paraburgimit në lartësinë e dënimit, ai veç e ka mbajtur dënimin ose 6) Akuza është refuzuar, përveç në rastin kur është refuzuar për shkak të mos kompetencës së gjykatës.

Para caktimit ose heqjes së paraburgimit, vështruar kjo në kontekst të dy situatave të fundit, përkatësisht, rasteve të parashikuara me paragrafin 3 ose 4 të nenit 367 të KPPK, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues së pari dëgjon mendimin e prokurorit të shtetit, nëse procedura është filluar me kërkesën e tij dhe pastaj dëgjon të akuzuarin apo mbrojtësin e tij, nenit 367 parag. 5 i KPPK.

Kur i akuzuari gjendet në paraburgim dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues çmon se ende ekzistojnë shkaqet për të cilat ishte caktuar paraburgimi, paraburgimin e vazhdon me aktvendim të posaçëm. Po ashtu, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues me aktvendim të posaçëm e cakton ose e heq paraburgimin. Në këto raste, paraburgimi i caktuar ose i vazhduar mund të zgjasë derisa aktgjykimi të merr formë të prerë, por jo, më shumë se koha e

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

dënimin të shqiptuar në aktgjykimin e gjykatës themelore. Megjithatë, ligjdhënësi ka parashikuar se i akuzuari i dënuar me burgim, i cili gjendet në paraburgim, me kërkesën e tij mund të transferohet me aktvendim të gjyqtarit të vetëm gjykues ose të kryetarit të trupit gjykues në institucionin për vuajtjen e dënimit para se aktgjykimi të marrë formë të prerë.³²

5. Përpilimi me shkrim dhe dorëzimi i aktgjykimit

Pas shpalljes, aktgjykimi duhet të përpilohet në formë të shkruar. Përpilimi me shkrim i aktgjykimit, si rregull duhet të bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, kur i akuzuari është dërguar në mbajtje të burgimit, përkatësisht brenda 15 ditëve kur i akuzuari gjendet në paraburgim dhe brenda 30 ditëve në rastet tjera. Megjithatë, kur rasti është i ndërlikuar, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë nga kryetari i gjykatës që të zgjasë afatin për përpilimin me shkrim të aktgjykimit deri në 60 ditë, neni 369 paragrafi 1 i KPPK.³³

Aktgjykimin e nënshkruajnë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues dhe procesmbajtësi. Kopja e vërtetuar e aktgjykimit e cila përmban udhëzimin për të drejtën në ankesë u dërgohet palëve dhe mbrojtësit sipas neni 478 të KPPK. Ajo së bashku me udhëzimin për të drejtën në ankesë i dërgohet edhe të dëmtuarit, personit të cilit i është konfiskuar sendi me aktgjykim, si dhe personit juridik të cilit i është konfiskuar dobia pasurore e fituar me veprë penale. Në fakt, kopje të vërtetuar të aktgjykimit gjykata e çështjes ua dorëzon edhe gjykatave tjera të cilat kanë shqiptuar aktgjykime ndaj të akuzuarit, kur ajo është gjendur në situatë që të shqiptojë dënimin unik për rastet e veprave penale të kryera në bashkim, neni 369 paragrafi 2,5 i KPPK.³⁴

Të akuzuarit i cili nuk ka mbrojtës duhet t'i dorëzohet aktgjykimi personalisht, ose personit që ai e cakton. Kur i akuzuari nuk ka mbrojtës dhe duhet dorëzuar

³² Kodi i Procedurës Penale i Kosovës - Nr. 04/ L-123, neni 367, par. 1-8 dhe Doracaku për Pregatitjen e Provimit të Jurisprudencës, Prishtinë 2015, fq 304 - 305.

³³ Doracaku për Pregatitjen e Provimit të Jurisprudencës, Prishtinë 2015, fq 305 - 306.

³⁴ Po aty.

aktgjykimin me të cilin i është shqiptuar dënimi me burgim, por aktgjykimi atij nuk mund t'i dërgohet në adresën e tij të mëparshme, gjykata menjëherë ia cakton një mbrojtës, i cili e ushtron këtë detyrë deri sa të gjendet adresa e re.³⁵

6. Përmbajtja dhe forma e aktgjykimit

Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të jetë identik me aktgjykimin e shpallur. Si i tillë, aktgjykimi i përpiluar përbëhet prej tri pjesëve: hyrjes, dispozitivit dhe arsyetimit.

Hyrja e aktgjykimit përfshinë: shënimin se aktgjykimi nxjerret në emër të popullit, emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit dhe të anëtarëve të trupit gjykues dhe të procesmbajtësit, emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit, veprën penale për të cilën i akuzuari është dënuar dhe nëse ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ditën e shqyrtimit gjyqësor, nëse shqyrtimi gjyqësor ka qenë i hapur, emrin dhe mbiemrin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe të përfaqësuesit të autorizuar të cilët kanë qenë të pranishëm në shqyrtim gjyqësor, datën e shpalljes së aktgjykimit të shqiptuar dhe datën e përpilimit të aktgjykimit.

Dispozitivi i aktgjykimit përfshinë të dhënat personale të të akuzuarit dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për veprë penale për të cilën akuzohet, ose me të cilin lirohet nga akuza për atë veprë apo me të cilin refuzohet aktakuza. Kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshinë të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 365 të këtij Kodi, ndërsa kur ai është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshinë përshkrimin e veprës për të cilën është akuzuar dhe vendimin për shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike, nëse një kërkesë e tillë është paraqitur. Në rastin e gjykimit të veprave penale në bashkim, gjykata në dispozitivin e aktgjykimit shënon dënimet e shqiptuara për secilën veprë penale, e pastaj dënimin për të gjitha veprat në bashkim. Gjkata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit.

³⁵ Sahiti, Dr. Ejup: E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2005, fq 220.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Në këtë aspekt, gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata po ashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mos miratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjes juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të Kodit Penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij. Dispozitivi i aktgjykimit të përpiluar me shkrim duhet të jetë identik me dispozitivin e aktgjykimit të shpallur në shqyrtimin gjyqësor.

Kur i akuzuari dënohet me burgim, arsyetimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit. Gjykata veçanërisht arsyeton se në cilat shkaqe është bazuar kur ka konstatuar se ka të bëjë veçanërisht me rast të rëndë dhe se duhet shqiptuar dënim më të rëndë se dënimi i paraparë, ose ka konstatuar se është e nevojshme të ulë apo të heqë dënimin, të shqiptojë dënim alternativ ose masën për trajtim të detyruar rehabilitimi ose t'i konfiskohet dobia pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale.

Kur në aktakuzë përcaktohet pasuria që i nënshtrohet konfiskimit, aktgjykimi përcakton nëse pasuria konfiskohet apo jo. Aktgjykimi përmban arsyetimin për konfiskimin e secilës pasuri për të cilën urdhërohet konfiskimi dhe arsyetimin për secilën pasuri për të cilën nuk urdhërohet konfiskimi. Kur i akuzuari lirohet nga akuza, varësisht nga rasti, në arsyetim veçanërisht shënohen arsyet pse vepra me të cilën është akuzuar i akuzuari nuk paraqet vepër penale, cilat janë rrethanat që përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe si erdhi në përfundim se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Kur të akuzuarit i është shqiptuar aktgjykimi me të cilin është refuzuar akuza, në arsyetim gjykata nuk do të ndalet në vlerësimin e çështjes kryesore, por, ajo do të kufizohet vetëm në arsyet e refuzimit të akuzës.³⁶

³⁶ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës - Nr. 04/ L-123, neni 370, par. 1-11 dhe Doracaku për Prgatitjen e Provimit të Jurisprudencës, Prishtinë 2015, fq 306 – 307 si dhe Sahiti, Dr. Ejup dhe Murati, dr. Rexhep: E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2013, fq 378 dhe 380.

7. Gabimet e imëta në aktgjykim

Gabimet në emra dhe numra, gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, parregullsitë në mënyrën e përpilimit të aktgjykimit me shkrim dhe mospërputhja e aktgjykimit të kopjuar me origjinalin e aktgjykimit, me kërkesë të palëve, të mbrojtësit ose sipas detyrës zyrtare, me aktvendim të posaçëm përmirësohen nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues.

Në rast se gabimet e tilla janë objekt i ankesës, ato si rregull i përmirëson Gjykata e Apelit, konform nenit 403 të KPP.

Kur ekziston papajtueshmëri midis aktgjykimit të hartuar me shkrim dhe origjinalitetit të tij përkitazi me të dhënat kryesore të tij, përkitazi me të dhënat nga neni 365 par.1, nën par. 1 deri 6 të KPP, aktvendimi për përmirësim u dërgohet personave të cilët kanë të drejtë ankesë kundër aktgjykimit. Në rastin e tillë, afati i ankesës kundër aktgjykimit llogaritet nga dita e dorëzimit të aktvendimit. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë e posaçme, (paragrafi 3 i nenit 371 i KPP)³⁷.

Përfundim

Aktgjykimi është vendimi kryesor gjyqësor me të cilin zgjidhet çështja penale konkrete, aktgjykimi nxirret dhe shpallet në emër të popullit.

Dhënia e Aktgjykimit është e drejtë ekskluzive e Gjykatës, nëpërmjet Aktgjykimit zbatohen masat e shtrëngimit shtetëror kundër atyre që është vërtetuar se kanë kryer ndonjë vepër penale. Aktgjykimi i formës së prerë ka fuqinë e ligjit për çështjen penale konkrete që është zgjidhur me të dhe si i tillë është i detyrueshëm për të gjithë.

Aktgjykimi nxirret pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor dhe pasi që të jetë tërhequr trupi gjykues në seancën për këshillim dhe votim, vetëm në disa raste aktgjykimi nxirret jashtë shqyrtimit gjyqësor, siç është aktgjykimi për urdhër ndëshkimor të cilin e nxjerr gjyqtari i vetëm gjykues. Gjykata e bazon

³⁷ Po aty.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor, gjykata nuk është e lidhur me propozimet e prokurorit të shtetit në pikëpamje të cilësimit juridik të veprës. Në seancën për këshillim dhe votim mund të nxjerr këto lloje të aktgjykimeve: aktgjykim refuzues, aktgjykim lirues dhe aktgjykim fajësues.

Pasi gjykata të nxjerr aktgjykimin, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, si rregull e shpallë atë menjëherë. Me rastin e shpalljes së aktgjykimit gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i udhëzon palët për të drejtën në ankesë.

Pas shpalljes, aktgjykimi duhet të përpilohet në formë të shkruar. Përpilimi me shkrim i aktgjykimit, si rregull duhet të bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tij kur i akuzuari është dërguar në mbajtje të burgimit, përkatësisht brenda 15 ditëve kur i akuzuari gjendet në paraburgim dhe brenda 30 ditëve në rastet tjera. Megjithatë, kur rasti është i ndërlikuar, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë nga kryetari i gjykatës që të zgjasë afatin për përpilimin me shkrim të aktgjykimit deri në 60 ditë. Aktgjykimin e nënshkruajnë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues dhe procesmbajtësi.

Gabimet eventuale në Aktgjykim, me kërkesë të palëve, të mbrojtësit ose sipas detyrës zyrtare, me aktvendim të posaçëm përmirësohen nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues.

Literatura

- Sahiti, Dr. Ejup dhe Murati, Dr. Rexhep, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2013;
- Hajdari, Dr. Azem, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2010;
- Sahiti, Dr. Ejup, E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë 2005;
- Komentari i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë 2014;

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kosovë 2008;
- Doracaku për Pregatitjen e Provimit të Jurisprudencës, Prishtinë 2015;
- Doracaku për Pregatitjen e Provimit të Jurisprudencës, Prishtinë 2008;
- Doracaku i Institutit Gjyqësor të Kosovës, Prishtinë 2016;
- Kodi i Procedurës Penale i Kosovës – Nr. 04/LL-123;
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur- Nr. 03/L-193;

Edina Jupolli*

MARRËVESHJA MBI PRANIMIN E FAJËSISË SIPAS LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Abstrakti

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë (plea bargainig) të cilës i referohen edhe si institut, siguron zgjidhjen e rasteve penale përmes marrëveshjes ndërmjet prokurorit dhe të pandehurit mbi pranimin e fajësisë. Sistemi i drejtësisë penale në Kosovë për zgjidhjen e çështjeve jashtë gjyqësore ka përfshirë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë e cila është e autorizuar në Kodin e Procedurës Penale. Kosova ka përqafuar konceptin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësië dhe institucionalizuar atë duke ju referuar SHBA-ve. Në Kosovë, me ndryshim-plotësimet e bëra në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale në vitin 2008, ka hyrë si institucion i ri marrëveshja për pranimin e fajësisë ndërkaq në vitin 2013 kjo marrëveshje ka hy në fuqi te Kodi i ri i Procedurës penale, me ndryshime më të favorshme për aplikim sa më efektiv. Ndryshime e bëra sipas kodit në fuqi kanë pasur modifikime të paragrafeve të kodit të vjetër si dhe inkorporime krejtësisht të reja të paragrafeve. Sipas statistikave të Këshillit Prokurorial të Kosovës, regjionet që kanë lidhur më së shumti marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë janë Prokuroria Themelore e Gjilanit, Prokuria Themelore e Pejës si dhe Prokuroria Themelore e Prizrenit. Trendi i zbatimit të këtij institucioni në vendin tonë është në rritje, si dhe po përdoret më së shpeshti për veprat penale rrezikimi i trafikut publik si dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve.

Fjalët Kyqe: marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, vepra penale, procedura penale, prokurori i shtetit, i pandehuri, reforma e legjislacionit penal.

* Edina Jupolli, Prokurore e sapo emëruar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë

Hyrje

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë (plea bargaining) do të thotë zgjedhja e një çështjeje penale pa gjykim. Sipas fjalorit juridik, “Marrëveshja për pranimin e fajësisë rezulton në një marrëveshje ndërmjet prokurorit dhe të pandehurit mbi pranimin e fajësisë”¹. Më tej sipas definicionit, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, i pandehuri pajtohet për të gjitha pikat e aktakuzës pa u përfshirë në procedure penale, ku të dyja palët pajtohen për kufinj të e dënimit që vijnë si propozim nga ana e prokurorit të shtetit².

Sistemi i drejtësisë penale në Kosovë ndër vite ka pësuar ndryshime rrënjësore. Tranzicioni i këtij sistemi është bërë prej atij inkuzitorë, i cili është dominuar nga gjyqtari hetues në atë kuazi-akuzator ku gjykata mbante disa nga kompetencat hetuese, ndërsa prokurori dhe mbrojtësi kishin kompetenca dukshëm më të mëdha. Sistemi i tanishëm është akuzator, në të cilin hetimet zbatohen plotësisht nga prokurori shtetit.³

Në vazhden e përafrimit të ligjeve me shtetet e zhvilluara, sistemi gjyqësor në Kosovë për zgjidhjen e çështjeve jashtë gjyqsore ka përfshirë Marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Kjo marrëveshje rregullohet me nenin 233 të paraparë në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPP) në fuqi.⁴ Ky nen i përgjigjet me përmbajtjen e vet, nenit 308 A të ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të vitit 2008.⁵ Marrëveshja mbi pranimin e fajit është e autorizuar shprehimisht në Kodin e Procedurës Penale.

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë e cila mund të referohet edhe si institut është një zgjidhje legjislative e re, me të cilën sigurohet zgjidhja e rasteve penale në kohën optimale nëpërmjet një procedure e cila thjeshton dhe shkurton gjykimin penal, në të cilën parashihet të përfitojnë të dyja palët. Për më tepër, kjo marrëveshje për pranimin e fajësisë vlenë pothuajse në cilën do

1 West's Encyclopedia of American Law, edition 2. Copyright 2008 The Gale Group, Inc.

2 Ibid.

3 Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, 2013, fq.13.

⁴ Ligji nr.03/L-003, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nëntor, 2008.

⁵ Ibid.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

fazën, që do të thotë gjenë zbatim para ose pas ngritjes së aktakuzës, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë.⁶

Negocimi për arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë mund të kërkohet nga mbrojtësi i të pandehurit ose të inicohet nga prokurori i shtetit. Në të dyja rastet kjo kërkesë duhet të miratohet nga kryeprokurori i zyrës përkatëse për të filluar negociatat për marrëveshjen për pranimin e fajësisë. Pasi kërkesa të miratohet nga kryeprokurori i shtetit të zyrës përkatëse të tij, prokurori i shteti ka dy alternativa të cilat ia ofron mbrojtësit të të pandehurit, 1. dërgon letër marrëveshjen e ofruar me kushtet e përcaktuara , dhe 2. takon mbrojtësin dhe të pandehurin për të negociuar kushtet dhe mundësitë e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Marrëveshja e arritur mbi pranimin e fajësisë duhet të jetë e nënshkruar nga prokurori, kryeprokurori i zyrës përkatëse, mbrojtësi dhe i pandehuri si dhe duhet të jetë detyruese për të gjitha palët nënshkruese. Marrëveshja me shkrim mbi pranimin e fajësisë i paraqitet gjykatës e cila hyn në fuqi pasi që të evidentohet në procesverbale pasi që është pranuar zyrtarisht nga gjykata.⁷

Ky punim ka për qëllim që të analizoj marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë (plea bargaining), të ofroj kontekstin historik mbi fillet dhe zbatimin e sajë në SHBA dhe Europë. Më tej, punimi fokusohet në analizën e marrëveshjes, duke përfshirë edhe pësimin e ndryshimeve përgjatë periudhës 2008 – 2013 si dhe zbatimin e tij në praktikë. Poashtu, punimi do të elaboroj në hollësi procedurën e Marrëveshjes për pranimin e fajësisë, duke u bazuar në Kodin e Procedurës Penale. Përfundimisht, ky punim do të ofroj rekomandime, me qëllim të aplikimit sa më të sukseshëm të negociimit dhe arritjes së marrëveshjes ndërmjet prokurorit dhe të pandehurit.

Historiku

Marrëveshja për pranimin e fajësisë fillet e saja i ka pasur shumë me herët, ndërsa, legjitimitetin e ka arritur në vitin 1970 në rastin Brady vs. United States. Ky rast ka ndikuar që Gjykata Supreme e SHBA-ve të pranojë që

6 Plea Bargaining – How Courts Work, American Bar Association , 2017.

7 Udhëzime mbi Marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Nëntor 2013.

marrëveshja mbi pranimin e fajësis të jetë pjesë përbërse e sistemit procedural penal të SHBA-ve. Marrëveshja mbi pranimin e fajësis në fillim të shekullit XIX ka qenë më shumë si marrëveshje mbi aktakuzën me të cilën paditësi ka pasë mundësi që të tërhiqet nga disa pika të akuzës ose të zbusë akuzën në këmbim të pranimit të fajit për veprën e kryer. Ndërsa, në fund të shekullit XIX marrëveshja ka pësuar ndryshime, ku gjyqtari ka pranuar marrëveshjen e pastaj ka kaluar me marrëveshjen mbi sanksionin. Marrëveshjet për pranimin e fajësis kanë qenë kryesisht të dominuara me rastet e shitjes së kundërligjshme të alkoolit e më pasë janë zbatuar në rastet e veprave më të rënda siç janë vrasjet.⁸

Zgjidhja e rasteve penale në SHBA përmes Marrëveshjes për pranimin e fajësis ka influencuar edhe procedurat penale të shteteve të Evropës kontinentale, në të cilat më shumë zbatohet parimi i legalitetit të ndjekjes, kështuqë edhe ata kanë filluar të marrin parasyshë zgjidhjen e çështjeve përmes procedurave alternative të pranimit të fajësisë. Nga fundi i shekullit 20, marrëveshja për pranimin e fajësis ka gjetë aplikimin në vendet Anglo-saksone dhe Euro-kontinentale.⁹ Shumica e shteteve të Evropës kanë krijuar eksperiencë në praktikimin e këtij institucioni si dhe aplikimi i saj ka qenë majft i qëlluar dhe efektiv. Këtë marrëveshje edhe e drejta romake e ka njohur edhe pse përbërja e saj ka qenë kryesisht e karakterit juridik civil duke përfshirë edhe të drejtat zakonore të shumë popujve.¹⁰ Ndërsa në Ballkan, dy shtete si Kosova dhe Bosnia dhe Hercegovina kanë përqafuar konceptin e plea bargaining, adpotuar dhe institucionalizuar atë duke ju referuar SHBA-ve. Karakteristikat e përgjithshme të zgjidhjeve konsensuale sipas legjislacioneve të shteteve në BE kanë dallim nga zgjidhja e çështjeve penale nëpërmes të plea bargaining me SHBA-të.¹¹

Ekzistojnë disa teori të cilat shtjellojnë idenë nëse procesi i negociimit të fajësisë është i drejtë dhe i barabartë. Përkrahësit e këtij institucioni argumentojnë se numri i akuzave është shumë i madhë dhe se prokurorëve u mungon koha për të ndjekur të gjitha akuzat përmes seancave gjyqësore,

⁸ Plea Bargaining's Triumph: A History of Plea Bargaining in America ,George Fisher, 2004

⁹ Practical Application of Plea Bargaining for the type and severity of criminal sanction in the 1st year of its application on the new law on criminal procedures, OSCE, 2016

¹⁰ Plea and Charge Bargaining – Research Summary, Bureau of Justice Assistance, U.S Department of Justice

¹¹ Buletini i Odës së Avokatëve VIII, nr. 14/2012

kështuqë përdorimi i këtij institucioni e përshpejton procesin e gjykimit. Poashtu, shteti arrinë të përfitojë ekonomikisht në raste kur marrëveshja e drejtë arrihet pa procese të stërzgjatura. Ndërsa, kundërshtuesit e këtij institucioni, argumentojnë se të pandehurit duhet të trajtohen në mënyrë të paanshme si dhe shkelësit e dhunshëm do të kishin më pak mundësi të merrnin dënime më të buta.¹²

Sot, marrëveshja e fajësisë është një pjesë thelbësore e sistemit të drejtësisë penale. Pjesa më e madhe e akuzave, mbi 90 për qind në shumë juridiksione, zgjidhen nëpërmjet një lloji të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.¹³

1. Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë në Kosovë - Pësimi i ndryshimeve në ligj

Në Kosovë, me ndryshim-plotësimet e bëra në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale në vitin 2008, (në tekstin e mëtejshëm KP përkatësisht KPP), është inauguruar si institucion i ri edhe marrëveshja për pranimin e fajësisë.¹⁴ Ndërsa, nga 1 janari i vitit 2013, ka hy në fuqi Kodi i ri i Procedurës Penale, me ndryshime më të favorshme për aplikimin më efektiv të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.¹⁵

Ndryshime e bëra sipas kodit në fuqi kanë pasur modifikime të paragrafeve të kodit të vjetër si dhe inkorporime krejtësisht të reja të paragrafeve. Inkorporimi i ri vërehet tek paragrafi 1 i nenit 223, me të cilin rregullohet negociimi i kësaj marrëveshjeje para se të ngritet aktakuza, mundësi kjo e cila nuk ofrohej nga kodi i vitit 2008 nenit 308A paragrafi 1. Poashtu, paragrafi 5 i nenit 233 të KPPRK është krejtësisht i ri pasi që parashihet mundësinë që marrëveshja për pranimin e fajësisë të negociohet edhe me iniciativë nga prokurori e cila sipas kodit të vjetër nuk e parashihte këtë mundësi. Ndërsa, ndryshimin më të rëndësishëm në këtë kod paraqet përmbajtja e nenit 7 me nën paragrafet 7.1 deri tek paragrafi 7.4 ku saktësohen benifitet për arritjen e marrëveshjes sipas etapave. Ndërsa, paragrafi i 9 i cili pjesërisht i përgjigjet

¹² Plea and Charge Bargaining – Research Summary, Bureau of Justice Assistance, U.S Department of Justice

¹³ Ibid

¹⁴ Ligji nr.03/L-003, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nëntor, 2008

¹⁵ Komentar – Kodi i procedurës penale të republikës së kosoves – Ejup Sahiti

paragrafit 5 të nenit 308A, ku përcakton situatat kur i pandehuri si dëshmitar bashkëpunues, atëhere prokurori i shtetit, siguron që kërkesa pasurore juridike e të dëmtuarit të shqyrtohet me këtë institucion. Një inkorporim i ri i në dispozitën ligjore të paragrafit 15 të nenit 233, përfshinë mundësinë e negociimit dhe arritjes së marrëveshjes para ngritjes së aktakuzës, ku pas asaj paraqitet një aktakuzë e veçantë në të njejtën kohë me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Ndërkaq, dispozitat tjera ligjore me të cilat rregullohet ky institucion mbeten të njejta.¹⁶

2. Procedura - Negocimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë

Marrëveshja për pranimin e fajësisë mund të arrihet në çdo periudhë para ngritjes së aktakuzës ku prokurori i shtetit dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e kësaj marrëveshje të shkruar në bazë të së cilës i pandehuri pranon fajësinë në shkëmbim për: Pajtimin e prokurorit të shtetit që t'i rekomandojë gjykatës dënimin më të lehtë, por jo të jetë nën minimumin e paraparë me ligj, apo sipas paragrafit 7 i cili përcakton minimumin e dënimit si mëposhtë¹⁷:

- a) Të arritur në shqyrtimin gjyqësori i pandehuri mund të denohet së paku 90 % të minimumit të dënimit të përcaktuar me Kodin Penal
- b) Të arritur para shqyrtimit gjyqësor i pandehuri mund të denohet së paku 80% të minimumit të dënimit të përcaktuar me Kodin Penal
- c) Të arritur para shqyrtimit gjyqësor kur i pandehuri është dëshmitarë bashkëpunues si dhe siguron prova në procedurë penale mund të denohet së paku 60% të minimumit të dënimit të përcaktuar me Kodin Penal.
- d) Të arritur para shqyrtimit gjyqësor kur i pandehuri është dëshmitarë bashkëpunues në hetim të fshehtë dhe siguron prova mund të denohet së paku 40% të minimumit të dënimit të përcaktuar me Kodin Penal.¹⁸

Ndërsa konsiderime tjera në interes të drejtësisë, është edhe rasti kur i pandehuri mund të lirohet nga dënimi.

¹⁶ Ligji NR.03/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e kodit të përkohshëm të procedurës penale & Ligji nr.03/L-003, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nëntor, 2008

¹⁷ Ligji NR.03/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e kodit të përkohshëm të procedurës penale

¹⁸ Ibid

Poashtu, marrëveshja për pranimin e fajësisë mund të arrihet në çdo kohë pas ngritjes së aktakuzës si dhe para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, ku prokurori i shtetit dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e kësaj marrëveshje të shkruar njëjloj si kushtet e përshkuara për pranimin e fajësisë para ngritjes së aktakuzës (Shih paragrafin më lartë).¹⁹

3. Procesi i Incimit të negociimit të Marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë

Në rastet kur i pandehuri dëshironë të arrijë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, mbrojtësi i të pandehurit kërkon një takim me prokurorin e shtetit me qëllim të fillimit të negociimit të kësaj marrëveshje. Pas pranimit të kërkesës, prokurori i shtetit informon kryeprokurorin e zyrës së tij përkatëse, i cili jep autorizimin me shkrim për mbajtjen e takimit që ka për qëllim të diskutoj mbi pranimin e fajësisë, në të cilin deklaratave të të pandehurit i ipet imunitet i kufizuar, që do të thotë se këto deklarata nuk mund të përdoren si prova të pranueshme në shqyrtimin gjyqësorë, nëse marrëveshja nuk pranohet nga gjykata.²⁰

Të gjitha format e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, duhet të jenë në formë të shkruar dhe të pranuar nga kryeprokurori i zyrës përkatëse të prokurorisë, para se ato ti ofrohen të pandehurit formalisht.

Ndërsa, sa i përket incimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë nga ana e prokurorit të shtetit, procedura rrjedhë në atë mënyrë që prokurori i shtetit pasi që e merr miratimin nga kryeprokurori i zyrës së tij përkatëse për të filluar negociatat për marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, së pari i dërgon letër mbrojtësit të të pandehurit në të cilën përshkruhet marrëveshja e ofruar si dhe kushtet të cilat përfshijnë: pikat e aktakuzës për të cilat i pandehuri pranon fajësinë, nëse i pandehuri pranon të bashkëpunojë, të drejtat nga të cilat hiqet dorë, dhe përgjegjësia e të pandehurit për kompenzimin e të dëmtuarit dhe konfiskimi i të gjitha pasurive të cilat i nënshtrohen konfiskimit nga kapitulli XVIII të KPPRK. Përveq opsionit të dërgimit të letrës, ai mund të takohet me

¹⁹ Ibid

²⁰ Ibid

mbrojtësin dhe të pandehurin për të negociuar mundësinë dhe kushtet e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.²¹

4. Informimi i të dëmtuarit sipas Marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë

Sipas procedurës të dy, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij duhet të jenë të pranishëm gjatë takimeve mbi negociimin e pranimit të fajësisë dhe duhet të pajtohen me kushtet e marrëveshjes me shkrim të përpiluara nga prokurori i shtetit para se ajo ti paraqitet gjykatës. Në rastet kur i pandehuri nuk merrë pjesë si dëshmitarë bashkëpunues zbatohen kushtet si vijojnë: prokurori i shtetit e informon të dëmtuarin për marrëveshjen e arritur, pasiqë marrëveshja të jetë në formën përfundimtare si dhe, të dëmtuait duhet ti jepet rasti që të paraqesë kërkesë pasurore juridike para se gjykata ta pranoj marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Në rastet kur i pandehuri merrë pjesë si dëshmitarë bashkëpunues, prokurori i shtetit siguron që kërkesa pasurore juridike e të dëmtuarit të përfshihet në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Kur i dëmtuari paraqet kërkesë pasurore juridike që rrjedh nga vepra penale e paraqitur në aktakuzë atëherë kjo marrëveshje duhet ta trajtoj kërkesën e të dëmtuarit. I dëmtuari duhet të ketë mundësinë të paraqet deklaratë gjykatës mbi kërkesën pasurore juridike para se gjykata ti shqiptoj dënimin të pandehurit sipas marrëveshjes së arritur.

5. Roli i gjykatës në procesin e negociimit të marrëveshjes

Gjykata nuk merr pjesë në negociimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, mirëpo roli i saj qëndron tek caktimi i afateve të arsyeshme kohore, të cilët nuk mund të jenë më gjatë se tre muaj, dhe ky përcaktim kohor bëhet me qëllim që procedurat të mos stër zgjatin.

Para se gjykata të pranoj marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, të dy palët si prokurori i shtetit ashtu dhe i pandehuri mund të refuzojnë marrëveshjen mbi

²¹ Ibid

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

pranimin e fajësisë, atëherë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të caktoj shqyrtimin gjyqësorë. Marrëveshja me shkrim mbi pranimin e fajësisë duhet të përmbajë të gjitha kushtet e marrëveshjes e cila duhet të jetë e nënshkruar nga prokurori i shtetit, kryeprokurori i zyrës përkatëse, mbrojtësi, dhe i pandehuri. Dhe kjo marrëveshje është detyruese për të gjitha palët nënshkruese. Kjo marrëveshje duhet ti përfshijë kushtet nga nenin 233 KPPRK , paragrafi 12 dhe 13.²²

Marrëveshja poashtu mund të përfshijë dispozitën ku palët pajtohen për kufijtë e dënimit që do të propozohet nga ana e prokurorit të shtetit nëse i pandehuri bashkëpunon susbtancialisht, ndërsa nëse gjykata shqipton dënim jashtë këtyre kufijve në dëm të ndonjëres prej palëve ajo palë ka të drejtë ankese kundër vendimit mbi dënimin.²³

6. Shqyrtimi i marrëveshjes nga ana e gjykatës

Marrëveshja përfundimtare me shkrim i paraqitet gjykatës në seancë dëgjimore të hapur për publik, dhe në rastet kur i pandehuri vendosë të jetë dëshmitarë bashkëpunues gjykata mund të urdhëroj që seanca dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të jetë e mbyllur për publik. Gjykata, zyrtarisht mund të pranoj apo refuzoj marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Gjykata, poashtu gjatë shqyrtimit nëso do të duhet të pranohet apo jo marrëveshja duhet të marrë personalisht në pyetje të akuzuarin, mbrojtësin e tij, dhe prokurorin e shtetit, në mënyrë që të përcaktoj nëse këto kushte janë pëmbushur:

- a) I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;
- b) Pranimi i fajësisë është bërë vullentarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë;
- c) Pranimi i fajësië mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë, apo me provat materiale të

²² Komentar – Kodi i procedurës penale të Republikës së Kosovës – Ejup Sahiti

²³ Ibid

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

paraqitura nga prokurori për plotësimin e aktakuzës dhe të pranuar nga i pandehuri, si dhe me dëshmi tjera siç mund të jenë deklaratat e dëshmitarëve të paraqitura nga prokurori apo i pandehuri;

- d) Dhe nuk ekzistojnë rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK.²⁴


Në rast se gjykata nuk bindet se janë përmbushur të gjitha kushtet e lartëcekura atëhere gjykata refuzon marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe rasti vazhdon në gjykim të rregullt. Ndërsa, nëse gjykata bindet për pranimin e fajësisë dhe urdhëron që marrëveshja të vendoset në shkresat e lëndës në gjykatë. Më pasë, gjykata cakton lëndën kur palët do të japin deklaratat e tyre në lidhje me dënimin, pas së cilës gjykata shqipton dënimin.²⁵

7. Zbatimin e tij ne praktikike duke u mbështetur ne statistika

Sa i përket marrëveshjeve të lidhura mbi pranimin e fajësisë në regjionet e Kosovës për periudhën 2015-2017, sipas stasisikave të mbledhura nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, shihet se regjionet që kanë lidhur më së shumti marrëveshje të ranguara në treshe janë: Prokuroria Themelore e Gjilanit, Prokuria Themelore e Pejës si dhe Prokuriora Themelore e Prizrenit. Në lidhjen e këtyre marrëveshjeve kryeson Prokuroria Themelore e Gjilanit me numër më të madhë të veprave penale të lidhura, gati dyfish deri në katërfish më shumë në krahasim me Prokuroritë Themelore të regjioneve tjera.

²⁴ Ibid

²⁵ Ligji NR.03/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e kodit të përkohshëm të procedurës penale & Ligji nr.03/L-003, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nëntor, 2008



Burimi i të dhënave²⁶

Për periudhën 2015 - 2017, në Prokurinë Themelore të Gjilanit marrëveshjet më të shpeshta të lidhura kanë qenë për veprën penale rrezikimi i trafikut publik, për Prokurorinë Themelore të Pejës marrëveshjet më të shpeshta të lidhura kanë qenë për veprën penale Mbajtja në Pronësi, Kontroll ose Posedim të paautorizuar të armëve. Ndërsa, sa i përket regjionit të tretë të ranguar për lidhjen më të madhe të marrëveshjeve, Prokurorisë Themelore të Pejës. Vepra penale më e shpeshtë ka qenë poashtu Mbajtja në Pronësi, Kontroll ose Posedim të paautorizuar të armëve. Për këtë periudhë numri i prokurorëve të cilët kanë aplikuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në Prokurionë Themelore të Gjilanit kanë qenë 14 Prokuror, në Prokurorinë Themelore të Prizrenit 11 prokurorë ndërsa në prokurorinë Themelore të Pejës kanë qenë 7.

Përfundimi

- Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë (plea bargainig) ka sjellë shumë rezultate të rëndësishme në sistemin gjyqësorë, dhe në mënyra të

²⁶ Këshilli Prokurorial i Kosovës – Statistikat, 2017

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

- ndryshme e modifikuar është përqafuar nga SHBA dhe në shumë shtete Evropiane ashtu edhe në legjislacionin e Republikës së Kosovës.
- Në Republikën e Kosovës, me ndryshim-plotësimet e bëra në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale në vitin 2008, ka hyrë si institucion i ri marrëveshja për pranimin e fajësisë mirëpo në vitin 2013 kjo marrëveshje është përsosur me modifikimet dhe inkomporimet e reja në dispozitat ligjore.
 - Ky institut në legjislacionin tonë të ri dita e ditës gjenë pranimin më të madhë, ndërsa zbatimi i tij në mënyrë konstante zgjerohet dhe modifikohet. Inkomporimi i këtij instituti në secilin shtet gjen aplikim të ndryshëm meqenëse secili shtet e ka përshtatur atë me kushtet e legjislacionit penal dhe gjyqësorit të vetë.
 - Kështu në këtë mënyrë janë krijuar forma të ndryshme të kësaj marrëveshjeje si të atyre më restriktive të cilat marrëveshjen e kanë lejuar për aplikim vetëm në vepra penale të lehta deri te marrëveshjet të cilat parashikojnë aplikimin e saj pavarsisht peshës dhe llojit të veprës penale.²⁷ Kosova e ka përqafuar këtë institucion pa u kufizuar në llojin e veprës penale, dhe përdorimin më të shpeshtë e ka pasur në veprat e rrezikimit të trafikut publik dhe mbajtjen në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve.
 - Përdorimi i këtij institucioni e përshpejton procesin e gjykimit. Poashtu, shteti arrinë të përfitojë ekonomikisht në raste kur marrëveshja e drejtë arrihet pa procese të stërzgjatura. Mirëpo duhet ta kemi parasyshë përsosshmërinë e këtij institucioni dhe mundësinë për të vrejtur pikat e dobta të aplikimit të tij në të drejtën tonë.
 - Duhet të bëhen vazhdimisht përpjekje për modifikimin dhe përshtatjen e këtij institucioni sipas kushteve dhe nevojave të Republikës së Kosovës. Prandaj, është me rëndësi ti përmbahemi parimeve bazë si dhe të kemi mjaftushëm sensibilitet për problemet praktike si të organeve të gjyqësorit ashtu edhe institucioneve për ekzekutimin e sanksioneve penale.

²⁷ Sporazum o priznanju krivnji kod krivicnih djela homogenog koneksiteta – Univerziteta u Zenic.

Literatura

- Buletini i Odës së Avokatëve VIII, nr. 14/2012
- Këshilli Prokurorial i Kosovës – Statistikat, 2017
- Komentar – Kodi i procedurës penale i republikës së kosoves – Ejup Sahiti
- Komentar – Kodi i procedurës penale i republikës së kosoves – Ejup Sahiti
- Ligji NR.03/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e kodit të përkohshëm të procedurës penale & Ligji nr.03/L-003, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nëntor, 2008
- Ligji NR.03/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e kodit të përkohshëm të procedurës penale
- Ligji NR.03/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e kodit të përkohshëm të procedurës penale & Ligji nr.03/L-003, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nëntor, 2008
- Ligji NR.03/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e kodit të përkohshëm të procedurës penale & Ligji nr.03/L-003, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nëntor, 2008
- Ligji nr.03/L-003, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nëntor, 2008.
- Ligji nr.03/L-003, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nëntor, 2008
- Plea and Charge Bargaining – Research Summary, Bureau of Justice Assistance, U.S Department of Justice
- Plea and Charge Bargaining – Research Summary, Bureau of Justice Assistance, U.S Department of Justice
- Plea Bargaining – How Courts Work, American Bar Association , 2017.
- Plea Bargaining's Triumph: A History of Plea Bargaining in America ,George Fisher, 2004
- Practical Application of Plea Bargaining for the type and severity of criminal sanction in the 1st year of its application on the new law on criminal procedures, OSCE, 2016

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

- Sporazum o priznanju krivnji kod krivicnih djela homogenog koneksiteta – Univerziteta u Zenic.
- Udhëzime mbi Marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Nëntor 2013.
- Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, 2013, fq.13.
- West's Encyclopedia of American Law, edition 2. Copyright 2008 The Gale Group, Inc.

Enis Gashi*

NOCIONI DHE RËNDESIDIA E FAJIT NË TË DREJTËN PENALE

Abstrakt:

Në të drejtën penale rëndësi të posaçme paraqet nocioni i veprës penale, që trajtohet në mënyrë të detajuar, duke i kushtuar një kujdes i veçantë nga shumë autor. Në këtë punim jam përcaktuar që të trajtoj çështjen e nocionit dhe rëndësisë së fajit, si një nga katër elementet e veprës penale, duke marrë për bazë rëndësinë e këtij elementi të veprës penale, sepse ka të bëjë me qëndrimin apo mardhënien e kryesit ndaj veprës penale që e ka kryer.

Arsyeja e rëndësisë së fajit të kryesit të veprës penale, çëndron në faktin se është element kyç për t'u krijuar përgjegjësia e kryesit të veprës penale. Duke marrë për bazë faktin e rëndësisë së madhe të këtij elementi të veprës penale, që ka qenë motivi im për përcaktimin e kësaj teme, është sepse në të drejtën penale, në praktikën e përditshme gjyqësore shfaqen probleme dhe dilema të ndryshme lidhur me vërtetimin e fajësisë së kryesit të veprës penale, që është e domosdoshme që në çdo rast konkret, fajësia e kryesit të veprës penale të vërtetohet me prova konkrete edhe pse paraqet vështirësi, varësisht prej rastit dhe rrethanave.

Vepra penale në aspektin material, është sjellje e njeriut e cila dëmton apo rrezikon vlerat elementare të njeriut, të shoqërisë dhe sistemit juridik. Elementet themelore të veprës penale janë: veprimi i njeriut, kundërligjshmëria, përcaktueshmëria e veprës penale në ligj dhe përgjegjësia penale e kryesit (fajësia). Meqenëse faji është një nga dy elementet e përgjegjësisë penale, pasi që përgjegjësia penale përbëhet nga: vetitë e caktuara psikike të kryesit (përgjegjësia) dhe qëndrimi apo marrëdhënia e kryesit ndaj veprës penale që e ka kryer (fajësia), andaj kam paraqitur lidhshmërinë e këtyre dy elementëve të përgjegjësisë penale. Para trajtimit të temës së fajit, kam trajtuar përgjegjësinë penale dhe përgjegjshmërinë, pastaj format e fajit si: dashja dhe pakujdesia në bazë të së drejtës penale si dhe literaturës shtesë po ashtu kam analizuar dhe trajtuar llojet e dashjes si: dashja direkte dhe eventuale, llojet e pakujdesisë si: pakujdesia me vetëdije dhe

pakujdesia pavetëdije, pastaj përgjegjësia dhe ndëshkimi i kryesit të veprës penale, varësisht nga forma e fajit.

Fjalët kyçe: Përgjegjësia, përgjegjshmëria, faji, dashja, pakujdesia.

1. Përgjegjësia penale

Përgjegjësia penale në të drejtën penale përbëhet prej përgjegjësisë dhe fajësisë, ashtu që një person konsiderohet i përgjegjshëm atëherë kur posedon aso aftësi (cilësi) psikike që e bëjnë të mundshme të kuptojë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojë sjelljet e veta. Ndërsa, kryesi i veprës penale konsiderohet i fajshëm, atëher kur ndaj veprës së kryer, ka pasur asi qëndrimi apo raporti i cili bën të mundshme që t'i ngarkohet vepra, përkatësisht kur veprën e konsideron si të vetën.¹

Nga kjo rezulton se për të ekzistuar përgjegjësia penale, kryesi duhet të jetë i përgjegjshëm dhe i fajshëm. Përgjegjësia dhe fajësia si elemente përbërëse të veprës penale, janë të lidhura ngushtë midis vete. Ashtu që, nëse një person nuk është i përgjegjshëm, nuk është i aftë që të kuptojë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojë sjelljet e veta, atëherë nuk mund të konsiderohet i fajshëm. Me fjalë të tjera, përgjegjësia është kusht për t'u sajuar fajësia, në anën tjetër një person nuk mund të jetë i përgjegjshëm, por të mos jetë i fajshëm për veprën e kryer.²

Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, në nenin 17 paragrafi 1 është paraparë që kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia. Në paragrafin 2 të po këtij neni është paraparë që një person është penalisht përgjegjës për veprën penale të kryer nga pakujdesia vetëm nëse këtë shprehimisht e përcakton ligji. Ndërsa në paragrafin 3 është paraparë që

* Enis Gashi, Prokuror i sapo emëruar në Prokurorinë Themelore në Prizren

¹ Ismet Salihu, E drejta penale, Prishtinë, 2008, fq. 275.

² Po aty.

personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet.³

Në të drejtën penale bashkëkohore është përvetësuar parimi i përgjithshëm, se që të mund të dënohet kryesi, përveç që vepra duhet të jetë e paraparë me ligj si vepër penale, duhet që kryesi të jetë penalisht i përgjegjshëm. Përgjegjësia penale, përkatësisht fajësia, është një ndër elementet e përgjithshme që duhet të shprehen tek çdo vepër penale. Kjo njëherësh është garanci e të drejtave të njeriut dhe kufizim i së drejtës së shtetit që t'i ndëshkojë qytetarët (*ius puniendi*). Pra, përgjegjësia penale, përkatësisht fajësia, është kusht që duhet të plotësohet doemos që të mund t'i shqiptohet dënimi kryesit të veprës penale, parim ky që është formësuar me maksimën “*nulla poena sine culpa*” (nuk ka dënim pa fajësi). Fajësia është digë mbrojtëse nga arbitrariteti i mundshëm i gjykatës, ngase gjykata nuk mund të dënojë asnjë person nëse nuk e konstaton fajësinë e tij.⁴

2. Përgjegjshmëria penale

Para se të trajtoj çështjen e fajit dhe formave të kryerjes së veprës penale, është e rëndësishme të trajtohet edhe përgjegjshmëria, ashtu që për t'u konsideruar një person penalisht i përgjegjshëm dhe për të mundur të ndëshkohet për veprën e kryer ai duhet të jetë i përgjegjshëm.

Në të drejtën penale një person konsiderohet i përgjegjshëm atëherë kur posedon aso veti apo aftësi intelektuale (mendore) dhe volutive që i bëjnë të mundshme të mendojë, të gjykojë, të vendos dhe t'i kontrollojë sjelljet dhe veprimet e veta. Nga ky përkufizim del se përgjegjshmëria përbëhet prej dy elementeve: elementit intelektual apo të vetëdijës dhe elementit volitiv apo dëshirës - vullnetit.⁵

³ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 17 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 19, datë 13.07.2012, Prishtinë.

⁴ I. Salihu, H. Zhitija & F. Hasani, Kometari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2014, fq. 72.

⁵ Ismet Salihu, vep. e cit., fq. 277.

Elemeti intelektual apo aftësia intelektuale (mendore), ekziston atëherë kur kryerësi i veprës penale është i aftë që të kuptojë rëndësinë e veprës së vetë, që të ketë pasqyrë, përfytyrim të qartë se është duke kryer një vepër të rrezikshme dhe të kundërligjshme. Elementi volitiv apo elementi i dëshirës, përkatësisht vullnetit, ekziston atëherë kur personi është në aso gjendje apo ka aftësi psikike që të vendosë dhe t'i kontrolloj sjelljet e veta, pra aftësia psikike e personit që i bën të mundshme vullnetarishtë të vendos për të kryer një vepër dhe aftësia për t'i kontrolluar sjelljet e veta.⁶

Për t'iu ngarkuar vepra penale kryesit është e domosdoshme përmbushja e dy elementeve. D.m.th, për ekzistimin e përgjegjësisë penale është e domosdoshme ekzistimi i aftësisë mendore dhe fajësia (fajësia e cila paraqitet me paramendim ose nga pakujdesia). Kjo është e kuptueshme, se pa ekzistimin e aftësisë mendore nuk mund të ekzistoi as fajësia duke pas parasysht që aftësia mendore është bazë mbi të cilën paraqitet fajësia. Në anën tjetër, aftësia mendore mund të ekzistoj dhe atëherë kur te kryesi nuk ka fajësi për veprën e kryer, në të dyja rastet nuk ka përgjegjësi penale, kështu që nuk mund të vjen as deri te dënimi për veprat e kryera në mungesë të elementeve të cekura më lart. Aftësia mendore dhe fajësia mund të maten sipas shkallës, d.m.th mund të ekzistoj shkallë më e lart ose më e ultë e aftësisë mendore si dhe shkallë më e lartë ose më e ultë e fajësisë në varësi nga shkalla dhe intensiteti i paraqitjes së elementeve subjektive dhe psikike (vetëdijes dhe dëshirës) të kryesit të rastit konkret. Kjo d.m.th që përgjegjësia penale mund të matet me shkallë. Ky fakt është shumë i rëndësishëm, sepse nga shkalla e përgjegjësisë penale, varet jo vetëm lloji dhe lartësia e dënimit për veprën e kryer, por në disa raste dhe ekzistimi i dënimit e me këtë ekzistimi i veprës penale. Pasi që përgjegjësia penale është kusht për zbatimin e dënimeve sipas kryesit të veprës, ajo duhet të ekzistoi dhe në kohën e kryerjes të veprës penale. Kjo d.m.th që aftësia mendore dhe fajësia duhet të ekzistojnë në momentin e kryerjes të veprës penale në raport me veprën penale konkrete të kryer.⁷

⁷ Borisllav Petroviq, E drejta penale, fq. 66, Sarajevë/Prishtinë, tetor 2006

3. Faji

Siç u theksua më lart, për t'u konsideruar kryesi i veprës penale person penalisht përgjegjës për veprën e kryer, duhet të jetë i përgjegjshëm dhe i fajshëm, kështu që përgjegjshmëria dhe fajësia janë elemente përbërse të përgjegjësisë penale, ndërsa kur flasim për elementet e veprës penale, faji është element subjektiv i veprës penale.

Përkundër faktit se përgjegjshmëria mund të supozohet, se një person veprën penale e ka kryer në gjendje të përgjegjshme, fajësia nuk mund të supozohet por ajo medoemos për çdo rast konkret të veprës penale duhet të vërtetohet, duhet që në procedurë penale të administrohen provat e nevojshme, në mënyrë që të konstatohet se personi veprën penale të caktuar e ka kryer me fajin e tij.⁸

Është me rëndësi të ceket fakti se barra e të provuarit të fajësisë, sipas Kodit të Procedurës Penale, Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, në nenin 6 është përcaktuar se hetimet fillohen me vendim të prokurorit të shtetit andaj barra e të provuarit bie në organin e akuzës, respektivisht prokurorin e shtetit, ashtu që sipas nenit 103 të po këtij kodi, në bazë të hetimeve dhe grumbullimit të provave, apo me aktakuzë të drejtpërdrejtë në rastet kur ka prova të mjaftueshme dhe lejohet pa zbatim të hetimeve, të argumentoj fajësinë e personit i cili dyshohet që të ketë kryer vepër penale në rastin konkret.

Faji është përgjegjësia personale e kryesit për veprën e vet. Një person konsiderohet se veprën penale e ka kryer me faj, në rastet kur ka ditur se me veprimin apo mosveprimin e tij, do të shkaktojë pasojë të ndaluar në botën e jashtme, pasojë kjo që në ligj është paraparë si vepër penale dhe nëse ndaj pasojës – ndaj veprës, ka pasur aso marrëdhënie, relacion e cila i bën të mundshme gjykatës që t'ia ngarkojë, tia vëjë në barrë atë vepër. Marrëdhënia apo relacioni i kryesit ndaj veprës në të drejtën penale quhet fajësi.⁹ Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, i akuzuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni

⁸ Ismet Salihu, vep. e cit., fq. 291.

⁹ Po aty.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

375 par.2 të KPRK-së, në të cilin rast është konstatuar fajësia e të akuzuarit për veprën penale me të cilën është ngarkuar nga prokuroria, ku si rrethanë faktike mbi të cilën është akuzuar i pandehuri dhe gjykata e ka konstatuar fajsinë, është se i akuzuari e ka përdoruar armën në mënyrë kërcënuese me qëllim të frikësimit të të dëmtuarit, në atë mënyrë që disa here ka shtënë në ajër, pastaj lidhur me shqiptimin e dënimit ka marrë për bazë shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe motivin e kryerjes së veprës penale.

Në shkencën e së drejtës penale por edhe në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, është përcaktuar koncepti se faji i ka dy forma kryesore: **dashjen** (dolus) dhe **pakujdesinë** (culpa), ashtu që dashja është forma më e rëndë e fajit dhe më së shpeshti veprat penale kryhen me dashje.

Në rastet kur vepra penale kryehet me dashje, kryesi çdoherë konsiderohet përgjegjës, ndërsa pakujdesia është formë më e lehtë e fajit dhe për veprat penale të kryera nga pakujdesia, kryesi dënohet vetëm në rastet kur me ligj shprehimisht parashihet se do të dënohet edhe për vepër penale nga pakujdesia.¹⁰

Faji në një shkallë a në një tjetër, është vlerësuar gjithmonë nga e drejta penale, e hershme a e vonët, si element i rëndësishëm për ekzistencën e veprës penale. Parimi i fajësisë është shprehur me formulën e njohur romake “*Nullum crimen, nulla poena sine culpa*”, nuk ka krim nuk ka dënim pa faj.¹¹

Në strukturën e elementeve të përgjithshme të veprës penale, faji është element subjektiv i veprës penale. Për t’u ndëshkuar një person për veprën e tij, nuk mjafton që të ketë kryer vetëm vepër të kundërligjshme që parashihet si vepër penale, por ai atë vepër duhet ta ketë kryer me fajin e tij. Në të drejtat penale bashkëkohore, për t’u konsideruar personi penalisht i përgjegjshëm dhe për t’u bërë e mundur të dënohet, duhet që veprën ta ketë kryer me fajin e tij.¹²

¹⁰ Ismet Salihu, vep. e cit, fq. 273.

¹¹ Shefqet Muçi, E drejta penale, Tiranë, 2012, fq .162.

¹² I. Salihu, H. Zhitija & F. Hasani, vep. e cit. fq. 91.

Në shkencën e së drejtës penale njihen tri konceptione apo teori. Këto janë: *Teoria psikologjike*, *teoria normative* dhe *teoria psikologjike–normative*. Sipas *teorisë psikologjike*, faji është marrëdhënie (relacion) psikik i kryesit ndaj veprës së vet dhe pasojës së asaj vepre, e cila shprehet me dashje dhe nga pakujdesia. Kjo teori mbështetet në logjikën se kur personi është i përgjegjshëm, ai është i aftë edhe të konkludojë, të dijë se veprën që e kryen në shoqëri vlerësohet si vepër e dëmshme, e keqe dhe kriminale. Me fjalë të tjera, sipas teorisë psikologjike, një person konsiderohet i fajshëm kur psikikisht është i aftë të bëjë dallimin midis veprës së mirë, në një anë, dhe veprës së keqe, të dëmshme, në anën tjetër. Sipas *teorisë normative*, një person konsiderohet se e kryen veprën me fajin e tij në rastet kur veprën e vet e vlerëson si të kundërligjshme. Pra, sipas kësaj teorie, faji ekziston nëse kryesi ka qenë i vetëdijshëm ose duhet të ishte i vetëdijshëm, ka qenë i detyruar të jetë i vetëdijshëm se vepra e tij është e kundërligjshme, në ligj është e përcaktuar si vepër penale. Brenda e kësaj teorie konsiston në faktin se një person e konsideron të fajshëm ngase nuk është sjellë, nuk ka vepruar ashtu si e obligojnë normat juridike, sociale dhe morale. Vlerësimin lidhur me atë se a është sjellë, a ka vepruar në kundërshtim me ligjin, e jep gjykata. Kësaj teorie i bëhet vërejtje ngase në masë të konsiderueshme lë pas dore elementin psikik të fajësisë dhe kësaj anë më tepër në drejtim të përgjegjësisë objektive. Sipas *teorisë psikologjike–normative*, një person konsiderohet se e ka kryer veprën me faj në rastet kur janë shprehur elementet e përmendura të teorisë psikologjike dhe të teorisë normative. Rrjedhimisht, sipas kësaj teorie, kryesi konsiderohet i fajshëm atëherë kur ka qenë i vetëdijshëm se me veprimin apo mosveprimin e tij do të shkaktojë pasojë të dëmshme, dhe nëse e ka ditur se ajo vepër është e ndaluar, është në kundërshtim dhe dënohet sipas normave juridike, morale dhe sociale.¹³

4. Dashja (dolus)

Në shkencën penale por edhe në praktikën gjyqësore, ekziston përkufizimi se vepra penale është kryer me dashje, kur kryesi ka qenë i vetëdijshëm për veprën e vetë dhe ka dashur ta kryej, apo kur ka qenë i vetëdijshëm se për

¹³ Po aty, fq. 92-93.

shkak të veprimit apo mosveprimit të tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar, por e ka pranuar, është dakorduar që të shkaktohet ajo pasojë.¹⁴

Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, në nenin 21 është përcaktuar se vepra penale mund të kryhet me **dashje direkte** ose **eventuale**. Në paragrafin e parë të këtij neni është përcaktuar se personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vetë dhe e dëshiron kryerjen e saj. Ndërsa, në paragrafin e tretë është parçaktuar se personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj.¹⁵

4.1 Dashja direkte (*dolus directus*)

Te dashja direkte është me rëndësi fakti se kryesi i veprës penale krijon, aso relacioni apo lidhje me veprën penale, ashtu që është i vetëdijshëm për pasojën që do të shkaktohet me rastin e kryerjes së veprës penale dhe po ashtu e dëshiron kryerjen e veprës penale dhe shkaktimin e pasojave në botën e jashtme, e dëshiron kryerjen e veprës penale duke qenë i vetëdijshëm njëkohësisht.

Kjo formë e dashjes ekziston atëherë kur kryesi është i vetëdijshëm, se me veprimin apo mosveprimin e vet do të kryejë vepër të dëmshme, vepër penale dhe dëshiron kryerjen e asaj vepre, dëshiron që të shkaktohet pasoja e ndaluar në botën e jashtme. Te dashja direkte, kryesi është i vetëdijshëm për veprimet e veta, është i vetëdijshëm për rrezikshmërinë shoqërore abstrakte të sjelljes së vet, e parasheh mundësinë e shkakimit të pasojës së dëmshme, përkatësisht është i vetëdijshëm për rrezikun konkret, me vullnet i drejton (qeverisë) sjelljet e veta dhe dëshiron shkaktimin e pasojës së rrezikshme. Së këndejmi, te kjo formë e dashjes shprehet elementi i vetëdijes (elementi intelektual) dhe elementi i vullnetit (elementi i dëshirës).

¹⁴ Ismet Salihu, vep. e cit. fq. 295.

¹⁵ Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës, neni 21.

Elementi i vetëdijes (intelektual), në kuadrin e dashjes direkte shprehet në rastet kur kryesi është i vetëdijshëm, e di, ka përfytyrim të qartë për veprën që e kryen dhe pasojat që do të shkaktohen nga ajo veprë dhe për lidhjen kauzale midis veprës dhe pasojës që do të shkaktohet. Te kjo formë e dashjes, kryesi duhet të jetë i vetëdijshëm edhe për tiparet e tjera që e përbëjnë figurën e veprës penale të caktuar, siç janë objekti i veprës penale, koha, mënyra, mjetet e kryerjes së veprës penale dhe të gjitha rrethanat e tjera reale të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale. Nëse kryesi i veprës nuk ka qenë i vetëdijshëm për ndonjë rrethë nga rrethanat reale që është tipare, element përbërës i veprës penale, atëherë te kryesi i tillë nuk ekziston dashja lidhur me atë veprë. Për shembull, nëse personi A nuk e di se akoma gjendet në martesë dhe lidh martesë me personin B, atëherë nuk mund të konsiderohet se ka kryer veprën penale të bigamisë.¹⁶

Elementi volitiv apo i dëshirës (i vullnetit), është komponentë e dytë e dashjes direkte. Ky element shprehet atëherë kur kryesi ka dashur, ka dëshiruar që me veprimin apo mosveprimin e vet të shkaktojë pasojën e caktuar. Konsiderohet se personi e ka dëshiruar kryerjen e veprës kur ndërmerr veprimin me qëllim që të shkaktojë pasojën, e cila është tipar i veprës penale të caktuar. Vullneti apo dëshira është komponentë praktike e vetëdijes. Me anë të vullnetit, me vetëdije orientohen dhe dirigjohen veprimet mendore dhe fizike në drejtim që të arrihet qëllimi i caktuar. Duke u mbështetur në vullnetin personal, njeriu mund t'i kontrollojë sjelljet e veta, të sillet në harmoni me normat shoqërore, të frenojë realizimin e motiveve që janë në kundërshtim me normat juridike, sociale dhe morale. Në përgjithësi, veprimi i vullnetshëm përfshin këto komponentë: përcaktimin e qëllimit; planifikimin dhe parashikimin e mjeteve që duhet përdorur për realizimin e qëllimit të caktuar; ndërmarrjen e veprimit dhe qeverisjen e veprimeve në drejtim të arritjes së qëllimit. Nga kjo që u tha, marrë në tërësi, elementi volitiv përbëhet prej këtyre dy komponentëve; prej komponentit të qeverisjes vullnetare me sjelljet (veprimet) e veta dhe prej komponentit të qëllimit (dëshirës) që të shkaktohet pasojë e caktuar. Së këndejmi, konsiderohet se kryesi e ka dëshiruar kryerjen e veprës në rastet kur e ka ndërmarrë veprimin me qëllim që ta realizojë veprën, që të shkaktojë pasojën e cila është tipare e veprës penale të caktuar.

¹⁶ I. Salihu, H. Zhitija & F. Hasani, vep. e cit. fq. 94.

Kështu, p.sh. personi A me qëllim që ta privojë nga jeta personin B shkrepi nga revolja në drejtim të tij dhe e vret. Mirëpo, do të konsiderohet se personi e ka dëshiruar kryerjen e veprës edhe atëherë kur ndërmarrja e një veprimi të kundërligjshëm është i domosdoshëm ngase i shërben për ta realizuar qëllimin e vet, p.sh. e vret personin tjetër me qëllim që t'ia marrë të hollat, apo në rastin kur ndokush e vret të afërmin e vet me qëllim që ta trashëgojë pasurinë e tij.¹⁷

Forma e fajit përcaktohet rast pas rasti nga gjykata, duke analizuar tërësinë e rrethanave të çështjes. Fakti arsyetohet në një vendim gjyqësor-ekziston dhe përbën vepër penale. Kjo vepër penale është kryer me faj nga i pandehuri dhe është kryer me dashje direkte. I pandehuri ka parashikuar pasojat e veprës penale të shkaktuara me veprimet e kundërligjshme të tij dhe ka dëshiruar ardhjen e tyre.¹⁸

4.2 Dashja eventuale (dolus eventualis)

Ekziston atëherë kur kryesi ka qenë i vetëdijshëm se për shkak të veprimit apo mosveprimit mund të shkaktohet pasoja e ndaluar, mirëpo me vetëdije është pajtuar, është dakorduar që ajo të shkaktohet (neni 21, par. 3 i Kodit Penal). Dashja eventuale ka ngjashmëri me dashjen direkte, mirëpo ka edhe dallime kualitative në sferën e vetëdijes, e edhe më tepër në sferën e vullnetit, dëshirës lidhur me shkaktimin e pasojës së ndaluar. Rrjedhimisht, te dashja eventuale, ndryshe nga dashja direkte, kryesi me veprimet e veta nuk ka për qëllim që të shkaktojë pasojën e caktuar që është tipare e veprës së ndaluar, madje shkaktimin e asaj pasoje nuk e parasheh as si të sigurt, mirëpo është i vetëdijshëm se me ndërmarrjen e veprimit krijohet një mundësi e madhe, një rrezik i madh se do të kryhet edhe ajo vepër dhe do të shkaktohet edhe ajo pasojë, të cilën vetëm e parasheh si të mundshme, por të cilën nuk e dëshiron.

Këtu edhe qëndron thelbi i dashjes eventuale, dhe themeli i sajimit të përgjegjësisë penale, ngase kryesi, edhe pse është i vetëdijshëm se me veprimin apo me mosveprimin e vet krijon një rrezik të madh që të shkaktohet

¹⁷ I. Salihu, H. Zhitija & F. Hasani, vep. e cit. fq. 95.

¹⁸ Shefqet Muçi, vep. e cit. fq. 165.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

pasoja e ndaluar (të kryhet vepra penale) dhe përkundër saj nuk abstenon nga ajo vepër.

Me fjalë të tjera, te dashja eventuale personi vendos të ndërmarrë një veprim apo mosveprim të ndaluar apo të lejuar, edhe pse është i vetëdijshëm se mund të shkaktohet pasoja e ndaluar. Këtu duhet theksuar se pasoja e shkaktuar nuk është ajo të cilën ai e dëshiron, mirëpo ai llogaritet, supozon me një probabilitet të madh, me një mundësi të madhe se ajo vepër do të shkaktohet dhe përkundër kësaj ai pajtohet, pranon që të shkaktohet edhe ajo pasojë në mënyrë që ta realizojë qëllimin e vet kryesor. Ja disa shembuj ku shprehet vepra e kryer me dashje eventuale: personi A shkrep revolen me qëllim që ta vrasë personin B që është duke vozitur automobilin, në të cilin është edhe personi C. Këtu personi A është i vetëdijshëm se mund ta godasë edhe personin C, apo me vrasjen e personit B do të shkaktohet edhe vdekja e personit C për shkak të ndeshjes apo rrokullisjes së automobilit.¹⁹

Elementi intelektual apo i vetëdijes ekziston atëherë kur kryesi është i vetëdijshëm, supozon se nga veprimi apo mosveprimi i tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar. Sipas kësaj, kjo formë e fajit ekziston në rastet kur kryesi, shkaktimin e pasojës e parasheh vetëm si të mundshme. Nuk mund të ekzistojë dashja eventuale kur kryesi fare nuk parasheh mundësinë e shkaktimit të pasojës nga veprimi apo mosveprimi i tij. Përkatësisht kur kryesi fare nuk parasheh mundësinë e ardhjes së pasojës, mund të bëhet fjalë për pakujdesinë pa vetëdije. Gjithashtu, nuk konsiderohet se vepra penale është kryer me dashje eventuale kur kryesi, shkaktimin e pasojës e parasheh si të sigurt, si të domosdoshme. Në rastet e këtilla është fjala për veprën e kryer me dashje direkte. Me fjalë të tjera, dashja eventuale shprehet në rastet kur kryesi është i vetëdijshëm se me ndërmarrjen e veprimit krijohet rreziku konkret, apo krijohet situata e rrezikut të madh që të shkaktohet pasoja e ndaluar dhe megjithatë nuk heq dorë nga veprimi.

Elementi volitiv apo i vullnetit te dashja eventuale shprehet kur kryesi pranon, jep pëlqimin apo lejon që të shkaktohet pasoja e ndaluar. Në krahasim me dashjen direkte, elementi volitiv apo i dëshirës është më i vogël, lajmërohet

¹⁹ I. Salihu, H. Zhitija & F. Hasani, fq. 96.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

në formë më të butë. Në të drejtën penale konsiderohet se një person pranon, dakordohet që nga veprimi apo mosveprimi i tij të shkaktohet pasoja e ndaluar. Në rastet kur ai pajtohet që si rezultat i veprimit të tij të paraqitet edhe një pasojë e dëmshme, të cilën nuk e dëshiron, mirëpo edhe nuk e kundërshton, por përkundrazi e lejon, dakordohet që të shkaktohet ajo pasojë. Me fjalë të tjera, kush e parasheh mundësinë e shkakimit të pasojës së dëmshme, kush është i vetëdijshëm se veprimi i tij përmban në vete një dozë të madhe të rrezikut, dhe nëse pajtohet me atë rrezik dhe me atë pasojë eventuale, konsiderohet se veprën e ka kryer me dashje eventuale. Së këndejmi, kryesi këtu është i vetëdijshëm për mundësinë e shkakimit të pasojës së dëmshme, të cilën përndryshe nuk e dëshiron, mirëpo të cilën e pranon si një lloj çmimi me qëllim që ta realizojë qëllimin e tij kryesor.²⁰

Përgjegjësia dhe ndëshkimi - Për kryerjen e veprës penale me dashje, sipas kodit penal por edhe sipas të drejtës penale, kryesi çdoherë dënohet, respektivisht përgjigjet penalisht për veprat penale të kryera me dashje, pa marrë parasysh se veprën penale e ka kryer me dashje direkte apo eventuale. Edhe pse në kodin penal nuk është i shprehur dallimi sa i përket ndëshkimit të kryesit të veprës penale, varësisht se a ka kryer veprën penale me dashje direkte apo eventuale, një dallim ka në teori dhe praktikë duke konsideruar se veprat penale të kryera me dashje direkte, janë më të rënda se sa ato të kryera me dashje eventuale.

Kur jemi tek veprat penale të kryera me dashje, është me rëndësi të ceket se te kjo formë e kryerjes së veprës penale, paraqitet si element me rëndësi edhe qëllimi dhe motivi i kryerjes së veprës penale, të cilat janë kategori psikologjike dhe subjektive të kryesit të veprës penale, e që kanë rëndësi në të drejtën penale.

Kryesi i veprës penale zakonisht vepron me qëllim të caktuar kur e kryen veprën penale, zakonisht te veprat penale tek të cilat kryerësi vepron me dashje, supozohet se kryhet me qëllim të caktuar, që do të thotë se kryesi paraprakisht formon bindjen se me kryerjen e veprës penale do të arrihet qëllimi i caktuar. Te disa raste për t'u konsideruar se është kryer vepra penale,

²⁰ Po aty, fq. 97-98.

duhet të përmbushet edhe elementi i qëllimit tek kryesi i veprës penale, që vepra penale të jetë kryer me qëllim të caktuar, si për shembull te vepra penale e vjedhjes konsiderohet se është kryer atëherë kur kryesi pasurinë e huaj e merr me qëllim të përfitimit për vete apo personin tjetër në mënyrë të kundërligjshme. Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, i akuzuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, ashtu që gjykata si rrethana faktike mbi të cilat është akuzuar i pandehuri dhe mbi bazën e të cilave është shpallur fajtor, ka cekur se i akuzuari me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten, ka vjedhur pasurinë e të dëmtuarit duke i shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.

Edhe motivi sikurse qëllimi gjendet jashtë dashjes dhe konsiderohet se vepra penale është kryer me dashje pavarësisht se a ka ekzistuar motivi në rastin konkret, mirëpo disa vepra penale konsiderohet se janë kryer vetëm nëse në ato raste është shprehur motivi për kryerjen e veprës penale, sikurse është për shembull vepra penale e vrasjes e kryer me motive fetare, racore, vrasja për interes etj. Mirëpo në disa raste nëse vepra penale kryhet nga motive të caktuara, atëherë e bën veprën të cilësuar apo formë më të rëndë, si për shembull vepra penale e vrasjes e kryer për interesa materiale, e bën formë të vrasjes së rëndë etj.

5. Llojet e posaçme të dashjes

Kur bëhet fjalë për llojet e dashjes, pos dashjes direkte dhe eventuale, në të drejtën penale ekzistojnë edhe llojet e posaçme të dashjes, por edhe pse kodi ynë penal nuk i njeh këto lloje të dashjes, ato janë të rëndësishme për praktikën gjyqësore.

Dolus determinatus (dashja e caktuar), kjo formë shprehet kur kryesi i ka paraparë pasojat dhe tiparet e tjera të figurës së caktuar të veprës penale. Kjo formë e dashjes përputhet në tërësi me dashjen direkte. **Dolus generalis (dashja e përgjithshme)**, shprehet në rastet kur kryesi e kryen veprën me një dashje të pacaktuar, pra kryesi ka një përfytyrim të përgjithshëm, si për

shembull personi a ia vjedh portofolin personit b dhe nuk e dinë sa të holla ka në të. **Dolus alternativus (dashja alternative)**, ky lloj i dashjes shprehet në rastet kur kryesi me veprimin e tij parasheh mundësinë e realizimit të dy pasojave, përkatësisht parasheh mundësinë se do të kryej dy vepra penale, mirëpo e di mirë se varësisht nga rrjedha e ngjarjes do ta kryej vetëm njëren apo veprën tjetër, për shembull personi a hedh gurin në drejtim të personit b dhe c, por e di se vetëm njërit prej tyre mund të i shkaktoj lëndime. **Dolus praemeditatus (dashja e paramenduar)**, konsiderohet se një veprë penale është kryer me dashjen e paramenduar kur personi e kryen veprën pasi të ketë menduar gjatë për pasojat e mundshme dhe tiparet e tjera të figurës së veprës penale dhe pas që të përgatisë kryerjen e veprës penale. **Dolus repentinus (dashja e atëçastshme, papritmas)**, kjo formë e dashjes shprehet zakonisht në rastet kur ndokush është i provokuar rëndë prej tjetrit dhe ky duke u gjendur në një tronditje psikike aty për aty në moment vendos të kryej veprë penale, për shembull vrasja në afekt etj.²¹

6. Pakujdesia (culpa)

Pakujdesia është forma e dytë e fajit dhe për nga intensiteti i përgjegjësisë penale është formë më e lehtë e fajësisë. Marrë në përgjithësi në aspektin e së drejtës penale, pakujdesia ekziston atëherë kur kryesi nuk e dëshiron pasojën e shkaktoar, përkatësisht kur pasoja shkaktohet kundër vullnetit të tij.

Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, në nenin 23 është paraparë instituti i pakujdesisë. Në paragrafin e parë është përcaktuar se vepra penale mund të kryhet me pakujdesi të vetëdijshme apo të pavetëdijshme. Në paragrafin e dytë ceket se, personi vepron me pakujdesi të vetëdijshme kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose të mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet, apo se ai do të mund ta parandalojë shkaktimin e saj. Ndërsa, në paragrafin e tretë të po këtij neni ceket se personi vepron me pakujdesi të pavetëdijshme kur nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij

²¹ Ismet Salihu, vep. e cit. fq. 304 - 305.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

personale ka mund të ishte apo do duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi.²²

Në të drejtën penale konsiderohet se një person e ka kryer veprën penale nga pakujdesia në rastet kur nuk i ka respektuar kërkesat e shoqërisë që në veprimtarinë apo sjelljet e tij të jetë i kujdesshëm. Me fjalë të tjera, konsiderohet se një person e kryen veprën penale nga pakujdesia kur pasoja e dëmshme është rezultat i moskujdesit, indiferencës apo joseriozitetit të tij. Me pakujdesi shkaktohet pasoja e dëmshme (vepra penale), e cila ka mundur të mos shkaktohet po të ishte kryesi më i kujdesshëm. Ky moskujdes, i cili rezulton në vepër penale, kryesisht tregon mungesë të adaptimit social të kryesit dhe mungesë të ndjesisë që të respektohen vlerat e jetës së përbashkët dhe në një masë është edhe mungesë e kulturës.

Përcaktimi i pakujdesisë nisët nga fakti që te kryesi duhet të ekzistojë raport i caktuar psikik ndaj veprës se paraqitur, ose vetëdijen për mundësin e pasojave ose shkakut dhe mundësisë për parashikimin e pasojës. Kështu, në nenin 16 KP të Kosovës vepër e kryer nga pakujdesia konsiderohet ajo vepër në të cilën kryerësi ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të ti, por, me mendjehetësi, mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai do të mund të parandaloj shkaktimin e saj. Do të thotë se dallimi në mes të dashjes dhe pakujdesisë paraqitet në elementin e dëshirës për pakujdesi. Elementi i dëshirës paraqitet në pajtimin më pasojën, përderisa te pakujdesia elementi i dëshirës nuk ekziston fare.²³

Në këtë fakt sajohet dhe mbështetet edhe fajësia në formë të pakujdesisë, sepse kryesi i këtillë nuk i respekton, apo i respekton në masë jo të duhur kërkesat, standardet dhe masat që parashihen me qëllim të parandalimit të pasojave të dëmshme. Kodi ynë penal, sikundër edhe kodet penale të shteteve të tjera, i njeh dy lloje apo dy shkallë të pakujdesisë, dhe atë *pakujdesinë me vetëdije* apo *nga mendjehetësia* dhe *pakujdesinë pa vetëdije* apo *nga neglizhenca* (par. 1 i nenit 23). Këto dy lloje të pakujdesisë dallohen midis vetes vetëm sipas elementit të vetëdijes apo elementit intelektual. Kurse të dyja këto lloje të

²² Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës, neni 23.

²³ Borisllav Petroviq, vep e cit, fq. 82

pakujdesisë dallohen nga dashja, ngase në asnjë formë nuk shprehet dëshira apo vullneti për të shkaktuar pasojën e ndaluar në botën e jashtme.²⁴

4.1 Pakujdesia me vetëdije apo mendjelehtësia (luxuria)

Sipas paragrafit 2 të nenit 23, ekziston atëherë kur personi është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit apo mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet, apo se ai do të mund të parandalojë shkaktimin e saj. Karakteristikë kryesore dhe tipike e pakujdesisë me vetëdije është se kryesi nuk e dëshiron pasojën, madje as nuk e pranon, nuk dakordohet me shkaktimin e saj.

Shprehja mendjelehtësi apo pakujdesi me vetëdije, të cilën e përdor ligjdhënësi për ta përcaktuar këtë lloj të fajësisë, ka për qëllim që veprimin e kryesit ta kualifikojë si sjellje mendjelehtë, sipërfaqësore, të papërgjegjshme, indolente, apo sjellje me të cilën ai i ka mbivlerësuar aftësitë e veta. Nga përkufizimi i pakujdesisë që është përcaktuar në Kodin Penal dhe nga kjo që u tha, del se kjo formë e fajit përbëhet prej dy elementeve: a) prej vetëdijes mbi mundësinë e shkaktimit të pasojës dhe b) prej shpresës apo bindjes se do të mund ta parandalojë shkaktimin e pasojës, apo pasoja nuk do të shkaktohet fare.²⁵

Dallimi i dashjes eventuale nga pakujdesia me vetëdije. Në aspektin teorik janë përcaktuar kritere mjaft të qarta, në bazë të të cilave mund të bëhet dallimi midis dashjes eventuale dhe pakujdesisë me vetëdije. Mirëpo, në praktikën gjyqësore është mjaft vështirë të bëhet dallimi i dashjes eventuale nga pakujdesia; ngase siç pamë më sipër, shumica e kritereve, në bazë të të cilave bëhet dallimi midis këtyre dy llojeve të fajësisë, janë të natyrës subjektive, dhe i përkasin elementit intelektual dhe *volitiv* të kryesit. Për këtë arsye, me të drejtë thuhet se tërheqja e paraleles midis dashjes eventuale dhe pakujdesisë

²⁴ I. Salihu, H. Zhitija & F. Hasani, vep. e cit. fq. 104 - 105.

²⁵ Po aty, fq. 105 - 106.

është njëra ndër çështjet më të vështira dhe më diskutabile në të drejtën penale.²⁶

4.2 Pakujdesia pa vetëdije apo neglizhenca

Pakujdesia pa vetëdije apo neglizhenca ekziston kur personi nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mos veprimit të tij edhe pse në rrethana dhe sipas vetive të tij personale ka mundur të ishte apo duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi.²⁷

Kështu që te pakujdesia pa vetëdije na paraqitet situatë kur kryesi i veprës penale, veprën penale nuk dëshiron që ta kryej por as që ka supozuar se me veprimin ose mosveprimin e tij do të kryej vepër penale. Prandaj, dallimi në mes pakujdesisë me vetëdije dhe pakujdesisë pa vetëdije ekziston se te pakujdesia me vetëdije, kryesi e parashih mundësinë se me veprimin ose mosveprimin e tij mund të kryhet vepër penale, ndërsa te pakujdesia pa vetëdije, kryesi nuk është i vetëdijshëm, nuk e parashih mundësinë që nga veprimi apo mosveprimi i tij mund të kryhet vepër penale. Kështu që, pakujdesia pa vetëdije dallon nga llojet e tjera të fajësisë sepse këtu mungon raporti psikik ndaj veprës penale, pra mungon elementi intelektual dhe i vetëdijës, si për shembull gjuetari shtien në egërsirë, mirëpo me atë rast godet njeriun që ka qenë duke prerë dru në mal; një i ri në shaka gjuan tjetrin me top bore me ç'rast e godet në sy dhe i shkakton lëndim të rëndë trupor.

Neglizhenca ekziston atëher kur personi nuk e parashikon mundësinë e ardhjes së pasojave, megjithëse sipas rregullave duhej dhe kishte mundësi t'i parashikonte. Mosparashikimi i pasojave mund të vijë nga paaftësia intelektuale e personit për të parashikuar, kuptuar dhe vlerësuar lidhjet që krijohen midis fenomeneve ose nga pamundësia objektive e këtij parashikimi në rrethanat ku kryhet vepra. Në këtë rast nuk bëhet fjalë për përgjegjësinë penale.

²⁶ Po aty, fq. 107.

²⁷ Ismet Salihu, vep. e cit., fq. 312.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Përgjegjësia penale ekziston kur personi i ka aftësitë për të parashikuar pasojat e veprimeve ose mosveprimeve të tij, kur nuk ka rrethana objektive penguese në këtë aspekt. Sigurisht ndonëse në këtë lloj pakujdesie mungon shfaqja e vullnetit në sjelljen e personit, ligji ka parashikuar se ai i ka pasur mundësitë për ta shprehur vullnetin, duke parandaluar ardhjen e pasojave të dëmshme.²⁸

Me rastin e përcaktimit të pakujdesisë pa vetëdije duhet të merren parasysh dhe të ndriçohen dy grupe rrethanash apo faktesh, të cilat edhe pse shqyrtohen ndaras, ato janë të lidhura ngushtë mes vetes dhe e kushtëzojnë njëra-tjetrën. Grupi i parë i rrethanave i përket situatës reale, kushteve objektive në të cilat personi ka vepruar, pra janë a) *rrethana të natyrës objektive*. Grupi i dytë i rrethanave i përket b) *vetive dhe aftësive të kryesit*, pra janë rrethana të natyrës subjektive. Obligimi për t'i ndriçuar këto dy grupe rrethanash rrjedh prej nenit 23, par. 3 të Kodit Penal.

Në grupin e parë të rrethanave, të kushteve dhe situatës në të cilat është kryer vepra duhet të merren parasysh dhe të ndriçohen rrethanat e ndryshme objektive, siç janë p.sh. a ka qenë natë, a ka pasur mjegull, rruga e rrëshqitshme me borë dhe akull, rruga e terur, çfarë mundësie e të parit ka ekzistuar, mjetet të cilat i ka pasur kryesi, a ka pasur mundësi kryesi të mendojë më gjatë apo është dashur të vendosë shpejt etj. Lidhur me këtë, është më se e domosdoshme të kihet parasysh natyra e situatës dhe karakteri i veprës penale të kryer. Për shembull, në një mënyrë do të vlerësohet pakujdesia e sjelljes gjatë prodhimit të artikujve që ndezën lehtë, dhe ndryshe gjatë prodhimit të artikujve ku nuk ekziston ky rrezik. Është detyrë e gjykatës, që në çdo rast konkret, t'i marrë parasysh dhe t'i ndriçojë të gjitha rrethanat që mund të ndikojnë, për të mundur të konstatohet nëse kryesi ka qenë i obliguar dhe a ka mundur të jetë i vetëdijshëm se nga veprimi apo mosveprimi i tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar.

Në grupin e dytë të rrethanave në të cilat është kryer vepra penale me pakujdesi pavetëdije duhet marrë parasysh *vetitë, aftësitë dhe atributet e tjera subjektive të kryesit të veprës penale*, në mënyrë që të konstatohet se kryesi ka qenë i detyruar dhe ka mundur të jetë i vetëdijshëm se nga veprimi apo mosveprimi

²⁸ Shefqet Muçi, vep. e cit., fq. 169.

i tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar. Në këtë aspekt, në procedurën penale provat duhet të administrohen ndaj njeriut konkret që e ka kryer veprën penale konkrete në situatën dhe rrethanat e caktuara. Me këtë rast vendimtare janë vetitë, aftësitë dhe gjendja momentale psikike dhe fizike e kryesit të veprës penale, siç janë p.sh.: aftësia e të pamurit, aftësia e perceptimit dhe e reagimit, shëndeti, mosha, zhvillimi psikik, profesioni, përvoja, lodhja, pagjumësia, frika si dhe rrethanat e tjera që e karakterizojnë personalitetin e personit në fjalë dhe të cilat në rastin konkret kanë pasur apo kanë mundur të kenë ndikim në mundësinë për të ditur dhe për të supozuar se nga sjellja dhe veprimi i tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar. Mirëpo, me këtë rast për të mundur të konsiderohet se vepra është kryer me pakujdesinë pavetëdije, duhet mbështetur në supozimin dhe njohuritë se ndonjë person tjetër, i cili sipas vetive, aftësive dhe tipareve të tjera, që më së tepërmi janë të ngjashme me personalitetin e kryesit të veprës, a do të kishte mundësi të parashihte se nga veprimi apo sjellja e tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar.²⁹

4.3 Pakujdesia profesionale

Pakujdesia profesionale është pakujdesi personit, i cili gjatë ushtrimit të profesionit apo zejës së tij, është i detyruar të jetë më i kujdesshëm sesa njerëzit e tjerë. Me fjalë të tjera, konsiderohet se vepra është kryer nga pakujdesia profesionale nëse personi gjatë ushtrimit të profesionit, nuk ka treguar atë masë të kujdesit që kërkohet gjatë ushtrimit të profesionit të tij dhe nëse për shkak të mungesës së kujdesit të duhur është shkaktuar pasoja e ndaluar. Kjo shprehet sidomos te ata persona, veprimtaria e të cilëve, krahas dobisë shoqërore të madhe, është edhe e rrezikshme.³⁰

Sipas natyrës së saj, pakujdesia profesionale zakonisht është pakujdesi pa vetëdije, por mund të shprehet edhe me pakujdesinë me vetëdije. Kodi Penal i Kosovës, sikundër shumica e kodeve penale të shteteve të tjera, nuk e ka paraparë në mënyrë shprehimore pakujdesinë profesionale si lloj të posaçëm të pakujdesisë. Andaj, përgjegjësia penale e personave, të cilët i kryejnë veprat

²⁹ I. Salihu, H. Zhitija & F. Hasani, vep. e cit., fq. 111.

³⁰ Ismet Salihu, vep. e cit. fq. 317.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

penale nga pakujdesia gjatë ushtrimit të profesionit të tyre, zgjidhet sipas normave penale që vlejnë në përgjithësi për personat që veprat i kryejnë nga pakujdesia.

Pra, Kodi ynë penal nuk parasheh norma të posaçme me të cilat rregullohet çështja e përgjegjësisë penale për veprat që kryhen nga pakujdesia profesionale. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se pakujdesia profesionale nuk ushtron kurrfarë ndikimi në trajtimin penalo-juridik të kryesve të këtyllë të veprave penale. Përkundrazi, në rastet kur gjykata konstaton se pasoja e shkaktuar është rezultat i pakujdesisë gjatë ushtrimit të profesionit, kjo konsiderohet formë më e rëndë e pakujdesisë dhe kryesit të veprës penale do t'i merret si rrethanë rënduese me rastin e matjes së dënimit.³¹

Përgjegjësia - Siç u theksua për veprat penale të kryera me dashje, kryesi çdoherë konsiderohet penalisht përgjegjës dhe dënohet, ndërsa te veprat penale të kryera nga pakujdesia, kryesi nuk dënohet çdoherë, por dënohet vetëm kur për atë vepër penale është paraparë që kryesi dënohet edhe për rastet kur veprën e kryen nga pakujdesia, kështu që në rastet kur është paraparë që kryesi dënohet edhe për veprat e kryera nga pakujdesia, dënimi është i paraparë më i butë se sa dënimi për veprën e kryer me dashje.

Se për cilat vepra të kryera nga pakujdesia kryesi do të dënohet, kjo është çështje e politikës kriminale. Mirëpo, lidhur me këtë vendimtare është rëndësia individuale dhe shoqërore e objektit i cili mbrohet edhe me të drejtën penale. Shikuar në përgjithësi, sipas Kodit tonë penal, për pakujdesi dënohen kryesit e veprave penale kundër shëndetit të njeriut, kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe të pasurisë në trafikun publik, mandej për veprat penale nga pakujdesia të personave që ushtrojnë detyra (funksione) të rëndësishme si dhe për veprat penale kundër jetës dhe trupit.

Lidhur me ndëshkimin, Kodi ynë penal nuk bën dallim nëse është kryer vepra me pakujdesinë me vetëdije apo me pakujdesinë pa vetëdije. Dallimi midis

³¹ Kometari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, faqe 112, Prishtinë 2014

këtyre dy llojeve të pakujdesisë mund të ketë ndikim vetëm me rastin e matjes së dënimit.³²

Në të shumtën e rasteve, vepra penale e kryer me pakujdesi me vetëdije konsiderohet formë më e rëndë se pakujdesia pavetëdije. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se pakujdesia pavetëdije gjithherë është formë më e lehtë e fajit në krahasim me pakujdesinë me vetëdije. Përkundrazi, në disa raste pakujdesia pavetëdije mund të jetë formë shumë më e rëndë se pakujdesia me vetëdije ngase në rastin konkret, përveç elementit subjektiv, vepra penale e kryer nga pakujdesia pavetëdije mund të shkaktojë pasoja shumë më të rënda se e njëjta vepër që është kryer nga pakujdesia me vetëdije.

Pra, kjo është çështje faktike dhe për këtë arsye, siç theksuam, Kodi Penal nuk bën dallim lidhur me ndëshkimin e kryesit nëse është kryer vepra me pakujdesi me vetëdije apo pavetëdije. Mirëpo duke i marrë parasysh dispozitat e përgjithshme lidhur me matjen e dënimit (neni 73), gjykata duhet të konstatojë shkallën e pakujdesisë (pamaturisë), rrethanat e situatës në të cilën është kryer vepra penale, llojin dhe peshën e pasojës së shkaktuar, e veçmas duhet konstatuar se pakujdesia e personit konkret a është e karakterit episodik apo është tipar (veti) i përhershëm i personalitetit të tij. Këto dhe rrethanat tjera objektive dhe subjektive mund të ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe masës së dënimit. Në aspektin e rrezikut, mund të ndodhin raste që kryesi i veprës nga pakujdesia, marrë parasysh gjendjen e tërësishme të personalitetit të tij, të jetë më i rrezikshëm në krahasim me ndonjë person tjetër që ka kryer vepër penale me dashje.³³

5 Dijenia, dashja, pakujdesia ose qëllimi

Në nenin 22 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës është paraparë një dispozitë e re ligjore sipas të cilës, dijenia, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethanat faktike.

³² Po aty, faqe. 113

³³ I. Salihu, H. Zhitija & F. Hasani, vep. e cit. fq. 113.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Dijenia, dashja, pakujdesia dhe qëllimi janë elemente subjektive të veprës penale. Për shkak të natyrës së tyre, këto elemente subjektive të veprës penale në disa raste është jashtëzakonisht vështirë të vërtetohen ngase duhet të depërtohet në psiken, në mendjen e personit. Pikërisht për këtë arsye, është paraparë dispozita e nenit 22 për t'u krijuar bazë juridike gjykatave që në rastet e caktuara këto elemente subjektive, e sidomos dashja dhe pakujdesia të konstatohen në bazë të rrethanave faktike.

Përfundimi

Nga humultimi në lidhje me fajin në të drejtën penale, mund të nxirren këto përfundime kryesore:

1. Në të drejtën penale çështja e fajësisë ka rëndësi shumë të madhe, sepse për t'ia shqiptuar dënimin kryesit të veprës penale, gjykata duhet të vërtetoj që i njëjti së pari të ketë qenë i përgjegjshëm dhe në bazë të përgjegjshmërisë të dënohet, respektivisht të vërtetohet se kryesi a është i fajshëm.
2. E rëndësishme është çështja e fajësisë sepse që të konsiderohet një person përgjegjës për veprën penale të cilën e ka kryer, së pari duhet të vërtetohet lidhja apo vetit psikike të kryesit ndaj veprës penale, të cilat veti, bëjnë që të ketë mundur të e kuptoj rëndësinë e veprës penale dhe të ketë mundur të kontrolloj sjelljet e veta, e kjo me qëllim që të konsiderohet i përgjegjshëm, sepse nëse te kryesi mungon vetia apo aftësia intelektuale, respektivisht mendore, atëherë kryesi konsiderohet i papërgjegjshëm.
3. Rëndësinë e çështjes së fajësisë në bazë të cekurave më lart, e shton elementi i qëndrimit apo marrëdhënies psikike të kryesit ndaj veprës që e ka kryer, i cili ka ditur se me veprimin apo mosveprimin e tij do të shkaktoj një pasoj në botën e jashtme, e cila me ligj është paraparë si vepër penale, me qëllim që të jetë e mundur të i ngarkohet ajo vepër,

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

respektivisht kur kryesi veprën e konsideron të vetën, e kjo me qëllim që mund të konsiderohet i fajshëm për kryerjen e veprës penale.

4. Për të mundur gjykata të ia vë në barrë kryesit veprën penale, është e rëndësishme dhe duhet të vërtetohet se në kohën e kryerjes së veprës penale, kryesi të ketë pasur veti të caktuara psikike (përgjegjësi) dhe qëndrim apo marrëdhënie ndaj veprës që e ka kryer (fajësia), në të kundërtën kur mungon përgjegjësia, apo edhe fajësia, nuk sajohet përgjegjësia penale e kryesit të veprës penale dhe në mungesë të përgjegjësisë apo në mungesë të fajësisë, i njëjti kryes nuk mund të dënohet për veprën penale të kryer.
5. Edhe pse me kodin penal janë të përcaktuara elementët e veprës penale, në rastin konkret faji dhe format e fajësisë, me dashje apo nga pakujdesia, në praktikë ka mjaft dilema në rastet konkrete rreth përcaktimit të formës së fajësisë, me dashje apo nga pakujdesia, po ashtu problemet edhe me të theksuara paraqiten rreth vërtetimit të dashjes direkte apo eventuale, pakujdesisë me vetëdije apo pavetëdije, dalimi në mes dashjes eventuale dhe pakujdesisë me vetëdije etj, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe të lartësisë së dënimit.

Literatura

Akademia e Drejtësisë, Moduli i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2016.

Borisllav Petroviq, E drejta penale, Sarajevë/Prishtinë, tetor 2006.

Ismet Salihu, E drejta penale, Prishtinë, 2008.

Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës.

Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës.

Kometari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2014.

Shefqet Muçi, E drejta penale, Tiranë, 2012.

Vendime gjyqësore

Ilir Morina*

DISA ASPEKTE PRAKTIKE TË TRAJTIMIT TË VEPRËS PENALE: RREZIKIMI I TRAFIKUT PUBLIK NGA PROKURORI I SHTETIT

Abstrakt

Trafiku publik në kuptimin e gjerë përfshinë tërë hapësirën dhe infrastrukturën e trafikut nacional ku kryesisht bëjnë pjesë: Trafiku rrugorë, Trafiku ajrorë dhe Trafiku ujor. Për qëllim të këtij publikimi, fokusi do të jetë në trajtimin e çështjes së trafikut rrugor në Republikën e Kosovës. Trafiku rrugor mund të konsiderohet si një shërbim i cili u ofrohet qytetarëve përmes së cilit realizohet lëvizja dhe qarkullimi në përgjithësi.¹

Në vendin tonë ky shërbim është i rregulluar me Ligjin për trafikun rrugor (tutje “Ligji”)². Ky ligj është relativisht i ri dhe në vete përfshinë të gjithat parimet dhe rregullat e nevojshme dhe të domosdoshme për sjelljen e pjesëmarrësve dhe subjekteve të tjera në qarkullim rrugor. Në procesin e qarkullimit rrugorë ndodhin shumë ngjarje dhe veprime të shkaktuara nga veprimet e pjesëmarrësve në qarkullim rrugor, të cilat shkaktojnë pasoja të rënda për jetën, trupin dhe pasurinë e qytetarëve, si rezultat i shkeljes së rregullave të përcaktuar me Ligj.

Me qëllim të mbrojtës së rendit publik në përgjithësi dhe jetës, trupit dhe pasurisë së individëve në veçanti, në Kodin Nr. 04/L-123 Penal të Republikës së Kosovës (tutje “KPRK”) janë paraparë dhe sanksionuar veprimet të cila janë të karakterit penal. Kështu, në nenin 378 të KPRK-së e paraparë vepra

*Ilir Morina, prokuror i sapo emëruar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë

¹ Salihu, Ismet; Zhitia, Hilmi; Hasani, Fejzullah: Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Botimi I, Prishtinë, 2014, faqe 1051.

² Ligjin Nr.05/L-088 për trafikun rrugor, në fuqi nga data 20 shtator 2016.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

penale e rrezikimit të trafikut publik dhe janë përcaktuar sanksionet për kryesit e kësaj vepre.

Kësisoj, për shkak të zhvillimit të madh të trafikut publik dhe rritjes së numrit të pjesëmarrësve në të, rastet e veprave penale nga neni 378 , të cilat i trajton Prokuroria e Shtetit është i madh dhe me tendenca të rritjes.

Fjalët kyçe: Praktika, Prokurori i Shtetit, Rrezikim i trafikut publik, aksident komunikacioni;

Hyrje

Në këtë punim do të trajtohet praktika ekzistuese e procedimit të rasteve nga vepra penale e rrezikimit të trafikut publik, e paraparë dhe sanksionuar me nenin 378 të KPRK-së, me theks të veçantë paragrafi 1, 6 dhe 7, nga ana e Prokurorive Themelore në raport me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Këto tri paragrafe të nenit 378 të KPRK-së janë marr në konsideratë për tu trajtuar për shkak se dënimi maksimal i paraparë për kryesin, është deri në 3 vite burgim dhe sipas nenit 101 paragrafi 2 të KPP-së, prokurori i shtetit mund të ngrit aktakuzën e cila në praktikë njihet si “aktakuzë e drejtpërdrejtë”. Ndryshimet e paraqitura në KPP të vitit 2012, kanë krijuar një situatë juridike të re, ku praktika e trajtimit të këtyre lloj rasteve kërkon një qasje tjetër procedurale, e cila mund të jetë në mospërputhje me praktikën aktuale të prokurorive themelore.

Në parim, rastet e aksidenteve në komunikacion, në procedurë penale janë trajtuar si raste të vogla ose te lehta dhe gjithnjë është proceduar me aktakuzë të drejtpërdrejtë. Përmes këtij punimi, synohet të adresohet mundësia e një mospërputhje eventuale në mes të praktikës së prokurorive të krijuar me vite të tëra dhe risive procedurale që ka sjell KPP, që nga hyrja në fuqi në vitin 2013.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Prandaj, pyetja kryesore që parashtrohet në këtë rast është se a mund prokurori i shtetit të ngrit një aktakuzë të drejtpërdrejtë në rast se ka zhvilluar procedurë dhe ka nxjerr të paktën dy (2) prova relevante siç janë ekspertiza e komunikacionit dhe ekspertiza mjekoligjore. A duhet që kjo aktakuzë të ngritet në bazë të dispozitave të KPP që i referohen ngritjes së aktakuzës pa hetime, apo dispozitave që i referohen aktakuzës pas hetimeve?!

Përveç asaj që u tha më lartë, në këto raste sfidë paraqet edhe respektimi i të drejtave të të pandehurit dhe të dëmtuarit, si palë procedurale të përcaktuara nga KPP. Kodi i ri i procedurës penale, i vitit 2013, ka paraparë shumë të drejta të të pandehurit, si palë procedurale. Andaj, ky punim synon që të trajtojë këtë temë në prizmin e praktikës në raport me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale dhe statusit të drejtave të pandehurit dhe të dëmtuarit.

1. Praktika e prokurorisë në trajtimin e veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 (paragrafët 1, 6 dhe 7) i Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Të gjitha Prokuroritë Themelore në Kosovë, trajtimin e rasteve nga vepra penale rrezikim i trafikut publik e paraparë dhe sanksionuar me nenin 378 paragrafi 1, paragrafi 6 dhe paragrafi 7, të KPP-së, e bëjnë pothuajse në mënyrë të njëjtë. Këto raste i referohen paragrafit 1, 6 dhe 7 të nenit 378 të KPRK-së, për shkak se vepra penale është kryer nga pakujdesia dhe dënimi maksimal i paraparë është deri në 3 (tri) vite burgim.

Praktika e tanishme në prokurori³ është e atillë që sapo paraqitet një kallëzim penal për veprë penale të rrezikimit të trafikut publik, prokurori i shtetit, pothuajse, me automatizëm ndërmerr dy (2) veprime procedurale, në të njëjtën kohë: E para, e cakton një ekspert të komunikacionit, me qëllim të përcaktimit të shkaqeve të aksidentit dhe kush është shkaktari, dhe e dyta, urdhëron ekspertizën mjekoligjore nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore, për të

³ Shih rastet: PP.II.nr.2200/2016; PP.II.nr.2429/2016; PP.II.nr.2583/2016; PP.II.nr.2675/2016; PP.II.nr.2761/2016; PP.II.nr.4857/2016; PP.nr.3546/2016; PP.nr.4191/2016; PP.II.nr.200/2017; PP.II.nr.202/2017; 395/2017;

përcaktuar llojin dhe natyrën e lëndimeve trupore të dëmtuarit. Të dy vendimet/urdhëresat kanë për referencë nenin 137 të KPP-së. Më pastaj, kur i pranon këto dy ekspertiza, prokurori i shtetit menjëherë ngrit aktin akuzues duke u referuar në dispozitat e nenit 102 paragrafi 2 dhe 241 të KPP-së, apo si njihet në praktikën prokuroriale, “aktakuzë e drejtpërdrejtë”.

Kjo mund të mos jetë në harmoni me dispozitat e KPP-së, me referencë të veçantë në aktvendimin për fillimin e hetimeve, në caktimin e ekspertit dhe në të drejtat e të pandehurit.

2. Marrja e ekspertizës dhe aktvendimi për fillimin e hetimeve

Në praktikë aktuale të disa prokurorive themelore në Kosovë, rastet e veprave penale ndaj trafikut publik, nga neni 378 paragrafët 1, 6 dhe 7 të KPRK-së, procedohen pa aktvendim për fillimin e hetimit, me argumentin se dënimi i paraparë për këto raste nuk është më shumë se tre vjet burgim.

Sipas nenit 101 paragrafi 2 të KPP-së, citoi: ‘... **kur policia apo ndonjë person tjetër bën kallëzim tek prokurori i shtetit për një dyshim të arsyeshëm për një veprë penale ose për disa vepra penale, asnjëra nga të cilat nuk dënohet me më shumë se tre vjet burgim dhe prokurori i shtetit vlerëson se ekziston dyshim i bazuar mirë për të mbështetur aktakuzën, prokurori i shtetit mund të ngrit aktakuzë sipas nenit 241 të këtij Kodi..**’. Nga kjo dispozitë rrjedh, se prokurori mund të ngrit aktakuzë të drejtpërdrejtë aty për aty, **menjëherë kur paraqitet kallëzimi** dhe nëse plotësohen dy kushte: vepra nuk dënohet më shumë se tre vjet burgim dhe ekziston dyshimi i bazuar mirë.

Mirëpo, në rastin e veprave penale nga neni 378, në momentin e paraqitjes së kallëzimit penal ekziston **vetëm dyshimi i arsyeshëm** por jo edhe dyshimi i bazuar mirë, andaj procedimi apo mbledhja e provave, pa aktvendim për fillimin e hetimeve mund të jetë në kundërshtim me dispozitat procedurale të KPP-së. Kjo për faktin se, kallëzimi penal përmban vetëm raportin policor të vendit të ngjarjes dhe raportin mjekësor të emergjencës për të dëmtuarin, kurse këto veprime hynë në fazën e veprimeve fillestare të policisë, por jo në fazën e hetimit. Megjithatë, këto prova nuk mjaftojnë për të krijuar dyshimin e bazuar mirë për shkak se në rastet e veprës penale nga neni 378 par.6 lidhur

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

me 1 të KPRK-së, nuk përcakton shkakun dhe shkaktarin e aksidentit dhe nuk tregon për llojin dhe shkallën e lëndimeve trupore. Në mungesë të këtyre provave dhe me qëllim të krijimit të dyshimit të bazuar mirë se vepra penale është kryer dhe se i pandehuri konkret, është kryesi, prokurori është i detyruar që të ndër marr veprime hetimore për të mbledh prova shtesë, siç janë ekspertiza e komunikacionit dhe ekspertiza mjekoligjore.

Andaj, vlerësoi së në këtë fazë prokurori hynë në fazën e hetimeve dhe nxjerrja/sigurimi i këtyre dy provave relevante juridike, është një veprim hetimor. Duke qenë veprim hetimor, këto veprime duhet të ndërmerren gjatë fazës së hetimit, e cila fillon me aktvendim për fillimin e hetimeve sepse janë prova vendimtarë dhe kruciale për të dëshmuar fajësinë apo pafajësinë e të kallëzuarit. Lidhur me fazat e procedurës penale, në nenin 68 të KPP-së janë paraparë 4 faze, e që fillon me fazën e hetimit. Megjithatë, ligjdhënësi në të njëjtin nen ka paraparë që procedurës penale i paraprijnë veprimet fillestare të policisë ose mbledhja e informatave nga nenit 84 të KPP-së.

Prandaj, vlerësoi se prokurori nuk mund të aplikoj nenin 101 paragrafi 2 të KPP për veprat penale nga neni 378 paragrafi 1, 6 dhe 7 të KPRK dhe të ngrit aktakuzë të drejtpërdrejtë, në rast se ka ndër marr veprime hetimore për sigurimin e provave, siç janë dy lloje të ekspertizave të cekura më lartë. Në këto raste, nuk kemi të ashtuquajturën "aktakuzë të drejtpërdrejtë" por duhet të kemi një aktakuzë, pas zhvillimi të hetimit, konfrom nenit 240 par.1 të KPP-së. Konsideroj se, në aspektin procedural, prokurori është i obliguar me dispozita të KPP-së që të filloj fazën e hetimit (pra të nxjerr aktvendim për fillimin e hetimit) me qëllim që të ndër merr veprime hetimore për sigurimin e dy ekspertizave të cekur më lartë sepse konsideroj se këto veprim, në aspektin juridiko-procedural-penal, hynë në kategorinë e veprimeve hetimore që kryhen në fazën e hetimit.

Nga kjo rrjedh se, nëse prokurori nuk i ka të gjitha provat në momentin e pranimit të kallëzimit penal dhe për pasoj nuk mund të ngrit aktakuzë të drejtpërdrejtë, atëherë ligjërisht dhe proceduralisht është i obliguar që të nxjerr aktvendim për fillimin e hetimit sipas nenit 102 të KPP-së, sepse mundësi tjetër procedurale të parapara në KPP, nuk ka. Tutje, sipas mendimin tim nga momenti i paraqitjes së kallëzimit deri në momentin e nxjerrjes së aktvendimit

për fillimin e hetimeve, prokurori i ka në dispozicion vetëm dy mundësi procedurale për sigurimin e provave: **Mbledhja e informatave, sipas nenit 83** të KPP-së dhe **Masat e Fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit sipas nenit 84** të KPP-së. Mirëpo, dy ekspertizat e cekura më lartë, nuk hynë as në veprimet procedurale nga neni 83 dhe as në ato nga neni 84 të KPP-së. Kësisoj, mund të jetë ligjërishit i diskutueshëm vendimi i prokurorit për të siguruar këto dy lloj prova (ekspertizat), pa nxjerr aktvendim për fillimin e hetimit.

Në rastet e veprës penale nga neni 378 të KPRK, kallëzimet penale krijojnë bazë të mjaftueshme për fillimin e procedurës penale por nuk krijojnë bazë të mjaftueshme për të ngritur aktakuzën. Në këtë drejtim edhe Prof. Ejup Sahiti, në komentarin e KPRK-së, të vitit 2013 jep një qasje të tillë sa i përket fazës së fillimit të hetimit. Ai, mes tjerash, thekson se, citoj: ‘... *opsioni i paraparë se prokurori i shtetit mund të fillojë procedurën penale, do të duhej shikuar edhe në prizmin e asaj se informacionet që arrijnë te prokurori i shtetit, jo çdoherë krijojnë bazë të mjaftueshme për fillim të procedurës penale. Sidoqoftë, këtu duhet pasur parasysh neni 109 i Kushtetutës, sipas të cilit prokurori i shtetit është përgjegjës për ndjekjen penale të personave të akuzuar. Megjithëkëtë, parimi i legalitetit vlen edhe më tutje për ndjekje në procedurë penale, duke u mbështetur në nenin 4, paragrafi 2 dhe neni 7 i Ligjit për Prokurorin e shtetit..’.*

Në këtë stad të procedurës nuk dihet shkaku dhe shkaktari i aksidentit, nuk dihet lloji dhe natyra e lëndimeve trupore, nuk dihet sasia dhe vlera e dëmit material të shkaktuar, nëse vepra është kryer me dashje eventuale apo nga pakujdesia, etj. Pra, janë një mori pyetjesh për të cilat gjatë procedurës hetimore duhet dhënë përgjigje. Dhe e gjithë kjo bëhet përmes një procedure hetimore formale, me aktvendim për fillimin e hetimeve konform nenit 104 të KPP-së dhe nën mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, siç është përcaktuar në nenin 22 par.2 të KPP-së.

Për shembull, në rast se i pandehuri ose i dëmtuari eventualisht paraqesin ankesë tek gjyqtari i procedurës paraprake (tutje ‘GjPP’) lidhur me vendimin e prokurorit për ekspertizë nga neni 137 të KPP, GjPP mund të gjendjet para një situatë konfuze juridike sepse mund të ketë një ankesë procedurale- penale, por, në anën tjetër nuk është i njoftuar fare se ka një

procedurë penale duke u zhvilluar. Prandaj, është e rëndësishme që të nxirret ky Aktvendim dhe ti dërgohet gjyqtarit të procedurës paraprake, sepse procedura penale është procedurë formale dhe si e tillë kërkon respektim rigoroz të dispozitave përkatëse të KPP-së dhe kështu eviton dyshimin eventual për veprime të paarsyeshme nga ana e Shtetit. Për më tepër në botimin “Doracak i Gjyqtarëve për procedurën penale” të Institutit Gjyqësor të Kosovë (IGJK), të vitit 2005 theksohet, citoj:

“ ... Gjatë zhvillimit të hetimeve ndërmerren veprime hetimore të cilat disa prej tyre janë kompetencë e gjyqtarit të procedurës paraprake si p.sh.: urdhër kontrolli, urdhri për kontroll personal, urdhri për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, urdhrat për lëshimin e masave të fshehta të vëzhgimit dhe të hetimit, ekspertizat të cilat janë nën autoritetin e gjykatës, por edhe veprime të tjera, siç është: lëshimi i urdhërarrestit për të arrestuar të pandehurin, mundësia e veçantë hetuese ”

3. Sigurimi i ekspertizës si provë në procedure dhe të drejtat e të pandehurit/dëmtuarit

Roli i një ekspertize, si mjetë i të provuarit, në procedurë penale është shumë i rëndësishëm. Madje në disa situata të caktuara penale-juridike, është vendimtar për të vendosur për fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit. Megjithatë, edhe respektimi i të drejtave të pandehurit gjatë zhvillimit të procedurës së nxjerrjes së provës- ekspertizës, është shumë i rëndësishëm për të pasur një proces penal të drejt, objektiv dhe të bazuar në ligj (në KPP), si dhe për të shmangur dyshimet e mundshme për arbitraritet nga ana e organit të akuzës. Në këtë drejtim, ligjdhënësi, përmes dispozitave të nenit 137 dhe 138 të KPP ka paraparë një procedurë strikte procedurale rreth autorizimeve të prokurorit për ndërmarrjen e këtij veprimi hetimor (sigurimi i ekspertizës) dhe të drejtave të të pandehurit për tu njoftuar me këto veprime dhe të drejtën për parashtrimin e një kundërshtimi procedural.

Në këtë drejtim, çështja e parë ligjore për shtjellim që parashtrohet në këtë pjesë, është fakti nëse i pandehuri njoftohet lidhur me vendimin e prokurorit për caktimin e ekspertit, konform nenit 137 të KPP-së dhe raportin e

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

ekspertizës, konform nenit 138 të KPP-së. Në praktikën aktuale të prokurorive themelore në Kosovë, prokurori i shtetit me të pranuar kallëzimin penal lidhur me veprat nga nenit 378 të KPRK-së, cakton një ekspert të komunikacionit dhe një ekspert mjekoligjor për të kryer ekspertizat përkatëse. Ky vendim për caktimin e ekspertit, mbështetet në nenin 137 të KPP-së dhe i dërgohet ekspertit të caktuar, i cili brenda afatit të përcaktuar, përgatit raportin e ekspertizës, në pajtim me nenin 138 të KPP-së.

Në rastin konkret dilemat paraqiten lidhur me faktin nëse gjatë caktimit të ekspertit nga ana e prokurorit, po respektohet procedura e paraparë në nenin 137 të KPP-së. Sipas procedurës së paraparë në këtë nen, prokurori e cakton ekspertin e komunikacionit në bazë të paragrafit 1 të KPP dhe e njofton për këtë, të pandehurin dhe të dëmtuarin pasi që, sipas paragrafit 2 të njëjtë nen, kanë të drejtë të paraqesin kundërshtime lidhur me përvojën e ekspertit të caktuar apo mundësin e konfliktit të interesit. Më saktë në paragrafin 2 të nenit 137 të KPP-së parashihet që i pandehuri, mbrojtësi, viktimia ose mbrojtësi i viktimës mund të kundërshtojnë ekspertin e caktuar nga prokurori, mbi bazat e dhëna me ligj dhe për këtë i drejtohen gjyqtarit të procedurës paraprake.

Gjatë përvojës më të re në Prokurorinë ku jam caktuar të punoj dhe nga diskutimet me koleg të disa Prokurorive tjera, kam kuptuar se, aktualisht prokurori nuk e njofton të pandehurin dhe as të dëmtuarin me vendimin për caktimin e një eksperti, duke ju pamundësuar që të parashitrojnë një kundërshtim eventual.

Ky veprim i prokurorit paraqet një sfidë në procedurën penale sepse më vonë gjatë gjykimit i pandehuri mund të pretendoj se këto dy prova relevante juridike, janë marr në shkelje të dispozitave të KPP-së dhe si të tilla të konsiderohen si prova të papranueshme. Tutje, ai/ajo mund ta kontestoj ekspertizën e ekspertit mbi bazën e konfliktit të interesit apo ekspertizës se tij/saj dhe për pasojë do të shkaktohet vonesë në procedimin e lëndës gjatë shqyrtimit gjyqësor. Prandaj, vlerësoj se juridikisht dhe formalisht prokurori është i obliguar që gjatë implementimit të nenit 137 të KPP-së, të respektoj edhe të drejtat e të pandehurit dhe të dëmtuarit, duke i njoftuar lidhur me vendimin për caktimin e ekspertit. Në këtë mënyrë, kundërshtimet eventuale

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

nga ana e të pandehurit dhe palëve të tjera, do të mund të trajtoheshin gjatë procedurës hetimore, duke e minimizuar mundësinë që një gjë e tillë të ndodhë gjatë shqyrtimit gjyqësor, në njërën anë kurse në anën tjetër e përmbush detyrimin për të respektuar parimin e “barazisë së armëve” në procedurë.

Lidhur me këtë, në Udhëzuesin për Kodin e Procedurës Penale, të vitit 2013⁴, është theksuar se:

*Një parim i rëndësishëm për të drejtat e njeriut është **barazia e palëve**, e cila është e mishëruar në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky parim nënkupton që sistemi juridik duhet t'i jep të drejta të barabarta të pandehurit për të realizuar mbrojtjen e tij në gjykatë. Kodi i mëparshëm i procedurës penale i jepte mbrojtjes disa mundësi, mirëpo në disa segmente të procedurës penale mungonte qasja e barabartë. Për shembull, ekspertët gjithashtu i hapin rrugë shkeljeve të së drejtës së barazisë së palëve. Neutraliteti i ekspertëve të caktuar nga gjykata ka qenë bazë për shkelje të të drejtave të njeriut*

Sipas praktikës aktuale⁵, në shumicën e prokurorive themelore, i pandehuri apo i dëmtuari, nuk është i informuar për këtë veprim procedural të ndërmarr nga ana e prokurorit dhe për të drejtat e tij gjatë kësaj procedure. Madje, marr parasysh faktin procedural se prokurori ngrit “aktakuzë të drejtpërdrejtë”, të pandehurit vetëm në shqyrtim gjyqësorë i jepet mundësia që të njoftohet për këto veprime procedurale të ndërmarra nga prokuroria.

Kjo situatë ishte evidentuar edhe në Raportin e OSBE në Kosovë, Qershor 2016⁶, në të cilën mes tjerash theksohet, citoj:

Në praktikë, mbrojtja rrallëherë e kundërshton përzgjedhjen e ekspertit të angazhuar nga prokuroria. Gati të gjithë prokurorët, të cilët janë përgjigjur në pyetësor, deklaruan se mbrojtja “rrallëherë ose asnjëherë” nuk e sfidon përzgjedhjen e ekspertëve nga ana e tyre

⁴ Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale, të vitit 2013, faqe 14;

⁵ Rasti PP.II.nr..... ; PP.II.nr.....; PP.II.nr.; PP.II.nr.....

⁶ Raporti i OSBE në Kosovë, titulluar “Shqyrtimi i zbatimit të kodit të ri të procedurës penale në Kosovë”, Qershor 2016, faqe 17-18;

sipas nenit 137(1) të KPP duke paraqitur kundërshtim pranë gjyqtarit të procedurës paraprake. Për më tepër, 92 për qind e gjyqtarëve konfirmuan se ata “rrallëherë ose asnjëherë” nuk pranojnë kundërshtime të tilla. Fakti që mbrojtja gati asnjëherë nuk paraqet kundërshtime të tilla gjithashtu ngre dyshime se prokuroria nuk e njofton gjithmonë mbrojtjen mbi vendimin për emërimin e ekspertëve. Në të vërtetë, afërsisht 40 për qind e avokatëve, të cilët janë përgjigjur në pyetësor, deklaruan se ata nuk janë njoftuar për vendimet e prokurorëve për emërimin e ekspertit. Kjo informatë është vërtetuar gjatë disa intervistave me avokatët. Njëri prej tyre nënvizoi se prokurorët në përgjithësi jo vetëm që nuk ia japin atij këto vendime, por edhe se nuk i sigurojnë asnjë lloj dokumentacioni. Ai duhet të shkojë në zyrën e prokurorisë dhe të mbledhë dokumentacionin. Ky shqetësim është ngritur edhe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në raportin e konsoliduar, ku ceket se “në praktikë është e vështirë të sigurohet barazia e armëve [...] prokurorët shpeshherë nuk arrijnë t’u sigurojnë mbrojtësve qasje të pakufizuar në shkresat e lëndës”.

Një çështje shumë e rëndësishme sa i përket ekspertizës, ka të bëjmë me procedurën ligjore të paraparë në nenin 138 paragrafi 5 të KPP-së. Në këtë dispozitë është përcaktuar se një kopje e raportit të ekspertit, sapo të pranohet nga prokuroria, duhet t’i dorëzohet të pandehurit. Megjithatë, aktualisht prokuroritë nuk e përmbushin këtë obligim ligjor. Për pasojë, të pandehurit i mohohet e drejta për të kundërshtuar përmbajtjen e ekspertizës dhe mundësinë e propozimit të një eksperti tjetër apo kundërthënie mes ekspertizave siç është paraparë në nenin 141 dhe 142 të KPP-së.

4. Veprimet e prokurorit pas pranimit të raportit të ekspertizës

Në praktikën aktuale të Prokurorive Themelore të Kosovës, pas pranimit të raportit të ekspertizës së komunikacionit dhe raportit mjekoligjor rreth lëndimeve të dëmtuarit, prokurori nuk e njofton fare as të pandehurin as të dëmtuarin.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Ky mosveprim i prokurorit bije ndeshë me nenin 138 paragrafi 5 të KPP-së, ku është paraparë që raporti i ekspertit t'i zbulohet të pandehurit dhe të dëmtuarit. Për pasojë, jo vetëm i pandehuri por edhe i/e dëmtuari nuk kanë njohuri për ekzistimin e raportit dhe u mohohet mundësia për ta kundërshtuar. Një rast ku prokurori mund të plotësoj të gjitha detyrimet ligjore që lidhen me ekspertizën është marrja e deklaratës së ekspertit. Në këtë rast, KPP e ka përcaktuar si një veprim procedural të rëndësishëm ku të gjithat palët janë prezentë dhe mund të parashtrojnë pyetje, kundërshtime, propozime, lidhur me raportin e ekspertit, siç është paraparë në nenin 140 të KPP-së. Në këtë mënyrë, shumica e dilemave eventuale që mund t'i kenë palët, do të adresoheshin. Mirëpo, nga praktika e deritanishme është konstatuar se prokurorët shumë rrallë e ftojnë ekspertin për të dhënë deklaratë në procedurë.

Konsideroj se, marrja e deklaratës së ekspertit gjatë procedurës hetimore dhe menjëherë pasi që ai/ajo e dorëzon raportin e ekspertizën, siç është përcaktuar në nenin 140 të KPP-së, duhet të jetë një veprim procedural i domosdoshëm, sidomos në ato raste kur nga ekspertiza mbështetet përfundimi mbi fajsinë e të pandehurit. Duke aplikuar këtë dispozitë procedurale, prokurori i shtetit përmbush obligimin që rrjedhë nga neni 9 i KPP-së, ku është paraparë barazia e palëve në procedurë. Gjithashtu, ky obligim rrjedh edhe nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kapitulli "Liritë dhe të Drejtat e Njeriut".

Në anën tjetër, gjatë zhvillimit të procedurës së përshkruar më lartë, gjendja shëndetësore e të dëmtuarit nuk sqarohet mjaftueshëm. Përveç raportit të emergjencës që është përpiluar ditën e aksidentit prokurori nuk ka asnjë provë tjetër rreth gjendjes shëndetësore të dëmtuarit. Shpesh herë ndodhë që nga paraqitja e kallëzimit penal deri në ngritje të aktakuzës së drejtpërdrejtë kalon më shumë se 6 muaj. Dhe mund të ndodhë që gjatë kësaj periudhe kohore gjendja shëndetësore e të dëmtuarit të përkeqësohet ose të pësoj ndonjë ndryshim krahas gjendjes që ishte ditën e aksidentit. Prandaj, konsideroi se është mëse ligjore dhe njerëzore që prokurori para se të ngrit një aktakuzë të ketë në dispozicion të dhënat e fundit, të përditësuara, lidhur me gjendjen shëndetësore të të dëmtuarit të shkaktuar nga aksidenti rrugor.

Lidhur me këtë, në Udhëzuesin për KPP-në të vitit 2013⁷, mes tjerash u theksua, citoj: theksua se:

*“...Një parim udhëheqës i hartuesve të këtij Kodi ishte balancimi. Në çdo rast kur është bërë ndonjë ndryshim që ka rezultuar në zgjerimin e kompetencave të njëres palë, është bërë edhe ndryshimi tjetër për të balancuar ato kompetenca. Në të shumtën e rasteve, ndryshimi i tillë është bërë duke fuqizuar palën tjetër. Për shembull, sipas nenit 137 prokurori mund të angazhojë ekspertin, por kjo nënkupton që eksperti më nuk shihet si neutral ashtu siç konsiderohej eksperti i caktuar nga gjykata. Andaj, **kompetenca e prokurorit për të caktuar ekspertin balancohet nga disa faktorë. Së pari, neni 138 detyron ekspertin që të hartojë një raport në të cilin bëhet përmbledhja e metodës së ekspertimit dhe nxjerrjes së përfundimit, i cili pastaj i jepet të pandehurit dhe të dëmtuarit para deklaratës së ekspertit në procedurë paraprake. Së dyti, i pandehuri ose i dëmtuari ka të drejtë të "+ kërkojë që deklarata e ekspertit të merret nga prokurori sipas nenit 138, paragrafët 3 dhe 4. i pandehuri gjithashtu mund të angazhojë ekspertin e tij sipas nenit 141 dhe mund të kundërshtojë çdo kundërthënie ndërmjet ekspertëve nga neni 142. Prandaj ky ndryshim – autorizimi i prokurorit për të caktuar ekspertin – balancohet me një ndryshim tjetër, pra dhënien e më shumë mundësive të të pandehurit për të kundërshtuar përzgjedhjen apo ekspertimin e ekspertit...”***

Së këndejmi, e konsideroj relevante theksimin e faktit të balancimit të kompetencës së prokurorit dhe të pandehurit në procedurën penale. Duke respektuar këtë parim, prokurori dëshmon se procedura ishte zhvilluar në harmoni me dispozitat e KPP-së dhe me këtë shmang çdo pretendim eventual për veprime “arbitrare” dhe në të njëjtën kohë dëshmohet se të drejtat e të pandehurit në procedurë, të garantuara me Kushtetutë dhe ligj, janë respektuar. Fakti që KPP si një Kodi i ri, ka paraparë “parimin e balancimit të kompetencave” në mes të prokurorit dhe të pandehurit në një procedurë penale, paraqet një sfidë karshi praktikës disa vjeçare, ekzistuese të prokurorisë, përkitazi me trajtimin e rasteve nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPP-së. Rrjedhimisht, për dallim nga praktika e më hershme, tani prokurori është i obliguar që, pothuajse për çdo veprim procedural të ndërmarrë, të njoftoj të pandehurin dhe të dëmtuarin. Përfundimisht, bëjnë rastet

⁷ Udhëzuesi për KPP, viti 2013, faqe 19;

kur kjo e drejtë i kufizohet të pandehurit me ligj. Mirëpo, në rastin e procedimit konform nenit 137 dhe 138 , KPP ka paraparë detyrim për prokurorin e shtetit që, për një veprim të tillë procedural, ta njoftoj menjëherë të pandehurin.

Përfundim

Bazuar në ato që u thanë më lartë, është me rëndësi të theksohet se gjatë trajtimit të rasteve nga vepra penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 1, 6 dhe 7 të KPRK-së, prokurori i shtetit duhet të jetë koshient se nuk po përmbush vetëm një rol të karakterit procedural por në të njëjtën kohë duke përmbushur atë rol, ka obligime që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga Standardet ndërkombëtare, përkitazi me të drejtat e të pandehurit në procedurë. Në këtë mënyrë mbrohen dhe respektohen të drejtat e palëve në procedurë, rritet transparenca dhe besimi ndaj publikut si dhe bëhet balancimi i kompetencave të palëve në procedurë. Andaj, vij në konkludimin se në rastet e veprave penale nga neni 378 par.1,6 dhe 7 të KPRK-së, prokurori i shtetit duhet të luaj një rol proaktivë në procedurë për ta përmbushur mandatin e tij dhe atë përmes veprimeve vijuese:

- në rastet nga neni 378 par.1,6 dhe 7 të KPRK-së, nuk duhet të ngritet e ashtuquajtura ‘aktakuzë të drejtpërdrejtë’, sipas nenit 102 par.2 të KPP-së, por duhet të paraqitet aktakuzë pas zhvillimit të hetimit;
- duhet të nxjerr Aktvendim për fillimin e hetimit, sipas nenit 104 të KPP-së, para se të caktoj ekspertin e komunikacionit dhe ekspertin mjekoligjor, konform nenit 137 par.1 të KPP-së;
- të njoftoi palët në procedurë lidhur me vendimin për caktimin e ekspertit, obligim që rrjedh nga neni 137 par.2 të KPP-së, duke u dhënë mundësinë ligjore-procedurale për të parashtruar një kundërshtim eventual.
- të njoftoi palët në procedurë me raportin e ekspertizës, konform nenit 138 të KPP-së dhe me këtë respekton të drejtën ligjore, të paraqesin kundërshtimet përkitazi me përfundimet apo me përvojën e ekspertit.
- Të marr deklaraten e ekspertit, konform nenit 136 par.3 dhe 4 të KPP-së, kur atë e kërkon i pandehuri apo i dëmtuari, në mënyrë që t’u japë mundësinë ta ekzaminojnë ekspertin përkitazi me përfundimet e nxjerra.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

- të marr deklaratën e të dëmtuarit, konform nenit 131 të KPP-së, pasi që praktika ka dëshmuar se deklarata e tij/saj e marr në polici nuk është marr në harmoni me dispozitat e KPP-së, që kanë të bëjnë me këto lloj deklaratash;
- të marr në pyetje të pandehurin, konform nenit 152 të KPP-së për t'i ja dhanë mundësinë që të përgjigjet lidhur me të gjeturat e procesit hetimor.

Literatura

Duke marr parasysh faktin se kjo temë është mjaftë specifike dhe rrallë herë e trajtuar, për përgatitjen e saj janë shqyrtuar një numër i akteve ligjore dhe publikimeve të ndryshme. Në vijim, po i listojmë literaturën relevante:

Aktet Juridike;

- a) Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- b) Kodi Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës
- c) Kodi Nr. 04/L-123 Procedurës Penale të Republikës së Kosovës
- d) Ligjin Nr.05/L-088 për trafikun rrugor, në fuqi nga data 20 shtator 2016:

Publikime;

- a) Salihu, Ismet, Prof. Dr; Zhitia, Hilmi Mr. Sc; Hasani Fejzullah Dr. Sc; Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Botimi i I;
- b) Sahiti, Ejup, Prof. Dr. Sc; Murati, Rexhep, Prof. Dr.Sc.; Elshani, Xhevdet Mr; Komentari i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës;
- c) Sahiti Ejup; Murati, Rexhep; E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2016;
- d) Udhëzues për Kodin e procedurës penale të R. Kosovës, Prishtinë, 2013;
- e) Mcbride, Jeremz; Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Procedura e Penale, Praktika gjyqësore e GjEDNJ;
- f) Aktgjykimi numër Pml.nr.154/2017 i datës 27.6.2017, i Gjykatës Supreme të Kosovës;

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

- g) OSCE, Raport; Shqyrtimi i zbatimit të Kodit të Ri të Procedurës Penale në Kosovë, qershor 2016;
- h) 'Doracaku i Gjyqtarëve për procedurën penale'' të Institutit Gjyqësor të Kosovë (IGJK), të vitit 2005;
- i) Doracaku I Programit të Trajnimit Fillestarë për Prokurorë, Akademia e Drejtësisë, Dhjetor 2016;
- j) Hajdari, Azem, Prof; Komentari i Kodit të procedurës penale, Qershor 2016

Ilijana ÇOLLAKU TAFÄ*

VEPRA PENALE NXITJA E URREJTJES, PËRÇARJES OSE MOS DURIMIT KOMBËTAR, RACOR, FETAR APO ETNIK

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është të trajtojë rëndësinë e inkriminimit dhe trajtimit të duhur nga organet e ndjekjes të krimeve nga urrejtja¹. Në këtë punim, në veçanti do të trajtohet vepra penale Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, si vepër penale e cila sanksionohet me Nenin 147 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës² (në tekstin e mëtejme “KPRK” ose “Kodi Penal i Kosovës”). Me këtë dispozitë sanksionohet nxitja, apo përhapja publikisht e urrejtjes, ashtu që grupe të caktuara do të mund të ekspozoheshin ndaj sulmeve dhe veprave kriminale e që përbëjnë krime të urrejtjes.

Nga rezultatet e këtij punimi mund të nxjerret përfundimi se një trajtim adekuat në ndjekjen penale dhe gjykimin e kryesve të krimeve të kryera nga urrejtja është i një rëndësie të veçantë meqenëse akte të tilla mund të rezultojnë në përçarjen e shoqërisë, dhe mund të shkaktojnë dhunë në përmasa më të gjera.

Fjalët kyçe: Vepër penale, nxitje, urrejtje, mosdurim, liria e shprehjes, Kosovë.

* Autorja Ilijana Çollaku Tafa, M.A., është Prokurore e Shtetit në Departamentin e Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë

¹ Në gjuhën angleze *hate crimes*, definicioni i së cilës është: një krim i motivuar nga paragjykimi sipas racës, seksit apo ndonjë paragjykimi tjetër e që përfshinë dhunë.

² Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr 19/12 Korrik 2012 hyrë në fuqi nga data 1 janar 2013.

Hyrje

Krimet e motivuara nga jotoleranca ndaj grupeve të caktuara në një shoqëri quhen krime nga urrejtja. Nga hulumtimet dhe statistikat e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, krimet nga urrejtja ndodhin pothuaj në të gjitha shtetet. Një trajtim adekuat në hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e kryesve të këtyre krimeve është i një rëndësie të veçantë meqenëse akte të tilla mund të rezultojnë në përçarjen e shoqërisë, dhe mund të shkaktojnë dhunë në përmasa më të gjera. Trajtimi efikas i këtyre veprave ka një rëndësi të veçantë po ashtu edhe për vendin tonë, popullsia e së cilës, përveq kombit shqiptar që përbën shumicën, përbëhet edhe nga një diversitet i komuniteteve³ si dhe religjioneve të ndryshme. Prandaj, edhe Kodi Penal i Kosovës ka sanksionuar këto vepra penale përmes dispozitave ligjore që do të shtjellohen më poshtë.

Për të kuptuar veprën penale “Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik”, siç është paraparë me nenin 147 të Kodit Penal të Kosovës, së pari duhet përshkruar definicionin e krimeve nga urrejtja në përgjithësi, dhe karakteristikat e kësaj kategorie të veprave penale. Tek krimet nga urrejtja, veprimi së pari duhet të jetë i sanksionuar sipas Kodit Penal, dhe së dyti vepra penale duhet të jetë kryer nisur nga motivi i paragjykimin. Objekt i veprave të tilla penale mund të jetë personi, apo prona që ndërlidhet me një grup që ndan karakteristika të mbrojtura, siç mund të jenë raca, religjioni, etnia, kombësia, gjuha, orientimi seksual etj⁴.

Duhet theksuar se, ligji mbron të gjithë njerëzit njësoj. Sa u përket këtyre veprave penale, ligji specifikon cilat karakteristika të grupit janë të mbrojtura, thënë më saktë, ligji mbron të gjithë individët që identifikohen në përgjithësi me ato karakteristika. Për shembull, kur kemi religjionin si grup i mbrojtur, do të thotë se me dispozitat e krimeve nga urrejtja mbrohen të gjitha grupet fetare,

³ Lidhur me përkufizimin e termit komunitete, shih Ligjin Nr. 04/L-020 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjestarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Në bazë të këtij ligji, këto grupe janë komuniteti serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, goran, malazet dhe komunitete tjera.

⁴ “Understanding hate crimes”, OSCE/ODIHR 2011, në dispozicion në www.osce.org/odihr/104166

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

qofshin ato muslimane, të krishtera, apo grupe tjera fetare. Me mbrotjen e grupeve etnike apo kombëtare, do të thotë që në të njëjtën mënyrë ndiqen edhe krimet ndaj grupit etnik që përbën shumicën e popullatës, po ashtu edhe kur ndodhë krimi ndaj pakicave kombëtare⁵.

Ky lloj i veprave penale ka disa karakteristika siç janë: shtimi i numrit të këtyre veprave penale meqenëse kryesit duke menduar se janë duke vepruar në interes të komunitetit të tyre, vazhdojnë të kryejnë akte dhune të drejtuara ndaj një komuniteti apo grupi të caktuar; eskalimi i dhunës së përdorur nga ana e kryesve të këtyre veprave; hakmarrja e cila mund të vije nga ana e viktimave apo grupeve të viktimizuara në drejtim të kryesve⁶. Për këtë arsye, është e domosdoshme që organet e ndjekjes të jenë më efikase, ashtu që dëmi që do të mund të shkaktohej nga këto vepra për shoqërinë të jetë më i vogël.

Statistikat në vende të ndryshme të botës tregojnë një rritje të numrit të veprave të kryera nga urrejtja⁷, dhe duket se ky shtim i numrit të veprave penale të kryera nga urrejtja diktohet nga zhvillimet politiko-shoqërore në një vend. Kryerja e këtyre veprave shpesh herë motivohet nga disa qeveri, organizata, përfshirë edhe organizatat terroriste, për të shtrirë ndikimin e vet, dhe për të arritur qëllimet e veta politike.

Situata specifike në Kosovë, jo vetëm pas luftës së vitit 1999 por edhe në vitet e mëparshme, ka bërë që numri më i madh i krimeve nga urrejtja të ndodhë kryesisht në mes komuniteteve që jetojnë në Kosovë në drejtim të popullatës shumicë shqiptare dhe anasjelltas. Viteve të fundit, objekt i këtyre veprave penale në Kosovë shpesh herë kanë qenë të kthyerit, grupet fetare, objektet e

⁵ HATE CRIME LAWS, A practical guide, OSCE/ODIHR 2009, në dispozicion tek <http://www.osce.org/odihr/36426>

⁶po aty

⁷ shih “FBI Releases 2015 Hate Crime Statistics”, në dispozicion <https://www.fbi.gov/pressrel/fbi-releases-2015-hate-crime-statistics>; shih po ashtu “Are Hate Crimes Increasing in America” by Rachel Schwartz, në dispozicion tek inter.ifyc.org/are-hate-crimes-increasing-in-america; shih po ashtu CIVITAS “Hate crime: the facts behind the headlines”, Briefing note: October 2016, në dispozicion te: www.civitas.org.uk/content/files/hatecrimethefactsbehindtheheadlines.pdf; shih po ashtu “Current migration situation in the EU: hate crime” në dispozicion te fra.europa.eu/en/publication/2016/current-migration-situation-eu-hate-crime

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

shenjta fetare, e po ashtu edhe antarët e grupeve të caktuara të orientimit të ndryshëm seksual⁸.

Po për shkak të situatës specifike në Kosovë, shpesh herë krimet e kryera në mes antarëve të komuniteteve të ndryshme, janë konsideruar apo edhe raportuar nga organizatat e ndryshme si krime të urrejtjes, edhe atëherë kur nuk është vërtetuar qëllimi apo motivi si element përbërës i veprës penale bazë. Për të ekzistuar një vepër me elemente të krimit të urrejtjes, siç u tha edhe më lartë, duhet të ekzistojë motivi i caktuar nga paragjykimi.

Tek veprat penale që mund të kryhen me dashje, siç janë veprat penale të kryera nga urrejtja, krahas ekzistimit të elementeve të dashjes, shpesh kërkohet që kryesi të ketë vepruar me qëllimin dhe motivin e caktuar⁹. Për një numër të veprave penale, e në rastin konkret krimeve nga urrejtja, si element konstitutiv të figurës së caktuar të veprës penale, ligji parasheh qëllimin apo motivin me të cilin mund të kryhet një vepër.

Gjatë procedurës hetimore nëse një vepër është e motivuar nga paragjykimet dhe nëse ajo vepër duhet të konsiderohet si krim me motive të urrejtjes, duhet të merren parasysh disa indikacione kryesore, dhe duhet të hetohet më tej për të zbuluar motivin¹⁰. Disa nga indikacionet do të mund të ishin: perceptimi i viktimave dhe dëshmitarëve për krimin; komentet e kryesit, gjestet apo deklaratat e shkruara që reflektojnë paragjykimet, përfshirë grafitet apo simbolet tjera; ndonjë dallim në mes të kryesit dhe viktimës; incidente të ngjashme në lokacion të njëjtë për të përcaktuar nëse ekziston motivi; nëse viktimja ishte përfshirë në aktivitete për të promovuar grupin ose komunitetin, përmes veshjes apo sjelljeve; nëse incidenti kishte koiciduar me ndonjë festë apo datë të një rëndësie të veçantë për grupin e sulmuar apo antarin e atij grupi; mungesa e ndonjë motivi tjetër, si për shembull motivi pasuror¹¹.

⁸“Hate Crimes in the OSCE Region-Incidents and responses: Annual Report for 2012” (OSCE/ODIHR) në dispozicion tek www.osce.org/odhr/108395

⁹Ismet Salihu, E drejta penale - pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2012, fq. 303-304.

¹⁰“Investigation of hate crimes-Model Policy”, në dispozicion te:

https://www.nychiefs.org/images/ModelPolicies/MPTC_Hate_Crimes_Model_Policy.pdf

¹¹ Ibid

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Më 11 korrik 2013, Kuvendi i Kosovës kishte aprovuar Ligjin mbi Amnistinë¹² në bazë të të cilit amnistohen një numër i veprave penale të kryera para datës 20 qershor 2013, kryesisht veprat që kishin elemente të krimeve të urrejtjes, e po ashtu edhe vepra penale Nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik.

Përveç veprave penale të shkaktuara për shkak të tensioneve në mes të komuniteteve, në Kosovë kishte pasur sulme po ashtu edhe ndaj komunitetit LGBT¹³. Një grup personash kishin shkatërruar mjetet dhe e kishin rrahur njërin nga punonjësit gjatë lansimit të revistat Kosovo 2.0 me temë seksin, në dhjetor 2012. Revista në fjalë përfshinte disa artikuj lidhur me çështjet e LGBT¹⁴.

Sa i përket statistikave për veprën penale Nxitja e Urrejtjes, përçarjes ose e mosdurimit kombëtar, racor, fetar ose etnik në Kosovë, Këshilli Prokurorial i Kosovës në Raportet e mekanizmit përcjellës për harmonizimin e raporteve statistikore viteve të fundit ka filluar të përfshijë edhe statistikat e kësaj vepre penale¹⁵.

1. Rregullimi penalo-juridik i krimeve nga urrejtja në Kosovë

Për të ndjekur dhe gjykuar një vepër penale me elemente të krimeve nga urrejtja, organet e ndjekjes duhet të bazohen në ligjet vendore si dhe aktet ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë, të cilat inkrimojnë veprimet me të cilat kryhet kjo kategori e veprave penale.

2. Aktet Ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë

¹² Ligji Nr. 04/L-209, për Amnistinë

¹³ “LGBT” u referohet komuniteteve të lezbejkeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transeksualëve

¹⁴ Shih fusnote 10

¹⁵ Shih Raportet e mekanizmit përcjellës për harmonizimin e raporteve statistikore, në dispozicion tek <http://www.psh-ks.net/sq/mekanizmi-percjelles-per-harmonizimin-e-raporteve-statistikore>

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Legjislacioni ndërkombëtar në lidhje me krimet e urrejtjes ka rëndësi jo vetëm për faktin se Kosova synon antarësimin në organizatat ndërkombëtare siç janë Kombet e Bashkuara (KB) dhe Bashkimi Europian (BE), por në veçanti për faktin se këto akte ndërkombëtare janë direkt të aplikueshme në legjislacionin tonë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës i vendos dispozitat e instrumenteve të shumta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si obligative brenda rendit juridik të Kosovës. Në nenin 22 të Kushtetutës, janë të listuara marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, të cilat zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës, dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Dispozita të caktuara që do të përmenden më poshtë, rregullojnë liritë e individëve në gëzimin e të drejtave të tyre, por edhe kufizimet që duhet t'u nënshtrohen, dispozita të cilat do të mund të aplikohen ndaj grupeve radikale dhe propaganda e tyre.

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit¹⁶, e zbatueshme direkt në Kosovë sipas Kushtetutës, përmban dispozitat relevante në lidhje me detyrimin e shteteve palë për të ndjekur krimet e nxitjes së urrejtjes, krimet e urrejtjes dhe forma të ndryshme të deklaratave që shprehin gjuhë të urrejtjes. Në bazë të kësaj Konvente, shtetet zotohen konkretisht të shpallin vepra të dënueshme me ligj çdo përhapje të ideve të bazuara në epërsinë ose urrejtjen racore, çdo nxitje për diskriminim racor, si dhe çdo akt dhune, ose provokim për kryerjen e akteve të kësaj natyre kundër çdo race apo grupi personash të një ngjyre ose origjine tjetër etnike, gjithashtu edhe veprimtaritë e organizuara që ndihmojnë dhe nxisin diskriminimin racor.

¹⁶ Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 2106 A(XX) të datës 21 dhjetor 1965, në fuqi nga data 4 janar 1969.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike¹⁷, në dispozitat përkatëse të saj, duke proklamuar lirinë e shprehjes, gjithashtu flet për kufizimet në ushtrimin e kësaj të drejte duke ndaluar nxitjen për dhunë dhe gjuhën e urrejtjes. Në dispozitën përkatëse kjo Konventë parasheh se e drejta për lirinë e shprehjes mund t'u nënshtrohet disa kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve si dhe për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.

Konventa Europiane për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut¹⁸ (“KEDNJ” ose “Konventa”), në paragrafin 2 të nenit që parasheh lirinë e shprehjes, gjithashtu parasheh: “[...]kufizimet apo sanksionet e parashikuara me ligj, dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve[...].”

Neni 9 (2) i KEDNJ, që flet për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, poashtu parasheh kufizimet në ushtrimin e këtyre të drejtave, si në vijim: “Liria e shfaqjes së fesë së tij ose besimeve të dikujt nuk mund t’i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve”.

Po ashtu, është me rëndësi të ceket edhe neni 17 i KEDNJ, i cili parasheh ndalimin e keqpërdorimit të të drejtave të parapara në këtë Konventë: “Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një shteti, grupimi ose individi, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cënimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë”.

¹⁷ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 2200 A (XXI) të datës 16.12.1966, në fuqi nga data 23 mars 1976.

¹⁸ Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, në fuqi nga 3 shtator 1950.

Përafrimi i ligjeve në përputhje me Acquis Communautaire¹⁹ të BE-së është një nga kushtet që duhet të plotësohen nga secili shtet që synon antarësimin në BE. Meqenëse Kosova synon antarësimin në BE, Vendimi Kornizë i Bashkimit Europian mbi luftimin e racizmit dhe ksenofobisë²⁰ me anë të ligjeve penale²¹ është relevant gjithashtu edhe për Kosovën. Qëllimi i Vendimit në fjalë është që përmes legjislacionit penal të luftohen krimet raciste dhe ksenofobike. Sipas këtij Vendimi, krimet në lidhje me racizmin dhe ksenofobinë janë të drejtuara ndaj grupeve të personave, ose ndaj ndonjë antari të ndonjë grupi të tillë, në bazë të racës, ngjyrës, religjionit, prejardhjes, ose origjinës kombtare ose etnike.

3. Praktika e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) lidhur me rastet që ndërlidhen me krimet e urrejtjes

Derisa në njërin anë ndjekja penale dhe gjykimi i kryesve të veprave penale nga urrejtja është i rëndësishëm për të ruajtur sigurinë dhe rendin publik si dhe garantimin e lirisë dhe të drejtave të parapara me Kushtetutë, në anën tjetër organet e ndjekjes dhe gjykatat duhet të sigurohen se procedura penale dhe gjykimet kundër kryesve të jenë në pajtim me standardet dhe parimet e parapara me Kushtetutën e Kosovës dhe standardet ndërkombëtare të cilat janë të aplikueshme në bazë të Kushtetutës. Një detyrim i tillë i obligon organet e ndjekjes që gjatë zhvillimit të procedurave penale kundër kryesve mos të mohojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të cilat janë të garantuara me Kushtetutën e Kosovës.

Në bazë të nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

¹⁹Legjislacioni i BE-së

²⁰Definicioni i ksenofobisë: frika apo urrejtja nga të huajtë, njerëzit nga kulturat tjera

²¹ Vendimi Kornizë i Këshillit 2008/913/JHA i datës 28 nëntor 2008, mbi luftimin e formave dhe shprehjeve të racizmit dhe ksenofobisë me anë të ligjit penal

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Në praktikën e hetimit dhe ndjekjes së veprave nga urrejtja, jo vetëm në vendin tonë por edhe në vendet tjera, shpesh here është ngritur çështja nëse një veprim apo një delaratë e dhënë mbrohet nga e drejta e lirisë së shprehjes, lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, apo nëse ato veprime inkriminohen.

GjEDNj që nga viti 1962 kur për herë të parë kishte shqyrtuar lirinë e shprehjes, e deri më tani, ka marrë vendime lidhur me nenin 10 të Konventës Europiane për rreth 1000 raste²². GjEDNj vazhdimisht ka trajtuar lirinë e shprehjes si të drejtë themelore të njeriut, duke theksuar rëndësinë e saj si shtyllë bazike të demokracisë dhe të të drejtave të njeriut²³. Gjithashtu, është cekur se paragrafi 2 i nenit 10 të Konventës u lejon shteteve që të vendosin kufizime të caktuara ndaj lirisë së shprehjes për të mbrojtur interesat e përgjithshme.

GjEDNj gjatë praktikës zhvilloi disa elemente të gjuhës së urrejtjes e që janë qëllimi, përmbajtja apo konteksti i të shprehurit dhe pasoja e ndaluar²⁴.

Rastet që do të paraqiten në vijim janë vetëm disa nga rastet e shumta nga praktika e GjEDNj, me ç'rast janë dhënë opinionet se kur veprimet e caktuara hyjnë në fushën penale dhe deri në ç'masë duhet kufizuar ushtrimi i lirive dhe të drejtave në të cilat ankuesit thirren.

Në rastin Gündüz kundër Turqisë,²⁵ GjEDNj kishte gjetur se kishte pasur shkelje të nenit 10 të Konventës kur ankuesi ishte dënuar me dy vite burgim, për shkak se ai, si udhëheqës i një sekti Islam, gjatë një debati televiziv, kishte shfaqur pakënaqësitë e tij ndaj institucioneve sekulare dhe demokracive shtetërore. Megjithatë, GjEDNj gjeti se nuk ka dyshim se shprehjet që propagandojnë, nxisin apo arsyetojnë urrejtjen bazuar në intolerancë, përfshirë edhe intolerancën fetare, nuk gëzojnë mbrojtje të nenit 10. Megjithatë, sipas

²²Shih faqe 9, Liria e shprehjes, Udhëzues për interpretimin dhe domethënjen e nenit 10 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Toby Mendel

²³ po aty

²⁴Shih Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes, OSCE, Shkup 2013, në dispozicion tek <http://www.osce.org/sq/skopje/116609>

²⁵Aktgjykimi i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, 4 dhjetor 2003, rasti Müslüm Gündüz v. Turkey, aplikacioni nr.35071/97

pikëpamjeve të GjEDNj, komentet dhe deklaratat e Müslüm Gündüz të shprehura gjatë debatit televiziv nuk mund të merreshin si thirrje për dhunë, ose “gjuhë e urrejtjes” në baza fetare. GjEDNj vazhdon më tej se ankuesi vetëm duke mbrojtur të drejtën e sheriatit, pa bërë thirrje për dhunë për ta imponuar atë, në rastin konkret nuk mund të konsiderohej gjuhë e urrejtjes.

Në rastin Pavel Ivanov kundër Rusisë²⁶, ankuesi, pronar dhe botues i një reviste, ishte dënuar nga gjykata vendore për nxitje publike të urrejtjes në bazë të religjionit, racës, etnisë, përmes mediave. Ai ishte autor dhe publikues i një serie shkrimesh që i portretizonte hebrenjtë si burim i së keqes në Rusi, duke thirrur për përjashtimin e tyre nga jeta shoqërore. Ai akuzonte një grup të tërë etnik se bënë komplot kundër rusëve dhe u atribuonte ideologji fashiste udhëheqësisë hebreje. Edhe në publikimet e tij, por edhe gjatë gjykimit, ai mohonte se hebrenjtë kishin dinjitet kombëtar, duke thënë se ata nuk përbënin një komb. Ankuesi u ankua në GjEDNj se dënimi i tij për nxitje të urrejtjes racore nuk ishte i arsyeshëm. GjEDNj e kishte deklaruar ankesën të papranueshme. Sipas GjEDNj, nuk kishte dyshim se pikëpamjet e ankuesit ishin anti-semitike dhe u pajtua me vlerësimin e gjykatës vendore se përmes publikimeve të tij ai ishte përpjekur që të nxisë urrejtje ndaj hebrenjëve. Një sulm i tillë ndaj një grupi etnik është i drejtuar ndaj vlerave themelore të Konventës, posaçërisht tolerancës, paqes publike dhe mos-diskriminimit, rrjedhimisht, në bazë të nenit 17 të Konventës Europiane ankuesi nuk mund të përfitonte nga mbrojtja që ofron neni 10 i Konventës Europiane.

4. Ligjet vendore lidhur me krimet nga urrejtja

Përveq sanksionimit me dispozitën 147 të Kodit Penal të Kosovës, e cila për më detajisht do të shtjellohet më poshtë, po ashtu në disa dispozita të këtij kodi parashihet që, dënime më të larta do t’u shqiptohen kryesve të cilët veprat e caktuara penale i kanë kryer të ndikuar nga motive paragjyquese.

²⁶ Vendimi mbi pranueshmërinë, Pavel Ivanov v. Russia, Aplikacioni nr. 35222/04, date 20.02.2007.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Kështu, tek veprat penale kundër jetës dhe trupit, do të kualifikohet si Vrasje e rëndë dhe dënimi do të jetë më i lartë se tek vrasjet e rëndomta kur dikush privon nga jeta personin tjetër për motive racore, kombëtare ose fetare²⁷.

Neni 179 par. 1.10 i KPRK *“privon nga jeta personin tjetër për motive racore, kombëtare ose fetare”*

Nën një paragraf të veçantë po ashtu kualifikohet vepra penale e Asgjësimit apo dëmtimit të pasurisë, dhe parashihet dënim më i lartë në rastet kur është asgjësuar, dëmtuar apo është bërë e papërdorshme pasuria e personit tjetër për shkak të paragjyqimeve ndaj kombësisë, gjuhës, besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njëjërën nga këto karakteristika të mbrojtura²⁸.

Neni 333 par. 4 i KPRK *“Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer për shkak të paragjyqimeve ndaj kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njëjërën nga këto karakteristika të mbrojtura, kryesi i veprës penale dënohet me burgim deri në tre (3) vjet”*

Kur përcaktohet dënimi për kryesin e veprës penale, sipas Kodit Penal të Kosovës, gjykata do të marrë parasyshë motivet për kryerjen e veprës²⁹ ndërsa si rrethanë rënduese do të merret nëse vepra penale është kryer ndaj personit ose grupit të personave, ose pronës, për shkak të origjinës etnike ose kombëtare, shtetësisë, gjuhës, besimeve fetare, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njëjërën nga këto karakteristika³⁰.

Neni 73 par. 3 i KPRK *“Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme: [...]*

3.2. motivet për kryerjen e veprës[...]”

Neni 74 par. 2 i KPRK *“Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme rënduese: [...]*

²⁷ Shih neni 179, par. 1.10 i Kodit Penal të Kosovës

²⁸shih nenin 333 par. 4 të Kodit Penal të Kosovës

²⁹Shih nenin 73 par. 3.2 të Kodit Penal të Kosovës

³⁰Shih nenin 74 par. 2.12 të Kodit Penal të Kosovës

2.12. nëse vepra penale kryhet ndaj personit ose grupit të personave, ose pronës, për shkak të origjinës etnike ose kombëtare, shtetësisë, gjuhës, besimeve fetare, ose mungesës së besimeve fetare, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, orientimeve seksuale, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura”

Ligji mbi Liritë Fetare³¹, në pjesën përkatëse përcakton si në vijim:

“E drejta për të manifestuar fenë ose besimin nuk mund të abuzohet nëpërmjet nxitjes, ngacmimit, ose provokimit të jotolerancës ose urrejtjes nacionale, fetare ose racore, duke kërcënuar të drejtën për të jetuar, të drejtën për shëndet fizik dhe mendor, të drejtat për fëmijë ose të drejtën për të respektuar integritetin privat dhe familjarë.

[...]Sulmi ndaj çfarëdo zyrtari fetar, shkatërrimi ose dëmtimi i ndonjë vendi ose objekti fetarë, ose prone tjetër e ndonjë Bashkësie fetare, ashtu si edhe ndonjë akt ose aktivitet që ka për qëllim të shkaktojë, nxis, ose provokojë urrejtje fetare, është i ndëshkueshëm në bazë të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës”.

Ndalimi i nxitjes së urrejtjes në baza racore, etnike apo fetare, parashihet po ashtu edhe me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjestarëve të tyre në Republikën e Kosovës³². Neni 6 par. 8 i këtij ligji thotë si në vijim: “Rregulloret që kanë të bëjnë me ndalimin e nxitjes apo përhapjes së urrejtjes ose jo tolerancës racore, etnike apo fetare duhet të zbatohen edhe për mediat transmetuese që u përmenden më lart”.

5. Rregullimi penalo-juridik i krimeve nga urrejtja në disa nga shtetet e rajonit

Rëndësia e diskutimit të disa nga legjislacionet në rajon që rregullojnë krimet nga urrejtja në këtë punim është krahasimi me rregullimin penalo-juridik në

³¹Shih nenin 4.1 dhe 4.2 të Ligjit nr. 02/L-31 Ligji mbi Liritë Fetare

³²Shih nenin 6.8 të Ligjit Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjestarëve të tyre në Republikën e Kosovës

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Kosovë po për këto krime. Sanksionimi i gjuhës së urrejtjes, marrë në përgjithësi në Kodet Penale të vendeve që do t'i paraqesim më poshtë, fokusohen në inkriminimin e keqpërdorimit të lirisë së të shprehurit që konsiston me nxitjen e dhunës ose shkeljen e lirive dhe të drejtave të barabarta të të tjerëve ose shprehjen e sjelljes diskriminuese ndaj të tjerëve.

Kodi Penal i Shqipërisë³³, në nenin 50 parasheh një ndër rrethanat që rëndojnë dënimin edhe kryerjen e veprës të shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale. Tek dispozita për periudhën e sigurisë (neni 65/a), Kodi Penal i Shqipërisë parasheh “Gjykata, në dhënien e vendimit, mund të vendosë edhe caktimin e një periudhe sigurie, gjatë së cilës nuk lejohet zbatimi i nenit 64 të këtij Kodi³⁴, në rastet kur ekziston një nga këto rrethana:

[...]

d) kur kryerja e veprës penale është shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale.

Po ashtu, në Kodin Penal të Shqipërisë si vepra të veçanta parashihen edhe veprat penale Kanosja me motive racizimi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik (neni 84/a), Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit (neni 132). Më tej, në nenin 265, sanksionon nxitjen e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve: “Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve raciale, nacionale ose fetare, përhapja ose ruajtja me qëllim përhapjeje e shkrimeve me përmbajtje të tillë, dënohet[...]”, kurse me nenin 266 sanksionohet thirrja për urrejtje nacionale: “Vënia në rrezik e paqes publike duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë, duke i fyer ose shpifur për to, duke kërkuar përdorimin e dhunës ose të veprimeve arbitrare kundër tyre, dënohet[...]”.

Sipas **Kodit Penal të Kroacisë**³⁵, përveq që motivi i urrejtjes merret si rrethanë rënduese tek disa vepra penale, në nenin 87 mbi *domethënjet e shprehjeve në këtë ligj*, tek paragrafi 21, jepet domethënja e krimeve nga urrejtja: ndonjë vepër penale e kryer mbi baza të racës, religjionit, origjinës

³³ Kodi Penal i Shqipërisë, në dispozicion tek <http://ligjet.info/kodipenal>

³⁴ Neni 64 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë parasheh arsyet e veçanta për të cilat i dënuari me burgim mund të lirohet me kusht nga vuajtja e dënimit

³⁵ Kodi Penal i Kroacisë, në dispozicion tek <https://www.zakon.hr/z/98/Kazneni-zakon>

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

etnike apo kombëtare, paaftësisë, gjinisë, orientimit seksual apo identitetit gjinor të një personi do të konsiderohet krim nga urrejtja, dhe një veprim i tillë do të konsiderohet rrethanë rënduese përveç nëse me këtë ligj parashihet ndryshe”.

Përveq kësaj, me nenin 325 sanksionohet vepra penale Nxitje publike për urrejtje dhe dhunë, ku në paragrafin 1 parashihet si në vijim: “Kushdo që publikisht nxitë, përmes shtypit, radios, televizionit, sistemit kompjuterik ose të rrjetit, në ndonjë tubim publik apo në ndonjë mënyrë tjetër publikisht nxitë apo vë në dispozicion publik pamflete, imazhe apo ndonjë material tjetër që thërret për dhunë apo urrejtje të drejtuar ndaj një grupi të njerëzve apo ndonjë antari të atij grupi për shkak të racës, religjionit, origjinës etnike a kombëtare, ngyrës, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, paaftësisë apo ndonjë karakteristikë tjetër do të dënohet[...]”. Në paragrafët 2, 3, 4 dhe 5 sanksionohen veprimet kur ato ndërmerren duke organizuar apo udhëhequr grupet që kryejnë veprat penale si në paragrafin 1; pjesëmarrja në organizata të tilla; veprimet e kujtdo që publikisht aprovojnë gjenocidin, agresionin, krimet kundër njerëzimit apo të luftës të drejtuara kundër një grupi apo një antari të grupit bazuar në racën, religjionin, prejardhjen etnike a kombëtare, origjinën apo ngjyrën, në një mënyrë që nxit dhunë apo urrejtje kundër atij grupi apo antari të grupit; tentativa për të kryer këtë vepër.

Kodi Penal i Maqedonisë³⁶, gjuhën e urrejtjes e inkriminon si në vijim:

Neni 417, paragrafi 3 përcakton “Ai që përhap ide për superioritetin e një race mbi tjetrën ose propagandon urrejtje racore ose nxit diskriminim racor, do të dënohet nga gjashtë muaj burgim deri në tre vjet”. Dispozita e cila e inkriminon gjuhën e urrejtjes përmes sistemit kompjuterik përcaktohet në nenin 394-g “Ai i cili përmes sistemit kompjuterik përhapë në publik material të shkruara raciste dhe ksenofobike, fotografi ose prezanton ide apo teori të tjera të cilat ndihmojnë, promovojnë ose nxisin urrejtje, diskriminim ose dhunë, kundër çdo personi ose grupi, mbi bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes kombëtare ose etnike, si dhe besimit fetar, do të dënohet me dënim me burgim nga një deri në pesë vjet”. Neni 179 përcakton se “Ai i cili me

³⁶ Kodi Penal i Maqedonisë në dispozicion tek

qëllim të përbuzjes, publikisht do ta ekspozojë në poshtërim popullin maqedonas dhe pjesëtarët e bashkësive të cilët jetojnë në Republikën e Maqedonisë, do të dënohet me dënim me para”. Neni 319 parasheh “(1) Ai i cili me dhunë, keqtrajtim, rrezikim të sigurisë, shfaqje të përbuzjes ndaj simboleve nacionale, etnike ose fetare, me dëmtimin e sendeve të tjerëve, me përdhosjen e monumenteve, varreve ose në mënyrë tjetër do të shkaktojë ose do të nxisë urrejtje nacionale, racore ose fetare, përçarje dhe mostolerancë, do të dënohet me dënim me burgim nga një deri në pesë vjet”. Paragrafi 2 i këtij neni parasheh dënim më të rëndë kur kjo veprë kryhet me abuzimin e pozitës ose autorizimit ose nëse për shkak të atyre veprave kanë ndodhur trazira dhe dhunë ndaj njerëzve ose dëm pronësor të përmasave më të mëdha.

6. Vepra penale nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar ose etnik, sipas nenit 147 të KPRK

Neni 147 paragrafi 1, i Kodit Penal të Kosovës, përcakton si në vijim: “Kushdo që nxitë ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mosdurim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo grupe tjera të tilla që jetojnë në Republikën e Kosovës, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik³⁷, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet”.

Paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, paraqesin format e kualifikuara, më të rënda, të kësaj veprë penale, veprime për të cilat parashihet dënim më i lartë. Formë më e rëndë, e paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, do të jetë kur kryesi veprimet e parapara si në paragrafin 1, i ndërmerr në mënyrë sistematike; ose, kryesi vepron duke keqpërdorur pozitën apo autoritetin e tij; ose, kur kryesi me veprimet e tij duke nxitur apo përhapur publikisht urrejtje ndaj grupeve të caktuara të cekura në paragrafin e parë shkakton trazira, dhunë, ose pasoja tjera të rënda. Me paragrafin 3 të këtij neni, dënohen aktet e kujtdo “që kryen veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni përmes shtrëngimit, rrezikimit të

³⁷Neni 3 i Ligjit Nr. 03/L-142 Për Rendin dhe Qetësinë Publike, tek përkufizimet, përcakton: “Rendi dhe qetësia publike” nënkupton respektimin e sistemit ligjor dhe të institucioneve publike nga ana e qytetarëve, si dhe mbrojtjen e interesit ligjor dhe të lirive të personit

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

sigurisë, përqeshjes së simboleve kombëtare, racore, etnike apo fetare, duke dëmtuar pasurinë e personit tjetër ose duke përdhosur monumentet apo varrezat[...]. Ndërsa, paragrafi 4 sanksionon veprimet e kujtudo “që në mënyrë sistematike ose duke keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij kryen veprën penale nga paragrafi 3. i këtij neni ose shkakton trazira, dhunë ose pasoja të tjera të rënda me kryerjen e veprës së tillë”

Nga formulimi i veprës penale si më lartë, pyetjet që do të duhej të parashtroheshin në mënyrë që të identifikohet se veprimet e caktuara përbëjnë figurën e veprës penale “Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik”, do të ishin:

-kur ato veprime inkriminohen?

-cilat janë pasojat që duhet të jenë shkaktuar për tu konsideruar se një vepër e tillë është kryer?

-cilat grupe hyjnë nën mbrojtjen e këtij neni, cilat karakteristika janë të mbrojtura dhe çfarë është domethënja e shprehjes “*dhe grupet tjera të tilla*”?

Veprimet të cilat inkriminohen sipas kësaj vepre penale, janë *nxitja ose përhapja publikisht e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit*, pra përdorimi i një gjuhe koncepti i së cilës nuk mund të konsiderohet thjeshtë një e drejtë në lirinë e shprehjes apo mendimit, e mbrojtur edhe me standardet ndërkombëtare (*shih poashtu në pjesën përkatëse të këtij punimi*). Në paragrafin e parë të të njëjtës dispozitë, vazhdohet më tej duke thënë “në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik”. Është e paqartë, apo jo e sqaruar mjaftueshëm, se kur, me çfarë mënyre të veprimit të kryesit, do të konsiderohej se *ka ekzistuar mundësia* e prishjes së rendit publik.

Për më tepër, tek dispozitat ligjore të shteteve të lartpërmendura, përcaktohen në mënyrë të qartë mjetet me anë të të cilave kryesi vepron. Lidhur me këtë, tek Kodi Penal i Kroacisë, Maqedonisë, Shqipërisë, (*shih pjesën përkatëse të këtij punimi*) përcaktohet se thirrja apo nxitja, apo përhapja e urrejtjes, kryhet nëpërmes veprimeve si në vijim “ruajtja apo përhapja e shkrimeve”, “nëpërmjet sistemit kompjuterik”, “publikisht nxitë përmes shtypit, radios, televizionit, sistemit kompjuterik ose të rrjetit, në ndonjë tubim publik”, “përmes sistemit kompjuterik përhapë në publik material të

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

shkruar[...]fotografi ose prezanton ide apo teori të tjera”, “me dhunë, keqtrajtim, rrezikim të sigurisë, shfaqje të përbuzjes ndaj simboleve nacionale, etnike ose fetare, me dëmtimin e sendeve të të tjerëve, me përdhosjen e monumenteve, varreve ose në mënyrë tjetër[...]”

Pra, sipas paragrafit të parë të nenit 147 të KPRK, edhe pse veprimet janë ndërmarrë, pasoja e cila *mund* të shkaktohet, e që në këtë rast do të ishte prishja e rendit publik, dhe e cila nëse shkaktohet do të sanksionohet më rëndë ashtu siç është paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, nuk është shkaktuar ende.

Tek paragrafi 3, dënohen veprimet e kujtdo “që kryen veprën penale nga paragrafi 1, përmes shtrëngimit, rrezikimit të sigurisë, përqeshjes së simboleve kombëtare, racore, etnike ose fetare, duke dëmtuar pasurinë e personit tjetër ose duke përdhosur monumentet apo varrezat”. Pra, tek ky paragraf, janë të përcaktuara veprimet përmes të cilave konsiderohet se është kryer kjo veprë penale. Por, a inkriminohen edhe veprime të tjera, përveç këtyre në paragrafin 3, dhe përveç veprimeve të përcaktuara në paragrafin 2 ku thuhet “në mënyrë sistematike duke keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij”, apo në paragrafin 4 ku thuhet “kur me kryerjen e kësaj vepre, shkakton trazira, dhunë dhe pasoja të tjera të rënda”?

Nga sa u tha më lartë, duket se nga formulimi i tillë i dispozitës ekzistojnë paqartësi se kur do të konsiderohet se është shkaktuar pasoja e veprës penale. Tek paragrafi (1) kërkohet vetëm nxitja ose përhapja publike e urrejtjes, në mënyrën që mund të prishë rendin. Ndërsa tek paragrafët pasues pasoja konsiderohet se është shkaktuar kur pas nxitjes apo thirrjes së kryesit janë shkaktuar trazira dhe dhunë, si dhe kur është dëmtuar pasuria e personit tjetër apo përdhosja e monumenteve apo varrezave.

Edhe tek Komentari i Kodit Penal të Kosovës, pasoja e kësaj vepre penale përmendet në dy paragrafe të veçanta³⁸, si në vijim: “*Pasojë e kësaj vepre penale është shkaktimi, përhapja ose thellimi i urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit midis pjestarëve[...]*”, dhe “*Për ekzistimin e kësaj vepre penale*

³⁸ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentari, Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq 404-405

nuk është e domosdoshme që realisht të jetë shkaktuar urrejtja ose përçarja, apo që veprimi i kryerjes së nxitjes apo përhapjes të ketë shkaktuar intensitetin e urrejtjes apo mosdurimit ekzistues. Përkatësisht në sensin e këtij inkriminimi, si për nxitjen e urrejtjes ashtu edhe të përçarjes nuk kërkohet shkaktimi i pasojës”.

Sa i përket grupeve të mbrojtura, apo karakteristikave të mbrojtura me të cilat identifikohen ato grupe, sipas dispozitës së nenit 147 të KPRK janë: grupet kombëtare, racore, fetare, etnike, apo grupe tjera të tilla që jetojnë në Kosovë.

Krahasuar këtë dispozitë me ligjet e shteteve të tjera që u përmendën më lartë, por edhe me standardet ndërkombëtare, janë më të shumta grupet që do të duhej të mbrohen nga nxitja apo përhapja e urrejtjes. Ato janë “mbi bazë të ngjyrës, seksit, orientimit seksual, identitetit gjinor, paaftësisë apo ndonjë karakteristike tjetër”.

Çështja tjetër është se, nga dispozita e nenit 147 të KPRK, nuk është e qartë se çfarë nënkuptohet me termin “grupe të tjera të tilla”.

7. Kompetenca për ndjekjen e veprës penale nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar ose etnik

Në bazë të nenit 15 paragrafi 1, nënparagrafi 1.20 i Ligjit për Gjykatat³⁹, Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore i gjykon [...] “çfarëdo krimi që nuk gjendet i listuar në këtë nen i cili bie nën kompetencën ekskluzive apo vartëse të Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës siç përcaktohet në Ligjit mbi Zyrën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-52 (13 Mars 2008)”.

Neni 9 paragrafi 1 i Ligjit mbi Zyrën e Prokurorisë Speciale⁴⁰ (PSRK) përcakton se PSRK-ja do të ketë kompetencë plotësuese, sipas modaliteteve të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, për të hetuar dhe ndjekur penalisht

³⁹ Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat

⁴⁰Ligji mbi Zyrën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-52 (13 Mars 2008)

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

krimet: [...] b) nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar a etnik (neni 115, KPK) [...]

Po ashtu, pika “e” e paragrafit 2 të nenit 9 të Ligjit mbi PSRK-në parasheh se, sipas modaliteteve të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji dhe në pajtim me ligjin në fuqi para hyrjes në fuqi të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), PSRK-ja gjithashtu do të ketë kompetencë plotësuese për hetimin dhe ndjekjen e kësaj vepre penale.

Bazuar në nenin 22 të KPRK, kjo vepër penale nuk gjendet e listuar në grupin e veprave penale që konsiderohen krime të rënda për qëllime të këtij kodi. Rrjedhimisht, kjo vepër penale trajtohet në kuadër të Departamentit të Krimeve të Përgjithshme. Po ashtu, në bazë të dispozitave të cekura më lartë, çdoherë kur është në interes të hetimit a ndjekjes së duhur të krimeve, dhe kur plotësohet njëri nga kriteret e përcaktuara në nenin 10 të Ligjit mbi PSRK-në, hetimi dhe ndjekja e kryesve të kësaj vepre penale do të jetë në kompetencë të PSRK-së.

Përfundim

- Tek dispozitat ligjore që sanksionojnë krimet e urrejtjes, ligjdhënësi duhet të evitojë përdorimin e termeve të paqarta dhe të padefinuara. Rrjedhimisht, duhet të plotësohet neni 147 i Kodit Penal të Kosovës ashtu që termet e paqarta siç u elaboruan më lartë, si dhe veprimet e kryesit, mjetet përmes të cilave mund të kryhet kjo vepër penale, pasojat, me shkaktuarjen e të cilave do të konsiderohet se është kryer vepra e tillë penale, të definojnë qartë.
- Nga nxitja e urrejtjes, përçarjes ose e mosdurimit ndaj grupeve të caktuara, me Kodin Penal të Kosovës do të duhej të mbrohen edhe kategori të tjera, të drejtat e të cilave mbrohen me Kushtetutën e Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare, po ashtu siç është e përcaktuar edhe në ligjet e shteteve të tjera.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

- Gjatë procedurave gjyqësore në Kosovë, në rastin konkret për veprën penale Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose e mosdurimit kombëtar, racor, fetar ose etnik, apo ndonjë vepër tjetër penale me element të krimeve nga urrejtja, Prokuroria dhe Gjykatat duhet t'i referohen tekstit të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.
- Prokuroria dhe gjykatat duhet të sigurohen se procedura penale dhe gjykimet kundër kryesve të jenë në pajtim me standardet dhe parimet e parapara me Kushtetutën e Kosovës dhe standardet ndërkombëtare të cilat janë të aplikueshme në bazë të Kushtetutës, dhe të mos mohojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të cilat janë të garantuara me Kushtetutën e Kosovës.
- Një hetim i duhur dhe efikas i veprave penale që fillimisht raportohen si krime nga urrejtja do të ishte i një rëndësie të veçantë për të bërë të ditur se jo çdo vepër e kryer në mes të antarëve të grupeve apo komuniteteve të ndryshme përbën krim nga urrejtja.

Literatura

- E DREJTA PENALE-Pjesa e përgjithshme, Dr. Ismet Salihu, Universiteti Fama, Prishtinë, tetor 2012
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar, Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, Botimi I, Prishtinë, 2014
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082
- Ligji mbi Zyrën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-52 (13 Mars 2008)
- Ligji Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjestarëve të tyre në Republikën e Kosovës
- Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat
- Ligji Nr. 04/L-209, për Amnistinë

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

- Ligji Nr. 04/L-020 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjestarëve të tyre në Republikën e Kosovës
- Ligji nr. 02/L-31 Ligji mbi Liritë Fetare
- Ligji Nr. 03/L-142 Për Rendin dhe Qetësinë Publike
- Kodi Penal i Republikës së Kroacisë, NN 125/11, 144/12, 56/15, 61/15, në fuqi nga 30.05.2015
- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr 37/96, e përditësuar
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, LIGJI Nr.7895, datë 27.1.1995 (i perditësuar)
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, në fuqi nga 3 shtator 1950
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 2200 A (XXI) të datës 16.12.1966, në fuqi nga data 23 mars 1976
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 2106 A(XX) të datës 21 dhjetor 1965, në fuqi nga data 4 janar 1969
- Vendimi Kornizë I Këshillit 2008/913/JHA i datës 28 nëntor 2008, mbi luftimin e formave dhe shprehjeve të racizmit dhe ksenofobisë me anë të ligjit penal
- Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes, OSCE, 2013
- Liria e shprehjes, Udhëzues për interpretimin dhe domethënjen e nenit 10 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Toby Mendel
- Understanding hate crimes, OSCE/ODIHR 2011
- HATE CRIME LAWS, A practical guide, OSCE/ODIHR 2009
- Hate Crimes in the OSCE Region-Incidents and responses: Annual Report for 2012” (OSCE/ODIHR)
- Human Rights Watch report, January 2014, Kosovo, Country Summary
- Investigation of hate crimes-Model Policy
- Aktgjykime të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Jehona Grantolli*

***ASPEKTI JURIDIKO-PSIKOLOGJIK I KRIMIT DHE
DËNIMIT NË KOSOVË***

Abstrakti

Gjatë zhvillimit të historisë njerëzore, krahas shumë përpjekjeve për një jetë më humane, më të lirë, më të drejtë, lindi nevoja që me formimin e shteteve të rregulloheshin çështjet me rëndësi për individin dhe shoqërinë.

Kjo nevojë erdhi si pasojë e shumë shkeljeve të të drejtave elementare, padrejtësive, torturave nga më të rëndat, që njerëzimi po përjetonte. Këto përpjekje u zyrtarizuan me ratifikimin e bazës ligjore me qëllim të funksionimit të shtetit ligjor dhe juridik dhe idesë që shteti jo që jo vetëm t'i proklamojë këto liri dhe të drejta, por edhe t'i zbatojë në praktikë. Praktikë që ndoqi edhe Kosova që nga Pavarësia e deri më sot duke garantuar dhe siguruar liritë dhe të drejtat thelbësore të të gjithë shoqërisë.

Hyrje

Lufta kundër kriminalitetit është e vjetër sa vetë njerëzimi, historia dhe e drejta. Shteti përmes funksionimit të institucioneve përkatëse si në të kaluarën, ashtu edhe sot ka bërë përpjekje që duke e njohur si dukuri negative ta parandalojë atë duke inkriminuar dhe kodifikuar në Kodin Penal të gjitha sjelljet dhe veprimet e dëmshme për shoqërinë, sepse vetëm në këtë mënyrë është arritur të mbrohet vet individi por edhe të mirat përreth tij. Në literaturën juridike dhe sqarimet që japin mendimet e tyre juristët ndër vite mbizotëron mendimi se krimi dhe kriminaliteti si fenomen lidhet me gjendjen e pasigurisë, frikës dhe dëmit ekonomik dhe social. Mirëpo për të evituar dhe në të njëjtën kohë edukuar në aspektin juridiko-psikologjik, me rëndësi është që ekziston në këtë kontekst normimi juridiko-pozitiv, me qëllim të shqiptimit

* Jehona Grantolli, prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

të sanksioneve penale - dënimeve ekzekutimit të tyre në të ashtuquajturën politikë ndëshkimore¹. Marrë në tërësi, ajo përfshin (sistemin e) funksionin e legjislacionit penal, organizimin dhe funksionimin e institucioneve (policisë; gjykatave; prokurorisë; institucioneve penitensiare etj.) për zbatimin e tyre si dhe për shqiptimin dhe ekzekutimin e sanksioneve penale². I tërë sistemi gjyqësor duhet të jetë në fakt në funksion të politikës ndëshkimore, me qëllim të realizimit të parimeve fundamentale të një drejtësie ligjore të barasvlefshme për të gjithë. Ky sistem i drejtësisë ligjore nënkupton, në radhë të parë, drejtësinë institucionale, (të organizuar e shtetërore) e në radhë të dytë llojet e saj mbi bazën e masës së shkeljeve ligjore³. Është fakt se ndaj kriminalitetit në përgjithësi asnjë shoqëri nuk ka qenë dhe nuk është immune, pa marrë parasysh kohën e veprimit të saj dhe pa marrë parasysh rregullimin shoqëror-politik të saj⁴. Me gjithë rrethanat në të cilat është zhvilluar kjo luftë ndaj kriminalitetit në Kosovë, magjithatë nuk mund të mendohet assesi pa aspektin “represiv” të reagimit ndaj saj⁵.

Shoqëria, në përgjithësi, nënkupton të gjithë individët, pa marrë parasysh racën, gjininë, statusin social, përkatësinë fetare, etnike, etj. Por, veç këtyre, një kategori, e cila meriton një trajtim më ndryshe nga personat e tjerë, janë personat e dënuar, personat të cilët vuajnë dënimin me heqje të lirisë apo me burgim në institucionet penitensiare, si tek ne, ashtu edhe në shtetet e ndryshme të botës. Andaj, institucione dhe mekanizma të ndryshëm, sot, në botë, apelojnë që personat e dënuar të trajtohen në atë mënyrë që t’u jepet hapësirë dhe mundësi që të tregojnë aftësitë e tyre dhe të dëshmojnë se përkundër të kaluarës së tyre jo të mirë, do të përpiqen që në të ardhmen të rikthehen si pjesë e dobishme dhe e pranueshme, si në rrethin ku jetojnë, ashtu edhe më gjerë.

¹ Bajgora, Dr. Ali: “Disa karakteristika të kriminalitetit dhe politikës ndëshkimore në Kosovë”, **Prishtinë, 2001**, fq. 17-18.

² Po aty.

³ Dragoti, Dr. Edmond “Psikologjia ligjore e krimit”, Tiranë, 2007, faq.17.

⁴ Sahiti, Dr.Ejup “E drejta e procedurës penale”, Prishtinë, 2005, faq.1.

⁵ E quajmë represiv, sepse procedura penale zbatohet kundër kryerësit të veprës penale, pavarësisht nga vullneti i të pandehurit dhe sipas rregullit, pavarësisht nëse këtë e dëshiron i dëmtuari.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Në përmirësimin dhe avancimin e sistemit penitensiar, sot po merret një pjesë e madhe e institucioneve ndërkombëtare, e në këtë drejtim janë të njohura edhe Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajttimeve Çnjerëzore, si dhe Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare mbi Rregullat evropiane mbi burgjet. Rregullat evropiane mbi burgjet, të miratuara nga Këshilli i Evropës, në mënyrë të qartë shprehin se personat e privuar nga liria duhet të trajtohen në atë mënyrë, që të lehtësohet riintegrimi i tyre në shoqërinë e lirë. Mirëpo, përkundër kësaj, realiteti tregon se shumë pak është bërë dhe është punuar në këtë drejtim, pra në rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të dënuar. Kjo sigurisht shpjegohet me faktin që, sot, shkalla e recidivizmit në botë është e lartë dhe atë se shumë të burgosur, pasi kanë vuajtur dënimin, nuk kalon kohë e gjatë dhe i rikthehen rrethit vicioz të krimeve. Një problem kryesor, i cili shfaqet pothuajse në çdo shtet evropian, ashtu edhe tek ne, është problemi i mbipopullimit të qendrave të paraburgimit. Në disa shtete, mbipopullimi ka arritur në atë nivel sa që është dyfishuar numri i të burgosurve dhe ky numër është jashtë kapaciteteve të institucioneve. Mbipopullimi i institucioneve penitensiare, po ashtu pamundëson edhe privatësinë, kur është fjala për shfrytëzimin e tualeteve apo për nevojat personale të personave të dënuar. Në këtë rast, e drejta për jetë private është pamundësuar. Kjo gjendje, normalisht që rrit edhe tensionet në mes të personave të dënuar dhe rezultojnë shpesh edhe me përdorimin e dhunës. Në fakt, gjendja e mbipopullimit të institucioneve penitensiare ka si rezultat paraqitjen e kushteve johumane dhe degraduese nëpër qendrat e ndryshme të mbajtjes së dënimit dhe është në kundërshtim me parimet e të drejtave të personave të dënuar.

1. Të kryesh krim

Individi vendos të kryejë një vepër penale i ndikuar kryesisht nga raporti i koston dhe i përfitimit në procesin e dhunimit të ligjit⁶. Zakonisht presioni i koston, pra i vështirësive dhe rreziqeve që sjell shkelja e ligjit, merret gjithmonë parasysh, pavarësisht nga shkalla e vëmendjes që i kushtohet⁷. Në fakt, shikuar në aspektin fillestar psikologjik, një gjë e tillë duket të jetë zanafilla e botë së brendshme të individit kur vendos të kryejë një krim, apo

⁶ Dragoti, Dr. Edmond “Psikologjia ligjore e krimit”, Tiranë, 2007, faq 17.

⁷ Vep e cituar, fq.17

kur përballet me të. Faktorët tjerë socialë, ekonomikë dhe të natyrës individuale, janë pjesë e pandashme e këtij procesi vendimmarrës për individin. Në fakt, edhe psikologjia kriminale zakonisht merret me dy probleme kryesore. Një është zhvillimi i personalitetit deri të kryerja e veprës penale, ndërsa i dyti është problemi i vet kalimit në vepër⁸. Ky konstatim, që bën shkenca e psikologjisë gjyqësore, në përgjithësi në Kosovë me rastin e kryerjes së krimit nuk merret parasysh aspak nga ana e gjykatës që shqyrton rastin e kryerjes së veprës penale. Mungon sfera profesionale për një vlerësim të tillë dhe, si pasojë, kryerësi i veprës penale gjykohet vetëm brenda sferës objektive të mosrespektimit të ligjit, çka është shumë e dëmshme për personin, sepse rrallë arrihet të kuptohet në esencë qëllimi dhe rrethanat që kanë qar realisht individin të ndër marrë një veprim të kundërligjshëm dhe të rrezikshëm. Në përpjekje për të gjetur shkaqet dhe arsytet psikologjike, që janë thelbësore në vendimin për të kryer krime, botëkuptimi më gjithëpërfshirës mbi faktorët psikologjikë që mund të ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit janë se në paraqitje të delikucencës mund të ndikojnë niveli i inteligjencës, paqëndrueshmëria emocionale, niveli i ulët i tolerancës në frustrime, egocentrizmi, ndjenja e inferioritetit, mungesa e ndjenjës së përgjegjësisë, agresiviteti, vetitë psikopatologjike, sëmundjet psikike (shizofrenia, mania, psikoza maniake depresive), si dhe faktorë të tjerë të mbështetur në teori të ndryshme kriminologjike dhe psikologjike⁹. Këto veti në fakt janë shumë të pranishme tek një pjesë e madhe e kryerësve të veprave penale në vendin tonë dhe, veç këtyre, një faktor që ndërthuret në gjithë këtë proces të kryerjes së krimit është edhe faktori luftë, lufta e fundit që ka ndodhur në Kosovë, e cila si pasojë ka sjellë çekuilibrim të faktorit njeri. Rrethana të tjera, që ndikuan që njerëzit të kryejnë krime pas luftës janë të natyrave të ndryshme, mirëpo si pasojë pati edhe ndryshim të raporteve dhe marrëdhënieve familjare, andaj shumë njerëz sot në Kosovë vuajnë nga depresioni, varfëria dhe papunësia. Të gjithë këta faktorë psiko-social ndikuan që numri i krimeve të jetë i madh, gjë që nuk i kontribuoi aspak sistemit gjyqësor dhe sistemit të drejtësisë në përgjithësi. Është një gjë që duhet të ndodh tek këta njerëz: vetëdijësimi për të mos kryer krim, edhe pse shpesh në jetë ndjesitë dhe perceptimi që ndikon, varësisht nga konstruksioni biologjik i individit, nxit dhe qon në kalimin në

⁸ Sahiti, Dr. Ejup “Psikologjia gjyqësore”, Prishtinë, 2007, faq.31.

⁹ Vep. e cituar, fq. 32

vepër. Andaj, duhet bërë dallimin në mes të vendimit për të kryer vepër dhe kalimin në vepër. Sepse, mund të ndodh që personi që ka marrë një vendim për të kryer një vepër të mos arrijë ta realizojë atë, sikundër që ndonjëherë personi mund të ndodhet në aso situatë dhe rrethana të cilat i imponojnë atij që të kryejë krimin, të kalojë në kryerjen e veprës. Andaj, në këtë mënyrë rrethanat janë ato që kushtëzojnë individin që drejtpërsëdrejti të ndërmarrë veprimin për të kryer veprën, pa pasur hapësirë të reflektojë dhe të vendos paraprakisht për një gjë të tillë. Po të analizojmë të dhënat sa i përket kryerësve të veprave penale, mund të shohim se ata më shume vijnë nga rrethe me një ekonomi mesatare, njerëz që janë të thjeshtë dhe që patjetër paguajnë për krimin e bërë, ndërkaq pjesa tjetër, megjithëse kanë kryer vepër penale dënohen, por gjejnë forma dhe mënyra të ndryshme të mos përballen me dënimin. Raste të tilla gjejmë në praktikë dhe vërtet është për të ardhur keq të shohësh të ndodhin në realitet, kur p.sh., për të njëjtën vepër penale personat ndëshkohen në mënyra të ndryshme dhe kontradiktore nga ana e gjykatës.

2. Të jesh i dënuar

Të jesh i dënuar mbartë me vete një bagazh të rëndë si për vet individin ashtu edhe për familjen e rrethin ku jeton personi.. Një pjesë e mirë e personave, të cilët kryejnë krimin dhe më pas përballen me nofkën "i dënuar", nuk e kanë të qartë se tashmë është koha të vlerësojnë me seriozitet dhe të kuptojnë me sinqeritetin më të madh disa nga vlerat shoqërore. Madje, të tillët shpesh me mburrje tregojnë para shoqërisë për atë çfarë kanë bërë dhe se sa të guximshëm dhe të fortë janë. Kjo kategori personash janë naivët, persona me inteligjencë të nivelit të ulët, egocentrikë dhe të papërmbajtur. Për këtë kategori personash një gjë është e sigurt: mundësitë për t'i ndryshuar dhe rehabilituar janë minimale. E vetmja gjë që mund të ndryshojë ndoshta është zbutja e perceptimit antikonformist kundrejt sistemit ligjor, për ngritjen e vetëdijes se ligji është krijuar që t'u shërbejë atyre, në mënyrë që të gjithë njerëzit, pavarësisht se ku ndodhen, të jenë të sigurt për jetën dhe të drejtat e tyre. Të ndëshkosh, të jesh i dënuar për faktin se ke kryer një vepër penale sipas legjislacionit në fuqi, do të thotë të parandalosh kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të rehabilitosh, si dhe të parandalosh

personat tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen¹⁰. Sipas dispozitave etike, ligjore, në asnjë rast personit që ka kryer vepër penale nuk i shqiptohet dënimi për ta denigruar apo për t'u hakmarrë ndaj tij edhe pse dënimi në vete përfshin një dozë të kësaj të fundit, sepse personi dënohet sipas parimit të drejtësisë, sepse vetëm dënimi i drejtë mund të shuajë ndjenjën e hakmarrjes private, hakmarrjen e individit apo palës së dëmtuar ndaj kryerësit të veprës penale¹¹. Po të realizohej kjo situatë, atëherë vërtetë që të gjithë do të ishin të kënaqur. Por, kjo gjë nuk ndodh në praktikë. Viteve të fundit në praktikën gjyqësore edhe pse kundër një kategorie të personave që kanë kryer vepra penale të jakës së bardhë sic njihet në shkencën e kriminologjisë janë ngritur aktakuza, pikërisht kjo kategori përkundër një vendimi gjyqësor të plotfuqishëm kanë vazhduar të punojnë nëpër institucione shtetërore, madje në disa raste këta persona-të gjykuar janë avancuar nëpër pozita edhe më të larta shtetërore, sikundër që dënimet e parapara sipas legjislacionit në vend janë të ulëta, kur kemi parasysh faktin se për veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare sipas Kodit Penale të Republikës së Kosovës neni 422 është paraparë dënimi me burgim deri në pesë vite burgim, kur gjithmonë kemi parasysh faktin se bëhet fjalë për dëm të konsiderueshëm material dhe institucional në të njëjtën kohë.

3. Përballja me pasojat juridike

Se sa përballen sot kryerësit e veprave penale në Kosovë me pasojat juridike që burojnë nga ligji, është çështje e vlerësimit që bënë gjykata në çdo rast konkret, duke u futur në një proces të gjatë dhe të mundimshëm, që supozohet të përfundojë me një vendim gjyqësor. Ky proces zhvillohet përmes një procedure, e cila, sipas Prof. Dragotit, karakterizohet me emocione të përgjithshme për pjesëmarrësit¹². Veçanërisht situata tensionohet kur e vërteta që prezantohet në gjyq – është e vërteta formale që është ndryshe nga e vërteta në realitet¹³. Në këtë përballje paraqiten disa aktorë, siç i quan Prof. Dragoti,

¹⁰ Salihu, Dr. Ismet “E drejta penale”, fq 441, Prishtinë, 2008, faq .441.

¹¹ Po aty,, fq. 443

¹² Dragoti, dr. Edmond: „Psikologjia ligjore e krimit“, Tiranë, 2007, faq. 21.

¹³ Po aty.

“aktorët e gjyqit”¹⁴. Gjyqi në vetvete i ngjan një drame, ku përfshihen jo vetëm personazhet e skenës, pra aktorët, por edhe ata që e kanë përgatitur këtë dramë, pra autorët, ata që e kanë vënë në skenë, dhe madje edhe spektatorët, pra ata që e ndjekin, e shikojnë dhe e vlerësojnë¹⁵. Varësisht nga pozita procedurale e palëve, të drejtat, obligimet dhe përjetimet e tyre ndryshojnë¹⁶. Në gjithë këtë procedurë nuk duhet nënvlerësuar asnjë palë, nuk duhet dhënë përparësi asnjë prove, pa u konstatuar se një gjë e tillë është objektive për çështjen. Njëri ndër aktorët kryesorë është kryerësi që gjykohet. Ndonëse prezenca e tij në procedurë penale, sipas rregullit, është e domosdoshme, ai gëzon të drejtat e tij sipas ligjeve vendore dhe ato ndërkombëtare. Paralajmërimet të cilat duhet lexuar dëshmitarit, të pandehurit, etj...,¹⁷. Në këtë përballje procedurale, palët duhet të jenë të barabarta në aspektin ligjor dhe atë të paraqitjes dhe procedimit të provave. Legjislacioni në fuqi është striktë dhe rigoroz sa u përket parimeve të përgjithshme që duhet tu përmbahen palët. Kryerësi tashmë gjendet përballë një situatë, të cilën ndoshta nuk e kishte (e) menduar se do ta përjetonte, aq më pak se si do të reagonte, sepse kryerësi në kohën e vendosjes për të kryer veprën penale, në parashikimin e tij ikja, fshehja (mospërballja me pasojat juridike), mund të kenë qenë disa nga faktorët determinues për të vendosur të kryejë një akt të tillë. Në praktikë janë të rralla rastet kur kryerësit janë të ndërgjegjshëm dhe vetëdorëzohen, çdo herë ata kërkojnë rrugë të reja për të mos u përballur me këtë dramë të inskenuar nga vetë ata. Kryerësi që ka më pak informata në lidhje me pasojat që ka shkaktuar dhe se çfarë dënimi mund ta presë, është çdo herë nën stres të vazhdueshëm gjatë gjithë këtij procesi, sepse ai nuk mund të dijë se çfarë rëndësie kanë deklaratimet e personave në këtë proces. Përveç pasojave juridike, kryerësit duhet të përballen tani edhe me familjarët, shoqërinë, rrethin, ndërsa është me rëndësi nëse gjatë kësaj përballje që ndodh në aspektin psikik të kryerësit, personi e pranon personalisht vet faktin e të qenit fajtor. Kjo gjendje e ndryshon për të mirë kryerësin, për arsye se vetëm kur arrin në këtë pikë, do të thotë se ai është i vetëdijshëm se ka bërë diçka të keqe dhe në të ardhmen do të përpiqet të mos përsërisë veprime të këtilla të dëmshme jo vetëm për atë, por, edhe për rrethin dhe familjen. Ndërkaq në anën tjetër familja është ajo që më së shumti i vuan

¹⁴ Vep. e cituar, fq.23

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Sahiti, dr. Ejup: “Psikologjia Gjyqësore”, fq.117, Prishtinë, 2007

¹⁷ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 125,

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

pasojat, duke u përballur në këso raste me frikën, dhimbjen dhe ndjenjën e inferioritetit në ambientin në të cilin jetojnë, e gjithë kjo si rezultat i veprimeve të kundërligjshme të anëtarit të familjes. Fenomene të kësaj natyre hasim në mentalitetin e banorëve të vendit tonë, duke pasur parasysh faktin se jetojmë në një mjedis relativisht të vogël, ku të gjithë njihen dhe të gjitha dihen.

Prandaj, në këso situatë është me rëndësi që mekanizmat shtetërore, gjegjësisht institucionet e drejtësisë të merren më tepër me sensibilizim të qytetarëve për rëndësinë e respektimit të ligjit dhe rëndësinë e respektimit të rendit kushtetues dhe ligjor në mënyrë që të kemi sa më pak persona të privuar nga liria, sepse, vetëm në këtë mënyrë do arrijmë që të kemi në radhë të parë familje të shëndosha dhe rrjedhimisht edhe shoqëri më të qytetëruar.

Përfundim

Në vendin tonë kohëve të fundit vërehet një interesim i veçantë nga institucionet shtetërore por edhe nga organizata joqeveritare për sensibilizim të qytetarëve për respektimin e ligjit përmes kampanjave të ndryshme që reklamohen përmes mediave apo formave tjera efikase. Një organ, i cili vazhdimisht ka trajtuar çështjen e personave të privuar nga liria, është, siç u theksua, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor apo Poshtëruës, apo siç njihet shkurt Komiteti për Parandalimin e Torturës, e që është një organ i cili monitorohet nga Këshilli i Evropës. Ky organ është i përbërë nga ekspertë të paanshëm, të cilët janë të zgjedhur nga Këshilli i Evropës, përkatësisht Këshilli i Ministrave.

Sipas Raportit statistikor penal vjetor të Këshillit të Ministrave, të vitit 2007, është vlerësuar se janë më tepër se 1.8 milionë të burgosur në të gjithë Evropën, duke marrë parasysh edhe Qendrat e Paraburgimit. Ky numër nuk përfshinë edhe personat, të cilët mbahen në vende të tjera, si në institucionet e mbyllura psikiatrike, etj.

Ndërsa, sipas Rregullave evropiane mbi burgjet, për të burgosurit janë me rëndësi çështjet në vijim:

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

- Personat e privuar nga liria apo Të burgosurit duhet të kenë mundësinë e trajtimit mjekësor sa herë që ata kanë nevojë. Në burgje të disa vendeve ka raste të sëmundjeve të ndryshme, si të tuberkulozit, hepatitit, hiv aidsit. Po ashtu, edhe numri i të burgosurve, të cilët kanë qenë përdorues të drogave të ndryshme, duhet të trajtohet në mënyrë të veçantë.
- Një numër i konsiderueshëm i të burgosurve janë analfabetë, apo me shkollim të ulët. Për këtë arsye, personave të tillë duhet t'u mundësohet arsimimi dhe puna trajnuese, e cila kontribuon në mundësinë e fillimit të një jete normale pas lirimit.
- Puna në burg duhet të përcaktohet si një element pozitiv për të burgosurit. Rekreacioni dhe argëtimi duhet të përfshihen në aktivitetet ditore për të burgosurit.
- Personeli i burgut shpesh është nën presion dhe pëson si rezultat i kushteve jo të mira dhe numrit të madh të të burgosurve. Fatkeqësisht, punët në institucionet penitensiare paguhen dobët. Në mënyrë që sistemi i burgut të jetë më human dhe më efektiv, është e nevojshme që numri i personelit të jetë i caktuar dhe adekuat, në mënyrë që ata të paguhen arsyeshëm dhe të kontribuojnë në edukimin dhe trajnimin e personave të dënuar.

Ndërsa, sipas vlerësimeve më të fundit ndërkombëtare, konstatohet se është e nevojshme të themelohen sisteme efektive nacionale për monitorim. Protokoli i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Dhunës, Trajtimit Jhuman dhe Degradues, stimulon një mekanizëm të tillë të inspektimit dhe tashmë 14 shtete anëtare të Këshillit të Evropës e kanë ratifikuar këtë konventë, ndërsa 16 shtete tjera evropiane kanë nënshkruar dhe në të ardhmen do të bëhen pjesë e këtij protokoli. Detyra e monitoruesit mund ti jepet institucionit të Avokatit të Popullit, ose institucioneve të cilat veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Rekomandime në lidhje me respektimin e të drejtave të personave të dënuar, gjatë ekzekutimit të dënimit me heqje të lirisë, apo me burgim, në Kosovë

Të drejtat e personave të dënuar, gjatë ekzekutimit të dënimit me heqje të lirisë apo me burgim, në Kosovë, mund të thuhet se janë në përputhje me standardet e përcaktuara ndërkombëtarisht. Personat e dënuar, gjatë kohës së ekzekutimit të dënimit me heqje të lirisë apo me burgim, gëzojnë disa të drejta dhe këto të drejta duhet të respektohen nga ana e personelit korrektues, në atë mënyrë që të krijohen kushte sa më të mira në favor të personave të dënuar. Një proces i suksesshëm risocializues është rezultat i inkuadrimit të vet personave të dënuar.

Mirëpo, gjatë këtij procesi, janë vërejtur disa parregullsi dhe të meta, që realisht ndikojnë për të keq në respektimin e të drejtave të personave të dënuar. Parregullsitë janë të shprehura që nga fillimi i kohës së ekzekutimit të dënimit me heqje të lirisë, dhe këtu vlen të cekem të drejtat themelore, ndër të cilat është edhe sigurimi i ushqimit për personat e dënuar. Në përgjithësi, ushqimi që u servohet personave të dënuar nëpër institucionet korrektuese është i cilësisë së mirë dhe i plotëson standardet ndërkombëtare, në atë mënyrë siç edhe përcaktohet se ushqimi duhet t'u jepet personave të dënuar tri here në ditë dhe me sasi të caktuara kalorish.

Mangësi, në këtë kontekst, ka sigurimi i ujit të nxehtë në qendrat korrektuese në Lipjan dhe në Dubravë. Ndërsa, sa u përket kushteve higjieniko-sanitare, ato janë të rëndësishme të përcillen vazhdimisht, sepse në të kundërtën mund të sjellin pasoja të konsiderueshme për personat e dënuar, duke pasur parasysh se personat e dënuar paraqiten edhe si grup më i rrezikuar nga shumë sëmundje të ndryshme, sidomos një faktor i rrezikshëm në këtë drejtim është mbipopullimi i qendrave korrektuese dhe atyre të paraburgimit. Kjo gjendje sjell deri tek pamundësia e mbajtjes së higjienës personale, por edhe të vet objektit në përgjithësi, pastaj sjell deri te paraqitja e komplikimeve qoftë organike apo psikologjike, si dhe deri te mungesa e qetësisë personale dhe pasojave të tjera të paparashikuara. Prandaj, për të evituar situata të tilla, organet kompetente duhet të ndërmarrin veprime konkrete që kanë të bëjnë me sigurimin e hapësirës së nevojshme. Ndërsa, vendosja e personave të dënuar bëhet sipas dispozitave ligjore dhe personi i dënuar në mënyrë të saktë dhe të duhur me rastin e vendosjes në institucion njoftohet lidhur me të drejtat dhe

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

përgjegjësitë e tij. Gjithashtu, personat e dënuar sistemohen sipas rrethanave të tyre personale që merren parasysh, si vepra penale të cilën e kanë kryer, kohëzgjatja e dënimit dhe të tjera rrethana me rëndësi në përcaktimin e vendit dhe personave adekuat për qëndrim.

Një tjetër faktor që ndikon në përmirësimin e personave të dënuar është konstatuar të jetë puna, si një faktor nxitës dhe motivues si në aspektin psikik ashtu edhe në atë fizik. Personat e dënuar kanë mundësi më tepër të kyçen në punë që janë të përditshme dhe që nuk sjellin ndonjë avancim apo përparim në aftësimin e tyre për jetën në liri, ndërsa si pasojë nuk respektohet as e drejta për shpërblim në punë për shkak të mosrealizimit adekuat të të drejtës në punë.

Një e drejtë e cila nuk respektohet është edhe e drejta për pranimin e pakove familjare, të cilat janë më se të domosdoshme për përmbushjen e nevojave elementare të personave të dënuar, duke pasur parasysh faktin se në qendrën Korrektuese në Dubravë personat e dënuar nuk mund të përmbushin nevojat e tyre për gjësende higjieniko-sanitare dhe të tjera, sepse mungon furnizimi me gjëra të tilla, ndërsa në anën tjetër arsyetimi i institucioneve përkatëse se lejimi i pakove familjare do të rrezikonte qëndrimin e sigurt të personave të dënuar në institucion nuk është i bazuar, sepse për këtë mund të gjenden zgjidhje me mbikëqyrje më të shtuar nga ana e personelit korrektues. E drejta në pranimin e vizitave ndonjëherë nuk respektohet për një pjesë të personave të dënuar, sidomos kjo ndonjëherë i tejkalon edhe autorizimet zyrtare nga ana e personelit korrektues, që në mënyrë jotransparente mundëson vizita për një pjesë të personave të dënuar. Madje, këto autorizime keqpërdoren edhe në drejtime të tjera, duke bërë që të futen sende të palejuara, si telefona celularë, lloje të narkotikëve dhe madje duke mundësuar edhe ikjen e personave të rrezikshëm nga qendra korrektuese. Situata e tillë është e papranueshme dhe te një pjesë e personave të dënuar sjell anarki dhe mosbesim, madje edhe urrejtje ndaj stafit korrektues.

Do të ishte i nevojshëm edhe përmirësimi i kujdesit shëndetësor, sepse ka mangësi në realizimin e kësaj të drejte. E drejta në aktivitete rekreative dhe sportive po ashtu duhet të përmirësohet, më saktë të ndryshojë. Kjo nënkupton futjen e variacioneve me programe të organizuara nga vet personat e dënuar dhe në përkrahje edhe nga persona të profileve të ndryshme të botës së artit dhe kulturës në vend, gjithashtu në koordinim me Ministrinë e Drejtësisë dhe

të institucioneve korrektuese. Kjo do të ndikonte pozitivisht në disponimin e brendshëm të personave të dënuar në përgjithësi dhe në zbutjen e atmosferës së monotonisë brenda qendrave korrektuese. Ndërsa, e drejta në aftësim profesional dhe edukim respektohet dhe personat e dënuar, varësisht nga kualifikimet e tyre, u nënshtrohen kurseve të ndryshme trajnuese dhe për këtë u lëshohen certifikata, në të cilat, sipas dispozitave ligjore, nuk duhet të shënohet se janë përfunduar në institucion korrektuese, mirëpo së fundmi është vërejtur se në diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga Qendra Korrektuese në Lipjan shënohet vula e qendrës korrektuese dhe për këtë KMDLNJ ka kërkuar që të mos përsëritet në të ardhmen, por nuk hasur në mirëkuptim. Kjo situatë u sjell dëme personave të dënuar që pajisen me këto certifikata dhe diploma, sepse me rastin e punësimit prania e vulës mund të shikohet si një rrethanë negative për personin e dënuar. Ndërsa, shkollimi në nivele më të larta akoma nuk zë vend në këto qendra korrektuese. Gjithashtu, një ndër kushtet që janë paraparë me standarde ndërkombëtare është edhe ekzistimi i bibliotekës brenda institucioneve penitensiare dhe kjo e drejtë respektohet, sidomos në Qendrën Korrektuese në Lipjan, ndërsa e njëjta gjë nuk mund të thuhet për Qendrën Korrektuese në Dubravë, sepse këtu ka mungesë të literaturës, përkundër kërkesave të personave të dënuar për të lexuar. Prandaj, në të ardhmen, përmbushja e interesave të personave të dënuar duhet të realizohet, sepse ndikon tek personat e dënuar që të fitojnë njohuri dhe shkathhtësi të reja në lidhje me shumë aspekte jetësore.

Përkushtimi dhe vendosmëria gjithmonë janë dy faktorë që patjetër duhet të ndikojnë pozitivisht dhe për të mirë në çdo proces dhe kjo vlen edhe për sferën e institucioneve penitensiare përkatësisht institucioneve korrektuese dhe qendrave të paraburgimit-ndalimit dhe respektimit të drejtave të personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit me heqje të lirisë apo burgim në Kosovë, që dita ditës dhe hap pas hapi duhet të ngrihet në një shkallë më lartë, por me kusht që të ketë vlerë çdo person i dënuar, sepse vetëm duke i dhënë vlerë dhe respekt edhe këtë kategori të shoqërisë shteti do të mund ta riintegrojë me transparencë dhe barabarësi. Në vendet e zhvilluara, një fenomen që shfaqet është edhe bashkëpunimi në mes të vet personave të dënuar me organet e drejtësisë për zbulimin e veprave penale dhe kryerësve e të tyre dhe në të vërtetë një model i tillë është vlerësuar të jetë tejet efikas dhe produktiv, edhe pse në aspektin e lirive dhe të drejtave të njeriut ndonjëherë mund të bie ndesh

me parimet e garantuara, shtetet kanë marrë përsipër edhe këtë sfidë. Kjo do të mund të mendohej si një alternative edhe në vendin tonë, por kjo kërkon profesionalizëm dhe përkushtim të llojit të veçantë

Literatura

- Dragoti, Dr Edmond “Psikologjia ligjore e krimit”, Tiranë, 2007;
- Gashi, Dr Rexhep “Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri”, Prishtinë, 2001;
- Gruda, Dr. Zejnullah “Mbrojtja Ndërkombëtare e të drejtave të njeriut Dokumente II”, Prishtinë, 2001;
- Halili, Dr. Ragip “Penologjia”, Prishtinë, 2010;
- Salihu, Dr Ismet “E drejta penale”, Prishtinë, 2008
- Sahiti, Dr. Ejup “E drejta e procedurës penale”, Prishtinë, 2005;
- Sahiti, Dr Ejup “Psikologjia gjyqësore”, Prishtinë, 2007 ;
- Bajgora, Dr Ali “Disa karakteristika të kriminalitetit dhe politikës ndëshkimore në Kosovë”, Prishtinë, 2001;
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. R (99) 22 i Komisionit të ministrave të shteteve anëtare, që merren me çështjen e stërngarkimit të burgjeve dhe krekosjes së të burgosurve.
- Këshilli i Evropës, R. (99) 22, shtojca, par. 14;
- Komiteti për Parandalimin e Torturës, Raporti për Andorrën 1, paragrafi 39 (2000);
- Komiteti për parandalimin e Torturës, Raporti i 2-të i Përgjithshëm për Aktivitetet e KPT;
- Deklarata e Kajros mbi të drejtat e njeriut në Islam, dt. 05. 08. 1990
- Deklarata për të drejtat e njeriut dhe qytetarit, 26. 08. 1789, 24. 06. 1793
- Deklarata mbi mbrojtjen e të gjithë personave kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve të tjera mizore, johumane ose degraduese 09. 12. 1975 Rez. 3452 (XXX)
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës Prishtinë, dt. 15. 06. 2008
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

- Këshilli i Evropës, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës (KPT), Normat e KPT-së, Pjesët kryesore të raporteve të përgjithshme të KPT-së, CPT/Inf/E (2002) 1-Rev. 2004)
- Konventa kundër torturës dhe dënimeve a trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese, Rez. 39/46, 10.12.1984
- Konventa evropiane për parandalimin e torturës, trajtimit dhe dënimit johuman ose degradues, 26. 11. 1987, Strasburg
- Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijëve
- Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale i Republikës së Kosovës
- Kodi i Drejtësisë per te mitur i Republikës së Kosovës
- Gjendja në Burgjet e Kosovës, Raport i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, Prishtinë;
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Kushtet në qendrat e paraburgimit në Kosovë, Vlerësim i parë, Dhjetor 2010.
- Qendra ndërkombëtare për reformat në të drejtën civile dhe politika e drejtësisë penale, Politika ndërkombëtare e zhvillimit të instrumenteve të burgimit, Prishtinë, 2001
- Raporti vjetor i punës së sistemit shëndetësor të burgjeve të Kosovës për vitin 2008
- Raporti i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut mbi monitorimin e qendrave të paraburgimit dhe korrektuese Prishtinë, dt. 01. 08. 2009-31. 01. 2010
- Jeremy Bentham, Anarchichical Follies, quotes in N. Kinsella, "Tomorroë's Rights in the Mirror of History", in G. Gall, ed, Civil Liberties in Canada, Toronto: Butterëorths, 1982), p. 17.);
- John Rawls, Tëo concepts of the rights. Revision of document for Filosofic Club of Harvard Vol. 64, 30. 05. 1954;
- Lawrence M.Hinmen, Lectures for the purpose of punishment 13. 03. 2001, University of California, San Die

Mimoza Syla*

BASHKËKYERJA SI FORMË E BASHKËPUNIMIT NË KRYERJEN E VEPRËS PENALE

Abstrakt

Ekzistojnë dilema të mëdha që shfaqen në praktikën gjyqësore lidhur me problematikën se a kemi të bëjmë me bashkëkryerje apo ndonjë formë tjetër të bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale. Zbërthimi i saj paraqet një sfidë të madhe profesionale si teorike, edhe më shumë praktike. Pjesëmarrja e disa personave në kryerjen e veprës penale e bënë një vepër penale më të rrezikshme, për faktin se grumbullohet një sasi më e lartë e vullnetit dhe energjisë kriminale, andaj çdo vepër e kryer në këto rrethana kërkon një trajtim të veçantë.

Përcaktimi i saktë i kontributit të secilit bashkëkryes në kryerjen e veprës penale është esencial për matjen e drejtë të dënimit, rrjedhimisht është e domosdoshme që veprimet inkriminuese të bashkëkryesve të përshkruhen në mënyrë specifike dhe konkrete, si në aktakuzë ashtu edhe në aktgjykim, dhe të evitohet praktika e përshkrimit abstrakt të veprimeve inkriminuese, ngase kjo vështirëson diferencimin e rolit të secilit bashkëkryerës. Veprimet konkrete të secilit bashkëkryerës, duhet vlerësuar në relacion me vullnetin e përbashkët kriminal dhe kontributin e secilit. Nëse vepra do të ishte kryer pa kontributin e bashkëkryerësit apo nuk do të mund të kryhet në mënyrën siç është kryer, dhe atëherë të nxjerret përfundimi nëse veprimet e tilla konsiderohen bashkëkryerje apo jo.

Fjalët kyqe: bashkëkryerja, bashkëpunimi, vepra penale, praktika gjyqësore

* Prokurore në Prokurorinë Themelore në Ferizaj

Hyrje

Bashkëkryerja si njëra nga format më të rënda të bashkëpunimit, paraqet një veprimtari mjaft komplekse, jo vetëm në teorinë penale, por edhe në tërë praktikën gjyqësore.

Ekzistimi i disa teorive doktrinare lidhur me bashkëkryerjen përshkruhet nga teoritë subjektive, objektive dhe të përziera. Komplexiteti i tyre ka bërë që legjislacionet penale dhe praktikat gjyqësore të jenë më afër njërës apo tjetrës teori dhe si rezultat i saj shpesh, veprimet e njëjta disa herë janë konsideruar si bashkëkryerje, ndësa ndonjëherë vetëm ndihmë apo formë tjetër e bashkëpunimit.

Gjithashtu vlerësojmë se pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal në Kosovë janë ashpërsuar kriteret për t'u konsideruar veprimet e akterëve të krimit si bashkëkryerje. Në bazë të dispozitës së nenit 31 të KPK-së parashihet se “*nëse dy apo më shumë persona marrin pjesë në kryerjen e veprës penale apo në ndonjë mënyrë tjetër i kontribuojnë thelbësisht kryerjes së veprës penale*”. Përkufizimi na paraqitet si një qasje më restriktive, veçanërisht pjesa e dytë e kësaj kësaj dispozite, që i referohet fjalisë “*kontributit thelbësor në kryerjen e veprës penale*”, fjali e cila në legjislacionin e kaluar ka qenë e formuluar si “*në ndonjë mënyrë tjetër*” dhe ajo paraqet një kuptim më ekstensiv dhe një diskrecion më të gjerë për gjykatën, që varësisht nga rrethanat e rastit konkret t'i konsiderojë si veprime të bashkëkryerjes.

1. Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale me theks të veçantë në bashkëkryerjen

1.1 Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale

Në të drejtën penale me termin bashkëpunim kuptojmë pjesëmarrjen e dy apo më shumë personave në kryerjen e veprës penale, kurse me bashkëpunëtorë kuptojmë personin ose personat të cilët, me veprimet ose me mosveprimet e tyre, kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale.¹ Legjislacioni penal,

¹ SALIHU Ismet, “E drejta Penale”, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2008, faqe 372.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

praktika gjyqësore dhe doktrina i kushtojnë rëndësi të madhe bashkëpunimit, ngase kur vepra penale kryhet me pjesëmarrjen e shumë personave, kumulohet energji më e lartë kriminale dhe pikërisht në situatat e bashkëpunimit kryhen veprat më të rënda penale, që paraqesin rrezikshmëri më të theksuar për shoqërinë. Zakonisht, në bashkëpunim kryhen format e krimit të organizuar, trafikimi me qenie njerëzore, me drogë, armë etj .

Pjesëmarrja e dy apo më shumë personave në kryerjen e veprës penale shtron para të drejtës penale një varg pyetjesh, që duhet zgjidhur, përkritazi me rolin e kontributin e secilit pjesëmarrës në kryerjen e veprës si dhe përcaktimin e përgjegjësisë penale për secilin prej tyre.² Për t'u konsideruar se ekziston bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale, midis pjesëmarrësve duhet të ekzistojë lidhja e caktuar subjektive dhe objektive. Lidhja objektive ekziston ngase secili bashkëpunëtorë duhet të ndërmarrë ndonjë veprim me të cilën i kontribuon kryerjes së veprës penale. Të gjitha veprimet të cilat i ndërmarrin bashkëpunëtorët duhet të jenë të lidhura midis tyre dhe të drejtuara që të arrihet rezultati i njëjtë gjegjësisht të shkaktohet pasoja e caktuar. Pasoja e shkaktuar duhet të jetë rezultat i përbashkët i veprimeve të gjithë bashkëpunëtorëve.³

Lidhja subjektive, qëndron në faktin se të gjithë bashkëpunëtorët duhet të jenë të vetëdijshëm se në kryerjen e veprës penale të caktuar, marrin pjesë edhe persona të tjerë. Bashkëpunëtorët dinë për njëri tjetrin, por kjo nuk do të thotë që ata domosdoshmërisht duhen të njihen mes vete, mjafton dijenia se në kryerjen e veprës marrin pjesë edhe persona të tjerë të caktuar ose nga rrethi i caktuar.⁴

Kodi ynë Penal njihet katër forma të bashkëpunimit: bashkëkryerjen, shtytjen, ndihmën dhe bashkimin kriminal. Ndërsa, personat që veprojnë në këto forma quhen bashkëkryerës, shtytës, ndihmës dhe organizatorë ose anëtarë të organizatës kriminale.

² Salihu, Ismet and Zhitija, Hilmi and Hasani, Fejzullah (2014) *Komentari Kodit Penal të Republikës së Kosovës*. GIZ, Prishtinë, faqe 144

³ Salihu, Ismet and Zhitija, Hilmi and Hasani, Fejzullah (2014) *Komentari Kodit Penal të Republikës së Kosovës*. GIZ, Prishtinë, faqe 373.

⁴ Po aty, faqe 373

Këto katër forma, në shkencën penale, mund të ndahen në bashkëpunim në kuptimin e gjerë dhe bashkëpunim në kuptim të ngushtë.

Në bashkëpunim në kuptim të gjerë, bëjnë pjesë të gjitha format si bashkëkryerja, shtytja, ndihma, bashkimi kriminal, ndërsa në bashkëpunimin në kuptimin e ngushtë bëjnë pjesë shtytja, ndihma dhe bashkimi kriminal.

Në këtë punim trajtohen aspekte teorike të bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale. Në këtë kuadër rëndësi të veçantë i kam kushtuar bashkëkryerjes, si formë e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale, në të cilën gjithashtu shpjegohen teoritë subjektive, objektive dhe ato të përziera.

Gjithashtu trajtohen aspekte të rregullativës ligjore të bashkëkryerjes sipas Kodeve Penale të disa shteteve të rajonit dhe atë të Shqipërisë dhe Kroacisë, në fund do trajtohet bashkëkryerja në praktikën gjyqësorë të Gjykatës Komunale në Ferizaj në periudhën kohore 2005 – 2010. Në këtë kapitull jepet edhe pasqyra statistikore mbi llojin e veprave penale, bëhet analizimi i disa vendimeve gjyqësore për disa nga veprimet inkriminuese që kjo Gjykatë i ka konsideruar se përbëjnë veprim të bashkëkryerjes.

Përfundimi i punimit, përmban konstatimet kryesore mbi bashkëkryerjen si institut i drejtës penale dhe si formë e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale, si dhe faktin se gjatë periudhës pesë vjeçare në praktikën e Gjykatës Komunale në Ferizaj, cilat veprime më tipike janë trajtuar si bashkëkryerje.

2. Përgjegjësia dhe ndëshkimi i bashkëkryesit

Secili bashkëkryes ndëshkohet me dënimin e paraparë për veprën penale të kryer. Në këtë rast, bashkëkryesi përgjigjet penalisht brenda kufijve të dashjes apo pakujdesisë. Bashkëkryesit në kryerjen e veprës penale mund të veprojnë në forma të ndryshme faji. Është e mundur që njëri të veprojë me dashje direkte, kurse tjetri me dashje eventuale. Gjithashtu, është e mundur që njëri bashkëkryes të veprojë me dashje direkte ndërsa tjetri nga pakujdesia. Përgjegjësia penale dhe dënimi, përcaktohet veçmas për secilin bashkëkryes varësisht prej formës së fajit me të cilën ka kryer veprën dhe varësisht sa dhe si kanë kontribuar në kryerjen e veprës penale, pra edhe këtu zbatohet parimi i përgjegjësisë individuale.

Ky parim bënë të mundur që marrëdhëniet personale apo rrethanat personale të mund të merren si rrethana lehtësuese ose rënduese. Por, ka raste të rrethanave të cilat për shkak të tyre Kodi Penal, parasheh përjashtimin e përgjegjësisë penale ose lejon lirimin nga dënimi vetëm të atij bashkëkryesi, te i cili janë të pranishme ato rrethana. Për këto arsye është e mundur që në një veprë penale kualifikimi juridik i veprës penale për pjesëmarrësit të jetë i ndryshëm.

Parimi se çdo bashkëkryes përgjigjet brenda kufijve të dashjes së tij, nënkupton se bashkëkryesi nuk përgjigjet për ekscesin e bashkëkryesit tjetër. Se a ka ekzistuar ekscesi i bashkëkryesit, vendimtare është marrëveshja që është arritur midis tyre përkitazi me kryerjen e veprës penale dhe se bashkëkryerja shtrihet në masën e nevojshme për realizimin e vendimit të përbashkët. Përndryshe, po qe se gjatë realizimit të vendimit të përbashkët të bashkëkryesëve shkaktohet ekscesi kualitativ, që nënkupton kryerjen e një veprë penale, që në thelb dallohet prej marrëveshjes që është arritur, bashkëkryesi nuk përgjigjet penalisht.

3. Teoria e ndarjes së punës (rolit)

Sipas kësaj teorie bashkëkryes konsiderohet ai i cili së bashku me tjetrin në bazë të marrëveshjes mbi ndarjen e punës realizon pjesën e vetë në procesin e kryerjes së veprës penale, me ç'rast veprën e dëshiron si të veten dhe si të përbashkët. Sipas kësaj teorie cilido veprim i pjesëmarrësit e bënë atë bashkëkryes, po qe se veprën e ka ndërmarrë në suaza të marrëveshjes paraprake që është arritur lidhur me kryerjen e veprës penale dhe po qe se ai pjesëmarrës edhe e ka dëshiruar kryerjen e e asaj veprë penale.

Nga bashkëkryerja e domosdoshme duhet dalluar bashkëkryerjen fiktive, e cila ekziston në rastet kur dy apo më shumë persona së bashku realizojnë pasojën e veprës penale, por që në atë rast nuk kanë vepruar me vetëdije dhe as që kanë dëshiruar apo pranuar pasojën që është shkaktuar si psh : për shkak të fajit të dy vozitësve shkaktohet aksidenti në komunikacion, me ç'rast personi i tretë humbë jetën apo pëson lëndime të rënda trupore.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Veprat e tilla penale, në të cilat është e domosdoshme bashkëkryerja për shkak të veçorive të tyre ndahen në dy grupe : në vepra penale konvergjente dhe divergjente.

Kështu, në një rast, nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme e ka konsideruar si bashkëkryes kur të dëmtuarin e ka ftuar në shëtitje derisa personi tjetër ka kryer veprën penale të vjedhjes në banesën e të dëmtuarit.

Kjo teori, megjithatë nuk shërbehet me kritere të qarta përmes së cilave do të bëhet dallimi i qartë mes bashkëkryesit dhe bashkëpunëtorëve tjerë nuk e përcakton nocionin e bashkëkryesit, ndërsa si kriter vendimtar për t'u trajtuar si bashkëkryes merret marrëveshja paraprake dhe ndarja e rolit në procesin e kryerjes së veprës penale. Mirëpo çështja e marrëveshjes dhe ndarja e punës, nuk është e natyrës dhe kualitetit të tillë e cila mundë të shërbejë si moment vendimtar për përcaktimin e nocionit të bashkëkryesit dhe si kriter për dallimin e tij nga format e tjera të bashkëpunimit.

Teoria e lartpërmendur nuk e merr parasysh në masë të duhur rëndësinë e veprimit të kryerjes dhe kontributin real të individit në realizimin e veprës penale, ngase është e qartë se objektivisht nuk duhet të trajtohet njëjtë personi që bënë roje dhe personi që kryen veprën penale të vjedhjes apo të vrasjes.⁵

4. Kryesi indirekt

Në teorinë e së drejtës penale me kryerës indirekt, nënkuptohen rastet kur një person e shfrytëzon tjetrin si mjet për ta realizuar qëllimin e vet kriminal, për të kryer veprën penale. Këto janë rastet kur një person keqpërdorë papërgjegjësinë, mosdijen, lajthitjen e personit tjetër dhe kështu me ndihmën e tij kryen veprën penale. Psh: mjeku i cili dëshiron ta mbysë të sëmurin që është i shtrirë në spital i cakton dozë të fortë helmi, të cilën i'a jep infermierja.

Në këtë rast kryes i veprës penale të vrasjes me dashje është mjeku, kurse infermierja eventualisht mund të konsiderohet si kryese e vrasjes nga pakujdesia. Siç shihet, kryesi i drejtpërdrejtë është vetëm mjet apo vegël në duart e tjetrit dhe zakonisht nuk konsiderohet kryes i veprës penale dhe si i

⁵ Po aty, faqe, 378

tillë për shkak të pavetëdijes, sëmundjes psikike apo dhunës së ushtruar ndaj tij, nuk konsiderohet penalisht i përgjegjshëm.

Legjislacioni ynë penal nuk e njeh në mënyrë eksplicite kryesin indirekt, mirëpo, për shkaqe praktike që imponon jeta reale, këtë institut e njeh praktika gjyqësore, që bëhet e mundur të konsiderohet penalisht përgjegjës dhe dënohet kryesi i veprës penale.

5. Natyra juridike e bashkëpunimit

Lidhur me natyrën juridike të bashkëpunimit në shkencën e së drejtës penale janë dhënë mendime të ndryshme, të cilat mund të ndahen në dy grupe.

Në grupin e parë bëjnë pjesë:

- a) teoria aksesore apo e varur e bashkëpunimit,
- b) teoria e pavarur apo principale e bashkëpunimit.⁶

Teoria aksesore apo e varur e bashkëpunimit njihet edhe si teoria monistike dhe bazohet në konceptin se baza e përgjegjësisë penale e të gjithë bashkëpunëtorëve, që marrin pjesë në kryerjen e veprës penale, gjendet në veprën penale të kryerësit, me ç'rast bashkëpunëtorët e kanë shtytur, ndihmuar dhe e kanë këshilluar që kryerësi të kryej veprën penale.

Sipas kësaj teorie çdo vepre penale ku marrin pjesë shumë bashkëpunëtorë, ekziston veprimi kryesor dhe veprimi ndihmës apo sekondar, të cilat ndryshe quhen veprime të varura apo aksesore, në raport me veprimin kryesor. Me veprimin kryesor apo principal kryhet vepra penale, kurse në veprimet ndihmese apo aksesore, të varura, nuk kryhet vepra, por vetëm ndihmohet kryerja e saj.

Nga kjo rezulton se personi që merrë veprimin e kryerjes se veprës penale është subjekt, kryerës i veprës penale, ndërsa personat e tjerë që ndërmarrin

⁶ SALIHU, Ismet, E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë, faqe 384

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

veprime ndihmëse apo aksesore nuk janë kryerës të veprës penale, ata janë vetëm bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale.

Në aspektin e kauzalitetit, vetëm veprimi kryesor është shkaktar i pasojës së veprës penale, kurse veprimet e bashkëpunëtorëve konsiderohen vetëm si veprime aksesore dhe si të tilla nuk paraqiten si shkaktarë të pasojës së veprës penale, por ato shfaqen vetëm si kusht i pasojës së shkaktuar.

Bazuar në këtë teori, veprimet e bashkëpunëtorëve për shkak të natyrës së tyre, janë të varura nga veprimet e kryesit, ato ndëshkohen vetëm po që se ndëshkohen veprimet e kryerësit. Me fjalë të tjera, bashkëpunëtorët përgjigjen penalisht vetëm atëherë kur kryesi i veprës penale me veprimet e tij e ka realizuar veprën penale. Mirëpo aksesoriteti i bashkëpunimit, nuk do të thotë se përgjegjësia dhe ndëshkimi i bashkëpunëtorëve varen nga fakti se a është dënuar kryerësi për veprën e vetë penale. Në rastet kur shtytësi apo ndihmësi e shtytin apo i ndihmojnë personit të papërgjeshëm apo fëmijës që të kryej vepër penale të vrasjes, psh: për këtë vepër dënohen këta bashkëpunëtorë e jo kryerësi.

Teoria aksesore apo e varur e bashkëpunimit njihet edhe si teoria monistike dhe bazohet në konceptin se baza e përgjegjësisë penale e të gjithë bashkëpunëtorëve, që marrin pjesë në kryerjen e veprës penale, gjendet në veprën penale të kryerësit, me ç'rast bashkëpunëtorët e kanë shtytur, ndihmuar dhe e kanë këshilluar që kryerësi të kryej veprën penale.

Sipas kësaj teorie çdo vepër penale ku marrin pjesë shumë bashkëpunëtorë, ekziston veprimi kryesor dhe veprimi ndihmës apo sekondar, të cilat ndryshe quhen veprime të varura apo aksesore, në raport me veprimin kryesor. Me veprimin kryesor apo principal kryhet vepra penale, kurse në veprimet ndihmëse apo aksesore, të varura, nuk kryhet vepra, por vetëm ndihmohet kryerja e saj.

Nga kjo rezulton se personi që merrë veprimin e kryerjes së veprës penale është subjekt, kryerës i veprës penale, ndërsa personat e tjerë që ndërmarrin veprime ndihmëse apo aksesore nuk janë kryerës të veprës penale, ata janë vetëm bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Në aspektin e kauzalitetit, vetëm veprimi kryesor është shkaktar i pasojës së veprës penale, kurse veprimet e bashkëpunëtorëve konsiderohen vetëm si veprime aksesore dhe si të tilla nuk paraqiten si shkaktarë të pasojës së veprës penale, por ato shfaqen vetëm si kusht i pasojës së shkaktuar.

Bazuar në këtë teori, veprimet e bashkëpunëtorëve për shkak të natyrës së tyre, janë të varura nga veprimet e kryesit, ato ndëshkohen vetëm po që se ndëshkohen veprimet e kryerësit. Me fjalë të tjera, bashkëpunëtorët përgjigjen penalisht vetëm atëherë kur kryesi i veprës penale me veprimet e tij e ka realizuar veprën penale. Mirëpo aksesoriteti i bashkëpunimit, nuk do të thotë se përgjegjësia dhe ndëshkimi i bashkëpunëtorëve varen nga fakti se a është dënuar kryerësi për veprën e vetë penale. Në rastet kur shtytësi apo ndihmësi e shtytin apo i ndihmojnë personit të papërgjeshëm apo fëmijës që të kryej vepër penale të vrasjes, psh: për këtë vepër dënohen këta bashkëpunëtorë e jo kryerësi.

Kjo teori është shfaqur në Gjermani në gjysmën e dytë të shekullit XIX me që varshmëria apo aksesoriteti midis bashkëpunëtorëve dhe kryerësit mund të manifestohen në masë të ndryshme. Në doktrinën gjermane njihen disa variante të kësaj teorie dhe më të njohura janë teoria aksesore minimale, teoria aksesore e limituar apo e kufizuar dhe teoria aksesore ekstreme.

Sipas teorisë aksesore minimale, për të ekzistuar përgjegjësia penale e bashkëpunëtorëve është e domosdoshme që kryerësi të ketë ndërmarrë veprimin e kryerjes së veprës penale, pa marrë parasysh se a është veprim i kundërligjshëm apo jo.

E drejta jonë penale dhe legjislacioni ynë penal nuk e përvetëson këtë teori, ngase sipas saj mund të konsiderohen si bashkëpunëtorë dhe të ndëshkohet ndihma apo shtytja e personit, i cili ndërmer veprim në kushtet e mbrojtjes së nevojshme.

Teoria aksesore e limituar, përgjegjësia penale e bashkëpunëtorëve varet nga fakti se kryesi i veprës a e ka kryer veprimin i cili është i kundërligjshëm, që parashikohet si vepër penale dhe për të cilin është paraparë dënimi. Me fjalë të tjera, sipas kësaj teorie bashkëpunëtorë konsiderohet vetëm ai person që ndihmon apo e shtytë tjetrin që të kryej vepër penale. Kjo teori është përvetësuar në shumicën e kodeve penale të botës.

Teoria aksesore ekstreme, përgjegjësia dhe ndëshkimi i bashkëpunëtorit varet prej përgjegjësisë dhe ndëshkimit të kryesit të veprës, kjo do të thotë se që të mund të konsiderohet penalisht përgjegjës dhe që të mund të dënohet bashkëpunëtori, duhet që të jetë penalisht përgjegjës dhe të dënohet edhe kryerësi. Kjo teori ka qenë e përvetësuar në Kodin penal të Gjermanisë, të vitit 1871. Sipas këtij Kodi, bashkëpunëtori nuk është konsideruar penalisht përgjegjës dhe nuk është dënuar nëse nuk ka qenë penalisht i përgjegjshëm dhe nuk është dënuar edhe vetë kryerësi i veprës penale.

Përvetësimi i teorisë ekstreme ka kushtëzuar që në të drejtën penale gjermane, të inkorporohet nocioni i kryerësit indirekt të veprës penale. Kjo ka qenë e domosdoshme, që të evitohet mundësia që bashkëpunëtorët me qëllim të kryerjes se veprës penale të shërbehen me persona penalisht të papërgjegjshëm dhe në këtë mënyrë ti shmangen përgjegjësisë penale.

Teoria e e pavarur apo principale e bashkëpunimit, e cila quhet edhe teori plurale, nisët nga koncepti se të gjitha veprimet e bashkëpunorëve si dhe të kryesit konsiderohen si shkak i pasojës së veprës penale. Sipas kësaj teorie çdo bashkëpunorë i veprës përkatëse penale përgjigjet për veprimet e tij sikur në rastet kur vetë e kryen veprën penale. Me fjalë të tjera sipas teorisë principale në rastet e bashkëpunimit konsiderohet se janë kryer aq vepra penale sa veta edhe kanë marrë pjesë në kryerjen e saj. Sipas kësaj teorie ekziston vepra penale e kryesit për të cilën përgjigjet kryesi, vepra penale e shtytësit, për të cilën përgjigjet shtytësi, vepra penale e ndihmësit për të cilën përgjigjet ndihmësi dhe vepra penale e bashkimit kriminal për të cilën përgjigjet organizatori, themeluesi.

6. Aspekti ligjor i bashkëkryerjes sipas kodeve penale të disa shteteve të rajonit

6.1 Bashkëkryerja sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë

Në Legjislacion penal në Shqipëri llojet e bashkëpunorëve në veprën penale dhe përgjegjësia penale e tyre për herë të parë janë parashikuar në Kodin Penal të vitit 1928.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Neni 25 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë përcakton se bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje mes tyre. Ndërsa neni 26 par. 1 përcakton se bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale janë : organizatori, ekzekutori, shtytësit dhe ndihmësit.

Ndërsa ekzekutorët i përcakton dispozita e paragrafit të tretë të nenit 21 të Kodit Penal Shqiptar *“Ekzekutorët janë personat që kryejnë veprime të drejtpërdrejta për realizimin e veprës penale”*.

Nga kjo mundë të kuptohet se në mënyrë që një person të cilësohet si ekzekutor në kryerjen e veprës penale, duhet që ai të merr pjesë direkt në kryerjen e veprës penale dhe veprimet e tij duhet të sjellin pasojën kriminale, që do të thotë të ketë lidhje shkakësore të drejtpërdrejtë midis veprimeve të tij si ekzekutor dhe pasojës kriminale të ardhur, në raste kur vepra penale kërkon ardhjen e pasojës.

Siç shihet dispozita e Kodit Penal Shqiptar nuk e trajtojnë bashkëkryerjen apo bashkekzekutimin siç quhet në terminologjinë juridike në Shqipëri.⁷

Megjithatë, në shkencën e të drejtës penale dhe praktikën gjyqësore, duke u nisur nga nevojat e reale edhe të përditshmërisë, është pranuar se si ekzekutor në kryerjen e veprës penale, në bashkëpunim, mund të jetë një person ose edhe disa persona. Në rastet kur vepra penale ka dy ose më tepër ekzekutorë dhe nuk ka bashkëpunëtorë të tjerë, të cilët do të mund luajnë rolin e shtytësit, ndihmësit apo organizatorit dhe rrjedhimisht në të drejtën penale dhe në praktikën gjyqësore është pranuar se ndodhemi para një forme të veçantë të bashkëpunimit, që është ajo e bashkekzekutimit të veprës penale. Në të drejtën penale shqiptare bashkekzekutimi në kryerjen e veprës penale është në rastet kur vepra penale kryhet nga dy ose më shumë persona dhe të cilët të gjithë kanë rolin e ekzekutorit.

Karakteristikë tek bashkekzekutimi në veprën penale është se kemi vetëm një lloj bashkëpunëtori, që është vetë ekzekutorit dhe mungon ndarja e roleve në ekzekutor, shtytës, ndihmës dhe organizatorë, sepse ata nuk ekzistojnë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se në rastet kur ndodhemi para kësaj forme të

⁷ Muqi, Shefqet, E drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Tiranë, 2007

LUARASI, Aleksandër, Kodi Penal me Praktikë Gjyqësore, 2005, Tiranë, faqe, 42

Neni 26 par.1 i Kodit Penal të Shqipërisë i vitit 1995

bashkëpunimit, të mos kemi ndarje të roleve midis bashkëpunitorëve. Kjo ndarje e roleve ekziston, por është një ndarje fizike e roleve, duke përcaktuar karakterin konkret të veprimit, të çdo bashkëpunëtori dhe është veprim që lidhet direkt me kryerjen e veprës penale dhe jo ndarje juridike të roleve, e njohur nga ligji dhe e drejta penale.

Koncepti i bashkëpunimit të veprës penale, më shumë se nga ligji apo shkenca e së drejtës penale është dhënë nga praktika gjyqësore, e cila duke e shqyrtuar problematikën ligjore të çështjeve konkrete është detyruar ta trajtoj edhe mungesën në Kodin Penal. Kështu Gjykata e Lartë e Shqipërisë, në vendimin e saj unifikues nr. 1. i datës 26. 03. 2002 (i cili është i vetmi vendim unifikues që trajton çështjen e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale) ndër të tjera thekson : *“Marrëveshja mund të vendoset edhe midis vet ekzekutorëve të veprës penale, (në raste kur ata janë dy ose më tepër persona) dhe në këtë rast do të ndodhemi para bashkëpunimit për të kryer veprën penale në formën e bashkëpunimit të saj”*. Për të patur këtë formë bashkëpunimi, kërkohet që secili nga personat që marrin pjesë në realizimin e veprës penale ose, thënë ndryshe, secili nga bashkëpunitorët, të kryejnë veprime që të kenë lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore me pasojën e dëshiruar nga të gjithë të tjerët dhe që vjen si rezultat i këtyre veprimeve të kryera nga secili bashkëpunëtorë, domethënë, secili nga bashkëpunitorët me veprimin apo mosveprimet e tij, të marrë pjesë direkt në realizimin e anës objektive të veprës penale. Në të njëjtën kohë, kërkohet që veprimet e secilit prej bashkëpunitorëve të jenë rezultat i realizimit të dëshirave jo individuale të tij, por të jenë rezultat i realizimit të vullnetit të përbashkët të të gjithë bashkëpunitorëve të një veprimtarie të caktuar kriminale.⁸

Kur vepra penale kryhet në bashkëpunim në formën e bashkëpunimit, midis bashkëpunitorëve nuk ka më ndarje rolesh, në kuptimin klasik të kësaj fjale (ndarje në rolet organizator, ekzekutor, shtytës dhe ndihmës), por ka një lloj ndarje tjetër, e cila ka të bëjë me ndarjen e punëve direkt që duhet të kryej secili nga bashkëpunitorët për realizimin e vullnetit të përbashkët kriminal, vullnet ky që, në fund të fundit manifestohet në botën e jashtme, veç

⁸ HAZNEZIRI, Luan, Bashkëpunimi, Grupi i Strukturuar Kriminal dhe Organizata Kriminale Sipas Legjislacionit Shqiptar, Tiranë, 2008, faqe 58.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

veprimeve të secilit edhe me arritjen e rezultatit të përbashkët kriminal të dëshiruar prej tyre...”.⁹

Nga kuptimi që jep teoria e të drejtës penale dhe praktika gjyqësore konceptit të bashkëekzekutimit të veprës penale, kjo mënyrë e shfaqjes së bashkëpunimit ka këto karakteristika kryesore:

Së pari: Duhet të ekzistojnë se paku dy ose me shumë persona të cilët veprojnë vetëm në cilësinë e ekzekutorit, pra kryejnë veprime të drejtpërdrejta për realizimin e veprës penale;

Së dyti: Veprimet ose mosveprimet e secilit bashkekzekutor kanë lidhje shkakësore direkt me pasojën e veprës penale, e cila dëshirohet nga të gjithë bashkekzekutorët, të cilët kryejnë veprime konkrete për arritjen e kësaj pasaje;

Së treti : Secili nga bashkekzekutorët, me veprimet apo mosveprimet e tij, merr pjesë direkt në realizimin e anës objektive të veprës penale;

Së katërti : Veprimet e secilit bashkëekzekutor karakterizohen nga uniteti organik midis tyre, domethënë janë rezultat jo i realizimit të dëshirave individuale të tyre, por janë rezultat i realizimit të vullnetit të përbashkët të të gjithë bashkëpunëtorëve në kryerjen e veprës penale.

Së pesti: Në këtë formë të bashkëpunimit nuk ka ndarje të roleve në formë klasike, pra ndarje të roleve midis ekzekutorit dhe shtytësit, ndihmësit apo organizatorit, sepse këto të fundit nuk ekzistojnë, por ka një ndarje fizike të roleve ose më mirë një ndarje konkrete të veprimeve që synojnë të gjithë realizimin direkt të veprës penale, ndarje e cila tek e fundit bëhet me qëllim realizimin e vullnetit të përbashkët të të gjithë bashkëekzekutorëve për realizimin e asaj vepre penale që ata dëshirojnë.¹⁰

⁹ Vendim Unifikues Penal Nr.1, datë 12. 03. 2002 Gjykata e Lartë Republikës së Shqipërisë

¹⁰ HAZNEZIRI, Luan, Bashkëpunimi, Grupi i Strutuaruar Kriminal dhe Organizata Kriminale Sipas Legjislacionit Shqiptar, Tiranë, 2008, faqe 58.

6.2 Bashkëkryerja sipas Kodit Penal të Republikës së Kroacisë

Bashkëkryerja, sipas Kodit Penal të Republikës së Kroacisë, është e paraparë në dispozitën e nenit 35. par. 3 e cila përcakton se : *“Bashkëkryerës të veprës penale janë dy ose më tepër persona, të cilët në bazë të vendimit të tyre të përbashkët kryejnë veprën penale ashtu që çdo njëri prej tyre merr pjesë në kryerje ose në ndonjë mënyrë tjetër thelbësisht i kontribuon kryerjes së veprës penale”*.

Për dallim nga kodi penal i mëparshëm, pjesëmarrja në kryerjen e veprës penale në mënyrë tjetër i cili nuk është veprimi i kryerjes, kodi i ri kërkon që të jetë fjala për veprimin që paraqet kontribut thelbësor në kryerjen e veprës penale.

Formulimi në këtë mënyrë i bashkëkryerjes vështuar në aspektin teorik i heq teorit subjektive dhe objektive, ngase asnjë elementë në këtë formulim nuk udhëzon në dominimin elementit të vullnetit për paraqitjen e bashkëkryerjes. Por gjithashtu edhe teoria e objektive e shprehur në të ashtuquajturën teoria e ndarjes së roleve e cila ka qenë e pranuar nga praktika me aprovimin e Kodit të Ri Penal është deplasuar.

Nga aspekti teorik vështuar në formulimin e dispozitës është teoria e dominimit mbi veprën e cila është legalizuar në dispozitën e nenit 35. par. 4 të Kodit Penal të Kroacisë.

Dobësitë e teorive formale - objektive është se kufizon bashkëkryerjen vetëm në personat të cilët janë bartës të veprimeve që janë elementë të veprës penale, me ç'rast vjen deri tek papajtueshmëria me realitetin jetësor që paraqitet në situatat jetësore që i përkasin fenomenit të kryerjes së përbashkët të veprës penale, ngase nuk është në gjendje që si bashkëkryerje ti përfshijë edhe disa forma të rrezikshme të kryerjes së përbashkët të veprës penale.¹¹

Në anën tjetër teoritë subjektive, e zgjerojnë shumë peshën dhe kualitetin ose intensitetin e vullnetit kriminal, duke e nënvlerësuar kontributin objektiv,

¹¹ BACIC, Franjo & PAVLOVIC, Sime, Komentar Kaznenog Zakona, Zagreb, 2004, faqe 151.

Garacic, Ana, Sudioništvo po novom Kaznenom zakonu i sudskoj praksi, Aktualna pitanja novog kaznenog zakonodavstva, Inženjerski biro, Zagreb, 1999.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

andaj bashkëkryerës mund të jenë edhe personat të cilët kanë vepruar në përgatitjen e veprës, planifikimin dhe para marrjes së vendimit për kryerjen.

Bashkëkryerja, paraqet kryerje të planifikuar të veprës penale në bazë të marrëveshjes paraprake nga së paku dy persona të cilët kanë statusin e kryerësit. Kjo i përgjigjet edhe formulimit ligjor të përcaktuar në dispozitën e nenit 35. par. 3. Kryerja e përbashkët mund të paraqitet në dy forma në të cilët udhëzon dispozita: bashkëveprimi i dy apo më shumë personave në veprimin e kryerjes ose bashkëkryerja në kuptimin e ngushtë ose bashkëveprojnë, duke ndërmarrë ndonjë veprim i cili është jashtë figurës së veprës penale, e cila nuk hynë në veprimin e kryerjes së veprës, por paraqet kontribut thelbësor në kryerjen e veprës penale – apo bashkëkryerja në kuptimin e gjerë.

Bashkëkryerja është formë e kryerjes së veprës. Kontributi i secilit ka për qëllim realizimin e planit dhe është i një rëndësie thelbësore dhe i rëndësishëm në realizimin e planit të projektuar të kryerjes së veprës (i ashtuquajtur i pushteti funksional mbi veprën).

Baza është vendimi i përbashkët dhe kryerja e përbashkët, e cila përfshinë planin e realizimit të veprës, ndarjen e roleve dhe modalitetet e vetë kryerjes së veprës. Ky vendim i përbashkët është pika kohezive e bashkëkryerjes. Vendimi ndërlihdhë bashkëpunëtorët, vullnetet e tyre, dhe veprimet e tyre i përkasin një tërësie. Kontributi i njërit e plotëson kontributin e tjetrit, japin llogari tjetrit dhe të gjithë përgjigjen për realizimin e tërësishëm.

Kryerja e përbashkët e veprës penale e cila përfshinë bashkëkryerjen, e përcaktojnë dy komponentë të detyrueshme: njëra subjektive dhe tjetra objektive.¹²

Komponenta subjektive: paraqet vullnetin kolektiv të kryerjes - vendimin që së bashku, si kryerës, të kryejnë veprën penale. Çdo njëri së bashku më të tjerët është bartës i vendimit mbi veprën dhe kryerjen e përbashkët të saj. Të gjithë janë të ndërlidhur me njëri tjetrin, me vendimin e përbashkët, i cili natyrisht paraqet kryerjen e përbashkët të veprës dhe ndarjen e roleve për këtë kryerje.

¹² BACIC, Franjo & PAVLOVIC, Sime, Komentar Kaznenog Zakona, Zagreb, 2004, faqe 159

Po aty

Po aty

Fjala është për planin e përbashkët të kryerjes së veprës, mbi vetëdijen dhe vullnetin për kryerjen e përbashkët të veprës, mbi vetëdijen dhe vullnetin kooperues, të bazuar në vendimin e përbashkët për kryerjen e veprës, kërkesa për koordinim të aktiviteteve në realizimin e veprës. E rëndësishme është këtu lidhja reciproke subjektive. Çdonjëri dëshiron që kontributin e tij ta ndërlidhë dhe ta plotësoj me kontributin e të tjerëve, deri te kryerja e veprës. Vendimi i përbashkët e ndërlidhë kontributin e secilit në një tërësi. Vetë marrëveshja mund të arrihet edhe me heshtjen e individëve, pajtimin që delë nga veprimet konkludente. Kështu, edhe në vendimin e Gjykatës Supreme të Kroacisë, për ekzistimin e bashkëkryerjes nuk është e domosdoshme marrëveshja paraprake e detajuar, e mjaftueshme është marrëveshja e heshtur, respektivisht nga sjellja e bashkëpjesëmarrësve në mënyrë të padëshimtë dhe të qartë rezultojnë vullneti i secilit që të veprojë në kryerjen e veprës së përbashkët. Nuk do të thotë që duhet edhe të njihen mes vete, me rëndësi është që jenë në dijeni që përveç tyre veprojnë edhe persona të tjerë në kryerjen e veprës.

Komponentja objektive: Kërkon që (në bazë të vendimit të përbashkët për kryerjen e veprës dhe ndarjes së roleve) veprimin e caktuar dhe të kualifikuar në kryerjen e veprës penale, përkatësisht nga kontributi i secilit i dhënë në zingjirin e procesit të kryerjes së veprës, sipas rëndësisë se sa është pjesë thelbësore në realizimin e planit për kryerjen e veprës penale. Çdo person, së bashku me personat e tjerë së bashku, realizojnë veprën penale duke e dhënë kontributin e tyre, veprimi i njërit në kuadër të planit dhe ndarjes së roleve plotësojnë veprimtarinë e tjetrit dhe i bashkojnë në një proces të përbashkët në kryerjen e veprës. Tek veprimi i kryerjes mjafton që bashkëkryesi të jetë bartës i një pjese të këtij veprimi, ndërsa tek veprat penale të përbëra të ndërmarrë ndonjëherë nga veprimet: Shembull, mund të jetë tek grabitja, kur njëri përdorë dhunë ndaj të dëmtuarit, ndërsa tjetri i'a merr të hollat (VSRH Kz. 382/92).¹³

Përveç bashkëkryesve të cilët lidhen me veprimin e kryerjes nga figura ligjore e veprës (bashkëkryerja në kuptimin e ngushtë), mundet në bashkëkryerje të përfshihet edhe veprimi jashtë figurës së veprës (bashkëkryerja në kuptimin e gjerë) nën kushtin ligjor që kontributi të jetë thelbësor në kryerjen e veprës

¹³ BACIC, Franjo & PAVLOVIC, Sime, Komentar Kaznenog Zakona, Zagreb, 2004, faqe 160.

penale. Kërkohej kualitet i veçantë i këtij kontributi. Duhet të jetë ndryshe nga ajo që ligji e cilëson si ndihmë, ashtu si është bashkëkryerja formë e kryerjes, ky kontribut duhet të jetë i kualitetit të tillë siç është kontributi i kryesit që sipas vet rëndësisë në realizimin e veprës, ashtu që për bartësin e saj mund të thuhet se drejton procesin e kryerjes së veprës, se veprën e mban në duart e tij. Duhet të përcaktohet vija ndarëse ndaj ndihmës, kontributi sipas rrethanave duhet të jetë thelbësor, nga i njëjti të varet kryerja e veprës penale që nënkupton të jetë i tillë që pa të nuk do të mund të kryhet vepra. Rëndësia e kontributit rezulton nga rrethanat e situatës. Nga praktika gjyqësore rezulton se bashkëkryerja ekziston kur një person i ka shkaktuar goditje me thike në shpinë, deri sa në të njëjtën kohë dy persona e kanë mbajtur (VS RH, indeks 2/93., 127. Bërja e rojës, gjykatat shpeshherë i kanë konsideruar si bashkëkryerje (si psh VS RH, Izbor 1994., 346), që është dilematike nëse bërja e rojës ka qenë parëndësishme nën dritën e situatës së kryerjes së veprës penale.

6.3 Bashkëkryerja si formë e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale në territorin e Gjykatës Komunale në Ferizaj për vitin 2008

Gjykata Komunale në Ferizaj në periudhën kohore 2005- 2010 kishte pranuar gjithsejtë 5736 lëndë penale, prej të cilave 588 kanë të bëjnë me veprat penale sipas aktakuzave të kryera në bashkëkryerje. Ky numër paraqet një numër relativisht të lartë, me ç'rast disa persona kanë marrë pjesë në kryerjen e veprave penale në mënyrë të drejtpërdrejtë apo duke i kontribuar në mënyrë thelbësore kryerjes së veprës. Nga analiza e veprave të kryera në këtë formë konstatohet se shumica e këtyre veprave ishin vepra kundër jetës dhe trupit siç janë lëndimi i lehtë trupor, lëndimi i rëndë trupor, veprat penale kundër pasurisë si: vjedhja e rëndë, vjedhja dhe mashtrimi.

Si shembull në vitin 2008, në Gjykatën Komunale në Ferizaj janë pranuar gjithsej 1087 akuza, prej të cilave 99 janë akuza që kanë të bëjnë me veprat penale në bashkëkryerje. Nga 99 akuza të pranuar 64 prej tyre kanë përfunduar dhe atë:

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

-39 për këto akuza janë marrë aktgjykim dënues të pandehurit janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar sipas ligjit në fuqi.

-12 akuza janë hedhur me aktvendim

- 10 akuza janë refuzuar me aktgjykim

- për 3 akuza është pushuar procedura penale

-1 një akuzë është liruar me aktgjykim lirues

6.4 Analiza nga praktika gjyqësore të disa vendimeve se cilat veprime inkriminuese gjykatat i kanë vlerësuar se përbëjnë bashkëkryerje si formë e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale

a) Sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike Komunale në Ferizaj Pp. nr. 1128/08 të datës 15. 09. 2008, të pandehurit F. M., R. I. dhe A. S. janë shpallur fajtor për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 253. par. 1. nënpar. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe janë dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 4 (katër) muaj. Në përshkrimin e veprimeve inkriminuesë të pandehurve të lartpërmendur theksohet *”Pas marrëveshjes paraprake në bashkëkryerje dhe me mjete të përshtatshme - kaçavidave disa herë kanë hapur dritaret e shtëpive dhe përmes dritareve kanë depërtuar në shtëpitë e të dëmtarëve”*.

Gjithashtu në veprën tjetër nën pikën 2 të aktakuzës i përshkruhen *“se të pandehurit me mjet të përshtatshëm kanë hequr rrjetin e metaltë që ka qenë e rrethuar pompa e ujit hidroforin e tipit “*

Nga këto të dhëna mund të konstatojmë se prokuroria në aktakuzë i kishte përshkruar në mënyrë abstrakte dhe të përgjithësuar veprimet inkriminuese të pandehurve pa bërë ndonjë dallim dhe pa i konkretizuar veprimet individuale të pandehurve. Me që të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor kishin pranuar fajësinë, gjykata ishte pajtuar me këtë pranim dhe më tutje nuk ishin zberthyer

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

dhe shpjeguar veprimet konkrete të pandehurve, si vërehet edhe në arsyetimin e aktgjykimit.¹⁴

b) Gjykata ndër të tjera konstatoi se në mes të pandehurve ekzistonte marrëveshja paraprake për bartjen e substancave narkotike të llojit heroinë nga Maqedonia dhe më pas transportimin e tyre,që dëshmohet nga fakti së të pandehurit janë zënë në flagrancë me rastin e shkëmbimit të pakove me substanca narkotike për në automjetin e të pandehurit I. S., të cilën po e bënin në shtëpinë e të pandehurit Sh. R., ndërsa të pandehurit I. S. njëkohësisht i ishin konfiskuar edhe 11.000 €, të cilat ishin rezultat i kryerjes së veprës penale.

Rrjedhimisht në rastin konkret ekzistonte lidhja subjektive dhe objektive e të pandehurve përkatësisht marrëveshja dhe kontributi objektiv i secilit të pandehur në drejtim të kryerjes së kësaj vepra penale.¹⁵

c) Në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë përshkruhen veprimet inkriminuse të akuzuarve si vijonë : se me rastin e kontrollit policor të automjetit të cilën e drejton i akuzuari D.P, në të cilën ishin edhe të akuzuarit XH. F. janë gjetur 17 pistoleta, fishek dhe brisk, këto armë përmes të akuzuarit I. S. të akuzuarit D. P dhe XH. S. i kanë blerë prej të akuzuarve V. F dhe M. SH. Duke shtuar se ditën kritike pas takimit në një kafiteri janë marrë veshë për këtë shitblerje dhe kjo vërtetohet përmes përgjimeve telefonike.

Në këtë aktgjykim përshkruhet si lidhja e subjekteve e të akuzuarve si është marrëveshja mes tyre për shitblerjen e armëve, ashtu edhe veprimet e të akuzuarve të karakterit objektiv siç janë veprimet përkitazi me shitjen, transportin dhe blerjen e armeve, pra kryerja e veprës ishte rezultat i përbashkët i veprimeve dhe i vullneteve të tyre.¹⁶

d) Sipas propozimkuzës së Prokurorisë Publike Komunale në Ferizaj Pp. nr. 1232/09 të datës 25 . 08. 2009 të pandehurit N. M dhe A. M, janë shpallur fajtor për veprën penale lëndimi i lehte trupor nga neni 153 . par. 2 lidhur me

¹⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj P. nr. 654/09, të datës 04. 09. 2009 P. nr. 842/08, i datës 04 dhjetor 2008

¹⁵ Gjykata e Qarkut në Prishtinë, aktgjykimi P. nr. 219/08 të datës 27.06.2008

¹⁶ Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. nr. 219/08 të datës 27.06.2008

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

par. 1 nënpar. 4 lidhur të KPK-së të kryer në bashkëkryerje dhe ju ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje nga 1(një) vit.

Pasi që të njëjtit në shenjë hakmarrje i kanë shkaktuar lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit në përshkrimin faktik të veprimeve inkriminuse *“Në shenjë hakmarrje të pandehurit i dalin përpara të dëmtuarit E. M. të cilit njëri nga të pandehurit i drejtohet me fjalët zotëri a i ke borxh ndokujt, pse po del i lirë dhe në fillim me grushta e godasin në pjesë të ndryshme të trupit, kurse i pandehuri N. M. me një çelës metalik e godet të dëmtuarin njëherë në hundë dhe në shpinë, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë shtypje e kokës, shtypje e hundës dhe therje e kockës së hundës si dhe shtypje e krahut të majtë”*.

Nga përshkrimi faktik i lartpërmendur rezulton se i pandehuri N. M. kishte kontribuar në kryerjen e veprës, duke e goditur në shpinë të dëmtuarin, por edhe ekzistonte qartazi marrëveshja paraprake për t'u hakmarrë që konkludohet edhe nga vetë fjalët e përdorura se *“a i ke borxh ndokujt”*, nisur nga këto rrethana padyshim se në këtë rast ekzistonte *“animus actoris”* edhe tek ky i pandehur i cili rezultatin kriminal e dëshironte si të veten dhe njëkohësisht si të përbashkët.¹⁷

e) Sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike Komunale në Ferizaj Pp. nr. 1597/09 të datës 26. 11. 2009 të pandehurit B. S dhe S. B, janë shpallur fajtor për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 253. par. 1 nënpar. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së. Në veprimet inkriminuse ju përshkruhet se në bashkëkryerje dhe në marrëveshje mes vete, me çelësin që më parë e kishte marrë i pandehuri B. S, në mënyrë të paautorizuar kanë hapur derën e depos dhe kanë marrë gjëra jo ushqimore. Nga natyra e këtyre veprimeve të pandehurve padyshim se rezulton bashkëkryerja si në aspektin subjektiv përkatësisht marrëveshjes mes tyre dhe në aspektin objektiv përkatësisht kontributin e tyre në realizimin e veprës.¹⁸

ë) Sipas aktakuzës së PPQ- së në Gjilan Pp. nr. 47/06 të datës 30. 06. 2006 të pandehurit, H. R dhe A. SH janë shpallur fajtorë për veprën penale sulmi

¹⁷ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj P. nr. 654/09, të datës 04. 09. 2009.

¹⁸ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj P. nr. 1118/09, të datës 01. 03. 2010.

seksual nga neni 195. par. 3 lidhur me par. 1 pika 5 të KPPK-së të kryer në bashkëkryerje dhe i'u ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej një (1) viti tre (3) muaj dhe një (1) viti. Konsiderojmë kjo veprë penale për nga natyra e saj nuk mund të kryhet në bashkëkryerje por individualisht nga secili prej të pandehurve, meqenëse kjo veprë kryhet *“kushdo që prek personin tjetër me qëllim seksual ose e nxit personin tjetër të prekë personin tjetër me qëllim seksual ose nxitë personin tjetër ta prekë kryerësin apo personin e tretë me qëllim seksual pa pëlqimin e personit tjetër”* ndërsa në rastet kur veprën e kryejnë me shumë se një person, paraqet formë të rëndë të kryerjes së kësaj veprë penale e përcaktuar paragrafin 5 të nenit 198 të KPK-së, por nuk nënkupton se vepra është kryer në bashkëkryerje por si e tillë është kryer bashkërisht.¹⁹

f) Sipas aktakuzës së PPQ-së në Prishtinë PP. Nr. 572/04 të datës 05. 05. 2005 të pandehurit H. S, V.M, M.G.A dhe B. T. janë shpallur fajtorë për veprën penale rrëmbimi i personit nga neni 159. par. 2 lidhur me par. 1 lidhur nenin 23 të KPK-së. Në dispozitiv të këtij aktgjykimi përshkruhen veprimet inkriminuse të pandehurve të cilat përbëjnë bashkëkryerje si vijon: “pas marrëveshjes paraprake të pandehurit H.S dhe V. M së bashku edhe me të pandehurin A. I. (në arrati) kanë bërë planifikimin e rrëmbimit dhe i kanë ndarë rolet ashtu që në fsh .D. kanë rrëmbyer fëmijën A. M., në afërsi të shtëpisë dhe me veturën e të pandehurit V.M. e kanë kaluar kufirin në mënyrë ilegale, ndërsa i pandehuri H. S i ka pritur në pjesën e Maqedonisë, në vendin e caktuar ku janë takuar me të pandehurit A, V. dhe me fëmijën, ndërsa të pandehurit M.G. B. T. kanë mbetur në Kosovë dhe në të njëjtën ditë, gjithnjë sipas marrëveshjes, i pandehuri B. T. në kohë të caktuar ka shkuar në hotelin e të dëmtuarit N. M. ku ka pranuar disa telefonata nga të pandehurit, në telefonin e tij mobil dhe i'a përcjellë familjes së të dëmtuarit. Ndërkohë i pandehuri H. S. kthehet në Kosovë dhe e merre të pandehurën M.G me të cilën shkon në Sh. ku qëndrojnë së bashku disa ditë e prej ku me telefon të pandehurit i bëjnë bisedat me familjen e fëmijës së të dëmtuarit, duke i kërkuar shumën e të hollave prej 100.000 € për kthimin e fëmijës, mirëpo derisa të pandehurit angazhohen rreth kontaktit me familjen e të dëmtuarit dhe pranimin e të hollave, e kanë lënë fëmijën vet në shtëpi të pabanuar në fshatin H. të Sh.,

¹⁹ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Gjilan P. nr. 63/06 të datës 30. 06. 2006.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

prej ku fëmija arrin të ikë dhe takohet me një person të panjohur, i cili lajmëron policinë dhe ata e marrin dhe e kthejnë në shtëpi, ndërsa të hollat e kërkuara të pandehurit nuk arrijnë që t'i marrin”.

Në aktgjykim përshkruhen në mënyrë të saktë dhe të qartë veprimet dhe kontributin e secilit të pandehur që rrjedh si rezultat i marrëveshjes paraprake, e cila rezulton me ndarje të roleve, si rrëmbimin e fëmijës në fshat, me automjetin e njërit nga të pandehurit, organizmin në kalimin ilegal në shtetin fqinjë, disa bëjnë “negociata” me telefon me familjen e të dëmtuarit, përmes të pandehurit B.T, i cili mbetet në Kosovë për ti vendosur kontaktet me familjen e të dëmtuarit

Gjithashtu mjaft mirë e sqaron rolin e të pandehurës M. G. A duke theksuar se edhe pse nuk ka qene e kyqyr që nga fillimi në rrëmbimin e fëmijës, ajo ndërkohë i është bashkangjitur atyre në Sh.... dhe gjatë tërë kohës qëndroi më ta, dhe ajo dy herë bisedoj në telefon me prindin e të dëmtuarit, si dhe gjatë kësaj kohe duke u kthyer në Kosovë. Ndërsa duke marrë parasysht se kjo vepër është një vepër penale që zgjate deri sa zgjatë gjendja e kundërligjshme e pandehura me pjesëmarrjen e saj dhe me veprimet e saj në vazhdim është bashkëkryese e kësaj vepre penale.²⁰

g) Sipas aktakuzës së PPQ-së në Prishtinë PP. nr. 529/06 të datës 20. 09. 2006 të pandehurit, I. SH. dhe D. H. janë shpallur fajtor për veprën penale veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229. par. 3 lidhur me par. 1 dhe 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe u janë shqiptuar dënimet me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) dhe 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj burgim. Nga përshkrimi i veprimeve inkriminuse rezulton se: “ të pandehurit me qëllim të shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të substancave narkotike, në shtëpinë e të pandehurit I. Sh në fsh V.... komuna e F.....së pari janë mbushur dy qese të plastikës me substanca narkotike të llojit heroinë në sasi prej 490, 78 gr, pesha e përgjithshme prej 983, 62 gr. Të cilat i pandehuri I. i vendosi në veturën e tij të tipit “Golf” me targa2...KS...6... dhe pas kësaj me dt. . 2.....2006

²⁰Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë P. nr. 65/05 të datës 9. 02. 2006.

këtë veturë në të cilën ishte vendosë narkotiku i 'a jepë të pandehurit D. H, i cili nga F..... është nisur për në Prishtinë me qëllim të transportimit e pastaj shitjes së substancës narkotike dhe të njëjtën ditë në mbrëmje rreth orës 19:40 në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë policia e ka ndalë të pandehurin D.. dhe pas kontrollimit në veturë në ulëse ka gjetur dhe konfiskuar dy paketime me substancë narkotike të tipit heroinë e në peshë të përgjithshme prej 983, 52 gr, të cilat në oborrin e shtëpisë janë gjetur qese të najlonit në të cilat kishte pasur më herët heroinë dhe përzierje të narkotikut".

Siç konstatohet tek të pandehurit ekzistonte marrëveshja mes tyre për shitjen dhe shpërndarjen e substancave narkotike, e cila rrjedh nga veprimet konkludente e të pandehurve me ç'rast i pandehuri i I. SH mbush qeset me substancë narkotike, të cilat i vendos në automjetin e tij, ndërsa i pandehuri D. H me këtë automjet po e transportonte nga F.... ..në drejtim të Prishtinës, nga kjo rrjedhë se tek të pandehurit ekzistonte uniteti i lidhjes si subjektive ashtu edhe ato objektive përkatësisht kontributi i tyre real në kryerjen e kësaj vepre.²¹

Përfundimi

- Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale me të drejtë konsiderohet si një nga institutet më të komplikuar si në aspektin e teorisë juridike penale ashtu edhe në aspektin e praktikës gjyqësore. Pasi paraqiten si çështje për t'u zgjidhur roli dhe kontributi i secilit bashkëpunëtor në kryerjen e veprës penale si dhe përcaktimi i përgjegjësisë penale të tyre, të cilat në praktikë shpesh janë të ndërlikuara dhe kërkohet një analizim i kujdesshëm i veprimeve të secilit pjesëmarrës. Prandaj në trajtimin e këtyre veprave dhe kryerësve kërkohet një qasje e veçantë dhe një profesionalizëm i lartë i organeve të cilat merren me zbulimin, hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e tyre.
- Bashkëkryerja është formë e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale në rastet kur marrin pjesë dy apo më shumë persona të cilët kanë ndërmarrë veprimin e kryerjes, apo në ndonjë mënyrë tjetër i kontribuojnë në mënyre thelbësore kryerjes së saj.

²¹ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. nr. 174/07 të datës 27. 06. 2007

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

- Me veprimin e më shumë personave në kryerjen e veprës penale manifestohet një vullnet më i lartë kriminal se sa në rastet kur kryhen nga një individ, për faktin se të njëjtit do ta kenë më të lehtë kryerjen e saj, organizim më të mirë dhe mundësi për fshehjen e gjurmëve të kryerjes. Gjithashtu pjesëmarrja e më shumë personave në aspektin psikologjik i bënë me të vendosur dhe më të guximshëm në ndërmarrjen e veprimeve inkriminuse.
- Definimi i veprimit të drejtpërdrejt të kryerjes së veprës penale të ndërmarrë nga dy apo më tepër persona, nuk paraqet ndonjë vështirësi në aspektin ligjor ashtu edhe në aspektin praktik, por problemi paraqitet me rastin e përcaktimit të veprimit, i cili nuk është veprim i drejtpërdrejt i kryerjes, por veprim tjetër, i cili kontribuon në mënyrë thelbësore në kryerjen e veprës penale. Andaj në këtë punim pikërisht jam fokusuar në zbërthimin dhe shpjegimin e këtij segmenti të bashkëkryerjes si në legjislacionin tonë penal ashtu edhe në aspektin komperativ me legjislacionet penale të disa shteteve të rajonit.
- Në literaturën tonë ekzistuese nuk kam hasur se ekziston ndonjë studim i veçantë përkitazi me bashkëkryerjen, andaj nga kjo arsye në këtë studim jam munduar që të jetë më gjithëpërfshirës dhe atë duke trajtuar bashkëkryerjen si në aspektin teorik, ligjor dhe praktik.
- Është analizuar evoluimi në aspektin legjislativ i cili ndryshim ka lëvizur në drejtim të formulimit më të qartë dhe më preciz të kriteve, për ta definuar bashkëkryerjen.
- Të gjitha shtetet e rajonit me rastin e aprovimit të kodeve penale kanë aprovuar zgjidhje ligjore me të cilat njëkohësisht janë bërë përpjekje që ta riformulojnë në mënyrë më të qartë dhe më koncize bashkëkryerjen, veçanërisht veprimin i cili nuk është veprim i drejtpërdrejtë i kryerjes së veprës penale.
- Krahasimet mes kodeve penale të rajonit përkitazi me përcaktimin që i bëjnë veprimit që nuk është veprim i drejtpërdrejt i kryerjes së veprës penale si psh: në Kodin Penal të Kroacisë, parashihet që veprimi i tillë t'i kontribuojë thelbësisht kryerjes së veprës. Ndërsa në Kodin Penal të Shqipërisë, i cili nuk parasheh dispozitë të veçantë përkitazi me bashkëkryerjen si formë e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale, por definimi dhe qartësimi është bërë pikërisht nga praktika gjyqësore

dhe atë në Vendimin e Gjykatës së Lartë të Shqipërisë nr. 1, të datës 26. 03. 2002, në të cilën janë dhënë shpjegime mjaft domethënëse përkitazi me bashkëzekutimin siç edhe quhet në doktrinën dhe në terminologjinë juridike shqiptare. Ndër të tjera në këtë vendim shpjegohet: “Kur vepra penale kryhet në formën e bashkëzekutimit, midis bashkëpunorëve nuk ka më ndarje rolesh, në kuptimin klasik të kësaj fjale (organizator, shtytës dhe ndihmës), por ka një lloj ndarje tjetër, e cila ka të bëjë me ndarjen e punëve direkte që duhet të kryej secili nga bashkëekzekutorët për realizimin e vullnetit të përbashkët kriminal, vullnet ky që, në fund të fundit, manifestohet në botën e jashtme, veç veprimeve të secilit, edhe me arritjen e rezultatit të përbashkët kriminal të dëshiruar prej tyre..”

- Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, bashkëkryerja si formë e posaçme në kryerjen e veprës penale është paraparë në dispozitën e nenit 31, në të cilën është përcaktuar se veprimi i cili nuk është veprim i drejtpërdrejt i kryerjes së veprës penale, *“por veprim i cili në ndonjë mënyrë tjetër i kontribuon thelbësisht kryerjes së veprës penale”*, pra KPRK kërkon që ky veprim të jetë i asaj natyre dhe cilësie që do të kontribuonte në mënyrë thelbësore në kryerjen e veprës penale, që nënkupton se jo çdo kontribut i zakonshëm në kryerjen e veprës të trajtohet si bashkëkryerje.
- Rëndësi të veçantë i kam kushtuar vendimeve gjyqësore, pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal të Kosovës, fakteve se si gjykatat e kanë trajtuar bashkëkryerjen në çështjet e konkrete penale dhe se cilat veprime të kryesve të veprave penale i kanë vlerësuar si veprime të cilat përbëjnë bashkëkryerje, ndërsa një vështrim të veçantë përkitazi më këtë çështje i është bërë vendimeve gjyqësore të Gjykatës Komunale në Ferizaj, në periudhën kohore e cila ka qenë objekt i studimit tim.
- Në përgjithësi mund të përfundojmë se është e nevojshme që vendimet gjyqësore sidomos në situatat kur ndonjëri nga bashkëkryesit nuk ka ndërmarrë veprimin e drejtpërdrejtë të kryerjes së veprës, por në ndonjë mënyrë tjetër i ka kontribuar kryerjes së saj, të arsyetohet specifikisht dhe në mënyrë të detajizuar se pse gjykata ato veprime i ka vlerësuar se i kanë kontribuar në mënyrë thelbësore kryerjes së veprës penale.

- Vlerësojë se në praktikën gjyqësore në përgjithësi si me rastin e përpilimit të akteve akuzuese nga ana e prokurorëve (aktakuzës) dhe vendimeve gjyqësore, nuk përshkruhen në mënyrën e duhur dhe konkrete veprimet inkriminuese të secilit bashkëkryes, por bëhet një përshkrim i përgjithshëm dhe abstrakt i veprimeve inkriminuese. Gjithashtu në arsyetimin e vendimit disa veprime nuk arsyetohen fare ose arsyetohen në mënyrë jo të mjaftueshme.

Literatura

- SALIHU Ismet, E Drejta Penale – Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë, 2009
- Salihu, Ismet and Zhitija, Hilmi and Hasani, Fejzullah (2014) Komentar i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. GIZ, Prishtinë.
- HAZNEZIRI Luan, Bashkëpunimi, Grupi i Strukturuar Kriminal dhe Organizata Kriminale, Tiranë, 2008
- Luarasi Aleks, Kodi Penal me Praktikë Gjyqësore, botimi i dytë, Tiranë, 2005
- Muqi Shefqet, E drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Tiranë, 2007
- BACIC Franjo & PAVLOVIQ Shime, Komentar Kaznenog Zakona, Zagreb, 2005
- Garacic Ana, Sudionistvo po novom Kaznenog Zakonu I?? (u) Sudskoj Praksi, Zagreb

Ligjet

- Kodi Penal i Kosovës, Prishtinë, 06 prill 2004
- Kodi i Procedurës Penal i Kosovës, Prishtinë, 06 prill 2004
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës 04/L-082 GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr.19 / 13 KORRIK 2012, PRISHTINË
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë i vitit 1995
- Kodi Penal i Republikës së Kroacisë i vitit 2005

PhD. Cand. Milot KRASNIQI*

NDËRMJETËSIMI NË PROCEDURË PENALE PËR TË MITUR

Abstrakt

Ndërmjetësimi është procedurë alternative e cila mundëson zgjidhjen e çështjes penale në mënyrë jashtëgjyqësore. Kjo procedurë është e rregulluar me ligj të veçantë dhe zbatohet për disa fusha të së drejtës, si në procedurë penale, civile, administrative, konteste të punës, konteste të natyrës civile, tregtare, familjare, administrative, nëse nuk është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës ose e një organi tjetër kompetent. Pavarësisht faktit se ndërmjetësimi aplikohet në shumë fusha të së drejtës, megjithatë, objekti i këtij punimi do të jetë ndërmjetësimi në procedurë penale për të mitur.

Duke marrë parasysh karakteristikat e shumta që i veçojnë të miturit nga madhorët, ekziston besimi se ndërmjetësimi shërben si mjet i përshtatshëm për luftimin e kriminalitetit të të miturve me masa jopenale, me çka në praktikë rezulton me efekte shumë të mira, sepse mundëson moszhvillimin e procedurës penale ndaj të miturit, çdo herë kur është e mundshme.

Qëllimi i punimit është të elaboroj rëndësinë e ndërmjetësimit si procedurë alternative në fushën e drejtësisë penale për të mitur. Për përgatitjen e punimit kam përdorur metodën juridike, të analizës dhe atë sociologjike.

Nga rezultatet e këtij punimi mund të nxirret përfundimi se ndërmjetësimi është procedurë alternative e përshtatshme për zgjidhjen e shpejtë dhe efikase të çështjeve penale të të miturve, andaj ky mekanizëm ligjor është mirë që të referohet nga autoritetet përgjegjëse, në çdo rast kur për këtë plotësohen kushtet ligjore.

Fjalët kyçe: Ndërmjetësim, i mitur, procedurë penale, prokuror i shtetit, ndërmjetësues, Kosovë.

*Autori është Prokuror i shtetit në Departamentin e Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Prizren dhe vijon studimet e doktoratës në të drejtën penale.

Hyrje

Në kuadër të lëvizjeve reformatore të trajtimit të çështjeve penale, rëndësi të madhe luajnë promovimi dhe aplikimi i instituteve të reja. Me qëllim të lehtësimit të punëve në sistemin e drejtësisë penale, edhe Kosova ka përligjur dhe e aplikon institutin e ndërmjetësimit, marrëveshjen për pranimin e fajësisë, shpalljen e të pandehurit si dëshmitar bashkëpunues, diversionin dhe pezullimin e përkohshëm të procedurës penale. Këto institute, përkatësisht lloje të procedurave alternative rregullohen me dispozita të veçanta të përmbledhura në Kapitullin XIV të Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejme: KPP).¹

1. Nocioni dhe historiku i ndërmjetësimit

Në gjuhën shqipe shprehja *ndërmjetësim* do të thotë “*proces në të cilin një person merr iniciativë me qëllimin që t’i pajtoj palët ose për të zgjidhur një çështje kontestuese*”. Në jetën e përditshme shpeshherë përdoren shprehjet *ndërmjetësuan për pajtim, ndërmjetësim për paqe etj.*² Në jetën shoqërore kur ndodhin ngatërresa dhe mospajtime ndërmjet njerëzve, familja, miqtë dhe rrethi shpeshherë tentojnë që t’i tejkalojnë ato duke ndërmjetësuar ndërmjet palëve të përfshira në kontest.³

Në aspektin juridiko-penal ndërmjetësimi nënkupton një veprimtari jashtëgjyqësore⁴ e cila zbatohet nga një person i tretë (ndërmjetësuesi) për zgjidhjen e çështjes penale, në pajtim me kushtet e parapara me Kodin e Procedurës Penale⁵ dhe Ligjin për Ndërmjetësimin (në tekstin e mëtejme:

¹ Procedurat alternative janë të parapara në Kapitullin XIV të KPP, nenet 229-239.

² Fjalor i shqipes së sotme, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002, fq. 834.

³ Hajdari, A. & Krasniqi, M: Ndërmjetësimi si qasje e re e zgjidhjes alternative të çështjeve penale, Avokatura, nr. 13, Prishtinë, 2012, fq. 129.

⁴ Ndërmjetësimi është institut i veçantë proceduralo-penal, por duke marrë parasysh faktin se KPP atë e njej si lloj të procedurës alternative, edhe unë në këtë punim do t’i referohem terminologjisë që ka paraparë ky Kod.

⁵ Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>. Vizituar më: 05.05.2017.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

LNd).⁶ Rrjedhimisht, ndërmjetësimi është veprimtari jashtëgjyqësore e cila ka për qëllim të asistoj në zgjidhjen praktike të mosmarrëveshjeve ndërmjet subjekteve të së drejtës, përkatësisht zgjidhjen alternative në rrugë jashtëgjyqësore, të kontesteve ndërmjet subjekteve të së drejtës.

Ndërmjetësimi si institut shoqëror daton që moti, ai njihet në kuadër të së drejtës zakonore të popujve, përfshirë edhe shqiptarët. E drejta jonë zakonore e përmbledhur në Kanunin e Lekë Dukagjinit, e njeh ndërmjetësimin.⁷ Dispozitat e Kanunit të Lekë Dukagjinit, Kanunit të Skënderbeut, Kanunit të Labërisë dhe kanuneve tjera të së drejtës zakonore shqiptare e trajtojnë pajtimin, dëmshpërblimin dhe krijimin e paqes ndërmjet fisit të kryerësit dhe fisit të viktimës, mes vëllazërive dhe familjeve të tyre. Kjo e drejtë i ka përcaktuar rregullat e pajtimit me ndërmjetësim, sidomos të pajtimet e krimeve të vrasjeve dhe gjakmarrjeve, fyerjeve dhe dëmtimeve të pasurisë. Vendosja e paqes hyjnore “*pax dei*” sipas frymës të së drejtës zakonore ka kërkuar që të ndërpriten armiqësitë dhe konfliktet në mes të palëve (kryerësit dhe viktimës) si dhe të evitohet gjakmarrja dhe hakmarrja (*vendetta*).⁸ Këto nene përcaktojnë parimet kryesore të ndërmjetësimit dhe pajtimit për të siguruar paqe dhe mirëkuptim ndërmjet palëve, për të shmangur mosmarrëveshjet dhe konfliktet. Së pari gjendej një ndërmjetësues i cili i ndihmonte palët që t’i relaksonin raportet dhe të arrinin marrëveshje për pajtim me vullnetin e lirë të tyre.

Ndërmjetësimi mundëson shkarkimin e punës së gjykatave duke i zgjidhur çështjet penale të lehta. Shumë shtete e praktikojnë ndërmjetësimin për t’i dhënë zgjidhje të shpejtë dhe praktike mosmarrëveshjeve. Për këtë qëllim ato kanë nxjerrë ligje për ndërmjetësim dhe kanë krijuar praktikë solide në zbatimin e tij. Në Rajonin e Ballkanit ligj për ndërmjetësimin kanë nxjerrë Republika e Kroacisë, Sllovenisë dhe Shqipërisë. Kosova më 2008 e ka miratuar Ligjin për Ndërmjetësim për t’i hapur mundësinë ligjore

⁶ Shih nenin 2 të Ligjit nr. 03/L-057 për Ndërmjetësimin. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2592>. Vizituar më: 05.05.2017.

⁷ Kanuni i Lekë Dukagjinit e ka paraparë ndërmjetësimin dhe atë e rregullon në 16 nene, (nyje) 667-682. Më gjerësisht për këtë, shih: Gjeçovi, At Shtjefën: Kanuni i Lekë Dukagjinit, Prishtinë, 2001, fq. 68-69.

⁸ Halili, R: Viktimologjia, Prishtinë, 2007, fq. 157.

implementimit të tij në praktikë. Me këtë ligj rregullohet procedura e ndërmjetësimit në procedurë penale, civile, administrative, konteste të punës, konteste të natyrës civile, tregtare, familjare, administrative, nëse nuk është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës ose e një organi tjetër kompetent. Pavarësisht faktit se ndërmjetësimi aplikohet në shumë fusha të së drejtës, megjithatë, objekt i këtij punimi do të jetë ndërmjetësimi në procedurë penale për të mitur.

2. Qëllimi i ndërmjetësimit

Qëllimi i ndërmjetësimit është që të ndihmoj palët, (kryesin e mitur të veprës penale dhe të dëmtuarin/viktimën), që përmes procedurës jashtëgjyqësore të arrijnë pajtimin. Ndërmjetësuesi të cilit i besohet angazhimi në çështjet penale për të mitur, duhet të bëj përpjekje që përmes lehtësimit të komunikimit ndërmjet palëve të arrihet marrëveshja dhe pajtimi i tyre. Ndërmjetësuesi duhet të udhëhiqet nga parimet bazë të ndërmjetësimit, si dhe që procedura e ndërmjetësimit për të mitur të zhvillohet me urgjencë.⁹

Qëllimi i ndërmjetësimit në procedurë penale për të mitur mund të nxirret nga preambula e LNd, në të cilën përcaktohet se qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është që të bëj rregullimin, organizimin dhe funksionimin, si dhe zgjidhjen e kontesteve në mënyrë sa më efektive me ndërmjetësim si dhe me synimin e avancimit të sistemit juridik në Kosovë.

Si qëllime të tjera të ndërmjetësimit në procedurë penale për të mitur janë:

1. Zgjidhja e shpejtë e çështjes penale;
2. Kursimi i shpenzimeve të cilat do t'i shkaktonte procedura penale e rregullt;
3. Mosekspozimi i të miturve dhe ruajtja e personalitetit të tyre;
4. Shkarkimi i gjykatave nga një pjesë e konsiderueshme e punës;

⁹ Parimet e procedurës së ndërmjetësimit janë paraparë në nenet 3-7 të LNd, kurse urgjenca si parim i veçantë i veprimit në fushën e drejtësisë për mitur është i paraparë në nenin 40 (1) të KDM.

5. Promovimi i procedurave alternative dhe i drejtësisë restorative, karshi procedurës së rregullt penale;
6. Arritja e pajtimit në mes të palëve.

Nga analiza që mund të ju bëhet këtyre përparësive që ofron ndërmjetësimi, me të drejtë mund të besohet se ai do të ndikoj drejtpërdrejt në avancimin e sistemit juridik të Republikës së Kosovës.

3. Baza juridike e ndërmjetësimit

Me qëllim të zbatimit efikas të ndërmjetësimit në procedurë penale për të mitur, Republika e Kosovës ka nxjerrë një bazë solide juridike, e përbërë nga: Ligji për Ndërmjetësimin; Kodi i Procedurës Penale; Kodi i Drejtësisë për të Mitur si dhe Aktet nënligjore të nxjerra nga Komisioni për Ndërmjetësim i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Parimet e ndërmjetësimit

Parimet janë rregulla themelore në bazë të të cilave ndërtohet dhe funksionon një institut i së drejtës. Edhe ndërmjetësimi si institut i ri i së drejtës përshkohet nga një mori parimesh të cilat do t'i elaborojmë në vijim të këtij punimi.¹⁰

- 1. Parimi i ligjshmërisë,** është rregull themelor i drejtësisë në përgjithësi. Edhe ndërmjetësimi është i përshkruar nga fryma e parimit të ligjshmërisë sepse ai vetë buron dhe bazohet në LNd dhe aktet nënligjore të cilat derivojnë nga ai.
- 2. Parimi i vullnetit të palëve,** përcakton zgjidhjen se ndërmjetësimi mund të zbatohet vetëm kur ekziston shprehja e vullnetit të lirë të palëve për zgjidhjen e çështjes penale përmes ndërmjetësimit. Ky

¹⁰ Më gjerësisht rreth parimeve të ndërmjetësimit shih nenet 3-7 të Ligjit për Ndërmjetësimin të Republikës së Kosovës dhe nenin 3 të Ligjit për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Republikës së Shqipërisë.

parim gjen zbatim të plotë edhe në arritjen e marrëveshjes në procedurën e ndërmjetësimit, e cila është çështje ekskluzive e palëve.

- 3. Parimi i barazisë së palëve**, nënkupton faktin se palët në procedurën e ndërmjetësimit janë të barabarta. Konform frymës së LNd, ato kanë pozitë të barabartë si dhe të drejta dhe detyrime reciproke.
- 4. Parimi i objektivitetit** (neutraliteti, paanshmëria), kërkon që procedura e ndërmjetësimit të shtrohet dhe shqyrtohet besnikërisht dhe se ndërmjetësuesi të ketë pozitë neutrale ndaj palëve. Ky parim kërkon që ndërmjetësuesi si arbitër në këtë proces të jetë person me kredibilitet të lartë moral dhe profesional, plotësisht i paanshëm dhe objektiv. Ai duhet të jetë i pavarur në punën e tij nga çdo lloj ndikimi.
- 5. Parimi i fshehtësisë dhe besueshmërisë**, kërkon që procedura e ndërmjetësimit të jetë e natyrës konfidenciale. Të gjitha informatat në lidhje me çështjen penale të ndërmjetësuar, duhet të ruhen me kujdes dhe ato nuk mund të shfrytëzohen në ndonjë procedurë tjetër dhe pa pajtimin e palëve.
- 6. Parimi i veprimit me urgjencë**, kërkon që procedura penale por edhe ajo e ndërmjetësimit ndaj të miturve, të zhvillohet me urgjencë, sa më parë që është e mundur, dhe pa vonesa të paarsyeshme (neni 40/1 i KDM). Ky parim është në funksion të efikasitetit procedural dhe është paraparë në interesin më të mirë të të miturit.

5. Veprat penale të cilat mund të zgjidhen me ndërmjetësim

Ndërmjetësimi mund të zbatohet për zgjidhjen e çështjeve penale të cilat si objekt i kanë veprat penale të lehta. Sipas frymës së LNd me ndërmjetësim mund të zgjidhen veprat penale për të cilat është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në 3 (tri) vjet. Kjo qasje konsiderohet të jetë e arsyeshme, sepse nuk mund të paramendohet që për vepra penale të rënda të aplikohet ndërmjetësimi. Konsiderohet se kjo qasje e ligdhënësit bazohet në faktin se

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

këto vepra penale manifestojnë një shkallë më të ultë të rrezikshmërisë shoqërore, janë të shpeshta në praktikë, kryhen nga kryerës madhorë e shpeshherë edhe nga të miturit.¹¹

Rrjedhimisht, si kriter bazë për zbatimin e ndërmjetësimit merret pesha e veprës penale dhe lloji e lartësia e sanksionit penal, përkatësisht dënimit të paraparë për atë vepër penale. Pra, kushtet të cilat duhet të plotësohet që një vepër penale të referohet në ndërmjetësim janë:

- 1. Vepra penale të jetë e dënueshme me gjobë ose me burgim** (dënimi të jetë i paraparë në mënyrë alternative, ose njëri nga këto dënime);
- 2. Dënimi me burgim të jetë deri në 3 (tri) vjet.**

Nga analizimi i këtyre kriterëve, rezulton se në Kodin Penal janë paraparë rreth 200 forma të veprave penale të cilat mund të zgjidhen me ndërmjetësim.¹² Kriteri i parë është vlerësuar si pengesë në punën e prokurorëve dhe gjykatave, sepse ato nuk kanë mundur që t'i referojnë në ndërmjetësim një numër të konsiderueshëm të veprave penale, ngase për to është paraparë dënimi në mënyrë kumulative (dënimi me burgim dhe me gjobë). Kjo pengesë ligjore pritet që të zgjidhet në kuadër të rishikimit të Kodit Penal, Kodit të Drejtësisë për të Mitur si dhe Ligjit për Ndërmjetësimin. Nëse ligjdhënësi ynë përcaktohet për zgjidhjen që në ndërmjetësim të referohen veprat penale për të cilat parashihet dënimi me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tri) vjet, do të krijohen mundësitë që me ndërmjetësim të zgjidhet një numër më i madh i veprave penale.

6. Referimi i çështjeve penale në ndërmjetësim

Referimin e çështjeve penale në ndërmjetësim për të mitur, mund ta bëj prokurori i shtetit, gjyqtari për të mitur ose kolegji për të mitur. Kjo zgjidhje është paraparë në nenin 14 (2) të KDM. Se cili nga këto subjekte do të bëj

¹¹ Hajdari, A. & Krasniqi, M: vep. e cit., fq. 133.

¹² Këto forma të veprave penale në të shumtën e rasteve janë forma të lehta të veprave penale bazike. P.sh. Vepra penale: Vjedhja nga neni 325, mund të referohet në ndërmjetësim, por vetëm për paragrafin 2, dhe jo për paragrafin 1.

referimin e çështjes penale në ndërmjetësim varet se në cilën fazë është procedura. Prokurori i shtetit mund të referoj çështjen në ndërmjetësim nëse nuk ka paraqitur propozimin e arsyetuar në gjykatë (aktin akuzues) kurse gjyqtari për të mitur mund ta referoj një çështje në ndërmjetësim në çdo kohë, deri në marrjen e vendimit gjyqësor në lidhje me rastin. Para se të referojnë rastin në ndërmjetësim, prokurori i shtetit ose gjyqtari për të mitur, do të marrin parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historinë e të miturit, mundësinë e rivendosjes së raporteve normale në mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësinë e zvogëlimit të dëmit palës së dëmtuar, mundësinë e rehabilitimit të të miturit dhe riintegrimin e tij në shoqëri.

Ndonëse ligji nuk e cek shprehimisht, në praktikë edhe palët mund të propozojnë ndërmjetësimin. Me këtë rast, palët duhet ta njoftojnë prokurorin ose gjyqtarin për të mitur, varësisht në cilën fazë është procedura. Prokurori i shtetit ose gjyqtari për të mitur do të vendosin në lidhje me propozimin e palëve për ndërmjetësim, pasi të bëjnë një vlerësim në lidhje me veprën dhe kushtet e përmendura më lart. Në rastet kur plotësohen kushtet ligjore, rasti mund të referohet në ndërmjetësim, kurse në rastet kur këto kushte nuk plotësohen, çështja vazhdon në procedurë penale të rregullt.

7. Procedura e ndërmjetësimit për të mitur

Procedura e ndërmjetësimit për kryerësit e mitur të veprave penale rregullohet në mënyrë të pavarur me KDM. Ky Kod ka paraparë autoritetin i cili e propozon ndërmjetësimin, kriteret në të cilat mbështetet një vlerësim i tillë, atributet dhe përgjegjësitë e ndërmjetësuesit, marrëveshja në procedurën e ndërmjetësimit etj.¹³

Në procedurën e ndërmjetësimit kryerësi i mitur i veprës penale dhe viktimi me vullnetin e tyre të lirë arrijnë marrëveshje, lidhur me mosmarrëveshjen dhe për dëmin e shkaktuar me vepër penale. Për dallim nga neni 232 i KPP, i cili

¹³ Procedura e ndërmjetësimit ndaj kryerësve të mitur të veprave penale është rregulluar me nenet 14, 15, 81 dhe 82 të KDM.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

mundësinë e aplikimit të procedurës për ndërmjetësim për personat madhor e kufizon për vepra penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në 3 (tre) vjet, KDM nuk e përcakton as llojin e veprës penale, e as lartësinë e sanksionit penal, si kushte për t'u aplikuar ndërmjetësimi. Këtë çështje ia lë në vlerësim prokurorit, gjyqtarit për të mitur ose trupit gjykues për të mitur. Prokurori i shtetit, gjyqtari për të mitur apo trupi gjykues për të mitur, mund ta propozojnë ndërmjetësimin nëse e vlerësojnë të përshtatshme për palët, veçanërisht për të miturin. Ata do ta referojnë çështjen në ndërmjetësim duke marrë parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historinë e të miturit, mundësinë e rivendosjes së raporteve normale në mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësinë e zvogëlimit të dëmit palës së dëmtuar, mundësinë e rehabilitimit të të miturit dhe riintegrimin e tij në shoqëri.

Para se të referoj çështjen penale në ndërmjetësim, prokurori ose gjyqtari për të mitur, në pajtim me LNd, duhet t'i njoftoj palët për parimet dhe rregullat e ndërmjetësimit, procedurën, efektet ligjore të marrëveshjes që arrihet përmes ndërmjetësimit etj. Pëlqimi i palëve (të pandehurit të mitur dhe të dëmtuarit) për ndërmjetësim duhet të konstatohet në procesverbal. Procedura e ndërmjetësimit mund të zgjasë më së shumti 90 ditë nga dita kur prokurori apo gjyqtari ka nxjerr aktvendimin për emërimin e ndërmjetësuesit.¹⁴

Sipas nenit 82 të KDM, procedura e ndërmjetësimit përfundon kur:

1. Ka përfunduar me sukses ndërmjetësimi;
2. Ka kaluar afati prej 90 ditësh;
3. Ndërmjetësuesi konsideron se vazhdimi i procedurës së ndërmjetësimit nuk është i mundur ose është i paarsyeshëm, ose
4. I mituri ose pala e dëmtuar deklarojnë se dëshirojnë ta ndërpresin ndërmjetësimin.

Në rastin kur ndërmjetësimi përfundon me sukses dhe arrihet marrëveshja, me aktvendim ndërpritet, përkatësisht pushon procedura penale ndaj kryerësit të mitur të veprës penale. Në rastet kur ndërmjetësimi rezulton pa sukses prokurori, gjyqtari për të mitur ose trupi gjykues për të mitur i cili e ka propozuar ndërmjetësimin, rifillon procedurën e pezulluar nga aty ku ka

¹⁴ Salihu, I: E drejta penale për të mitur, Prishtinë, 2005, fq. 27.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

mbetur. Prokurori i shtetit apo gjyqtari për të mitur duhet t'i njoftojë palët e përfshira në ndërmjetësim me aktvendimin.

Ndërmjetësuesi realizon seanca të veçanta me palët brenda afatit sa zgjatë procedura e ndërmjetësimit, dhe i ndihmon ato në gjetjen e zgjidhjes e cila kurorëzohet me marrëveshje me shkrim. Sipas nenit 81 (8) të KDM, procedura e ndërmjetësimit për të mitur është pa pagesë për palët. Shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit i mbulon Këshilli Prokurorial i Kosovës apo Këshilli Gjyqësor i Kosovës, varësisht se kush e ka referuar çështjen në ndërmjetësim, prokurori i shtetit apo gjyqtari për të mitur.

8. Drejtësia restorative si segment i ndërmjetësimit në sistemin e drejtësisë për të mitur

Drejtësia restorative nënkupton riparimin e dëmit të shkaktuar me veprën penale. Drejtësia restorative është qasje e re në të drejtën penale, e cila ka për qëllim që në vend që të dënoj kryerësit e veprave penale, të bëjë riparimin, përkatësisht kompensimin e dëmit palës së dëmtuar nga kryesi i veprës penale (fajtori).¹⁵

Iniciatorët e drejtësisë restorative janë: Howard Zehr¹⁶, Mark Umbreit¹⁷ dhe Russell Immarigeon¹⁸ (ShBA dhe Kanada). Qëllimi i tyre ishte që përmes drejtësisë restorative të arrihet pajtimi i viktimës me kryesin. Ky program i

¹⁵ Po aty, fq. 27.

¹⁶ Howard Zehr (1944) është profesor i Kriminologjisë në Eastern Mennonite University në Virgjinia, i cili konsiderohet edhe si pionier i konceptit të drejtësisë restorative. Ai udhëheqë institutin i cili mban emrin e tij “Zehr Institute” i cili merret me studime nga lëmi i drejtësisë restorative. Për më shumë vizito: <http://zehr-institute.org/>. Shfletuar më: 22.03.2017.

¹⁷ Mark S. Umbreit (1949) është profesor në Universitetin e Minesotas, themelues i Qendrës së Drejtësisë Restorative dhe Arritjes së Paqes. Ai është promovuesi kryesor i drejtësisë restorative. Veprat e tij lidhen kryesisht me çështjet e drejtësisë restorative, ndërmjetësimit dhe qasjeve tjera alternative të zgjidhjes së çështjeve penale. Për më shumë vizito: <http://www.cehd.umn.edu/ssë/rjp/>. Shfletuar më: 22.03.2017.

¹⁸ Russell Immarigeon (1947) është gjyqtar. Edhe ky autor është njëri ndër ithtarët dhe promovuesit e konceptit të drejtësisë restorative. Për më shumë vizito: <http://www.livingjusticepress.org/>. Shfletuar më: 22.03.2017.

pajtimin për herë të parë është zbatuar në Ontario (Kanada) dhe për realizimin e tij kërkohej angazhimi i ndërmjetësuesit.

Drejtësia restorative bazohet në konceptin se krimi atakon vlerat njerëzore dhe i dëmton marrëdhëniet midis njerëzve. Edhe koncepti i drejtësisë aspirojnë që dëmi i shkaktuar nga vepra penale duhet riparuar, aq sa është e mundur. Ihtarët e drejtësisë restorative besojnë se nuk ka lloj të dëmit i cili në një mënyrë apo masë nuk mund të riparohet. Kjo lloj drejtësie mund të arrihet, kur në kuadër të saj përfshihen të gjitha palët dhe bashkërisht përcaktojnë se si të riparohet dëmi i shkaktuar¹⁹ sepse drejtësia penale përqendrohet në konceptin e dënimit të kryerësit, ndërsa lë anash viktimën dhe nevojat e personave që kanë pësuar nga vepra penale.

Koncepti i drejtësisë restorative aspirojnë në pajtim. Këtë proces e udhëheqë ndërmjetësuesi i angazhuar, detyra e të cilit është që në fillim t'i kontaktoj ndaras viktimën dhe kryerësin, në mënyrë që më vonë t'i pajtoj kundrejt një kompensimi të dëmit si satisfaksion për viktimën. Pajtimi është qëllimi primar, kurse kompensimi vjen vetvetiu, si rezultat i pajtimin. Pajtimi nuk e kënaq vetëm viktimën, por ai ka rëndësi të madhe edhe për kryerësin, dhe shoqërinë, e që si qëllim final është edhe në interes të drejtësisë.

Kompensimi i dëmit është i mundur në bazë të marrëveshjes në mes të viktimës dhe kryerësit të krimit, në lartësinë e kompensimit e cila mund të ekzekutohet edhe përmes procedurës penale të rregullt.²⁰ Zbatimi i këtij programi nuk bëhet në rastet e kryerjes së krimeve seksuale, deliktet e gjakut, sepse në rastet e tilla viktimat dhe familjet e tyre nuk janë të gatshme për këtë, për arsye emocionale dhe peshës së krimit, andaj, ky program zbatohet vetëm në rastet e veprave jo të dhunshme.²¹

Drejtësia restorative edhe në të ardhmen nuk do ta zëvendësojë legjislacionin penal, sepse do të ketë raste kur viktimën nuk është e mundur ta detyrojmë në bashkëpunim dhe në përgjigje për kompensimin e dëmit nga kryerësi i veprës penale, andaj, ajo do të ketë mundësi të zgjidhjes tjetër.²² Shumica e viktimave

¹⁹ Halili, R: Viktimologjia, Prishtinë, 2007, fq. 156.

²⁰ Po aty, fq. 307.

²¹ Ramljak, A. & Halilović, H: Viktimologjia, Sarajevo, 2004, fq. 299.

²² Shih: Lopez, G: Victimologie, Paris, 1997, fq. 166-187.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

të delikteve seksuale dhe delikteve të gjakut nuk dëshirojnë pajtim me kryerësin, sepse ato i janë ekspozuar dhunës dhe agresionit të kryerësit me të cilin të shumtën e rasteve nuk kanë pasur gjë të përbashkët dhe nuk i kanë kontribuar me vetëdije.²³ Për këtë arsye drejtësia restorative ka vështirësi evidente të zbatohet në këto raste.

Drejtësia restorative si koncept i ri i të drejtës penale në tri dekadat e fundit, është duke u konsoliduar dhe masivizuar si zgjidhje alternative në vend të dënimit klasik. Këtë koncept, në masë të caktuar e ka përvetësuar edhe KPK. Në nenin 51 (3) të KPK, krahas dënimit me kusht, si detyrim plotësues është paraparë, që kryerësi të kompensoj dëmin e shkaktuar me vepër penale. Për shkak të natyrës specifike të të miturve, drejtësia restorative është me interes të madh, ngase mundëson edukim dhe rehabilitim, pranohet më lehtë nga palët e dëmtuara kur kihet parasysh se kemi të bëjmë me persona të rinj, të cilët zakonisht kryejnë vepra penale për shkak të mungesës përkujdesjes së duhur, mendjelehtësisë, edukimit joadekuat etj.²⁴ Edhe KDM e ka përvetësuar konceptin e drejtësisë restorative. Në nenin 18 (1, 1,2 dhe 3) është paraparë pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar, pajtimin ndërmjet të miturit dhe familjes së tij, e sidomos kompensimin e dëmit palës së dëmtuar.

Rregullat Minimale Standarde për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit)²⁵ në lidhje me drejtësinë restorative, parashohin një nënkapitull me titull “Detyrimet e restitucionit dhe reparacionit”. Me këto detyrime: 1. Kryerësit e veprave penale ose personat tjerë përgjegjës për sjelljen e tyre, aq sa është e nevojshme, duhet të riparojnë dëmin e shkaktuar viktimave, familjeve të tyre ose personave të lidhur me ta; 2. Shtetet duhet të parashohin në legjisllacionin e tyre restitucionin në çështjet penale; 3. Në rastet kur vepra penale kryhet nga personi zyrtar, viktimat duhet t’u sigurohet

²³ Doerner, W. & Lab, S: *Victimology*, Cincinnati, 2002, fq. 156.

²⁴ Salihu, I: *E drejta penale për të mitur*, fq. 27-28.

²⁵ Rregullat Minimale Standarde për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit), janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën 40/33, datë: 29.11.1985. Eqqashmenë: <http://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/eijingrules.pdf>. Shfletuar më: 10.05.2017.

restitucioni nga shteti. Nëse ky shtet nuk ekziston ky detyrim bartet në entitetin suksesor.²⁶

Shumë nga parimet e lartpërmendura të drejtësisë restorative për të mitur, KDM i ka përfshirë në dispozitat e karakterit parimor dhe në disa dispozita me të cilat rregullohen çështje konkrete. Në nenin 18 të këtij Kodi si lloj i masës së diversitetit ndaj kryerësit të mitur të veprës penale është paraparë edhe kompensimi i dëmit palës së dëmtuar, në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me gjendjen financiare të të miturit. Nga kjo rezulton se KDM paraqet bazë juridike solide për zbatimin e drejtësisë restorative.

8. Marrëveshja në procedurën e ndërmjetësimit

Procedura e ndërmjetësimit realizohet me qëllim që të arrihet marrëveshja ndërmjet palëve. LNd e ka paraparë zgjidhjen sipas të cilës arritja e marrëveshjes është çështje ekskluzive e palëve. Marrëveshja në procedurën e ndërmjetësimit mund të arrihet vetëm me pëlqimin e palëve (të miturit të pandehur dhe viktimës).

Një rol të pazëvendësueshëm në arritjen e marrëveshjes në mes të palëve e luan ndërmjetësuesi, i cili duhet të marr masa për të siguruar se përmbajtja e marrëveshjes së ndërmjetësimit të jetë në proporcion me seriozitetin dhe pasojat e veprës penale.²⁷ Orientim kryesor i ndërmjetësuesit është përkushtimi me seriozitet për t'i ndihmuar palët që të arrijnë marrëveshje.²⁸ Kur ndërmjetësuesi e vlerëson të nevojshme dhe me qëllim të arritjes së marrëveshjes në mes palëve, ai mund të realizoj takime të ndara me to. Ai mund të propozoj alternativa dhe ide se si të zgjidhet çështja penale, por, palët janë të pavarura të vendosin përfundimisht për çështjen. Në çdo rast kur palët arrijnë marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, ndërmjetësuesi përpilon me shkrim marrëveshjen, të cilën e nënshkruajnë palët si dhe ndërmjetësuesi.

²⁶ Salihu, I: E drejta penale për të mitur, fq. 29.

²⁷ Krahaso nenin 228 (2) të KPP.

²⁸ Shih nenin 12 (12.1 dhe 12.2) të LNd.

Marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit është e barasvlershme me dokumentin përfundimtar (vendimin gjyqësor) dhe është i detyrueshëm.²⁹

Edhe pse ligdhënësi ynë nuk e ka paraparë përmbajtjen e marrëveshjes së ndërmjetësimit, por me që ajo përbën dokument formal, medoemos duhet të përmbaj të dhëna për: *palët, përshkrimin e çështjes penale, kushtet dhe detyrimet për të cilat palët pajtohen, zgjidhjen e arritur, vendin dhe datën e arritjes së marrëveshjes, nënshkrimet dhe vulën.*³⁰ E tërë procedura e ndërmjetësimit dhe arritja eventuale e marrëveshjes duhet të bëhet brenda 90 ditësh.³¹

Marrëveshja është e pavlefshme (nule) në rastet kur e cenon rendin publik dhe moralin, është lidhur në kundërshtim me rendin juridik, është ndikuar nga kanosja, dhuna, shtrëngimi ose rrethana tjera të ngjashme. Rrethanat që i bëjnë të pavlefshme punët juridike në përgjithësi vlejné përshtatshmërisht edhe për marrëveshjen në procedurën e ndërmjetësimit. Ajo që vlen të konstatohet është se në raste të tilla, kur marrëveshja është e pavlefshme si dhe në rastet kur palët nuk arrijné marrëveshje për zgjidhjen e çështjes brenda afatit ligjor, çështja kthehet në procedurë penale të rregullt nga fillimi.

9. Roli i ndërmjetësuesit në procedurën e ndërmjetësimit

Ndërmjetësuesi është person fizik në cilësi të palës së tretë, neutral lidhur me çështjen penale, të cilit i është besuar detyra të ndërmjetësoj në mes palëve me qëllim që të zgjidhin mosmarrëveshjen, në pajtim me parimet e procedurës së ndërmjetësimit. Ndërmjetësuesi udhëheqë procedurën e ndërmjetësimit dhe është i thirrur për të ndihmuar palët që të arrijné marrëveshjen dhe pajtimin.³² Ndërmjetësuesi duhet të jetë person i besueshëm, i pavarur dhe me kredibilitet të lartë moral dhe profesional. Vlerësohet se për të qenë i suksesshëm

²⁹ Neni 12 (12.3 dhe 12.4) i LNd.

³⁰ Neni 22 i Ligjit për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve i Republikës së Shqipërisë. Në kuadër të rishikimit të LNd do të duhet që të parashihej edhe përmbajtja e marrëveshjes në procedurën e ndërmjetësimit, sikurse ka vepruar Shqipëria.

³¹ Neni 228 (4) i KPP.

³² Shih nenin 151 (15) të KPK, nenin 15 të KDM si dhe nenin 2 dhe 22 të LNd.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

ndërmjetësimi është e domosdoshme që ndërmjetësuesi të fitoj besimin e palëve.

Një person për të qenë ndërmjetësues duhet t'i përmbush këto kushte: 1. Të ketë diplomë universitare; 2. Të ketë kaluar me sukses kursin e trajnimit për ndërmjetësim; 3. Të ketë ndërmjetësuar në të paktën 6 (gjashtë) seanca në prani të një ndërmjetësuesi; 4. Të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale të dënueshme me mbi 6 (gjashtë) muaj burgim; 5. Të ketë vlera të larta morale; 6. Të jetë i regjistruar në regjistrin e ndërmjetësuesve.³³ Përveç këtyre kushteve, kur kemi të bëjmë me ndërmjetësimin për të mitur, rekomandohet që ndërmjetësuesi të ketë trajnime të veçanta në lidhje me edukimin dhe mirëqenien e fëmijëve.

Roli ndërmjetësuesit është që përmes komunikimit konstruktiv dhe shtrimit objektiv të çështjes, t'i ndihmoj palët që të arrijnë marrëveshje dhe pajtim. Kur çështja gjendet në gjykatë, një kopje identike e marrëveshjes së arritur i dërgohet gjykatës, e cila pasi e aprovon atë, ajo fiton fuqinë e titullit ekzekutiv, sikurse vendimi gjyqësor.³⁴ Nëse çështja është referuar në ndërmjetësim nga prokurori i shtetit, ai do ta hedh kallëzimin penal, pasi të njoftohet për marrëveshjen e arritur në mes të palëve. Njoftimi i tillë rezulton me pushimin e çështjes penale, përveç rasteve kemi të bëjmë me pavlefshmëri të marrëveshjes. Palët duhet ta zbatojnë marrëveshjen e arritur kurse gjykata e obligon shërbimin përmbartimor kompetent për mbikëqyrjen e ekzekutimit të saj në praktikë.³⁵

Përfundim

Nga rezultatet modestet të këtij punimi në lidhje me ndërmjetësimin në procedurë penale për të mitur, mund të nxirren këto përfundime kryesore:

³³ Roli, të drejtat dhe detyrimet e ndërmjetësuesit në procedurën penale janë përcaktuar në nenin 22 të LN-d si dhe në nenin 15 të KDM.

³⁴ Shih nenin 12 (12.5) të LN-d.

³⁵ Neni 23 i Ligjit për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Republikës së Shqipërisë.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

- Ndërmjetësimi paraqet një institut të rëndësishëm shoqëror dhe juridik. Në aspektin shoqëror ai daton që moti, në kuadër të të drejtës sonë zakonore, kurse në aspektin juridik, veçmas atë penal ka hyrë në aplikim relativisht vonë.
- Ndërmjetësimi ka për qëllim që në pajtim me rregullativën ligjore në fuqi t'u ndihmoj palëve në kontest që përmes marrëveshjes së arritur në procedurë jashtëgjyqësore ta zgjidhin atë dhe të arrijnë pajtimin.
- Ndërmjetësimin e aplikojnë shumica e vendeve, kurse Kosova më 2008 e ka nxjerrë ligjin me të cilin e ka rregulluar ligjërisht këtë institut, por aplikimi i tij ka filluar disa vite më vonë. Vendet e përmendura kanë krijuar një praktikë solide të aplikimit të ndërmjetësimit në shumë fusha të së drejtës, veçmas në atë penale. Si shembuj të mirë në këtë aspekt vlen të përmenden Republika e Kroacisë dhe e Shqipërisë.
- Sipas rregullativës ligjore në fuqi, ndërmjetësimi mund të aplikohet në çështjet penale që për objekt kanë veprat penale për të cilat është paraparë si sanksion penal dënimi me gjobë ose me burgim deri në 3 (tri) vjet.
- Ndërmjetësimi si procedurë alternative mundëson shkarkimin e punës së gjykatave si dhe i kursen palët nga ekspozimi i procedurës penale, i cili nuk paraqet ndjesi të mirë. Përmes ndërmjetësimit palët shumë më shpejt, me më pak shpenzime dhe në mënyrë më efikase arrijnë të zgjidhin çështjen penale.
- Për realizimin me sukses të procedurës së ndërmjetësimit përpilohet marrëveshje me shkrim e cila pasi të njihet nga gjykata fiton fuqinë e titullit ekzekutiv. Marrëveshja si e tillë paraqet kurorëzim të rezultateve të arritura në procedurën e ndërmjetësimit.
- Sipas të dhënave të përdorura, nuk dihet numri i saktë i çështjeve penale për të mitur të zgjidhura me ndërmjetësim, sepse të dhënat e

siguruara nuk janë të ndara për madhor dhe të mitur, andaj dhe nuk dihet numri i saktë. Duke u bazuar në përparësitë e shumta që ka ndërmjetësimi në raport me procedurën penale të rregullt, është e domosdoshme që të promovohet më shumë si dhe të inkurajohen prokuroritë dhe gjykatat tona që ta aplikojnë atë, çdoherë kur plotësohen kushtet e parapara me ligj.

Literatura

Libra dhe artikuj:

- **Doerner, William & Lab, Steven:** Victimology, Cincinnati, 2002
- **Elezi, Ismet:** Statutet e Shkodrës, dokument me rëndësi juridike e historike, E drejta, nr. 4, Prishtinë, 2010.
- **Gjeçovi, At Shtjefën:** Kanun i Lekë Dukagjinit, Prishtinë, 2001.
- **Halili, Ragip:** Viktimologjia, Prishtinë, 2007.
- **Hajdari, Albulena & Krasniqi, Milot:** Ndërmjetësimi si qasje e re e zgjidhjes alternative të çështjeve penale, Avokatura, nr. 13, Prishtinë, 2012.
- **Hajdari, Azem:** I. Sistemi i drejtësisë për të mitur-Komentar, Prishtinë, 2010.
- **Hajdari, Azem:** II. E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2015.
- **Hajdari, Azem:** IV. Procedura penale-Komentar, Prishtinë, 2016.
- **Hajdari, Azem:** V. E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005.
- **Krasniqi, Milot:** Nocioni i kompensimit dhe zhdëmtimit të viktimave të krimit, Juristi, nr. 1, Prishtinë, 2010.
- **Lopez, Gerard:** Victimologie, Paris, 1997.
- **Ramljak, Alija & Halilović, Haris:** Viktimologjia, Sarajevo, 2004.
- **Sahiti, Ejup & Murati, Rexhep:** E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2014.
- **Salihu, Ismet:** I. E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2008.
- **Salihu, Ismet:** II. E drejta penale, pjesa e posaçme, Prishtinë, 2009.
- **Salihu, Ismet:** III. E drejta penale për të mitur, Prishtinë, 2005.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Akte normative:

- Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale i Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 37, datë 28.12.2012).
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur (Gazeta Zyrtare nr. 78, datë 20.08.2010).
- Ligji nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim (Gazeta Zyrtare, nr. 28, datë 04.06.2008).
- Ligji nr. 10/385 për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve i Republikës së Shqipërisë, (datë 24.02.2011).
- Rregullore mbi Regjistrimin e Ndërmjetësve, (Komisioni për Ndërmjetësim, datë 23.05.2011).
- Rregullore për Trajnimin dhe Certifikimin e Ndërmjetësve (Komisioni për Ndërmjetësim, datë 23.05.2011).
- Rregullat Minimale Standarde për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit), miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën 40/33, datë: 29.11.1985.

Burime tjera:

- Grup autorësh, Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 2002.
- Oda e Avokatëve e Kosovës, Doracak trajnimi për avokatët në fushën e drejtësisë për fëmijë, Prishtinë.
- USAID, Mission in Kosovo, Manual trajnimi - Ligji për Ndërmjetësimin, Prishtinë, 2013.

Shpend BINAJ*

MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT NË PROCEDURË PENALE ME THEKS TË VEÇANTË-DORËZANIA

Abstrakt:

Në kohë të fundit jemi dëshmitarë të zbatimit të shpeshtë të masave për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale. Si masë për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale janë: thirrja, urdhër arresti, premtimi i të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin, ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar, paraqitja në stacionin policor, dorëzania, arresti shtëpiak, diversioni dhe paraburgim. Këto masa përdoren me qëllim që zhvillimi i procedurës penale të ketë rrjedhë normale dhe aq sa është e mundur, të procedohet në përputhje me afatet e përcaktuara, gjegjësisht të synuara me KPP. Rrjedhimisht me këtë, është paraparë mundësia e ndërmarrjes së masave që në fakt sjellin deri te heqja ose kufizimi i lirive dhe të drejtave të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura penale.

Qëllimi i zbatimit të këtyre masave është: sigurimi i pranisë së të pandehurit, pengimi i përsëritjes së veprës penale dhe sigurimi i zhvillimit të suksesshëm të procedurës penale.

Këto masa i vendos gjykata përkatësisht gjyqtari i procedurës paraprake me propozim të Prokurorit të shtetit dhe udhëhiqet me parimin e ligjshmërisë, të gradualitetit, të proporcionalitetit dhe kontrollit gjyqësor “ex officio” të zbatimit të tyre dhe njëherë secila masë që caktohet nga gjyqtari i procedurës paraprake duhet të ketë parasysh kushtet e përcaktuara ligjore për masat konkrete dhe të sigurojë që të mos zbatohet masë më të rëndë (paraburgimi) kur mjafton masa më e butë.

* Autori ushtron funksionin e Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë Themelore të Prizrenit.

Fjalët kyçe: Masat, sigurimi i pranisë së të pandehurit, procedurë penale, prokurori i shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake, dorëzania.

Hyrje

Tema e cila do të trajtohet në këtë punim emërtohet “Masat për sigurimin e pranisë së të Pandehurit me theks të veçantë - Dorëzania“.

Qëllimi i punimit është trajtimi i masave të cilat mund të përdoren për të siguruar praninë e të pandehurit, për pengimin e ri-kryerjes së veprës penale dhe për zbatimin e suksesshëm të procedurës penale siç janë: Thirrja, urdhër arresti, premtimi i të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin, ndalimin për të t’iu afruar vendit ose personit të caktuar, paraqitjen në stacionin policor, dorëzania, arresti shtëpiak, diversioni, si dhe paraburgimi. Të gjitha këto masa janë të parapara edhe në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (më tej: KPP).¹ Në kuadër të këtij punimi, ndër të tjera do të trajtohen edhe kushtet, dhe forma e ekzekutimit të masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit. Në kuadër të këtij punimi kam nxjerrë edhe konkluzionet (përfundimet) dhe rekomandimet.

1. Shqyrtime të përgjithshme mbi masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, me theks të veçantë-dorëzania

Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit, për pengimin e kryerjes së veprës penale dhe për sigurim të zhvillimit me sukses të procedurës penale, në esencë, janë masa të cilat hapin shtigje, krijojnë kushte për ndërmarrjen e veprimeve procedurale përmes të cilave vërtetohen faktet relevante të rëndësishme për realizimin e qëllimit përfundimtar të procedurës penale. Këto masa mund t’i ndajmë në dy grupe: Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit dhe pengimin e kryerjes së veprës penale si parakusht për zhvillim

¹ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Kodi nr.04/L-123, G.Z., nr.37/2012.

të suksesshëm të procedurës penale, dhe masat për sigurimin e gjësendeve të nevojshme për zhvillim të suksesshëm të procedurës penale.²

Procedura penale zhvillohet me pjesëmarrjen e shumë subjekteve procedurale. Për sigurimin e pranisë së tyre KPP parasheh disa masa të cilat janë të natyrës së ndryshme dhe pikësëpari kanë të bëjnë me thirrjen e subjektit procedural, mirëpo ndaj disa subjekteve mund të ndërmerren edhe masa të tjera deri te kufizimi i lirisë (ndaj të pandehurit). Në mesin e masave të cilat i shërbejnë këtij qëllimi bëjnë pjesë edhe ato me anë të të cilave sigurohet prania e subjekteve procedurale në procedurë penale. Këto masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit dhe pengimin e kryerjes së veprës penale janë të llojllojshme dhe mund të zbatohen në të gjitha fazat e procedurës penale. Si masa të tilla KPP i parasheh: Thirrjen, urdhër-arrestin, premtimin e të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimin për t'iu afuar vendit ose personit të caktuar, paraqitjen në stacionin policor, dorëzimin, arrestin shtëpiak, diversionin dhe paraburgimin. Këto masa, në masë të madhe i referohen personit të pandehur.³

Gjykata me rastin e vendosjes se cilën nga masat do ta zbatojë për të siguruar praninë e të pandehurit në procedurën penale, duhet t'i marrë parasysh kushtet e përcaktuara për zbatim të masës konkrete si dhe të sigurojë që të mos zbatojë masë më të rëndë kur për arritjen e qëllimit mjafton zbatimi i masës më të butë, masa këto të cilat hiqen kur pushojnë shkaqet që i kane shkaktuar apo zëvendësohen me masa të tjera. Para ngritjes së aktakuzës vendimet lidhur me këto masa i merr gjyqtari i procedurës paraprake, ndërsa pas ngritjes së aktakuzës vendimet i merr gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues.⁴

2. Llojet e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale

Si masa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, për pengimin e ri kryerjes së veprës penale dhe për zbatimin e suksesshëm të

² Azem Hajdari: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2006, fq. 165.

³ Ejup Sahiti: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005, fq. 114.

⁴ Po aty, fq. 115.

procedurës penale janë ato të dispozitave të nenit 173 të KPPRK: Thirrjea, urdhër-arresti, premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar, paraqitja në stacionin policor, dorëzania, arresti shtëpiak, diversioni dhe paraburgimin. Këto masa, në masë të madhe i referohen personit të pandehur.

2.1 Thirrja

Prania e të pandehurit në procedurë penale sigurohet nëpërmjet thirrjes. Thirrja është masa themelore dhe më e butë nëpërmjet të cilës sigurohet prania e të pandehurit në procedurë penale. Gjykata, thirrjen të pandehurit i'a dërgon me letër të mbyllur, e cila si rregull, përmban: emrin dhe mbiemrin e të pandehurit, përcaktimin e veprës penale me të cilën ngarkohet, vendin, ditën dhe orën kur i pandehurit duhet të paraqitet, njoftimin se thirret në cilësi të pandehurit, paralajmërimin që në rast të mosparaqitjes kundër tij do të lëshohet urdhër arresti ose do të silltet forcërisht në gjykatë, vulën zyrtare dhe emrin e gjyqtarit që thërret.⁵

Kur i pandehuri thirret për herë të parë, në thirrje njoftohet për të drejtën e tij për të angazhuar mbrojtësin, i cili mund të asistoj gjatë marrjes së tij në pyetje. I pandehuri duhet menjëherë ta njoftoj gjykatën për çdo ndryshim të adresës së tij ose për qëllime që ta ndërrojë vendqëndrimin. I pandehuri njoftohet për këtë detyrim në rastin e marrjes në pyetje për herë të parë ose me rastin e dorëzimit të aktakuzës dhe njëkohësisht paralajmërohet për pasojat e mos përmbushjes së detyrimit siç është paraparë edhe me kodin e procedurës penale. Kur i pandehuri nuk është në gjendje t'i përgjigjet thirrjes për shkak të sëmundjes ose pengesës tjetër të paevitueshme, ai pyetet në vendin ku gjendet ose dërgohet në ndërtesën e gjykatës apo në vendin tjetër ku është duke u zbatuar procedura ose shtyhet marrja e tij në pyetje.⁶

⁵ Azem Hajdari: Kodi i procedurës penale, Prishtinë, 20016, fq.461.

⁶ Ejup Sahiti: Vep.cit, fq.114.

2.2 Urdhër arresti-Shoqërimi

Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sipas detyrës zyrtare mund të lëshojnë urdhër arrest me kërkesë të prokurorit të shtetit, ose në rrethana të ngutshme me kërkesë të policisë kur ekzistojnë kushtet nga paragrafi 1 i nenit 187 të Kodit të Procedurës Penale, ose kur i pandehuri i cili pasi është thirrur në mënyrë të rregullt nuk paraqitet dhe nuk e arsyeton mungesën e tij ose kur thirrja nuk ka mundur t'i dërgohet sipas rregullit dhe kur sipas rrethanave është e qartë se i pandehuri i shmanget pranimit të thirrjes.⁷

Urdhër arresti lëshohet me shkrim dhe si rregull, ai duhet të përfshijë: emrin dhe mbiemrin e personit i cili do të arrestohet dhe të dhënat tjera personale të njohura për gjyqtarin, përcaktimin e veprës penale me të cilën ngarkohet duke iu referuar dispozitës përkatëse të KP-, bazën mbi të cilën lëshohet urdhëri, vulën zyrtare dhe nënshkrimin e gjyqtarit që e ka lëshuar urdhër arrestin.⁸

Urdhër arrestin e ekzekuton policia. Oficeri i policisë i ngarkuar për ekzekutimin e urdhrit ia dërgon urdhrin të pandehurit dhe kërkon nga ai që të shkojë me të. Kur i pandehuri këtë e refuzon, atëherë shoqërohet forcërisht dhe dërgohet para gjyqtarit i cili e ka lëshuar urdhrin. Në kohën e arrestimit personi informohet në gjuhën që e kupton për arsyet e arrestimit dhe për të drejtat që i takojnë me atë rast.⁹

Sipas zgjidhjes së përcaktuar, me dispozitat e nenit 175 paragrafi 1 të KPPRK, urdhër arrestin mund ta lëshojë gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, ku secili nga këto subjekte masën në fjalë, si rregull, mund ta lëshojë sipas detyrës zyrtare ose mbi bazën e kërkesës së prokurorit të shtetit. Në këto është e paraparë se urdhër arresti, në rrethana të ngutshme, mund të lëshohet edhe me kërkesën e policisë. Rrethanat që determinojnë një mundësi të tillë, i referohen atyre që kanë të bëjnë me bazat e dyshimit se i pandehuri ka kryer veprë penale, se ai mund të fshihet ose ikë, asgjësojë e fshehtë ose falsifikojë provat e veprës penale, pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarin, të dëmtuarin ose

⁷ Azem Hajdari: Kodi i procedurës penale - Komentar, Prishtinë, 2016, fq. 463-464.

⁸ Azem Hajdari: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2006, fq. 167.

⁹ Ejup Sahiti: vep. e cit, fq. 115.

bashkëpjesëmarrësit në krim, dhe kur pesha e veprës penale, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer ajo. Më tej, karakteristikat personale të kryerësit, jeta e tij e mëparshme, tregojnë rrezikun se ai mund të përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale, ose kur i pandehuri i cili është thirrur me rregull nuk paraqitet dhe nuk e arsyeton mungesën e tij, si dhe kur rrethanat ekzistuese e bëjnë të qartë faktin se ai do të përpiqet ti shmangët detyrimit ndaj thirrjes.¹⁰

Gjatë analizës që mund t'i bëhet dispozitës së nenit 175 të KPPRK vlen të analizohen tri çështje. E para ka të bëjë me formësimin e urdhër arrestit, ku në fakt që të prodhojë efekte juridike, urdhërarresti duhet të përpilohet në formë të shkruar, që e manifeston formën konkrete të aktit. Çështja e dytë është ajo që i referohet përmbajtjes së urdhër arrestit dhe që duhet të përmbajë këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin e personit i cili duhet të arrestohet dhe të dhënat e tjera personale të njohura për gjyqtarin paraprak. Ndërsa, çështja e tretë ka të bëjë me kohën e skadimit të efekteve të urdhër arrestit ku sipas zgjidhjes së dhënë në këtë paragraf nëse nuk përcaktohet ndryshe në urdhëresë, urdhër arresti skadon në mesnatën e ditës së (365) nga dita e lëshimit të tij.¹¹

2.3 Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin

Gjykata gjatë procedurës mund të kërkojë nga i pandehuri premtimin se nuk do të fshihet ose largohet nga vendqëndrimi pa lejen e gjykatës, kur ekziston dyshim i bazuar se ai ka kryer veprë penale dhe ka arsye për dyshim si i pandehuri mund të fshihet, të shkojë në vend të panjohur ose të largohet nga Kosova. Premtimi i dhënë shënohet në procesverbal.¹²

Dokumenti i udhëtimit të pandehurit, i cili detyrohet me premtimin e dhënë mundë të konfiskohet përkohësisht. Ankesa kundër aktvendimit për konfiskimin e dokumentit të udhëtimit nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.¹³ Me rastin e dhënies së premtimit duhet të përpilohet procesverbali me ç 'rast paralajmërohet i pandehuri se kundër tij mund të

¹⁰ Azem Hajdari: Kodi, fq. 464.

¹¹ Po aty, fq.465.

¹² Po aty, fq. 467.

¹³ Po aty, fq. 467.

caktohet paraburgimi, po që se nuk i përmbahet premtimit. Premtimi të pandehurit mund të zbatohet si masë e pavarur, por mund të zbatohet edhe si masë plotësues me dorëzaninë.¹⁴

Gjykata që cakton masën e premtimit të të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin, mund të vendosë që të pandehurit t'i konfiskohet përkohësisht dokumenti i udhëtimit. Kundër aktvendimit për konfiskim të dokumentit mund të ushtrohet ankesë, por ajo nuk ka forcën që të pezullojë ekzekutimin e tij.¹⁵

Premtimi i të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin konsiston në kufizimin e lirisë së qarkullimit të pandehurit pa heqje të lirisë. Kjo masë zbatohet në rastet kur nevojat e sigurimit të prezencës së të pandehurit plotësohen edhe pa qenë i domosdoshëm paraburgimi i tij. Kjo masë është e përshtatshme të zbatohet ndaj grave, të sëmurëve dhe të moshuarave. Me këtë masë i pandehuri nuk izolohet plotësisht nga shoqëria, ai ruan të drejtën e komunikimit me personat me të cilët bashkëjetojnë, por i kufizohet komunikimi me persona të tjerë, ne përputhje me nevojat e sigurimit¹⁶.

Me nenin 176 (par. 3) të KPP, rregullohet çështja e paralajmërimit të pandehurit për pasojat me të cilën ai shkelë premtimin e dhënë me rastin e caktimit të masës së premtimit të të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin.¹⁷ I pandehuri duhet të paralajmërohet se ndaj tij mund të caktohet paraburgimi po që se e shkelë premtimin e dhënë. Shkelja e premtimit ekziston atëherë kur i pandehuri largohet nga vendbanimi ose vendqëndrimi i tij, i shmanget thirrjes, përhapë informata se ka shkuar në ndonjë vend tjetër. Për një zëvendësim të tillë duhet marrë në konsideratë peshën, motivet dhe rrethanat e shkeljes së premtimit, kjo masë mund të zbatohet si e pavarur, por edhe si masë plotësues me dorëzaninë.¹⁸

2.4 Ndalimi për t'iu afruar vendit apo personit të caktuar

¹⁴ Ejup Sahiti: vep. e cit, fq. 115.

¹⁵ Azem Hajdari: E drejta e procedurës, fq. 168.

¹⁶ Azem Hajdari: Kodi, fq. 467.

¹⁷ Po aty, fq. 469.

¹⁸ Po aty, fq. 469.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Ndalimi i të pandehurit për t'iu afruar vendit apo personit të caktuar është masë të cilën gjykata kompetentet e ndërmerr me qëllim të pengimit të ri kryerjes së veprës penale ,ose me qëllim që të sigurohet zhvillimi i suksesshëm i procedurës penale. Gjykata do ta zbatojë këtë masë kur: Ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale dhe kur ekziston rreziku se i pandehuri do të fshihet ose kur ekzistojnë rrethana që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij ose kur ndalimi i tij mund të zvogëlojë rrezikun që i pandehuri t'i asgjësojë provat e veprës penale, të ndikojë në dëshmitarët, në bashkëkryerës ose bashkëpjesëmarrës pas kryerjes së veprës, në përsëritjen e veprës penale, në përfundimin e veprës penale të tentuar ose në kryerjen e veprës penale të kanosur.¹⁹

Gjykata vendos për këtë masë me aktvendim të arsyetuar, në të shënohen kushtet e plotësuar për caktimin e masës dhe përcaktohen largësinë përkatëse nga vendi i caktuar ose nga personi të cilën i pandehuri duhet ta respektojë, aktvendimi i dërgohet të pandehurit dhe mundësisht, personit të mbrojtur nën këtë masë.²⁰

Gjykata urdhëron paraburgim nëse i pandehuri shkel aktvendimin, i pandehuri gjithmonë njoftohet me kohë për pasojat e mosbindjes. Nëse personi i mbrojtur me këtë masë qëllimisht cenon distancën të cilën i pandehuri detyrohet ta respektojë, gjykata mund ta dënojë personin e mbrojtur me gjobë siç parashihet në neni 444 të KPP. Për zgjatjen e masës nga ky nen para ngritjes së aktakuzës vendos gjyqtari i procedurës paraprake sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të prokurorit të shtetit.²¹

Me anë të kësaj mase personit të caktuar i ndalohet vajtja në një vend të caktuar, i cili mund të jetë një ose më shumë fshatra apo komuna si dhe shoqërimi me personin e caktuar, që po ashtu mund të jetë një apo shumë persona të tillë. Kjo masë është e përshtatshme të shqiptohet ndaj personave që dyshohen se kryejnë vepra penale në më shumë vende dhe që do i kryejnë në bashkëpunim.²²

¹⁹ Azem Hajdari: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2006, fq.168-169.

²⁰ Ejup Sahiti: Vep.cit, fq.115.

²¹ Azem Hajdari: Kodi i procedurës penale, Prishtinë, 2016, fq.470.

²² Po aty, fq.470.

2.5 Paraqitja në stacionin policer

Paraqitja në stacionin policor parashihet me dispozitat e nenit 178 të KPPRK, është gjithashtu masë e cila është në funksion të sigurimit të prezencës së të pandehurit në procedurën penale. Përmes zbatimit të kësaj mase gjykata vendos që i pandehuri të paraqitet herë herë në kohë të caktuar në stacionin policor, në regjionin ku i pandehuri ka vendbanimin apo vendqëndrimin, ose vendin ku i pandehuri është ndodhur në momentin e dhënies së urdhrit, për dallim nga masa ndalimi për t'iu afruar vendit apo personit të caktuar që është rregulluar me dispozitat e nenit 177 të KPPRK e cila mund të caktohet kur ekzistojnë ndonjëri prej shkaqeve për paraburgim sipas dispozitave të nenit 187 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 pikat 1.2.2 dhe 1.2.3, masën e paraqitjes në stacionin policor gjykata e cakton kur: Ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale dhe ka arsye për të dyshuar se i pandehuri do të fshihet, do të shkojë në vend të panjohur ose do të largohet nga Kosova,²³, siq po shihet kushtet për masën e paraqitjes në stacionin policor sipas dispozitave të nenit 178 paragrafi 1 pika 1.1 dhe 1.2 të KPPRK (të cekura më lartë) janë po ato për të cilat mund propozojë zbatimin masës premtimi i të pandehurit se nuk do të braktis vendqëndrimin

Gjykata vendos për këtë masë me aktvendim të arsyetuar në të shënon kushtet e plotësuar për caktimin e masës, aktvendimi i dërgohet të pandehurit dhe stacionit policor përkatës në territorin e të cilit duhet të zbatohet masa. Nëse i pandehuri shkel aktvendimin, gjykata urdhëron paraburgimin, i pandehuri gjithmonë njoftohet me kohë për pasojat e mosbindjes. Personit i cili i nënshkruhet masës paraqitja në stacionin policor mund t'i konfiskohet përkohësisht dokumenti i udhëtimit. Ankesa kundër aktvendimit mbi konfiskimin e përkohshëm të dokumentit të udhëtimit nuk e pezullon ekzekutimin.²⁴

²³ Azem Hajdari: E drejta e procedurës, ..., fq. 169.

²⁴ Ejup Sahiti: vep.cit, fq. 116.

2.6 Dorëzania

Dorëzania si masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale parashihet me dispozitat nenit 179 të KPPRK dhe nënkupton deponimin e shumës së caktuar të parave nga i pandehuri apo dikush tjetër në emër të tij si zëvendësim për paraburgim, kur paraburgimi do të caktohej apo është caktuar për shkak të rrezikut nga ikja, ose do të kryej vepër penale të një intensiteti të caktuar.²⁵

Gjykata mund të urdhërojë që i pandehuri të mbrohet në liri, ose të lirohet nga paraburgimi përmes deponimit të parave kur: ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale, ekziston rreziku që i pandehuri të ikë, nuk dyshohet për vepër penale të dënueshme me të paktën 5 (pesë) vjet burgim, ekziston rreziku se i pandehuri mund të përsërisë veprën penale, të përfundojë veprën e tentuar penale, ose të kryej veprën penale të cilën është kanosur ta kryej, premtan se nuk do të fshihet ose pa leje nuk do të braktisë vendqëndrimin e tij dhe premtan se nuk do ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryej veprën penale të cilën është kanosur ta kryej.²⁶

Dorëzania caktohet ose hiqet me aktvendim të arsyetuar të gjyqtarit të procedurës paraprake apo të kryetarit të trupit gjykues pas dëgjimit të mendimit të prokurorit të shtetit, nëse vepra penale ndiqet sipas detyrës zyrtare, dhe mendimit të pandehurit ose mbrojtësit. Caktimi i dorëzanisë mund të shoqërohet me marrjen e dokumentit të udhëtimit nga i pandehuri. Ankesa kundër aktvendimit nuk e pezullon ekzekutimin. Dorëzania gjithmonë ka të bëjë me shumë parash që caktohet duke marrë parasysh peshën e veprës penale, rrethanat personale dhe familjare të pandehurit dhe gjendjen pasurore të personit që ofron dorëzani.²⁷

Dorëzania mundë të jepet me para të gatshme, me letra me vlerë, sende të vlefshme dhe me pasuri të tjera të luajtshme me vlerë të konsiderueshme të cilat lehtë mund të shndërrohen në para dhe të ruhen (ari, pajisje të amvisërisë etj.) me vënien e hipotekës për shumën e dorëzanisë mbi vlerat e paluajtshme

²⁵ Po aty, fq. 116.

²⁶ Azem Hajdari: E drejta e procedurës, ..., fq. 170.

²⁷ Ejup Sahiti: vep. e cit, fq. 117.

të personit që jep dorëzanin, ose me detyrim personal të një ose më shumë personave që në rast të ikjes së të pandehurit zotohen të paguajnë shumë e caktuar të dorëzanisë.²⁸

Po që se i pandehuri që gjendet nën dorëzanin, përkundër premtimit të dhënë, nuk u përmbahet kushteve të dorëzanisë nuk paraqitet në thirrje të rregullt dhe mungesën nuk e arsyeton, përgatitet të ikë, apo e përsërit, e përfundon ose e kryen veprën penale, ose kur kundër tij, pasi është lënë në liri paraqitet ndonjë bazë tjetër ligjore për paraburgim, dorëzania hiqet me aktvendim. Nëse i pandehuri ikë ose përsëritë, përfundon ose kryen veprën penale për të cilën është kanosur se do ta kryejë, caktohet që vlera e dhënë si dorëzani të derdhet në buxhet, i pandehuri gjithmonë njoftohet për pasojat e mosrespektimit të masës së dorëzanisë.²⁹

Dorëzania hiqet kur procedura penale pushohet me aktvendim të formës së prerë ose me aktgjykim të formës së prerë, në këtë rrjedhë, kur i pandehuri dënohet me burgim. Dorëzania hiqet vetëm pasi ai të ketë filluar vuajtjen e dënimit. Me heqjen e dorëzanisë, paratë e gatshme të depozituara, letrat me vlerë, sendet me vlerë dhe sendet tjera të luajtshme me vlerë të konsiderueshme kthehen dhe hipotekat hiqen.³⁰

2.7 Aktvendimi mbi dorëzaninë

Gjykata me aktvendim të arsyeshëm vendos mbi masën, aktvendimi mbi dorëzaninë parashihet me dispozitat e nenit 180 dhe duhet të përmbajë arsyetimin që përcakton se janë plotësuar kushtet e dorëzanisë siç parashihen me dispozitat nenit 179 i KPPRK dhe nevojën për masën e tillë. Para ngritjes së aktakuzës, aktvendimi mbi dorëzaninë merret nga gjyqtari i procedurës paraprake ndërsa pas ngritjes së aktakuzës nga gjyqtari i vetëm i gjykues apo kryetari i trupit gjykues. Aktvendimi me të cilën dorëzania pranohet dhe aktvendimi me të cilën ajo anulohet merren pas dëgjimit të mendimit të prokurorit të shtetit, nëse vepra penale ndiqet sipas detyrës zyrtare, dhe mendimit të pandehurit ose mbrojtësit. Aktvendimi i dorëzohet të pandehurit,

²⁸ Azem Hajdari: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2006, fq.171.

²⁹ Ejup Sahiti: Vep.cit, fq.117.

³⁰ Azem Hajdari: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2006, fq.171.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

personit që i nënshtrohet aktvendimit me dorëzani i konfiskohet përkohësisht dokumenti i udhëtimit, përveç nëse ka arsye bindëse për gjykatën që të mos konfiskojë dokumentin e udhëtimit.³¹

Ankesa kundër aktvendimit nuk e ndal ekzekutimin e tij kur ekziston “ arsye bindëse” për mos sekuestruar dokumentin e udhëtimit është çështje faktike e cila i është lënë për vlerësim gjykatës, situata e tillë do të ishte p.sh kur i pandehuri duhet patjetër t’i nënshtrohet mjekimit në ndonjë institucion specialistë jashtë vendit, kur për mjekim të atij lloji nuk ekziston institucion mjekësor adekuat, ose kur i pandehuri jashtë duhet urgjent të japë deklaratë për trashëgiminë sepse në të kundërtën do t’i ekspozohet dëmit të madh material e të ngjashme.³²

2.8 Përmbajtja e Dorëzanisë

Dorëzania gjithmonë përkufizohet si shumë e parave e përcaktuar sipas peshës së veprës penale, rrethanave personale dhe familjare të pandehurit dhe gjendjes materiale të personit që e jep dorëzani. Dorëzania mund të jepet me para të gatshme, me letra me vlerë, sende të vlefshme dhe me pasuri të tjera të luajtshme me vlerë të konsiderueshme të cilat lehtë mund të shndërrohen në para dhe të ruhen. Me vënien e hipotekës për shumën e dorëzanisë mbi vlerat e paluajtshme të personit që jep dorëzani ose me detyrim personal të një apo më shumë personave që në rast të ikjes së të pandehurit zotohen të paguajnë shumën e caktuar të dorëzanisë. Nëse i pandehuri ik, me aktvendim të gjykatës caktohet që vlera e dhënë si dorëzani të derdhet në fondin për kompensimin e viktimave.³³

Dorëzania mund të jetë dorëzani reale ose dorëzani personale. Pavarësisht nga lloji i saj, dorëzania gjithëherë përcaktohet në një shumë parash të caktuar. Dorëzania është reale kur shumat për caktimin e saj jepet me para të gatshme, me lënien peng të sendeve me vlerë të konsiderueshme të cilat lehtë mund të shndërrohen në para dhe të ruhen, ose me hipotekë për shumën e dorëzanisë

³¹ Azem Hajdari: Kodi i procedurës penale, Prishtinë, 2016, fq.480-481.

³² Ejup Sahiti, Rexhep Murati & Xhevdet Elshani: Komentari i Kodit të Procedurës Penale, Prishtinë, 2014, fq.474-.475.

³³ Azem Hajdari: Kodi i procedurës penale, Prishtinë, 2016, fq.483.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

mbi vlerat e paluajtshme të personit që jep dorëzaninë. Lartësia e shumës së dorëzansisë nuk është përcaktuar konkretisht, pranimi ose mospranimi i propozimit për lirim nga paraburgimi me dorëzani i është lënë vlerësimi të gjyqtarit, i cili nuk lejon dorëzanin kur çmon se ajo nuk është e mjaftueshme të sigurojë praninë e të pandehurit. Shuma e dorëzansisë nuk duhet të caktohet në lartësi të cilën garanti nuk mund ta përmbush, as nuk siguron praninë e të pandehurit. Pranimi i sendeve të vlefshme (stolit ari, para ari) në dispozitën gjyqësor do duhej të kryhet në prani të personit profesional i cili mund të përcaktojë se për çfarë sendi është fjala dhe cila është vlera e saj, shpenzimet rreth përcaktimit të vlerës së sendeve të vlefshme i paguan propozuesi i dorëzansisë.

Dorëzania personale është një premtim personal me të cilin një apo më shumë persona (jo i pandehuri) zotohet se në rast të ikjes së të pandehurit do të paguajnë shumën e caktuar të dorëzansisë, por që shumën e tillë paraprakisht nuk e paguajnë as që vihet kufizimi në pasurinë e tyre. Propozuesi i dorëzansisë personale i prezanton gjykatës deklaratën e vërtetuar me të cilën merr përsipër obligimin për shumën saktë të përcaktuar të dorëzansisë.³⁴

Një shembull i caktimit të masës së dorëzansisë:

Ppr.nr.

GJYKATA THEMELORE, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e procedurës paraprake , me bashkëpunëtorin profesional, në lëndën penale kundër të pandehurit NN, nga fshati NN – Komuna e NN, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par. 2 të KP-së, duke vendosur sipas kërkesës së Prokurorisë Themelore në, Departamenti i Përgjithshëm për caktimin e paraburgimit PP/II.nr. të datës, pas mbajtjes së seancës së dëgjimit në praninë të Prokurorit të Prokurorisë Themelore të Prokurorit NN të pandehurit dhe mbrojtësit të tij av. NN nga NN, të datave NN dhe datën NN, morri këtë:

AKTVENDIM

³⁴ Ejup Sahiti, Rexhep Murati & Xhevdet Elshani: Vep.cit, fq.364.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Ndaj të pandehurit **NN**, nga i ati **NN** e ëma **NN**, e lindur, i lindur me datë **NN** në fshatin **NN**, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, student, i pa martuar, i gjendjes së memse ekonomike, shqiptar, shtetas i **NN** gjendet në ndalim nga data **NN** nga ora **NN**, tek gjyqtarja e procedurës paraprake është sjellë me datën **NN** në ora **NN** minuta.

REFUZOHET kërkesa e **PSH** për caktimin e paraburgimit **PP/II.nr.** të datës.

CAKTOHET MASA E DORËZANISË kundër të pandehurit **NN**, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par. 2 të **KP-së**, ashtu që i pandehuri **NN** obligohet që në emër të dorëzanisë të deponojë në arkën e gjykatës shumën prej 2.000/dymijë/euro.

Personi tjetër **NN** ka deponuar dorëzanimë në shumën prej 2.000/dymijë/euro, në emër të pandehurit **NN**.

Kuptim të nenit 181 par.3 të **KPP**, në rast se i pandehuri ikë me aktvendim të gjykatës caktohet që vlera e dhënë si dorëzani, derdhet në fondin për kompensim të viktimave.

Gjykata do të veprojë kuptim të nenit 182 lidhur me par.1,2,3,4 dhe 5 të **KPP**:

Arsyetim

Prokurori i Shtetit në **NN** me aktvendimin **PP/II.nr.** të datës, ka filluar hetimet kundër të pandehurit **NN** nga fshati **NN**, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par. 2 të **KP-sësë** dhe njëkohësisht ka parashtruar kërkesë për caktim të paraburgimit. Gjyqtari i procedurës paraprake duke vepruar sipas kërkesës për caktimin e paraburgimit ka caktuar seancën e dëgjimit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në **NN**, **NN** në seancën për caktimin e paraburgimit ka mbetur në tërësi pranë kërkesës për caktimin e paraburgimit me

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

arsyetim se duke pasur parasysh se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Arsyet për caktimin paraburgimit konsistojnë në bazë të dispozitave të nenit 165 par.2 nën par.2.4 dhe 2.5 pika 2.5.1 të KPP-ës, duke pas parasysh se i njëjti është shtetas i Maqedonisë dhe ekziston rreziku i arratisjes si dhe pika 2.5.2 duke pas parasysh se hetimet janë në fazën fillestare ende nuk janë dëgjuar i pandehuri, i dëmtuari dhe dëshmitarët dhe po që se i njëjti lihet në liri ekziston mundësia e ndikimit tek njëjtit dhe me këtë rast do të pengojë rrjedhën normale të procedurës hetimore.. Prokuroria konform nenit 164 par.2 nën par.2.6 para se të përcaktohet për këtë masë ka vlerësuar se masat tjera të parapara me nenin 173 të KPP-ës, por të njëjtat janë të pa mjaftueshme për të siguruar praninë e të pandehurit, duke e marr parasysh rrethanat e lartpërmendura, i ka propozuar gjyqtarës së procedurës paraprake që ndaj të njëjtit të caktojë masën e paraburgimit.

Mbrojtësi i të pandehurit NN, av. NN, në seancë në tërësi e ka kundërshtuar kërkesën për caktimin e paraburgimi duke propozuar gjykatës që ndaj të mbrojturit të tij të caktojë nmasën e dorëzarisë duke deponuar shumën prej 2.000 euro, të cilën do të paguajë menjëherë dhe se premtion se i mbrojturi i tij do ti përgjigjet çdo ftese të gjykatës.

Prokurori i Shtetit NN duke u deklaruar rreth propozimit të mbrojtësit për caktimin e dorëzarisë deklaroi se ia le në vlerësim të gjykatës rreth këtij propozimi.

Gjyqtarja e procedurës paraprake pasi që i ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe i ka dëgjuar pretendimet e palëve, ka ardhur në përfundim se kërkesa për caktim të paraburgimit nuk është e bazuar dhe konsideron se me masën e dorëzarisë mund të sigurohet prezenca e të pandehurit në procedurë dhe ndaj të pandehurit ka caktuar masën e dorëzarisë konformë nenit 179 par.1.p.1.dhe 1.2. të KPP, në lidhje me nenin 180 dhe 181 të KPP –së, sepse ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilat ngarkohet dhe duke pas parasysh faktin se i njëjti është student, hera e parë që ka ra ndesh me ligjin dhe faktin se i pandehuri ka premtuar gjykatës se nuk do ta përsërisë veprën penale dhe do ti përgjigjet çdo ftese të gjykatës dhe prokurorisë, andaj sipas vlerësimit të gjykatës caktimi i masës së dorëzarisë është i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për rrjedhën e kësaj procedure penale, sepse edhe me këtë masë do të arrihet të sigurohet prezenca e të pandehurit në procedurë

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

Masa e lartcekur do të jetë e mjaftueshme dhe do të sigurojë mbarëvajtjen e rregullte të procedurës penale pasi që eventualisht shkelja e kësaj masa ka edhe pasoja për të pandehurin- caktimin e paraburgimit, nëse i pandehuri mjetet – të hollat e deponuara do të derdhen në Fondin për kompenzimin e viktimave.

Nga arsyet e cekura si më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktvendimi kuptim të nenit 179 par.1 pika 1.1, 1.2, par.2 pika 2.4 dhe par.3 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË NN

Ppr.nr.të datës

B. Profesional

Gjyqtarja e procedurës paraprake,

NN

NN

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 24 orëve, përmes kësaj gjykate, Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

2.9 Heqja e dorëzarisë

Kur urdhërohet dorëzani sipas dispozitave të nenit 179 të KPPRK i pandehuri paraburgoset dhe dorëzania hiqet, nëse pas thirrjes me rregull ai nuk paraqitet dhe mungesën nuk e arsyeton, nëse përgatitet të ikë ose kur gjatë kohës sa është në liri paraqiten arsye të tjera ligjore për paraburgimin e tij. Kur urdhërohet dorëzania i pandehuri paraburgoset dhe shuma e dhënë si dorëzani me aktvendim derdhet në buxhet, kur ai ka përsëritur veprën penale për të cilën ai është kanosur se do ta kryejë, dhe i pandehuri gjithmonë njoftohet me kohë për pasojat e mosbindjes. Dorëzania hiqet kur procedura penale pushohet me aktvendim të formës së prerë ose me aktgjykim të formës së prerë.

Kur i pandehuri dënohet me burgim, dorëzania hiqet vetëm pasi ai të ketë filluar mbajtjen e dënimit, me heqjen e dorëzarisë, paratë e gatshme të

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

depozituara, letrat me vlerë, sendet me vlerë dhe pasuri të tjera të luajtshme me vlerë të konsiderueshme kthehen dhe hipoteka hiqet.³⁵

Një shembull i heqjes së dorëzarisë:

P.nr,

GJYKATA THEMELORE NË NN, Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues NN, me bashkëpunëtorin profesional NN, në çështjen penale kundër të akuzuarit NN nga NN, për shkak të veprave penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1 lidhur me par.3 të KPRK dhe përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK, duke vepruar sipas detyrës zyrtare lidhur me kthimin e dorëzarisë, e duke vepruar konform nenit 182 par.4 të KPPRK, me datë merr këtë:

A K T V E N D I M

I. HIQET dorëzania e caktuar ndaj të akuzuarit NN nga NN dhe atë në shumë prej 2.000,00 €/dymijë/euro, për shkak të përfundimit të procedurës penale me aktgjykimi të formës së prerë.

II. URDHËROHET që arkëtari i Gjykatës Themelore në NN, përkatësisht organi kompetent që dorëzanimin e deponuar në Gjykatën Themelore në NN, Departamenti për Krime të Rënda me datë ti kthehej të akuzuarit NN nga NN.

III. DORZANIA e deponuar nga ana e të akuzuarit do ti kthehet personalisht të akuzuarit NN nga NN.

A r s y e t i m

Kryetarja e trupit gjykues duke vepruar sipas detyrës zyrtare, ka marrë vendim për kthimin e dorëzarisë të akuzuarit sepse nga shkresat e lëndës rrjedh se

³⁵ Azem Hajdari: Kodi i procedurës penale, Prishtinë, 2016, fq.484-485.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

i akuzuari NN për shkak të veprave penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.1 lidhur me par.3 të KPRK dhe përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK, për këto dy vepra penale gjykata kuptim të nenit 80 par.2 pika 2.2 KPRK, ia ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1/një/viti e 6/gashtë/muajve, i cili dënim me burgim konform nenit 51 par.2 të KPRK, nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën e verifikimit prej 2/dy viteve nuk kryen vepër të re penale.

Me nenin 182 par.4 është parapare se dorëzania hiqet kur procedura penale pushohet me aktvendim të formës së prerë ose me aktgjykim të formës së prerë, kurse me paragraf 5 të këtij neni është parapare se me heqjen e dorëzanisë paratë e gatshme të depozituara, letrat me vlere, sendet me vlere dhe pasur të tjera të luajtshme me vlere të konsiderueshme kthehen dhe hipoteka hiqet.

Në rastin konkret nga shkresat e lendes dele se aktgjykimi e kësaj gjykate P.nr.132/15 i datës 15.07.2016, ka marrë formën e prerë me date 29.08.2016, janë plotësuar kushtet ligjore heqjen e dorëzanisë.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktvendimi konform nenit 182 par.4 dhe 5 të KPP.

Gjykata Themelore në NN

Departamenti i Krimeve të Rënda

P.nr. me datë

B. Profesional,
gjykues

Kryetarja e trupit

NN

NN

2.10 Arresti shtëpiak

Arrestimi shtëpiak është masë për sigurinë e të pandehurit në procedurë penale e cila konsiston në vendosjen e detyrimit ndaj të pandehurit që ai të mos largohet

nga lokali ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin apo nga institucioni publik ku ndodhet për trajtim ose përkujdesje.³⁶

Gjykata mundë të caktojë arrestin shtëpiak për të pandehurin nëse: ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale, dhe plotësohen kushtet që janë të përpara sipas kodit të procedurës penale se ka kryer veprë penale.³⁷

Gjykata mund ta kufizojë ose ta ndalojë kontaktin ndërmjet të pandehurit dhe personave me të cilët ai nuk jeton apo të cilët nuk janë të varur nga i pandehuri, përjashtimisht, gjykata mund t'ia lejojë të pandehurit që për kohë të caktuar të largohet nga lokali ku mbahet arresti shtëpiak, kur kjo është domosdo e nevojshme për përmbushjen e nevojave jetësore ose për kryerjen e ndonjë pune. Gjykata duhet për këtë ta njoftojë stacioni policorë në territorin e të cilit zbatohet masa gjykata vetë e mbikëqyrë zbatimin e masës së arrestit shtëpiak drejtpërdrejtë ose nëpërmjet policisë. Policia edhe pa kërkesë të gjykatës në çdo kohë mund të verifikojë zbatimin e masës së arrestit shtëpiak dhe pa vonesë e njofton gjykatën për çdo cenim të mundshme të masës.³⁸

Pas ngritjes së aktakuzës gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos në të gjitha rastet mbi vazhdimin e arrestit shtëpiak në bazë të propozimit të arsyetuar të prokurorit të shtetit. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij, kur i pandehuri ka mbrojtës, duhet njoftuar për propozimin brenda tre ditëve nga kalimi i afatit të aktvendimit aktual mbi arrestin shtëpiak. Personi në arrest shtëpiak përkohësisht i konfiskohet dokumenti i udhëtimit. Ankesa kundër aktvendimit mbi konfiskimin e përkohshëm të dokumentit të udhëtimit nuk e pezullon ekzekutimin.³⁹

2.11 Diversioni

I pandehuri i arrestuar për veprën penale për të cilën dënimi maksimal i paraparë është jo më shumë se një (1) vjet dhe i cili nuk ka dënime të mëparshme ose nuk ka marrë pjesë në diversion, mund ti caktohet diversioni

³⁶ Azem Hajdari: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2006, fq.171.

³⁷ Azem Hajdari: Kodi i procedurës penale, Prishtinë, 2016, fq.487.

³⁸ Ejup Sahiti: Vep.cit, fq.117-118.

³⁹ Azem Hajdari: Kodi i procedurës penale, Prishtinë, 2016, fq.488.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

sipas urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake. I pandehuri ose prokurori i shtetit gjithashtu mund të propozojnë diversionin. Nëse prokurori i shtetit pajtohet ose i propozon gjykatës masën e diversionit, gjyqtari i procedurës paraprake mund të pezullojë procedurën penale për një (1) vit dhe liron të pandehurin nën kushtet: kur i pandehuri duhet të bëjë kompensimin e arsyeshëm ndaj viktimës së veprës penale, nëse ka ndonjë, siç përcakton gjyqtari i procedurës paraprake, i pandehuri lajmërohet rregullisht në stacionin policor që është më së afërmi prej vendbanimit të tij, në intervalet e caktuara nga gjyqtari i procedurës paraprake, kur i pandehuri merr pjesë dhe përfundon këshillimin, trajtimin psikologjik, trajtimin nga abuzimi me substanca narkotike, arsimimin, ose veprimet e tjera të cilat konsiderohen të përshtatshme nga gjyqtari i procedurës paraprake, dhe kur i pandehuri vepron në pajtim me kushtet e përcaktuara nga gjyqtari i procedurës paraprake, procedura penale kundër të pandehurit pushohet nga gjyqtari i procedurës paraprakë gjatë muajit të dymbëdhjetë të diversiteti.

Nëse i pandehuri shkel kushtet e përcaktuara nga gjyqtari i procedurës paraprake, procedura penale rifillohet. Gjyqtari i procedurës paraprake, nëse është e nevojshme, mund të lëshojë urdhër arrest sipas Kodit të Procedurës Penale.⁴⁰

2.12 Paraburgimi

Paraburgimi është masë më e rëndë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale, ku zbatimi i kësaj mase shpie në kufizimin e lirisë së lëvizjes të personit të tillë, ku të pandehurit i kufizohet mundësia e realizimit të njëjës prej të drejtave themelore të njeriut e garantuar me të drejtën e brendshme dhe atë ndërkombëtare.⁴¹

Paraburgimi mund të caktohet vetëm nën kushtet dhe në pajtim me procedurat e parapara me Kodin e Procedurës Penale, dhe duhet të reduktohet në kohën sa me të shkurtër të mundshme. Kur i pandehuri mbahet në paraburgim, të gjitha organet që marrin pjesë në procedurën penale dhe organet që ofrojnë

⁴⁰ Po aty, fq.492-493.

⁴¹ Azem Hajdari: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2006, fq.171.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

ndihmën juridike detyrohen të veprojnë me nguti të posaçme. Paraburgimi hiqet dhe i paraburgosuri lirohet në çdo fazë të procedurës posa të pushojnë shkaqet e caktimit të tij. Me rastin e arrestimit, personi që i nënshtrohet paraburgimit informohet: gojarisht dhe me shkrim për të drejtat dhe me shkrim për të drejtat që i gëzon sipas Kodit të Procedurës Penale.⁴²

Arrestimin e personit të dyshuar e bënë policia, kur një person është kapur në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose është në ndjekje për veprën e kryer penale, policia ose çdo person tjetër që është i autorizuar ta arrestojë atë përkohësisht dhe pa urdhër të gjykatës. Arrestimi përfshinë momentin e kufizimit të lirisë së personit, ndërsa ndalimi përfshinë kohën e kufizimit të lirisë së personit të arrestuar prej momentit të arrestimit të tij deri të lëshimi i tij ose caktimi i paraburgimit me aktvendim të gjyqtarit të procedurës paraprake, por kjo kohë nuk mund të jetë më e gjatë se⁴³ dyzet e tetë orë.

Sipas dispozitave të nenit 187 të KPPRK parashihen shkaqet për caktim e paraburgimit kur gjykata mund të caktojë paraburgimin ndaj personit kur: Ekziston dyshimi i bazuar se ai ka kryer veprë penale, ekziston rreziku se ai do të fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij, ka arsye për të besuar se ai do asgjësojë, fshehe, ndryshoje ose falsifikojë provat e veprës penale ose kur rrethanat e posaçme tregojë se do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit ose bashkëpjesëmarrësit ose kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale etj.⁴⁴

Paraburgimi caktohet me aktvendimin me shkrim i cili përfshinë: emrin dhe mbiemrin e personit i cili paraburgoset dhe të dhënat e tij personale të njohura për gjyqtarin e procedurës paraprake, kohën e saktë të arrestimit, kohën e sjelljes të gjyqtari i procedurës paraprake, kohën e marrjes në pyetje për paraburgim, veprën penale për të cilën akuzohet, bazën ligjore për paraburgim, njoftimin për të drejtën në ankesë dhe arsyetimin e të gjitha fakteve vendimtare

⁴² Azem Hajdari: Kodi i procedurës penale, Prishtinë, 2016, fq.494-495.

⁴³ Ejup Sahiti: Vep.cit, fq.118-119.

⁴⁴ Azem Hajdari: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2006, fq.177.

që ka shkaktuar paraburgimin duke përfshirë arsyen për dyshin të bazuar se personi ka kryer veprë penale.⁴⁵

I pandehuri mund të mbahet në paraburgim më së shumti një (1) muaj nga dita e arrestimit në bazë të Kodit të Procedurës Penale, dhe pas kësaj kohe, ai mund të mbahet në paraburgim vetëm me aktvendim të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues me të cilin urdhërohet vazhdimi i paraburgimit. Para ngritjes së aktakuzës, paraburgimi nuk mund të zgjasë më shumë se katër (4) muaj kur procedura zbatohet për veprën penale të dënueshme me më pak se pesë (5) vjet burgim, tetë (8) muaj kur procedura zbatohet për veprë penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim.⁴⁶

Përfundime dhe rekomandime

Pas punës në hulumtimin dhe studimin e masave për praninë e të pandehurit në procedurë penale, pengimin e ri kryerjes së veprës penale dhe zhvillimin me sukses të procedurës penale, mund të konstatohet:

1. Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit, të trajtuara në këtë punim janë masa efektive dhe në të njëjtën kohë kufizojnë të drejtat e njeriut. Masa e cila është më e ashpër për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale është paraburgimi dhe njëkohësisht është masa e fundit për sigurimin e rrjedhës së suksesshme të procedurës penale (Rregulli 6.1 i Rregullave Standarde Minimale për Aplikimin Alternative të Dënimit me Burgim, të Kombeve të Bashkuara - “Rregullat e Tokios”). Ky standard është pjesë e parimit fundamental të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës për liri dhe siguri të personit, të paraparë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në Paktin Ndërkombëtarë për të Drejtat Civile dhe Politike.

⁴⁵ Azem Hajdari: Kodi i procedurës penale, Prishtinë, 2016, fq.503.

⁴⁶ Po aty, fq.506.

2. Dorëzania është masë e paraparë në KPP, e cila shërben si masë më e lehtë për tu arritur i njëjti qëllim sikurse masat tjera për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale. Prandaj, me qëllim të minimizimit të përdorimit të paraburgimit, Kodi Procedurës Penale parashikon masat më të lehta, në këtë rast, dorëzania do të shërbente për ta zvogëluar rrezikun e vazhdimit të kriminalitetit dhe të minimizoj rrezikun e ikjes. Gjithashtu, Kodi Procedurës Penale, i lejon gjykatës që t’ia ndalojë të pandehurit që t’i afrohet vendit apo personit të caktuar, e obligon atë që të paraqitet në stacionin policor apo ta vendos atë në arrest shtëpiak.
3. Sipas Paktit Ndërkombëtarë për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të gjithë personat e paraburgosur duhet të kenë të drejtë t’a kontestojnë ligjshmërinë e arrestimit dhe paraburgimit të tyre në çdo kohë. Pos kësaj, parashihet që personi për të cilin është vërtetuar se ka qenë viktimë e arrestimit dhe paraburgimit arbitrar, ka të drejtë të plotfuqishme të kompensimit.

Nga konkluzionet përfundimtare të këtij punimi mund të nxirren këto rekomandime kryesore.

- *Secili ka të drejtë të lirisë dhe sigurisë;*
- *Askush nuk duhet të jetë subjekt i arrestimit dhe paraburgimit arbitrar;*
- *Askujt nuk duhet t’i privohet liria përveç për arsye të caktuara dhe në pajtim me procedurën e caktuar që është vendosur me ligj.⁴⁷*

Në frymën e akteve ndërkombëtare paraprake, do të ishte e preferueshme që paraburgimi të shqiptohet s’i masë e fundit në raport me masat tjera të parapara në KPP.

Literatura

1. Azem Hajdari: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2006.

⁴⁷ Neni 9 (paragrafi 1) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; Neni 5 paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Justicia, nr. VI- Revistë shkencore juridike e prokurorëve të shtetit të sapo emëruar 2016/2017

2. Azem Hajdari: Kodi i procedurës penale - Komentari, Prishtinë, 2016.
3. Ejup Sahiti, Rexhep Murati & Xhevdet Elshani: Komentari i Kodit të Procedurës Penale, Prishtinë, 2014.
4. Ejup Sahiti: E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005.
5. Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (G.Z., nr. 37/2012).
6. Konventa Evropiane për Mbrojtjen të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, 1950
7. Pakti Ndërkombëtarë për të Drejtat Civile dhe Politike, 1966.

